

PSE NUK U NDËRTUA FRONTI PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS

Mr. Muhamet Kelmendi
Redaktore: Ada Hyso
Lektor: Skënder Zogaj
Arti grafik: Ana Hyso
Shtëpia Botuese „ILIRIA“ Tiranë, 1999

Hyrje

Çështjet që do të shqyrtohen këtu, kanë të bëjnë me organizimin politik e ushtarak të lutes në Kosovë. Ne njëherë anë, do të flitet për vetë subjektin politik e ushtarak (LPK-në dhe UÇK-në), ndërsa, ne anën tjetër, për subjektet politike legale, etj. Vetë ideja për ndërtimin e sistemit çlirimtar është e bazuar në programin e LPK-së. Kjo organizatë deri në maj 1998, bëri çka mundi për të ndërtuar Frontin Çlirimtarë Kosovë. Por, për të kuptuar këtë, do të ndalemi në anën historike të UÇK-së, të punës së saj dhe të lidhshmërisë me LPK-në, si subjekt krijues dhe udhëheqës i kësaj force ushtarake. Lidhur me këto çështje është shkruar, diskutuar e folur mjaft. Ka shkrime shumë pozitive, sikundër që ka edhe të kundërta me te, përkatësisht négative. Ka të tilla që ende nuk e kanë kapur si duhet atë, ndonëse çështja ka shkuar aq para, sa që tani me ka kaluar në subjekt individual politik e ushtarak, mbi të cilën po e ndërton jetën shoqërore. Çështjet që do të shtrohen dhe shqyrtohen në këtë vepër, nuk janë gjë tjetër veçse përshkrim i punës së madhe shumëvjeçare për organizimin dhe ndërtimin juridik e politik të luftës çlirimtare në Kosovë. Kuptohet se qëndrimet e vendimet e marra nga organet udhëheqëse, mbi organizimin tonë ushtarak e politik nuk i kam, sepse ato kanë mbetur në sekretarinë e LPK-së, si subjekti që e ka organizuar atë punë, por unë do të mbështetem në të dhënat që i kam shënuar gjatë punës sonë. Kënde, do të fus edhe disa letra, kërkesa e vendime origjinale, të cilat në një kopje kanë mbetur tek unë, origjinale siç janë, ndërsa disa të tjera vetëm do të përmenden. Është e kuptueshme se një analizë e tillë e punës sonë në fushën ushtarake, shumëkujt nuk do t'i shkonte përshtati, sepse këtu do të theksoj edhe emra të cilët janë të lidhur me çështjen tonë, me atë të UÇK-së dhe të luftës në Kosovë. Gjatë këtij shqyrtimi del gjendja, prandaj edhe për atë, do të përpiqem të jap fakte konkrete të cilat nuk do të priten mirë nga disa, ndërsa nga disa të tjerë, ndoshta edhe do të kërcënohem, sepse do t'i theksoj bash në realitetin ekzistues të kohës. Në librin tim me kujtime nga UÇK-ja do të përpiqem të ndriçoj anën politike, atë juridike dhe ushtarake-çlirimtare të veprimtarisë sonë deri në maj të vitit 1998, duke u mbështetur në punën e Kryesisë dhe të KP të D.j.v. që është bërë për të krijuar tabanin politik e juridiko-ushtarak dhe atë shtetëror për krijimin, organizimin e ndërtimin e UÇK-së. Duke e kapur këtë çështje me kaq rëndësi, do të dalë vetiu dhe koha e lindjes së saj, emërtimi dhe zhvillimi e pengesat e shumta të krijuara në terren dhe në forumet tona politike. Ndërsa, një pjesë e veçantë i kushtohet gjendjes duke nxjerrë edhe përfundime mbi pasojat dhe perspektivën e çështjes. Një çështje po aq e rëndësishme sa edhe vete krijimi i saj është padyshim edhe mbrojtja politike e juridike e UÇK-së nga LPK-ja, sikundër dhe ajo morale e diplomatike, që iu bë aksioneve të saj kudo në bote, pa dalë si krah ushtarak i LPK-së, ndonëse ishte e tillë dhe për vetë shkakun se LPK-ja ishte për ndërtimin e sistemit politik shtetëror (Frontit Çlirimtar të Kosovës) me të gjitha subjektet politike e organizative në vend. Veç kësaj, do të përpiqem me fakte të tregoj shkakun e krijimit të fondit "Vendlindja Thërret", si bazë e forte financiare për UÇK-në, e cila u krijua nga Kryesia e Degës j.v. të LPK-së dhe KP i saj, si formë e financimit të luftës brenda në Kosovë. Këtu do të flas edhe për raportet me subjektet politike e organizative në Kosovë, Shqipëri si dhe me qeverinë e Bukoshit, lidhjet e kontaktet me te, sepse as këto nuk mund të kalohen pa u shqyrtuar, pasi jo vetëm që nuk ka pasur bashkëpunim politik, por as financiar. Kjo gjë ka

shpënë tek forcimi i fondit tonë "Vendlindja Thërret". Qeveria e pati kundërshtuar edhe unifikimin, (bashkimin) në sistem, të fondit "Vendlindja Thërret". Po aq e rëndësishme është te kapet pikërisht çështja jonë edhe ne dritën e pikësnyimit të LPK-së për ndërtimin e sistemit politik e juridiko - shtetëror në Kosovë (Frontit Çlirimtar në Kosovë), si formë për te ecur në luftën tonë te madhe çlirimtare. Njëpërmjet tyre do të ndalem tek puna, aktiviteti dhe pengesat për ndërtimin e këtij sistemi. Këtë do ta përcjell edhe me disa letra që Kryesia u ka dërguar subjekteve dhe UÇK-së, të cilat i kam në pika te shkurtra, përkatësisht projektet e tyre të cilat ia pata paraqitur organeve udhëheqëse për t'i miratuar. Ato qenë dërguar në emër të LPK-së. Natyrisht, në këtë libër do të bëhet fjalë edhe për grupin politik (klikën) e krijuar në kuadër të LPK-së e UÇK-së, si dhe për faktorët që kanë ndihmuar në ndërtimin e klikës së tillë, jashtë sistemit tonë të përcaktuar në programin e LPK-së, që mori nën kontroll UÇK-në. Nuk do të lihet pa u vënë në shqyrtim edhe roli i subjekteve politike në Kosovë,, sidomos i disa politikanëve, të cilët bënë çmos të mos lejonin ndërtimin e saj, kuptohet, për shumë fakte, po mbi të gjitha nga pozitat e tyre karriériste, bajraktarë, financiare e frikacake, sepse ai sistem kërkonte kalimin tonë në vendin e çliruar duke qenë të lidhur me popullin. Po këtu do të shqyrtohet edhe roli i Tiranës zyrtare që në periudhën 1997-98, ishte mjaft negativ dhe pengues. Një punë jashtëzakonisht negative ka qenë lufta për të mos e ndërtuar Frontin. Në këtë anë, ka punuar vëte grupi politik i UÇK-së, Kryesia Teknike e Degës së LPKj.v. dhe klika e ndërtuar nga ana e tre anëtarëve të Kryesisë së vjetër për të mbizotëruar UÇK-në jashtë sistemit. Për të arritur formën e tashme të organizimit dhe këtë klikë e tillë, ata krijuan grupe akuzuese ndaj Kryesisë së vjetër, duke e ngarkuar atë me akuza të pavërteta dhe pa fakte mbi vrasjen e shokëve në Kosovë. Çdo gjë u vërtetua, sepse botërisht ishte treguar se ata kanë rënë në përleshje e sipër me pushtues, si në Vushtrri në janar të vitit 1997, kur ranë tre heronjtë e kombit tonë. Veç kësaj, bënë bllokimin politik të UÇK-së dhe me shpejtësi, duke u ndihmuar nga Kryesia Teknike e Degës së LPK-së jashtë vendit, e cita nuk ftoi për me se tre muaj asnjë mbledhje të KP e LPK-së, u devijuan përcaktimet politike dhe u ndërtua baza aktuale politike e UÇK-së, jashtë sistemit politik të përcaktuar në Front Çlirimtar, si dhe nuk lejuan lidhjet me te. Nuk kam dëshirë që ky punim të keqkuptohet, në mënyrë që nga ai të kalohet në hakmarrje fizike, ndonëse as asaj nuk i frikësohem. Por, jam i mendimit se ata që do të vihen në spikamë, nëse kanë prova të paraqesin mendimet e veta dhe po ashtu të vihen në ballafaqim faktet, në mënyrë që lexuesi t'i peshojë faktet pa qenë nën presion. Kjo është demokratike.

KAPITULLI I

ORGANIZIMI USHTARAK (UÇK) NË KOSOVË

Gjatë tërë historisë, populli shqiptar ka luftuar për çlirimin e vet kombëtar. Ai u kacafyt me armiq të shumtë, duke u përleshur e luftuar, në mënyrë që të çlirohet nga pushtuesit, ata që e kishin pushtuar me arme dhe me dhunë e terror e mbanin nën okupimin barbar. Nga luftërat e gjata të popullit tonë doli shteti shqiptar, por i përgjysmuar. Shqipërisë iu shkëputën vise të tëra, të pastra shqiptare. Nga trangu i atdheut ndanë Kosovën dhe shumë vise të tjera, të pushtuara nga Maqedonia, Serbia e Mali i Zi, Greqia, të cilave edhe ua aneksuan. Mirëpo, përkundër ndarjes, populli ynë e vazhdoi luftën e tij çlirimtare. Pas LDB-së ai luftoi pandërprerë kundër pushtuesve serbo-jugosllavë. Me arme në dorë dhe nëpër rrugët, sheshet e malet e Kosovës, u ndesh me armikun dhe luftoi për çlirimin e vet. Nga dhuna e terrori i ashpër serbomadhi u mbytnë me mijëra e mijëra shqiptare. Ndërsa, me qindra e mijëra të tjerë, fëmijë e gra, burra e pleq, u dëbuan nga trojet e veta shekullore. Kjo dhunë e ashpër, terror e masakrim çnjerëzor nuk e ndali kombin tonë nga rruga e lirisë, por përkundrazi, ai dhjetëvjeçar pas dhjetëvjeçari, pas çdo goditjeje u riorganizua, duke dalë edhe më i forte se

me pare. Natyrisht, edhe armiqtë e thelluan luftën dhe ndjekjet kundër kombit tonë, masat e dhunës dhe terrorin shtetëror. Ky veprim i ashpër i armikut, i kombinuar me masa dhunuese e terror fashist nga bazat shtetërore, te papara ne histori, parashtrori detyrën e organizimit te popullit tonë konform kushteve dhe rrethanave te krijuara te luftës për ekzistencë fizike e shoqërore. Ky pushtim mund te luftohej vetëm me organizimin ne përputhje me normal e ligjshme politike për te luftuar për liri, pavarësi e vetëvendosje kombëtare, forma këto te lejuara me akte ndërkombëtare. Organizimin ushtarak te Kosovës e paraqiti koha si kusht te domosdoshëm, pa te cilin kombi ynë nuk do te mund te luftonte me te gjitha mjetet dhe format për çlirimin vendit, për pavarësi e demokraci, për një shtet te pavarur te Kosovës.

Por, për te ardhur deri tek ky organizim politik e ushtarak natyrisht që kishte vështirësi te mëdha juridike, portikë e te karakterit kushtetutor. Këto vështirësi e pengesa u tejkaluan, sepse, vetë kompetentët sipas dispozitave kushtetutore nuk e organizuan atë punë. Kështu, u fitua ligjshmëria dhe, me punë e angazhim te madh te LPK-së, u organizua subjekti ushtarak ne Kosovë mbi bazat e dispozitave kushtetuese te shtetit. Subjekti ushtarak (UÇK) u emërtua nga organizatori i këtij subjekti, përkatësisht Kryesia e KP te LPK-së, Dega j.v., e cila e pati edhe përgjegjësinë politike, morale e diplomatike përballë këtij subjekti, kombit e organizmave ne bote. Ky subjekt ushtarak kishte edhe normat e përcaktuara për ndërtimin e Frontit Çlirimtar te Kosovës dhe e financonte atë me vetkontributin e anëtarëve. Me ndihmën e LPK-së u ndërtua, u dha kahja e aksioneve dhe u financuan njësitë e para te Ushtrisë Çlirimtare te Kosovës. Ne atë kohë (vitet 1990-1993) ende nuk ishte ky emërtim, por njësitë ushtarake siç ishin organizuar edhe vepronin. Atyre iu dhakahja politike e luftës çlirimtare te kombit tonë, duke krijuar bazën politike.

1. Bazat politike e juridike-organizative te UÇK-së

Duke u mbështetur ne dokumentet e organizatës, ne programin edhe ne statutin e LPK-së, në rezolutat dhe ne vendimet që dolën nga mbledhja e Pare dhe e Dytë, si dhe e Tretë në përgjithshme e LPK-së (vitet: 1987, 1989 dhe 1991), para organeve udhëheqëse te LPK-së, sidomos Kryesisë se KP-së, qoftë brenda qoftë jashtë vendit, u paraqit nevoja e organizimit te një subjekti ushtarak që do te fuste ne veprim te gjitha format dhe mjetet demokratike e ligjore te luftës, për te çliruar vendin dhe për te realizuar bashkimin kombëtar te popullit shqiptar, aspiratë historike e kombit tonë (*Dokumentet e LPK-së deri ne MP te Trete*).

Shumë herët u punua ne këtë fushë. Për te ndërtuar një ushtri u mbështetëm ne vijën politike te LPK-së dhe ne dispozitat juridike te kësaj organizate te popullit tonë. Ne organet udhëheqëse te kësaj organizate (ne Kryesi) nxorëm edhe sektorët për te gjitha sferat e veprimtarisë sonë çlirimtare, nga ato politike e juridike, deri tek sektori ushtarak, etj. Mirëpo, për te arritur këtë organizim ushtarak dolën edhe shumë detyra te mëdha ne fusha te ndryshme, sidomos ne ato politike, juridike e luftarake te cilat duhej te rregulloheshin, ne mënyrë që te arrihej tek organizimi i një subjekti ushtarak. Këto çështje e preokupuan me vite te tëra Kryesinë e LPK-së.

a) Çfarë kishte sanksionuar LPK-ja

Siç dihet, LPK-ja ishte vete e përcaktuar si organizate çlirimtare. Ne programin e saj thuhej: "Populli shqiptar lufton për te arritur çlirimin e Kosovës dhe formimin e shtetit te pavarur që do te përfshijë te gjitha trojet e veta nën pushtim, ku shqiptarët janë shumicë" (...).

Ndërsa për te arritur këtë pikësynim ishte sanksionuar: "Për te arritur pikësynimet kombëtare, çlirimin e vendit, LPK-ja do te përdorë te gjitha format e luftës çlirimtare: demokratike,

paqësore dhe te kryengritjes se armatosur çlirimtare" (Programi i LPK-së). Këto dy përkufizime juridike ishin bazë e veprimtarisë sonë politike e juridike ne kuadër te luftës për çlirimin e vendit. Megjithatë, me kalimin e kohës ne aspektin ushtarak, përveç ne atë politik e organizativ, LPK-ja u stërkeq dhe nuk kishte mundësi veprimi. Këtu ndikoi jeta plurale ne vend, përkatësisht krijimi i një numri te madh te partive politike. Dalja ne skenë e këtyre partive si dhe përpjekja që te bëhej rezistencë për ekzistencën juridike e organizative te LPK-së, bëri që ky pikësypnim programor te neglizhohej dhe gradualisht LPK-ja te kalonte ne parti politike. Ajo nuk u legalizua tek organet si parti, por veprimtarinë e vet, ne fakt e kishte te tille. Ndonëse e legalizuar ishte si organizatë, vetëm emërim e kishte te tille. Kështu jeta e organizatës u dyfishua. Pas mbajtjes se Mbledhjes se Përgjithshme te Tretë ne vend, ne vitin 1991, ajo përfundimisht e humbi karakterin e vët çlirimtar. Ne mbledhje brenda vendit u përcaktua vetëm karakteri politik i organizatës, si subjekt gjoja "legal". Për atë shkak mbetën disa këshilla jashtë ingranazheve te saj, sepse nuk e pranuan atë legalizim. Ndërsa, ne botën e jashtme, ende u mbajt ne jetë kombinimi i formave legale me ilegale te veprimtarisë, por ne fakt, përballë subjekteve politike shqiptare dilte si subjekt legal. Kjo ne një anë dhe, ne anën tjetër neglizhimi i udhëheqjes se dalë brenda vendit për te vazhduar punën, për çka edhe Kryesia dha dorëheqje, bënë që tërë aktiviteti i LPK-së brenda dhe jashtë, përsëri te kalonte ne botën e jashtme, tek Dega j.v. Ne fakt ky ishte edhe vendimi i LPK-së. Nëse baza jonë atje mbetej pa organe udhëheqëse, detyrat e saj t'i kalonin Kryesisë jashtë vendit. Pushimi faktik i veprimtarisë se saj brenda vendit, e nxori Kryesinë e LPK-së, Dega j.v. para një akt te vështirë. Kësaj i duhej te punonte ne dy fronte: se pari, ne drejtim te zgjerimit te radhëve te LPK-së brenda vendit dhe, se dyti, ne drejtim te krijimit te bazës politike e juridike, për te organizuar një force ushtarake për te luftuar për çlirimin e Kosovës. Ne fakt, njësitë e para vetëm sa ekzistonin. Ato lindën nga ish-këshillat popullore ne vitet '90-'91, atëherë kur, pas dorëheqjes se Kryesisë u stërkeq organizata brenda vendit dhe shumë këshilla kaluan vetvetiu ne njësi ushtarake çlirimtare. Por, kjo forme nuk mjaftonte për një luftë çlirimtare. Duhej te punohej ne krijimin e bazës politike e shoqërore, përkatësisht te platformës se subjektit që krijohej. Kjo ishte përcaktuar politikisht vetëm nëpër mbledhjet e përgjithshme te organizatës. Baza juridike e politike ishte ndërtimi i një Fronti Çlirimtar te Kosovës, me bashkimin e te gjitha subjekteve shqiptare, pa dallim pikëpamjeje politike, ideje, krahine a vendi, por që janë për çlirim. Përfundimisht bënte vetëm baza tradhtare. Kjo ishte e sanksionuar ne dokumente te LPK-së. Edhe ne mbledhjet e LPK-së, kuptohet, ato te përgjithshme, sidomos ne Mbledhjen e Dytë dhe te Tretë te Përgjithshme, te organizuara ne botën e jashtme, u nxorën edhe disa rezoluta ku tregohet baza politike e shoqërore dhe bëhej detyrë parësore e LPK-së, përkatësisht e udhëheqjes se saj, ndërtimi i një subjekt ushtarak, jashtë radhëve te LPK-së.

Kjo duhej te luante vetëm rolin e udhëheqjes, kuptohet ne anën politike, juridike, diplomatike dhe ta financonte atë. Prej kësaj, madje para shpërthimit te lutjes se armatosur, ishte përcaktuar ndërtimi i Frontit Çlirimtar te Kosovës, si forma e mjeti i vetëm për te çliruar Kosovën nga pushtuesit shekullor.

Mbi këtë bazë u kalua ne krijimin e bazës juridike për organizimin e njësite ushtarake. Që ne vitet 1991-1992 u vendës ne Kryesi platforma politike për subjektin e ri. Me atë bazë parashiheshin format e mjetet e luftës te cilat, përveç atyre pasive e aktive, përfshinin edhe mjetet çlirimtare për çlirimin e Kosovës. Kryesia e pranonte jetën pluralë ne vend dhe ndërtimin demokratik te shtetit te Kosovës. Këtij përkufizimi politik te paraqitur nga Sektori politik e juridik i organizatës i mungonte vetëm ana juridike. Për këtë shkak, si sektor u mbështetëm ne rezolutat e MP te LPK-së dhe mbi atë bazë nxorëm vendimin për organizimin dhe ndërtimin e subjektit te ri. Ky ishte vetëm një përforsim juridik i vendimit për subjektin e ri, i cili ishte duke u organizuar (Vendimet dhe Rezolutat e LPK-se Dega j.v. të MP te Tretë).

b) Baza organizative për ndërtimin e UÇK-së

Detyrë tjetër që doli para organit tonë ishte gjetja e firmave për te dalë nga gjendja që u krijua brenda vendit. Degës jashtë vendit i duhej te merrte rolin udhëheqës, jo vetëm për ndërtimin eradhëve te saj brenda vendit, por edhe te subjektit ushtarak.

Mbledhjet e LPK-së e përcaktuan këtë lloj organizimi, sepse brenda vendit, pas MP te tretë te saj, vitin 1991, u larguan Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Gani Sylja, etj, nga udhëheqja, madje Gani Sylja edhe si kryetar. Kësisoj, mbetën radhët pa udhëheqje, gjë që i kaluan kompetencat e saj tek udhëheqja e LPK-së jashtë vendit. Kjo ndodhi për shkak se ky grup pati kërkuar zyrtarisht te dilej me deklarinimin për te shpallur LPK-në inekzistente (*Raporti informativ i Grupit te Organizimit te LPK*). Ndërsa, si arsytim jepej se, kjo organizatë gjoja ishte e tepërt ne jetën plurale te Kosovës, LPK-ja si organizatë ilegale e kishte kryer detyrën e vet politike e shoqërore dhe se, tash ishin partitë légale që vepronin ne vend. Ne kohën që po diskutojmë, Kryesia e Degës j.v. përbëhej prej Kryetarit Fazli Veliu, Nënkryetarit Muhamet Kelmendi, Sekretarit Emrush Xhemaili, Përgjegjësit Financiar Gafurr Eishani dhe anëtarëve: Ali Ahmeti, Xhavit Haliti dhe Agush Buja, që ne MP te katërt u zëvendësua me Adem Grabovcin. Si Kryesi e KP te LPK-së Dega j.v. e zgjedhur pas MP te Tretë mori tërë aktivitetin e LPK-së. Nga ky moment iu futëm punës si Kryesi për një organizëm tjetër ne fushën ushtarake, krahas vazhdimet te punës për ndërtimin e LPK-së e cila parashikohej si bazë politike (Shënimet nga ditari i MK). Mirëpo, për te kryer detyrat që shtronte koha, si organ i tërësishëm, vetëm me mbledhjet tona te organizatës, që ishin sanksionuar edhe ne program, ishte e pamundur. U desh te grimcoheshin punët dhe te zgjidheshin sektorët për çdo fushë e veç e veç. Ne fakt, sektorët i kishim për veprimtarinë tonë te brendshme që nga vitet 1987, por tash lypsej rregullimi i tyre juridik dhe profesionalizimi i kuadrit ne to.

Ne këtë kohë nxorëm disa sektorë:

1. Sektori politiko-juridik me udhëheqës Muhamet Kelmendin, anëtarë Fazli Velion dhe Emrush Xhemailin, i cili ishte kompetent për anën politike dhe juridike. Ky sektor nxirrte projektvendime, rezoluta, qëndrime e rregullore dhe i paraqiste para organeve për miratim.

2. Sektori për organizimin e radhëve te LPK-së brenda vendit, që kishte udhëheqës Emrush Xhemailin, ndërsa anëtarë Gafurr Eishanin dhe Ali Ahmetin. Këtij sektori i ndihmonte edhe Xhavit Haliti. Ky ishte sektor që duhej te gjente radhët brenda vendit dhe te strukturonte organizatën tonë atje.

3. Sektori i rëndësisë se veçantë, me udhëheqës Xhavit Halitin dhe anëtarë Ali Ahmetin dhe Emrush Xhemailin. Këta ishin përcaktuar si ndërlidhës midis Kryesisë dhe radhëve te njësive çlirimtare. Ky sektor përcillte vendimet e qëndrimet tona atje dhe anasjelltas, te atyre tek ne. Merrej edhe me gjetjen e forcave te reja çlirimtare ne Kosovë (Shënimet nga ditari i MK).

Kishim edhe sektorë te tjerë, si sektori diplomatik me udhëheqës Rexhë Ibërdemaj dhe propagandistik me udhëheqës Fazli Velion. Edhe këto i kishin te përcaktuara kompetencat e veta. Pastaj, ishte sektori financiar, për agjitacion, mërgimtar, etj. Te gjithë këta sektorë vepronin ne kuadër te Kryesisë se Degës jashtë vendit. Vjen këtu te përmendet edhe puna e madhe për gjetjen e formave te organizimit. Një punë te madhe për këtë ka kryer një ekspert nga Tirana, i cili na pati ofruar materialin e organizimit te

kësaj veprimtarie, material që e shqyrtoam dhe e vumë ne bazë te organizimit tonë. Ky u mor edhe me aftësimin e kuadrit tonë për këtë detyrë te madhe kombëtare. Mbi këtë material i dhe Kryesia edhe kahet e organizimit, duke u mbështetur ne format e organizimit te njësive ushtarake te vogla, pa numër te madh, ne konspiracion dhe nxori vendimet për mënyrën e veprimtarisë se tyre. Ne Kryesi u diskutuan edhe kahet e veprimit ushtarak. Ndërsa, u vendos që brenda vendit te shkohej vetëm tek ish-anëtarët e LPK-së, tek te burgosurit dhe tek ata që njiheshin për sakrifica, trimëri dhe me vetëdije kombëtare, te paimplikuar ne veprimtari destruktive dhe që ishin treguar me vepra lugëtarë te zotë te çështjes kombëtare.

Krahas kësaj, ne Kryesi u diskutuan edhe format e veprimtarisë ushtarake te njësive që

organizoheshin, forma këto që i jepnin karakter politik veprimtarisë çlirimtare, duke dhënë kahet e saj, objektivat dhe forcën juridike të veprimtarisë. Për këtë nga sektori politik e juridik iu propozua Kryesisë së LPK-së të nxirrej ky vendim: "Njësitë ushtarake çlirimtare duhet të organizohen në njësi të vogla ushtarake, me konspiracion dhe disiplinë të rreptë. Ato kanë të drejtë të teprojnë vetëm kundër forcave pushtuese të armikut, njësive policore e ushtarake të pushtuesit dhe objekteve me rëndësi ushtarake e shtetërore. Në punën e sipër duhet të zgjerohen dhe të riorganizohen.

Në punën e vet çlirimtare, njësitë nuk guxojnë të kryejnë aksione kundër popullsisë civile fëmijëve e grave, në vendet publike dhe kundër objekteve social-kulturore, etj. Kjo për shkak se, nëpërmjet kësaj kalohet dhe vlerësohemi në ushtri "terroriste", akuzë të cilën pushteti i Beogradit po e përdor kudo, në bote dhe brenda vendit" (Projektvendimi i LPK-së). Ky vendim u aprovua njëzëri.

Megjithatë, ky vendim paraqiti për detyrë dhe po në këtë mbledhje u vendos, që në të ardhmen, të shkohej kah rregulli juridik i subjektit që po organizohej, kuptohet me akte normative e me dokumente tjera. Në Kryesi u kërkua që të ushtroheshin anëtarët që do të futeshin në këtë subjekt ushtarak dhe, të gjendeshin e të punohej edhe me forcat ushtarake, oficerët shqiptarë në Shqipëri, që ishin aktivë a të pushuar nga puna dhe me oficerët shqiptarë nga Kosova, që gjendeshin nëpër vendet e ndryshme në bote. Me vonë krijuam edhe grupe të veçanta të punës për çështjet e tilla, përkatësisht sektori për punë me oficerë si dhe për çështje të tjera të rëndësishme për luftën tonë çlirimtare.

c) Baza politiko-juridike për ndërtimin e UÇK-së

Pas nxjerrjes së vendimeve politike në Kryesi, u kalua në realizimin e tyre juridiko-politik. Ky organ shkoi kah gjetja dhe dhënia e bazave politike e juridike, si për organizimin, ashtu edhe për aktivitetet dhe veprimtaritë e tjera të saj, mbi të cilat duhej të ndërtohej ushtria jonë. Çështje që domosdoshmërisht duhet të përmendet, është qëndrimi unanim i atëhershëm i Kryesisë së Degës j.v. për disa çështje politike, juridike e ushtarake, mbi të cilat u punua. Veç kësaj, u përcaktuan edhe disa parime, të cilat duhej gradualisht të zgjidheshin nga ana jonë, në bashkëpunim me organet që do të dilnin nga njësitet çlirimtare të Kosovës, pra bashkimi politik e ushtarak në Front. Kryesia e Degës pati vendosur mbi disa çështje, mbi të cilat u punua deri në vitet 1997-1998.

a) Ishte vendosur që shtrirja territoriale e njësive të ishte në gjithë territorin shqiptar të pushtuar nga ish Republika Jugosllavisë, sepse në atë kohë ato nuk ishin ende shtete të pavarura, ndonëse ishte marrë vendimi që aksionet në Maqedoni dhe në Mal të Zi të kryeshin vetëm me urdhër të Kryesisë, pavarësisht nëse ekzistonte bashkësia shtetërore apo jo (Jugosllavia). Kjo duhej të bëhej duke i analizuar rrethanat në tërësi, qoftë të brendshme, qoftë të jashtme, prej nga duhej të vendoste edhe për subjektin që do t'i merrte në përgjegjësi aksionet çlirimtare në këto republika jugosllave.

b) Sanksionimi juridik i njësive ushtarake me emërtim të subjektit dhe me nxjerrjen e statutit të saj juridik, forme e cila ndalonte kalimin apo rrëshqitjen e njësive ushtarake në njësi të pavarura jashtë kontrollit politik, duke e ndërtuar atë juridikisht. Kjo, për faktin se, pa rregulla të tilla, ato mund të pavarësoheshin shumë lehtë dhe nga ndonjë situatë edhe të shndërroheshin në subjekte të pavarura. Ato, kështu, mund të kryenin edhe aksione të paparamenduara të cilat mund të vlerësoheshin terroriste dhe kështu, të dëmtohej lufta jonë çlirimtare, që me program i luftonte këto forma veprimtarie, përveç atyre çlirimtare.

c) Ndërtimi i Frontit Çlirimtar të Kosovës si forme e mjetit të vetëm për të bërë të mundur bashkimin e tërë forcave shqiptare, të subjekteve politike e shtetërore, të njerëzve me influencë, pa dallim përkatësie fetare, bindjeje ideologjike e vendit ku shtrihet veprimtaria, në luftë për liri, pavarësi e shtet, si forme që i jepte luftës sonë karakter kombëtar unik, prej nga

edhe krijohej tabani politik e juridik, që do te shpinte kah institucionalizimi i luftës dhe fora jonë çlirimtare (UÇK) shndërrohej ne ushtri te shtetit.

d) U hap Fondi "Vendlindja Thërret" si fond që i dedikohej kryesisht njësive çlirimtare. Ky fond, fillimisht u fut ne kuadër te sektorit financiar që e udhëhiqte Gafurr Eishani. Kështu vazhdoi deri ne vitet e me vonshme (1994-1995), kur me propozimin e Kryesisë; KP i LPK-së Dega jashtë vendit zgjodhi përgjegjës një shok te KP-së, Jashar Salihun dhe nëpër shtete e nëndegë përgjegjësit e tjerë te fondit. Që te gjithë i përgjigjeshin sektorit financiar te Kryesisë se KP te LPK-së, përkatësisht përgjegjësit te tij. Ndërsa, financimi bëhej nga baza detyruese e anëtarëve, duke dhënë nga një mijë e me shumë DM. Ka pasur raste kur vetëm Kryesia (anëtarët) kanë dhënë mbi 30-40 mijë DM për njësitë e UÇK-së (Vendimet e Kryesisë se KP eLPK-së D.J.V., maj 1993).

Për te gjitha këto detyra ishin sektorët e veçantë te punës. Çdo sektor e kishte lëmin e vet dheato filluan nga puna ne aspektin juridik. Shpejt u nxorën rregulloret nga Kryesia dhe u futën ne fuqi. Udhëheqëse mbeti Kryesia e LPK-së. U rizgjodhën edhe përgjegjësit për çdo sferë te veprimtarisë. Prandaj, me krijimin e këtyre bazave politike ne organizatë u kalua ne fushën,

ku, ne mënyrë profesionale, kryheshin detyrat ne lëmi të e veçanta. Kjo shënon edhe fillimin e punës profesionale.

Ky organizim krijoi tabanin juridik e politik për ndërtimin e njësive çlirimtare, te cilat me vonë u lidhën njëra me tjetrën organizativisht, ne strukturë dhe ne komandë dhe u ndanë edhe zonat e veprimtarisë ushtarake ne vend. Ne vitet e ardhshme u emërtua kjo force çlirimtare dhe u ndërtuan zonat dhe Shtabi Qendror i saj.

2) Njësitet e para çlirimtare ne Kosovë, financimi, emërtimi dhe ndërtimi juridik i UÇK-së

Krahas përcaktimit politik e juridik te platformës se njësive çlirimtare ne Kosovë, u punua me te madhe edhe ne ndërtimin e strukturës se tyre. Them i njësi, sepse këtu fjala është për vitet1990-1993, para se ky subjekt te emërohej ne "Ushtri Çlirimtare te Kosovës". Që para kësaj, ishin organizuar ne Kosovë njësi te cilat vepronin mbi bazën e përcaktimit politik te organizatës sonë e cila edhe i udhëhiqte. Kryesia e KP te LPK-së Dega j.v. u mor shumë here me këto çështje. Ajo shqyrtonte situatën ne vend, jepte këshilla politike dhe bënte financimin e njësive luftarake. Me ndihmën dhe punën e këtij organi ishin organizuar ne Kosovë disa njësi çlirimtare. Ato vepruan disa herë kundër forcave pushtuese serbe, përkatësisht policisë.

Mbi një bazë te tillë u krijuan edhe njësi tjera çlirimtare, ne viset tjera. Edhe pse kjo dihet, ka mendime te ndryshme për kohën e lindjes se UÇK-së. Ato janë kontradiktore. Kjo kontradiktë paraqet nevojën e ndriçimit te çështjeve te tilla. Dihet se ne varshmëri me zgjerimin e njësive, përkatësisht me ndërtimin e njësive çlirimtare, ne vitin1993 u paraqit nevoja edhe e emërtimit te kësaj force ushtarake, gjë që ne këtë vit u bë nga Kryesia e LPK-së, Dega j.v. Natyrisht, veprimtaria donte edhe një bazë financiare, nëpërmjet se cilës u siguruan mjetet dhe u veprua kundër pushtuesit. Ne vitin 1993 u sanksionua edhe baza politike udhëheqëse, përkatësisht LPK-ja, përderisa te organizohej Fronti. Por, çështja e ndërtimit te UÇK-së pas vitit 1993, duhet domosdoshmërisht te shtjellohet edhe me poshtë, sepse ato pasojnë ndryshim te madh ne jetën e përgjithshme te organizatës dhe te

UÇK-së. Janë, pikërisht, mjetet financiare dhe lufta karrieriste e përcjellë me bajraktarizëm, përveç konfliktit që lindi i ashpër midis radhëve tona, për mos ndërtimin e Frontit Çlirimtar te Kosovës, faktorët me kryesorë që kanë çuar deri tek ndarja dhe krijimi i klikave ne organizimin politik dhe ushtarak, si dhe ndërtimin i grupit politik ne te. T'i trajtojmë tash çështjet deri ne vitin 1993.

a) Njësitë e para çlirimtare

Bërthamat e para të UÇK-së janë krijuar nga bazat e LPK-së që mbetën pas dorëheqjes së udhëheqësish të LPK-së brenda vendit, kryetar i të cilës ishte Gani Sylaj. Ai pas një periudhe prej disa muajsh jetë tërësisht pasive për LPK-në, u largua edhe zyrtarisht. Me largimin e tij dhe të shokëve që i përmendëm më lart, në fakt, u paralizua jeta organizative e LPK-së. Kjo bëri që shumë këshilla të kërkonin të organizoheshin në aspektin ushtarak. Për këtë kërkuan dhe ranë në kontakt me shokët tanë të Kryesisë j. v. Nga ky moment, kompetencat e organizatës sonë i mori vetë Kryesia e Degës j.v., jo vetëm për ndërtimin e LPK-së brenda vendit, por edhe të organizimit, ndërtimit të udhëheqjes së njësisë çlirimtare që u organizuan për të futur në veprim të tëra mjetet e lejueshme në bote, edhe luftën e armatosur. Disa këshilla, në viset e ndryshme të Kosovës, u shkëputën nga jeta politike në kuadër të LPK-së. Ato e shpallën veten njësi ushtarake, ndërsa ne, si Kryesi, pas raportimit të sektorit, i pranuan (Vendimi i Kryesisë së KP). Natyrisht, në si Kryesi bashkë këtë lloj shkëputjeje nga radhët tona dhe organizim vetëm mbi bazën ushtarake nuk e donim. Ne, gjithashtu, nuk i njihim këta njerëz. Kryesia ishte për veprimtari të dyanshme, politike dhe ushtarake, duke u kombinuar njëra me tjetrën. Por, siç u pa, këto këshilla nuk donin me të merreshim me punë politike, përveçse me veprimtari çlirimtare. Puna politike, ajo e udhëheqjes, etj, iu la LPK-së. Këshillat kishin frikë nga dekonspirimet të cilat e kishin përcjellë mjaft gjatë organizatën. Bazat e LPK-së, brenda vendit, nuk donin që vetëm për organizim, apo për program, agjitacion a për ndonjë çështje normale, për ide e mendime, pa veprimtari konkrete çlirimtare kundër pushtuesit, të kapeshin e dënoheshin me dënim të rëndë. Me dëshirën e tyre dhe me miratim të organizatës disa këshilla të LPK-së kaluan në njësi luftarake. Ato vepruan ashtu me vullnetin e tyre, pa i detyruar kush. Natyrisht, kjo formë u përshëndet dhe menjëherë u riorganizuan. Në këtë kohë kishte edhe disa njësi tjera të UÇK-së, të krijuara në vitin 1990, por ato nuk ishin të lidhura me njësitë tona dhe vepronin të pavarura. Lidhja e tyre me ne u bë në vitet 1994-1995. Por, e rëndësishme është që të dihet fakti se, njësitë e para të armatosura datojnë nga viti 1990. Këtu fillon organizimi ushtarak i UÇK në viset tona të pushtuara. Edhe pse kishte njësi çlirimtare, ende në këtë kohë nuk kishte ndarje në zona, nënzona operative, etj, mbi të cilat duhej të veprimej ushtarakisht. Ato (njësitë çlirimtare) ishin të pavarura nga njëra tjetra. Kjo ndarje nuk u bë edhe për faktin sepse kishte jashtëzakonisht pak njësi çlirimtare, sikundër mund të shihet edhe nga vete aktiviteti në terren. Përveç disa veprimtarive luftarake në vitet 1990, 1991, 1992; në vitin 1993 ende nuk ishim në situatë për të kryer veprimtari të njësisë dhe në gjerësi të territorit tonë të pushtuar, sepse ende nuk kishte as shtrirje dhe as një komandë unike qendrore për të gjitha ato njësi ushtarake. Njësitë nuk kishin strukturë.

Njësitë luftarake ishin kryesisht në Drenicë, në Dukagjin në anët e Lumthetit, komunat e Glogocit e Skenderajt, Malishevës dhe Deçanit. Kishte njësi të vogla ushtarake edhe në Llap, e në disa fshatra të Ferizajt. Me vonë u zgjeruan dhe u organizuan njësitë çlirimtare edhe në vendet tjera, deri në viset e pushtuara shqiptare në Maqedoni. Viti 1993 shënon për herë të parë datën kur, edhe pse pak, në tërësi në vend kishim njësi çlirimtare të cilat vepronin të pavarura dhe të lidhura me Kryesinë e Degës. Prandaj, me organizimin e njësisë të para nga viti 1990 u kalua në organizimin edhe të njësisë të tjera, të cilat çojnë deri tek ndërtimi i saj si ushtri. Kjo u arrit në vitin 1993 kur u strukturua organi udhëheqës, Shtabi Qendror, si dhe kur u emërtua UÇK-ja nga Kryesia e Degës së LPK-së. Anëtarët e parë të këtij organi ishin nga Sektori i rëndësishëm së veçantë të Degës jashtë vendit. Ndërsa, si organ udhëheqës, me kompetenca politike, organizative, diplomatike, etj, mbeti Kryesia e Degës j.v. e cila e udhëhoqi atë deri më 01.05.1998. Në këtë kohë bëhet grushti politik ndaj këtij organi dhe nga ky moment kalohet në kooptimin e organit udhëheqës të UÇK-së, si dhe të sektorëve tjerë. Në këtë kohë, njësitë kishin program të vetin përcaktimin politik të organizatës që i udhëhoqte, përkatësisht LPK-në Dega j. v. Kryesia e saj ishte udhëheqëse politike, për të mos thënë edhe

Shtab i Përgjithshëm i njësive të armatosura, UÇK-së. Ky organ lëshonte informatat mbi punën, aktivitetin dhe me vonë edhe komunikatat në emër të SHQ-së të UÇK-së. Sipas programit të LPK-së dhe udhëheqjes së saj jashtë vendit, u përcaktuan edhe detyrat e saj për pavarësinë e Kosovës dhe bashkimin me shtetin tonë të të gjitha viseve etnike e të pushtuara nga shtetet sllave. Njësitë ushtarake nuk kishin rregullore dhe as program të vetin të veçantë. Ato vepronin mbi dispozitat që kishte LPK-ja. Dokumentet e kësaj organizate, përkatësisht programi, statuti, rezolutat dhe vendimet e kësaj organizate kishin vlerë politike e juridike edhe për njësitet e UÇK-së. Pas kësaj, u dhanë bazat politike nga LPK-ja edhe për UÇK-në e cila me vonë u shndërrua në subjekt dhe ajo mbi këto dispozita vepronte ushtarakisht.

b) Financimi i UÇK-së

Ndërtimi i njësive të para paraqiti para organizatës sonë dhe detyrën e financimit të tyre. Në si subjekt e kishim financimin e brendshëm i cili bëhej nëpërmjet anëtarësisë sonë. Por, ky financim ishte vetëm për organizatën, aq më tepër që ishte shumë simbolik, sepse kuotimet mujore që paguheshin ishin shumë të vogla.

Fillimisht u bë financimi i njësiteve të tilla nga financat e LPK-së. Ato jepeshin në forme të parave të gatshme, të mjeteve të ndryshme dhe në mjete luftarake të cilat siguroheshin në mënyrë ilegale, kudo ku i gjente grupi i punës, i ndihmuar nga Kryesia në tërësi. Mjetet ndaheshin sipas territorit, njësive e veprimtarisë që e kryenin ato. Me vonë, pas vitit 1995, siç do të shohim, ato iu dërguan Shtabit Qendror të UÇK-së dhe ai kryente administrimin e mjeteve. Kjo ndodhi deri në janar të vitit 1997, sepse pas dëmtimit të radhëve të UÇK-së, në vitin 1997, administrimi i mjeteve përsëri u bë nga Kryesia.

Mirëpo, deri në vitin 1993, ky subjekt luftarak që po krijohet ende nuk kishte strukturë. Në nuk e kishim dhënë ende informacionin në organizatë se mjetet e LPK-së po i dedikoheshin radhëve çlirimtare. Zaten, organet e organizatës as që i informuam për ekzistimin e njësive luftarake në anëtarësinë e vet, prandaj edhe mjetet financiare që i dedikonim nga anëtarësia e jonë kësaj veprimtarie i fusnim në kuadër të buxhetit që i dedikohej radhëve të organizuara brenda vendit, ku përfshiheshin edhe njësitet e tilla luftarake. Vetëm në vitin 1995, para MP të Peste të LPK-së Dega j. vendit, doli zyrtarisht para KP të organizatës dhe informoi për ekzistencën e UÇK-së si force ushtarake (MP e Peste e LPK-së)

Financimi i njësive në këtë kohë nuk e kalonte shumën 4-6 mijë DM në muaj. Kishte muaj ku as këto nuk mund t'i siguronim, ndonëse nevoja ishte e madhe. Prandaj, në vitet 1991-1993, disa herë u nxor vendimi që anëtarët e Kryesisë së Degës të japin ndihma financiare për punën e njësive çlirimtare. Kjo edhe u bë. Kishte raste, viti 1993, kur u dhanë nga një mijë DM. Kjo u përsërit disa herë në punën tonë. Ndërsa, në vitet e mëvonshme kësaj iu shtuan edhe anëtarët e KP-së dhe çdo anëtar i LPK-së (Vendimet e Kryesisë dhe të KP e LPK-së mbi çështjen financiare). Të gjithë anëtarët e LPK-së ishin të detyruar, me vendim, të paguanin shumën të veçanta.

Në vitet 1990-1993, për të cilat po diskutohej financimi, nuk kishte asnjë subjekt tjetër, as partiak, as qeveritar, organizëm kulturor, shoqatë, etj, që dha qoftë edhe një ndihmë financiare për UÇK-në. Financimi i vetëm në vite ishte nga LPK-ja. E tërë anëtarësia e LPK-së shkonte tek njësitet çlirimtare. Asnjë lek nuk kishte mundësi të mbahej për nevojat e LPK-së. Çdo shpenzim tjetër mbulohej individualisht, qoftë edhe për organizatën. Kjo na dëmtoi pa masë. Por, kundruall financave të vogla, kjo ishte domosdoshmëri për kohën.

c) Emërtimi dhe ndërtimi juridik i UÇK-së

Në vitin 1993 u ndërtua subjekti ynë ushtarak. Atij iu krijua struktura e organizimit dhe u bë ndarja e njësive nëpër terren. Para emërtimit, u nxor një rregullore e përkohshme për

funksionim te brendshëm e cila e përcaktonte strukturën e saj, ndarjen dhe komandimin nëpër terren, por vetëm deri tek emërtimi. Me pas u përcaktua nxjerrja e rregullores.

Ky subjekt nuk kishte ne këtë kohë as emër, as rregullore te përhershme dhe as dokumente normative. Prandaj, ky mosrregullim juridik me dispozita, ishte një ndër çështjet me te rënda dhe mbi te cilën ne Kryesinë e Degës j.v. u diskutua shumë here. Ne këtë kohë ishin tri çështje, për te cilat kishim frikë se shumë lehtë mund te rrëshqisnim ne pozitë te palakmueshme, ku mund te na kapnin si force destruktive, ne mos terroriste. Për këtë, ne emër te sektorit politik e juridik u paraqit platforma mbi këtë çështje:

- Se pari, te gjendej një emërtim që do t'i jepte kësaj force karakter te përgjithshëm kombëtar, mbi te cilën dhe rreth se cilës, mund dhe te duhej, te bashkoheshin te gjitha forcat e popullit tonë, duke ndërtuar Frontin Çlirimtar te Kosovës, subjektin shtetëror te përbashkët ne Kosovë.
- Se dyti, te punohej për rregullimin juridik te këtij subjekti ushtarak me dokumentet përkatëse, ku te përcaktohej karakteri i saj, pozita e saj dhe struktura, komandimi, përgjegjësia ushtarake dhe udhëheqja qendrore ushtarake dhe politike.
- Se treti, te punohej për te gjetur bashkëpunëtorë, subjekte politike, organizative e shtetërore, te cilat se bashku me ne, do te punonin për te ndërtuar Frontin Çlirimtar te Kosovës, si subjekt shtetëror dhe te cilit do t'i nënshtroheshin te gjitha forcat politike ne Kosovë, pa dallim bindjeje politike, organizimi, feje e territori ku shtrihej ai (Ditari i MK).

Çështjet e theksuara i futëm ne shqyrtim ne organin tonë, ne Kryesinë e KP te LPK-së Dega j.vendit. Ne si Kryesi, analizuam këto tri problème që po lindnin. Ne Kryesi përveç emrit aktual te UÇK-së, u paraqitën edhe dy propozime tjera: Forcat e Armatosura te Kosovës dhe Lëvizja Çlirimtare e Kosovës. Mirëpo, pas analizës se tyre mbi bazat politike, ushtarake e juridike, si dhe pas diskutimit te gjerë me vota unanime, 7-të pro dhe asnjë kundër (tërë anëtarët e Kryesisë), ne maj te vitit 1993, u pranua propozimi i sektorit, që kjo force ushtarake, që u organizua dhe po udhëhiqej nga LPK-ja, te emërohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës (Vendimi i Kryesisë se KP të LPK-së, maj 1993). Ky emërim u aprovua për shkak te tri çështjeve që i theksuam me lart, te cilat i jepnin asaj force karakterin e një ushtrie te rregullt shtetërore. Ky emërim kishte rëndësi edhe për faktin se kështu krijoheshin baza juridike e politike për ndërrimin e Fondit Çlirimtar te Kosovës, ndërsa nëpërmjet saj përcaktohej karakteri i luftës për liri përballë pushtuesit dhe qendrave politike ndikuese ne bote.

Ndërsa, për te marre karakterin shtetëror, pas emërtimit u paraqit edhe çështja e rregullimit juridik te përhershëm me dokumente dhe te shndërrimit te UÇK-së ne ushtri te shtetit. Me emërtim dhe rregullim te tille juridik, si ushtri e shtetit, askush nuk kishte te drejtë dhe as mundësi te akuzonte këtë subjekt ushtarak për terrorizëm a me ndonjë akuzë tjetër kriminale. Ky përkufizim i lidhur me aksionet që duhej te kishin karakter thjesht çlirimtar, te liruar nga veprimtaria që futej ne terrorizëm. Me urdhëratë që kishte lëshuar LPK-ja Dega j.v. e shndërroi këtë ne ushtri te rregullt.

Lidhur me këtë rregullim u diskutua mjaft gjerë ne organin udhëheqës te LPK-së. Ne Kryesinë e Degës u paraqit propozimi ne emër te sektorit politiko-juridik me anë te një projektregulloreje ku ishin përpiluar dispozitat dhe propozohej te miratoheshin disa qëndrime mbi karakterin politik e juridik te UÇK-së. Pas diskutimit te gjerë doli kjo rregullore e saj: "UÇK-ja duhet te kryejë aksione çlirimtare me karakter te drejtë, ku nuk goditen objektet social-kulturore, popullsia civile e objektet me rëndësi për jetën e popullit".

UÇK-ja duhej te godiste:

1. Objektet ushtarake dhe policore, vetëm makinerinë pushtuese, si dhe te gjitha mjetet e komunikacionit dhe te telekomunikacionit te atyre objekteve që pushtuesi i fut ne shërbim te luftës kundër popullit tonë.
2. Te goditen njësitet speciale policore dhe forcat ne shërbim te armikut, si vullnetarët serbe, paramilitarët e ushtarakët e sjellë nga Kroacia e Bosnja e Hercegovina ne Kosovë te cilët kryejnë veprimtari te rënda kriminale përballë kombit tonë.

3. Edhe elementët shqiptarë, përkatësisht tradhtarët, mund të ekzekutohen, por vetëm pasi të ishte bërë analiza dhe të ishte paralajmëruar mbi veprimtarinë tradhtare, duke ia lënë edhe afatin e tërheqjes, në mënyrë që të përmirësoheshin. Pas kësaj, lejohej të merrej vendimi për ekzekutimin, kuptohet, në organe me të larta dhe duke lajmëruar popullin, si dhe kërkoheshin të tregoheshin edhe shkaqet e një mase të tillë.

4. Aksionet nuk lejohen të kryhen në vende publike, aty ku mund të rrezikoheshin jeta e qytetarëve, pavarësisht nga rëndësia që paraqet objekti në aspektin ushtarak. (Platforma e LPK-së për luftën armatosur në Kosovë).

Mbi një bazë të tillë politike u paraqit një projektregullore nga udhëheqësi i grupit të punës, Xhavit Haliti i cili deklaroi në Kryesi se vjen nga SHQ i UÇK-së, për të diskutuar. Këtë miratoi edhe Ali Ahmeti. Në projekt pranoheshin vendimet tona, por nuk tregoheshin struktura e brendshme e UÇK-së. Në fakt, në këtë nuk e lypnim, sikundër as kuadrin e saj, as organet, kompetencat e aq me pak udhëheqësit. Në projekt vetëm tregoheshin se UÇK-ja e pranonte LPK-në si organizatë udhëheqëse të cilës i kaloheshin kompetencat në fushën politike, juridike, diplomatike e financiare (Rregullorja e UÇK-së). Mbi këtë u autorizua në të Kryesisë edhe për nxjerrjen e komunikatave në emër të SHQ të UÇK-së.

Ky projekt hyri në fuqi. Në MP të katërt të LPK-së Dega j.v, në vitin 1993, u diskutua gjendja brenda vendit. Aty u bë fjalë për luftën dhe përpjekjet tona në këtë anë, por nuk u tregua ekzistenca e UÇK-së. Para mbledhjes sonë jashtë vendit ishte mbajtur MP e Katërt brenda vendit, por ajo nuk pati jetë, përveç disa ditëve, sepse shumë anëtarë të saj u kapën. Këndeji, kaluan përsëri kompetencat tek Dega jashtë vendit. Kjo, me heshtje u pranua edhe nga delegatët, ndonëse nuk u diskutua, sepse ishte vendim. Me këtë u përforcua edhe me shumë pikëmbështetja jonë në punën tonë të ardhshme.

KAPITULLI II VEPRIMTARIA DHE NDËRTIMI I UÇK-SË

Vitet që pasuan për UÇK-në ishin të një rëndësie të madhe. Veprimtaria e saj, ndonëse ende jo e gjerë, shtroi çështje të ndryshme për të zgjidhur. Forcave që merreshin me çështjen e ndërtimit të këtij subjekti u duhej një punë e madhe për të ndërtuar UÇK-në, që të ishte në gjendje për të kryer aksione çlirimtare. Ajo përcaktohej nga qëndrimet politike të LPK-së si subjekt që do të mblidhte rreth vëtes tërë spektrin politik, juridik e shoqëror, tërë kombin tonë, i cili ishte duke kaluar ditët me të errëta në histori. Atij i duhej një subjekt ushtarak i aftë, që të thyente monotoninë e krijuar në kuadër të popullit tonë se, gjoja në s'kemi rrugë tjetër të veprimit, veç asaj pasive.

Dalja në skenë e kësaj force paraqiste para nesh si Kryesi edhe detyra tjera të mëdha dhe në shumë sfera. UÇK-ja duhej të organizohej në ushtri dhe të mbrohej e përkrahej në aspektin politik, juridik e shoqëror, në atë moral dhe diplomatik. Ajo kërkonte edhe mjete financiare. Pikërisht për këto shkaqe u përcaktuan disa qëndrime në vitet 1993-1996, të cilat për disa vite me radhë qenë udhëheqëse të UÇK-së, si në sferën politike e juridike, ashtu edhe në atë ushtarake. Në këtë kohë ramë në kontakt edhe me qeverinë e Bukoshit për të diskutuar situatën në përgjithësi, sidomos në fushën politike e financiare.

Çështja filloi të marre edhe kahen e vët. Tani punohej në ndërtimin e sistemit çlirimtar në Kosovë. Në këtë kohë askush nga ne nuk ishte kundër këtij sistemi. Dukej se zotëronte një unitet i plotë politik e juridik, shoqëror e çlirimtar. Çdo kush e dinte në Kryesi të Degës se pa bashkimin e tërë forcave kombëtare mbi bazën e sistemit politik çlirimtar, çështja jonë nuk mund të ecte përpara në rrugën e lirisë.

1. Veprimtaria organizative dhe ushtarake e UÇK-së

Uniteti ne Kuadër te Kryesisë se Degës për ndërtimin e UÇK-së ishte, nga emërtimi e deri ne janar te vitit 1997, i mbështetur ne vullnetin për te ndërtuar këtë subjekt ushtarak. Ne kuadër te radhëve tona dhe te UÇK-së nuk kishte konflikte, fërkime a grupe te ndara. Te gjithë punonin sipas vendimeve te nxjerra ne Kryesi. Çdo kush i kishte detyrat e veta dhe ato se bashku përbënin te përgjithshmen e ushtrisë sonë.

Kjo vazhdoi deri ne janar te vitit 1997, kur UÇK-ja nga burgosjet dhe vrasjet pësoi dëme te mëdha, kur praktikisht mbeti ky subjekt pa udhëheqje ushtarake te vetën. Tash nuk kishte me Shtab Qendror. Ai nuk funksiononte, sepse anëtarët e tij ishin shpërndarë; ça u vranë madje edhe u burgosën, ça ikën jashtë vendit. Tërë udhëheqja kaloi ne kuadër te Kryesisë se KP te Degës j.v. Me këtë filluan te duken edhe fërkimet e para, sepse dy anëtarët e sektorit (Xhavit Haliti dhe Azem Syla) kishin krijuar lidhje me disa forca brenda vendit, te cilat pretendonin te dilnin ne udhëheqje, edhe pse ne asnjë sferë nuk kishin aftësi profesionale, njohuri e nuk zotëronin as artin e luftës dhe te ushtrisë. Këta te dy se bashku me disa brenda vendit, krijuan klanin që bëri grusht politik.

Mirëpo, edhe përkundër këtyre vështirësive dhe faktit se Kryesia nuk i njihte radhët e UÇK-së, me njoftimin e dhënë nga sektori, bëmë një punë te madhe ne ndërtimin e saj. Kryesia ishte, ne fakt, ai organ që i dha radhët e veta dhe ndihmoi UÇK-në ne shtrirjen e radhëve te saj, duke i dhënë ne gjirin e saj shumë baza (këshilla popullore) te cilat u shndërruan ne baza (njësi) ushtarake te ushtrisë sonë ne ndërtim.

a) Organizimi dhe shtrirja e UÇK-së

Kryesia e dinte se UÇK-ja kishte mungesa te mëdha ne te gjithë fushat e veta. Ajo ishte një subjekt që u krijua nga radhët e LPK-së dhe si e tille, ishte shumë jo profesionale. Ne radhët e saj zotëronte urrejtja dhe dashka për çlirim, por nuk kishim një organizim e shtrirje ne tërë vendin tonë. Ajo ishte me shumë e karakterit popullor, pa një subjekt drejtues.

Duke e pare këtë ne Kryesi, dhamë shumë këshilla ne ushtri dhe pas organizimit te Mbledhjes se Katërt te Përgjithshme (viti 1993) te LPK-së brenda dhe jashtë vendit, (ndonëse brenda vendit u zhduk brenda disa ditëve, pasi u burgosën një numër i madh i shokëve dhe te tjerët u arratisen në botën e jashtëm), kaluam ne organizimin e shtrirjen e radhëve te UÇK-së. Tërë puna e jonë, ne përbërjen e re te KP dhe te Kryesisë se Degës që e udhëhiqte edhe LPK-në brenda vendit, si me UÇK-në ne sferën politike, juridike, shoqërore e diplomatike e cila mori edhe detyrën e Shtabit Qendror te UÇK-së, kaloi ne fushën e organizimit ushtarak te radhëve tona, duke dhënë edhe bazat politike, ato juridike e shoqërore, si dhe diplomatike për ndërtimin e një ushtrie te rregullt për luftë çlirimtare.

Edhe pas MP te Katërt (ne vitet 1993-1995) Kryesia e Degës përbëhej nga te njëjtët anëtarë, me përjashtim te Agush Bujës që u zëvendësua ne vitin 1993, ne mbledhjen e Degës me Adem Grabovcin. Sektorët e Kryesisë se Degës mbetën te njëjtë, përveç sektorit te veçantë dhe atij për lidhmbajtje brenda vendit. Ne sektorin e veçantë ishin vetëm dy shokë, Xhavit Haliti e Ali Ahmeti, që mbetën nga përbërja e vjetër. Si Kryesi ishim ne gjetje te anëtarëve tjerë për këtë sektor. E kishim hequr Emrush Xhemailin te cilit i dhamë sektorin për lidhmbajtje brenda vendit ne kuadër te LPK-së. Ky sektor përbëhej edhe nga Gafurr Eishani dhe Ali Ahmeti. I ndihmonte ne këtë kohë edhe Adem Grabovci dhe me vonë edhe Rexhep Ibërdemaj te cilët ne vitin 1995 u bënë anëtarë te rregullt te atij sektori (Ditari i MK).

Te gjithë sektorët e tjerë, ai politik me Muhamet Kelmendin udhëheqës, financiar, me Gafurr Eishanin udhëheqës, et), mbetën te njëjtë, sepse mbledhja zgjodhi përsëri te njëjtët anëtarë ne organet udhëheqëse te LPK-së, përkatësisht ne Kryesi.

Si u organizua UÇK-ja?

Pas zgjedhjeve ne Kryesi te Degës, te gjitha këto forca, si sektor e organ, u përqendruan ne organizimin e radhëve te UÇK- së dhe ne shtrirjen e saj ne te gjitha territoret e pushtuara

shqiptare. Për ne, si organizatë, nuk kishte dallim midis viseve dhe popullit tonë që ishte i pushtuar, qoftë nga serbët, qoftë nga maqedonët, qoftë nga malazezët, sepse ne programin tonë, që ishte baza edhe e saj, ishte sanksionuar tërësia territoriale, pa dallim pushtimi e ndarjeje që i ishte bërë Kosovës nga armiqtë.

Edhe për UÇK-në mbretëronte ideja e bashkimit popullor te të gjitha viseve shqiptare ne një shtet kombëtar.

Nga radhët e LPK-së u dhanë shumë këshilla për strukturën luftarake te UÇK-së. Kështu i kaluam nga viti 1992-93 deri ne vitin 1995 disa këshilla popullorë te Pejës, Deçanit e Gjakovës, pastaj te Lumthanit e Prizrenit, te Malishevës e Rahovecit, te Drenicës dhe Llapit, te Gollakut e te Tetovës dhe Kumanovës, te Gostivarit e Kërçovës ne njësi te UÇK-së Raporti i sektorit te veçantë ne mbledhje, Ditari i MK-se). Ne fakt, ne zgjodhëm rrugën e forcimit te subjektit ushtarak përballë atij politik e organizativ, por duke punuar edhe ne ndërtimin e LPK-së. Megjithatë, për ne nuk kishte asnjë dallim midis këtyre dy subjekteve. Kryesia e njihte strukturën, organet dhe aktivitetin që e kryente UÇK-ja.

Ne organizimin e UÇK-së me tej u mor sektori i rëndësisë se veçantë. Por, kësaj pune i ndihmuan edhe sektorët e tjerë, sidomos ai i lidh-mbajtjes dhe politik e juridik. Mund te themi se ne Kryesi u përcaktuan format dhe mënyrat e organizimit te njësive ushtarake. Aty u dha shtrirja territoriale e subjektit dhe u përcaktua lloji i aktivitetit, mënyra e veprimit dhe format e tjera te punës. Me një fjalë, edhe pas emërimit (viti 1993), sikundër përpara, e tërë puna e UÇK-së u përcaktua ne Kryesinë e Degës j.v. Ndërsa, sektori i veçantë kishte për detyrë vetëm lidhjen brenda vendit. Ai përgjigjej edhe për zbatimin e vendimeve te LPK-së nga UÇK- ja dhe anasjellas.

Këtij sektori, ne vitin 1995, nga Mbledhja e Përgjithshme e Peste e LPK-së jashtë vendit, iu bashkëngjitën me zgjedhje me vote ne Kryesinë e Degës edhe disa anëtarë te tjerë. Ai pësoi ndryshime. Nga mbledhja doli një Kryesi e rindërtuar. Tash, anëtarë te Kryesisë ishin edhe Azem Syla, Bashkim Mazreku dhe Rexhë Ibërdemaj. Nga Kryesia kaloi ne Këshillin e Përgjithshëm te Degës vetëm Gafurr Elashni. Te tjerët u rizgjodhën. As udhëheqja ne Kryesi te Degës nuk pësoi ndryshime, me përjashtim te sektorit financiar, ku përgjegjës u zgjodh Bashkim Mazreku i cili pas disa muajve dha dorëheqje për shkak te mos centralizimit te mjeteve financiare, sidomos te atyre që vinin nga fondi "Vendlindja Thërret". Ndërsa, ne sektorin e veçantë futëm edhe Azem Sylen dhe Jashar Salihun, ndërsa ne sektorin e lidh-mbajtjes zgjodhëm Rexhë Ibërdemen dhe Adem Grabovcin, veç Emrush Xhemailit e Gafurr Eishanit që ishin anëtarë te këtij sektori që nga përbërja e vjetër e Kryesisë se Degës. Me këtë përbërje u vazhdua me punë për ndërtimin organizativ e juridik te UÇK- së (MP e Peste e LPK-së, viti 1995).

Ne këtë kohë ne fushën politike, diplomatike, financiare, etj, Kryesia e Degës, ende ishte Shtabi Qendror i UÇK-së, përveç fushës aktive ushtarake. Prandaj u vendos që UÇK-ja te kishte një organizim te vetin politiko-juridik, ne mënyrë që te shndërrohej dhe ndërtohej ne ushtri te shtetit. Për këtë u veprua ne organizimin e radhëve te cilat, ne vitin 1995, u shtrinë ne te tëra viset e pushtuara shqiptare dhe u ndërtua struktura e brendshme organizative e UÇK-së.

Ajo kishte si subjekt edhe dispozitat juridike te veçanta dhe vepronte ushtarakisht si ushtri e shtetit. Nga Shtabi Qendror i UÇK-së u bë edhe rindarja, riorganizimi ushtarak i veprimit dhe komandimit ne zona dhe nënzona te veprimit operativ- luftarak, zona që edhe aktualisht janë te njëjta dhe veprohet mbi to. (Raport i Sektorit te veçante.)

Dihet se këtij organizimi i mungonin vetëm forcat profesionale te cilat nuk ishin përfshirë ne

te. Kuptohet se ne atë kohë (vitet 1993-1997) UÇK-ja ishte një subjekt ilegal, i ndjekur me te madhe dhe i nënçmuar nga subjektet politike shqiptare. Askush nuk besonte nga subjektet politike e politikanët shqiptare se do te ndërtohej një ushtri e tille çlirimtare, ku pas se cilës do te lidhej e ardhmja e kombit tonë. Shumë fora mendonin, madje edhe nga radhët tona, se ky ishte vetëm emër, pa një strukturë te vetën. Kishte te tille që nuk besonin se kishte mundësi faktike, përballë forcës ushtarake e policore serbe, diktaturës se egër që mbretëronte ne viset tona te pushtuara, se kishte mundësi te ndërtohej një ushtri çlirimtare, para hundës se armikut dhe ta luftonte atë.

Pas një pune këmbëngulëse, ne vitin 1995 u arrit që te kemi një strukturë unike te organizimit juridik, politik e shoqëror. UÇK-ja u ndërtua organizativisht ne ushtri te Kosovës. Tash u krijua një strukturë e ngjeshur, me një komandë luftarake qendrore. UÇK-ja vepronte edhe me mjete çlirimtare kundër forcave pushtuese e tradhtare te vendit. Vëte ky fakt tregonte forcën si subjekt ushtarak.

Ndërtimi juridik

UÇK-ja kishte rregulloren e vet. Por, ajo nuk përcaktonte ende fushën e veprimtarisë dhe as kompetencat e organeve te saj. Ne rregullore ishte përcaktuar struktura, por nuk zbatohet me rigorozitet. Rregullorja e brendshme ishte dokument forma..

Ne anën tjetër, mungonte një dokument komplet dhe që te rregullonte ne tërësi çështjet juridike, raportet dhe pozicionet midis UÇK-së dhe LPK-së. Ndonëse ishte një rregullore, po jo complete, nga ana e sektorit te veçantë u paraqit projektregullorja e raporteve te UÇK-së ne fushën politike e juridiko-shoqërore, si dhe ne atë shtetërore. Me te u rregulluan edhe raportet me LPK-në. Këtë projektregullore e pranoi Kryesia e Degës dhe e shndërroi ne rregullore te saj. Rregullorja e UÇK-së). Me anën e këtij dokumenti kalonin te gjitha kompetencat, ne fushën politike, juridike e diplomatike ne Kryesinë e Degës jashtë vendit. LPK-ja mbante edhe anën financiare me Fondin "Vendlindja Theret". Ky ishte organ politik dhe LPK-ja organizata politike e saj.

Kryesia me rregullore u ngarkua që te lëshonte komunikata, si dhe te bënte analizën e gjendjes dhe te jepte ide e mendime, si dhe te përcaktojë vijën për veprimtari çlirimtare te UÇK-së. Ky organ kishte te drejtë te nxirrte qëndrime e vendime, madje edhe te lëshonte urdhëresa dhe te kërkonte zbatimin e tyre. Gjithashtu, nëpërmjet Kryesisë se Degës j.v, kalonte informacioni, puna diplomatike ne drejtime te informimit te komuniteti ndërkombëtar mbi çështjen luftarake ne vend, luftën dhe aksionet çlirimtare, që kryheshin nëpër vendet e ndryshme te Kosovës. Ajo duhej që ato t'i mbulonte me veprimtari politike e kërkesa ndërkombëtare. Me një fjalë, ne Kryesinë c Degës kaloi e tërë puna e UÇK-së e cila përgjigjej edhe politikisht para kombit tonë dhe botes.

Duhet informuar gjithashtu se Rregullorja e ngarkonte Kryesinë edhe me marrjen e vendimit kundër nxjerrjes se vendimit për pranimin e saj si subjekt politiko-organizativ te veçantë. LPK-ja pranonte edhe aksionet luftarake, duke i treguar ato dhe duke i komunikuar, kuptohet ne bazë te rregullores dhe aksioneve. Ndërsa, UÇK-ja e konsideronte LPK-në me rregulloren e vet te brendshme krahe te vetin politik, si udhëheqëse e saj politike e shoqërore. Mirëpo, ky përkufizim juridik nuk u pranua nga organizata, sepse Kryesia e Degës ishte për organizimin e sistemit çlirimtar ne Kosovë nën Frontin Çlirimtar te Kosovës. Për këtë shkak, Kryesia e la te hapur këtë çështje dhe vendosi te vazhdohej puna duke kombinuar karakterin ushtarak që i mbetej UÇK-së, me atë politik, juridik e diplomatik si dhe financiar te LPK-së. Kjo tregoi sukses te madh, dhe ky funksionim u sanksionua.

Zgjerimi i radhëve te UÇK-së

Me dhënien e bazës politike - juridike si ushtri e shtetit të Kosovës, në radhët e UÇK-së filluan të futen edhe njerëz tjerë të viseve të ndryshme dhe të partive të ndryshme, persona që nuk ishin në LPK-ë dhe që ishin të gatshëm për të luftuar për çlirimin e vendit. Ata ishin anëtarë të partive të ndryshme që u futën në radhët e UÇK-së për të luftuar kundër pushtuesve tanë. Ky ishte hapi i parë i karakterit shtetëror të ushtrisë.

Mirëpo, në kishim përsëri pengesa të mëdha. Deri në shpërthimin e konfliktit të hapur ushtarak (pas kesaj do të flitej në vend tjetër) radhët ushtarake të UÇK-së ishin jashtëzakonisht të mbyllura dhe shumë konspirative. Këtë e diktonte edhe gjendja e vendeve, por edhe vëte dispozitat juridike dhe mënyra e organizimit. Me rritjen e veprimtarisë së saj u diktua puna në gjetjen e formave për ndërtimin e ushtrisë mbi bazat e shtetit, që të institucionalizohej si ushtri e Kosovës. Për këtë shkak u paraqit nevoja e marrjes së masave konkrete juridike, duke e hapur subjektin, në mënyrë që të zgjeroheshin radhët e UÇK-së me anëtarë.

Po, si u zhvillua procedura?

Detyrën për ndërtimin juridik e politik të sistemit çlirimtar e kishim filluar shumë me herët. Kishte kohë që Kryesia kishte të dhëna se radhët e UÇK-së nuk ishin fora të mjaftueshme politike, juridike e ushtarake për të organizuar popullin dhe për ta udhëhequr atë në luftën çlirimtare. Në anën tjetër, populli ynë ishte i ndarë nëpër parti e organizata, gjë që e paraqiste detyrën e bashkimit vetëm në sistem.

Prandaj, gjatë viteve 1993-1997, çështja e ndërtimit të UÇK-së u bë temë kryesore e radhëve tona të organizuara. Shumë punë u kryen, ndërsa në fillim të vitit 1997, menjëherë pas vrasjes së disa shokëve dhe burgosjeve të disa të tjerëve, Kryesia e Degës mori vendim për të ndihmuar UÇK-në në të gjitha fushat e jetës së saj, jo vetëm në anën politike e juridike, por edhe me kuadro të ndryshëm. Pas vrasjes në pritë afër Vushtrrisë të Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe Edmund Hoxhës, si dhe të burgosjes së me shumë se 20 vetave, në janar të këtij viti, u paraqit si domosdoshmëri dërgimi i kuadrove në Kosovë, zgjedhja e një grupi pune për t'u marrë me kuadrin ushtarak, në mënyrë që këta të futeshin në radhët e UÇK-së dhe ta ndërtonin atë ushtarakisht.

Në këtë kohë u kap edhe çështja e ndërtimit të sistemit, u përpilua projekti dhe filluan kontaktet me subjektet e ndryshme në vend dhe jashtë.

Nga janari i vitit 1997, UÇK-ja ishte praktikisht pa Shtabin Qendror në Kosovë (Raport i sektorit të veçantë). Atë e udhëhiqte vetëm Kryesia e KP të LPK-së dega j.v. Kjo i lëshonte tërë komunikatat dhe tregonte fushën e veprimit.

Duke e ditur këtë gjendje, në vitin 1997, u ndërmor një fushatë e gjerë e dërgimit të shokëve në Kosovë. Përveç kalimit me të madh të radhëve të LPK-së në njësi ushtarake, dërguam edhe shokë brenda vendit. Në këtë vit u kontaktua edhe me kuadrin ushtarak në botën e jashtme.

Nga ata u kërkua të futeshin në radhët e UÇK-së. Por, në kuadër të kushteve të krijuara, fërkimeve dhe organizimit të oficerëve në kuadër të qeverisë, ishte e pamundur shkëputja dhe dërgimi i tyre. Ndërsa, vetë qeveria nuk pranonte kontakte dhe as që donte të dëgjonte për luftën çlirimtare.

UÇK-ja kishte nevojë për çdo shqiptar. Prandaj, në këtë vit ramë në kontakt me shumë subjekte dhe lëshuam thirrje të brendshme, ku bënim thirrje për vullnetarë që do të shkonin në radhët e UÇK-së. Kuptohet se nga sektori, sidomos nga Xhavit Haliti dhe Azem Sylja, u kërkua që të lidhemi me shokët e Shtabit që vepron ende në Kosovë, para se të dërgoheshin vullnetarë brenda vendit. Këtë e pranuan, edhe pse ata kishin mbetur jashtë, pa shtab. Por, pas një kohe (*maj 1997*) erdhi përgjigja se gjoja (anëtarët e Shtabit) nuk kishte nevojë për vullnetarë, përveç për mjete financiare dhe arme (*Raporti i sektorit të veçantë*). Kjo nuk u mor parasysh nga Kryesia. Përkundrazi, duke ditur dëmtimin që kishte pësuar UÇK-ja dhe mos ekzistimin faktik të Shtabit Qendror, iu futëm punës për dërgimin e vullnetarëve dhe kërkua që të bëhej organizimi i organit udhëheqës. Për ne ishte e qartë se pa atë organ nuk

kishte ushtri.

Gjendje e njëjtë ishte edhe tek mjetet financiare. Mjete dërgoheshin, por ato, gjatë vitit 1997, u bllokuan diku ne Kosovë, apo kumbisnin nga sektori gjatë rrugës. Shumë radhë te organizuara a njësi te shumë rretheve te organizuara te UÇK- së mbetën pa mjete. Vlen për këtë te përmendet pjesa e Prekazit e forcave te UÇK-së, Llapi e Rrafshi i Dukagjinit (*Informacion nga terreni ne mbledhje te kryesisë*). Ne këtë gjendje ishin edhe njësitet luftarake ne Tetovë, Kumanovë e viset tjera shqiptare. Këto rrethe e fora ishin lënë fare pa mjete financiare, për çka u detyrua Kryesia e Degës (viti 1997-1998) te bënte vëte ndarjen e mjeteve financiare.

Ne gjendje me te mire nuk ishte as vetë jeta e brendshme e UÇK-së. Nuk kishte me asnjë organ udhëheqës. Komanda ishte shpartalluar. Çdo njësi, rreth e organ i UÇK-së vepronte sipas vendit dhe rrethanave që ishte. Nuk kishte asnjë lidhje ne kuadër te UÇK-së. Ne këtë kohë, nëntor 1997, disa çeta te Drenicës dalin publikisht para popullit. Kjo theu tërë dyshimin e "ekzistencës" apo jo te UÇK-së si force ushtarake (Koha Ditore, tetor-nëntor 1997).

Pse u refuzuan kërkesat për dërgimin e kuadrove?

Ne kuadër te dërgimit te kuadrit brenda vendit, ne vitin 1996 kishim çuar shumë shokë ne radhët e UÇK-së. Ndonëse kishte luhajtje dhe rezerva tek dy anëtarët e sektorit, ne asnjëherë nuk patëm mosmarrëveshje te thella ne Kryesinë e Degës për dërgimin e anëtarëve te LPK-së, simpatizantëve apo te veprimtarëve tjerë ne UÇK. U vendos me vota. Çdo kush kishte te drejtë te paraqiste kërkesën dhe mbi te merrej vendimi. Pas kësaj shokët dërgoheshin nga sektori brenda vendit.

Ne vitin 1996 shqyrtuam kërkesën e Fehmi Ldrovcit te cilën e paraqiti Ali Ahmeti (Ditari i MK). Ai kishte kërkuar lejen nga Kryesia për te shkuar brenda vendit për vetë, për bashkëshorten e vet dhe mase 10 shokë. Ne si Kryesi e kishim shqyrtuar këtë kërkesë disa here, por kundër shkuarjes se grupit te Fehmi Ldrovcit brenda vendit ishte kryesisht Xhavit Haliti dhe Azem Syla, me arsyetimin se, ky njeri dhe shokët e tij janë karrieristë, njerëz që shkojnë atje për te udhëhequr luftën e jo për te luftuar (Deklarata ne Kryesi e anëtarëve te sektorit te veçantë). Ky bllokim kuptohet se bëhej ne emër te Shtabit Qendror te UÇK-së, duke kërcënuar e lëshuar mbledhjen. Deri ne maj te vitit 1997 e bllokuan vendimin e dërgimit te Fehmi Ldrovcit me shokë.

Arsyetimi i këtyre dy vetave, ne emër te SHQ te UÇK-së, sepse, Ali Ahmeti ishte për t'i lejuar, ndërsa Jashar Salihu nuk ishte anëtar i Kryesisë, ndaj as që merrte pjesë ne mbledhje, e bllokoi Kryesinë dhe ishte shumë negativ. Ata, përveç që akuzonin për karrierizëm e mosdëgjueshmëri, me thënien: "shokët brenda vendit nuk kanë nevojë për shokë nga jashtë, por vetëm për para" (Deklarata ne Kryesi e Xhavit Halitit dhe Azem Sylës), krijuan një fërkim dhe mosbesim te madh. Ne emër te kësaj kjo thënie ne Kryesi gjeti përkrahje, u shty për një kohë te pacaktuar marrja e vendimit për dërgimin e Fehmi Ldrovcit me shokë ne Kosovë. Duke u mbështetur ne këtë gjendje, ne vitin 1997, shkruam një letër drejtuar Shtabit Qendror, ne te cilin bazoheshin dy anëtarët, për te shqyrtuar situatën e krijuar. Këtu po tregoj vetëm përmbajtjen ne mënyrë te përmbledhur.

Ne letër shpjegohej situata jonë politike, juridike e diplomatike ne bote; shkruhej për akuzat ndaj luftës dhe kërkohej që te dy organet, ai i UÇK-së dhe Kryesia te takoheshin se bashku, ne nivel te tyre, apo te dy a me shumë delegatëve, diku ne Shqipëri a ne Kosovë. Ne te lypsej te diskutohej situata aktuale, gjendja e brendshme e dërgimi i forcave, detyrat dhe, sidomos, kërkohej që te bisedohej mbi Frontin Çlirimtar te Kosovës te cilin ne donim te ndërtonim (*Projekti i letrës*). Letra iu dha Azem Sylës dhe ai na premtoi se do ta dërgonte ne vend, tek Shtabi Qendror. Por, si duket, kjo letër kurrë nuk iu është dërguar shokëve atje. Ajo ka mbetur ne sirtarët e tij, nëse i ka, ne xhepa apo veç është zhdukur. Ne vend te kësaj, ai i kishte

lajmëruar shokët brenda vendit, se ne po shkonim për te udhëhequr luftën nga jashtë. Prandaj, filluan edhe fërkimet e para midis Azem Syles dhe Xhavit Halitit ne një anë, dhe pjesës tjetër te Kryesisë se Degës jashtë vendit, duke u mbështetur ne gjoja faktin se "nga bregu do te udhëhiqim luftën".

Mirëpo, dobësimi i radhëve brenda vendit, megjithë kundërshtimin e tyre, pas janar-shkurtit 1997, kur UÇK-ja mbeti pa organ te vetin udhëheqës, përveç Kryesisë që e udhëhiqte atë, përsëri morëm ne shqyrtim kërkesën e Fehmi Ladrovci. Ne maj te vitit 1997, edhe pse përsëri dy ishin kundër Azem Sylas dhe Xhavit Haliti, u vendos dërgimi i tyre ne Kosovë. Për realizimin e këtij vendimi u caktua Ali Ahmeti, Xhavit Haliti dhe Azem Sylas. E bëmë këtë me qëllim që këta te mos i nxirrin vështirësi grupit te Fehmi Ladrovci gjatë rrugës dhe ne vendlindje, sepse nëse nuk veprime kishte rrezik që te precipitonte deri te konfliktet e brendshme, ne kuadër te UÇK-së. Përkundër tërë kësaj ngjarjeje, vendimi nuk u realizua, për shkak te vrasjes nga forcat serbe te Luan Harajdinajt duke kaluar kufirin me shokë. Por, e përbashkët është se, përkundër dobësimit te radhëve te ushtrisë, me bllokimin e vullnetarëve e kuadrove, u veprua edhe kundër kërkesave te shokëve te tjerë te Kryesisë a te KP te Degës j.v. te cilët e shprehën gatishmërinë për te shkuar brenda vendit. Çdo kërkesë që bëhej ne Kryesi nga dy anëtarë te sektorit (Xhavit Haliti dhe Azem Sylas), u refuzua kategorish, ne emër te UÇK-së, e, gjoja se nuk kishin nevojë, ndërsa dërgonin persona te tjerë, anëtarë që i kishin nën kontrollin e tyre. Këtë e refuzonte Ali Ahmeti, duke treguar se ato nuk ishin vendime te UÇK-së (*Ditari i MK*).

Ne këtë kohë nga këta dy anëtarë te sektorit, paraqitet kërkesa për gjetjen e ndërlydhësve midis Kryesisë se Degës dhe UÇK-së. Nga Xhavit Haliti dhe Azem Sylas u paraqitën Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, si kuadro te veshëm e te sakrificës për detyrën e tille. Ne nuk i njihnim, por me propozim te sektorit Kryesia i pranoi dhe ata nga sektori u dërguan si ndërlydhës nga Cyrihu i Zvicrës, ku ishin vendosur brenda vendit. Kjo, natyrisht, ishte e drejtë, por e keqja është se kështu nga këta paraqitëshin dy kute krejtësisht te kundërta: ai i refuzimit te shokëve që nuk i kishin nën kontroll Xhavit Haliti e Azem Sylas, si dhe te pranimit nga ata te dy për te dërguar te tjerë brenda vendit, kuptohet sipas raporteve që kishin ata. Puna e tille e sektorit, me mire te themi e krijuar kështu, nuk kishte asnjë diskutim që bëhej me qëllim moslejimin e ndërtimit te radhëve te UÇK-së me fora profesionale, me fora që ishin për ndërtimin e sistemit çlirimtar, përveç se me ato fora te cilat drejtoheshin prej tyre edhe ishin kundër atij sistemi. Ne këtë kohë këta ende nuk dilnin kundër sistemit a shokëve. Mirëpo, ne emër te saj vepronin kundër, me qëllim për mos ndërtimin e UÇK-së dhe Frontit Çlirimtar te Kosovës. Për këtë, ne emër te luftës, forcuan dy ish ndërlydhësit, Hashim Thaçin e Kadri Veselin, ne emër te radhëve brenda vendit, duke kundërshtuar dërgimin e shokëve që nuk i konsideronin shokë apo mobilizimin e kuadrit te aftë ushtarak, ne llogari te kuadrit te paaftë e karrierist.

Ky bllokim e pengoi punën e UÇK-së.

b) Veprimtaria ushtarake e UÇK-së

Krahas ndërtimit organizativ dhe politiko-juridik te UÇK- së, detyrë tjetër që doli para kësaj force ushtarake ne ndërtim, ishte edhe aktiviteti ushtarak kundër forcave pushtuese. Fillimisht ato ishin te ndara, pa një komandë gjenerale, si dhe te një rëndësie jo te madhe. Ndërsa, pas organizimit te Shtabit Qendror dhe rregullimit te saj juridik e te krijimit te sistemit komandues, aksionet ishin me te koordinuara.

Ne këtë kohë lëshohen edhe udhëzimet nga Kryesia e Degës jashtë vendit mbi veprimtarinë e UÇK-së ne sferën politiko-juridike-diplomatike. Ne ato rregulla, sikundër folëm me pare, përcaktoheshin kahet e aksioneve, vendi dhe mjetet e objektet që duhej te sulmoheshin. Kjo bëhej thjesht për te mos u akuzuar veprimtaria jonë si vepër penale terroriste. Për këtë qëllim

u lëshuan rregullat e veprimit ushtarak dhe njësitë ushtarake kryen mbi këto baza juridike aksione çlirimtare. Prandaj, që nga dita e pare e veprimtarisë, me aksionet ne Kosovë nuk u krye as edhe një aktivitet terrorist, (aktivitet qe me norma ndërkombëtare e teorinë e terrorizmit mund të kualifikohet në të tillë). Ato ishin thjesht akte ligjore çlirimtare. Duke u mbështetur ne pikësynimin e çlirimit te vendit që nga viti i pare i themelimit te UÇKsë,

ne aspektin zyrtar kur u emërua dhe u sanksionua zyrtarisht ky subjekt e deri ne mars- prill 1998, nga Kryesia është kryer punë dualiste.

Se pari, ne sferën e aftësimit te disa kuadrove tona me taktikë e mjete luftarake, me artin e luftës dhe me strategjinë e saj;

Se dyti, u punua ne ndërtimin e njësive te afta goditëse kundër armikut.

Ne sferën e pare ka qenë vetë Kryesia e Degës j.v. që ka organizuar veprimtarinë e përgatitjes se kuadrit ushtarak. Ajo i ka zgjedhur njerëzit dhe i ka çuar ne kurse teorike e praktike. Ka raste kur nga disa vetë kanë mësuar artin e luftës ilegale dhe ne kushte te rënda. Veç kësaj, është punuar edhe ne mënyrë teorike, ne mënyrë që luftëtarët te dinin te vepronin ne kushtet e pushtimit te rende.

Gjatë gjithë kësaj kohë, falë kësaj pune këmbëngulëse e ndërtimit te brendshëm ushtarak, ne kemi shumë aksione te përbashkëta te cilat tregojnë unitetin, komandimin dhe unifikimin e subjektit tonë ushtarak. Këto aksione luftarake kundër forcave pushtuese serbe u kryen ne vitin 1995, ne vjeshtë, kur u sulmuan me mjete te ndryshme luftarake dhe me bomba disa objekte policore e ushtarake dhe ne prill te vitit 1996, kur më se 10 aksione u kryen ne tërësi ne Kosovë, po ashtu ndaj objekteve ushtarake e policore. Pas kësaj kohë u kalua ne aksione me peshë, individuale dhe kryesisht kundër forcave pushtuese, si policore e ushtarake, ashtu edhe kundër objekteve dhe mjeteve luftarake. Ato ishin te komanduara nga një qendër deri ne janar te vitit 1997. Me aksionet e armikut kundër udhëheqjes se UÇK-së, ne këtë kohë, ky subjekt mbetet pa organ udhëheqës, komandim te vetin unik. Tash fillon veprimtaria e pavarur dhe ne çdo anë te vendit, tamam sipas organizimit ushtarak.

Ne këtë kohë komandimi kaloi ne zonat operative dhe nënzonat e vendit (*Raporti i sektorit të veçantë, 1997*). Ato organizuan ne vitin 1997 aktivitet çlirimtar, jashtë komandimit te përgjithshëm. Nga zonat e nënzonat operative u planifikuan dhe u kryen aksione kundër forcave te pushtuesit ne shumë vende. Nga ky moment, nuk kemi me komandë qendrore ushtarake, prandaj edhe shumë aksione u kryen edhe nga njësitet operative, jashtë komandave te zonave operative te veprimit ushtarak, jo vetëm jashtë asaj qendrore, por edhe te atyre te zonave e nënzonave. Kjo, për shkak se nuk ishte Shtabi Qendror për te bërë koordinimin, gjë që bëri që ne -sferën ushtarake, përgatitja, operacionalizimi dhe komanda te kalonte ne zona, nënzona dhe ne njësi te vendit, jashtë rregullave te veprimit luftarak (*Raporti i sektorit te veçante, 1997*).

Mirëpo, ky decentralizim ne veprimtari, ndonëse për karakterin e ushtrisë jo i lejueshëm, ne kushtet tona ndikoi pozitivisht. Zonat e nënzonat fituan besim ne aftësitë e veta operative, prandaj aksionet luftarake u thelluan. Edhe njësitet luftarake e shtuan aktivitetin. Këtu duhen përmendur aksionet e njësive operative te Drenicës ne janar-maj dhe shtator-nëntor te vitit 1997. Këto njësi disa hère i thyen forcat pushtuese serbe. Disa hère u thyen forcat e pushtuesit serb nga fshati i Prekazit dhe te fshatrave te tjera te Skenderajt. Aksione pati ne këtë kohë edhe ne Prishtinë, kundër rektorit serb te Universitetit te Prishtinës, pastaj kundër shumë njësive policore ne Llap e ne Rrafsh te Dukagjinit, sidomos kundër stacioneve, policore serbe ne Komaran, ne Kievë, ne Kliqinë e Irzniq te Deçanit. UÇK-ja kreu aksione edhe kundër kriminelëve serbe, tradhtarëve e bashkëpunëtorëve te ndryshëm ne terren (*Raporti i sektorit te veçantë*). Kemi, kështu, një veprimtari te gjerë luftarake e cila shkonte duke u thelluar e intensifikuar.

Falë kësaj veprimtarie te gjerë u zgjerua lufta jonë çlirimtare. Ne mars-prill te vitit 1998, ajo

shpërtheu me vrullin me të lartë të shekullit të fundit, sepse armiku kreu ofensiva kundër Prekazit e disa fshatrave në Drenicë dhe me vonë në Dukagjin, ku masakroi e dhunoi me dhjetëra veta, duke shuar familje, gjë që shtoi terrenin për rezistencën popullore. Nga kjo kohë u kalua në mobilizimin e kombit tonë. Ai u ngrit moralisht dhe nga ai moment u kalua në kryengritje popullore të gjerë. Me UÇK-në u bashkuan shumë fshatra, lagje e krahina të vendit; u bashkuan punëtorët, intelektualët, fshatarët e gjithë popullsia. Lufta jonë çlirimtare u thellua dhe, për periudhën e marre në shqyrtim, u çliruan mbi 40% të territorit të Kosovës. Kjo kohë e vitit 1998 shënoi bashkimin me të madh të popullit me luftën.

Përveç aksioneve të përbashkëta dhe unike që u kryen, ku u vendos kontrolli i UÇK-së mbi shumë vise të Dukagjinit e Drenicës, Rrafshit të Kosovës, etj., kemi pasur shumë aksione të veçanta të cilat kryheshin në disa vende, veç e veç, nga forcat e UÇK-së. Këtu duhen përmendur aksionet në Llap, në Gollak e në viset e Kaçanikut, në Shalë të Bajgorës, etj. Edhe në këto vise kishte njësi të UÇK-së, ndonëse jashtë komandës. Pô, veç këtyre aksioneve, kemi edhe nëpër qytete të ndryshme aksione kundër forcave pushtuese të cilat duhej domosdoshmërisht të futeshin në tërësinë e luftës çlirimtare. Vlen të përmenden këtu edhe manifestimet popullore për të bërë mobilizimin e masës.

Por e përbashkëta është: aksionet u kryen jashtë komandës së përgjithshme, kurse populli u bashkua si rezultat i dhunës e emrit të lartë të UÇK-së, jashtë punës së saj.

2. Mbrojtja politike, juridiko-diplomatike e morale e UÇK-së nga LPK-ja

Çështja tjetër që u paraqit para nesh gjatë kohës së kryerjes së aksioneve çlirimtare ishte edhe marrja në përgjegjësi e veprimeve ushtarake. Fillimisht nuk ishte ndonjë problem i madh, sepse aksionet ishin të rralla, pa ndonjë peshë dhe për përgjegjësi a mbrojtje nuk kishte nevojë.

Por, me thellimin e aksioneve dhe me shtrirjen e tyre, kjo çështje u shtrua me force para organit tonë për të shqyrtuar dhe marre vendim.

Me ndërtimin juridik të strukturës së UÇK-së, në vitet 1993-1994, nga Shtabi Qendror që paraqitur kërkesa dhe që lënë nën kompetencat e Kryesisë nxjerrja e vendimit se si të veprohej me këtë çështje. Shtabi Qendror na komunikoi me shkrim se ai, si organ i UÇK-së, ishte përgjegjës vetëm për anën ushtarake të aktivitetit luftarak dhe se nuk donte fare të futej në çështje tjera, në ato politike, juridike, shoqërore a diplomatike. Këto anë të sferës së veprimtarisë i takonin Kryesisë dhe LPK-së, e cila duhej të vendoste formën se si të mbroheshin, sqaroheshin e ligjësoheshin aksionet çlirimtare të kryera në Kosovë nga njësitet luftarake të UÇK-së (Ditari i MK).

Duke u mbështetur në këtë vendim, para MP të Peste, viti 1995, Kryesia e Degës, nëpërmjet sektorit të vet me anëtarë Muhamet Kelmendin, Fazli Veliun dhe Emrush Xhemailin, të cilët patën bërë projektin, mori vendimin për mënyrën e mbrojtjes së aksioneve. Ky vendim iu paraqit edhe KP të Degës dhe vetë MP të Peste të LPK-së.

Në projekt ishin dy çështje kryesore: se pari, a të dilnim para opinionit me emër të UÇK-së si subjekt ushtarak, ndërsa LPK-ja të dilte në mbrojtje politike, juridike, morale e diplomatike. Pas shqyrtimit të gjerë të çështjeve dhe, duke u mbështetur në gjendjen të zotëronte dhe në pikësynimin për të ndërtuar Frontin Çlirimtar Kosovës, u zgjodh rruga e dytë (Projektregullorja e sektorit politik të LPK-së). Kjo formë e koordinimit të veprimtarisë ishte shumë me e vesharë, por, natyrisht, kështu tregojë karakteri popullor-shtetëror i UÇK-së e liruar nga subjektet politike. Thjesht, vendosëm ta mbronim e ta përkrahim në fushat e përmendura.

a) Përkrahjen politike e juridike

Para LPK-së, konkretisht Kryesisë së Degës, u paraqit detyra e mbrojtjes dhe përkrahjes së

UÇK-së. LPK-ja, Dega jashtë vendit lëshoi te gjitha komunikatat deri ne atë te 49-të, ne emër te UÇK- së, duke dalë edhe me emrin e tij vetë ne mbrojtje dhe ne përkrahje e UÇK-së, para qytetarëve, armikut dhe subjekteve ne bote e qendrave atje. Gjatë gjithë kohës, dv ishin veprimtaritë e Kryesisë se Degës, te cilat ajo i kryente njëkohësisht dhe ne marrëveshje me UÇK-në.

- Se pan, informimi dhe përpilimi politik e ushtarak i komunikatave, te cilat Kryesia e Degës i lëshonte ne emër te UÇK-së pas çdo aktivitet ushtarak ne terren.

- Se dyti, ishte puna e vët ne përkrahje politike e juridike, morale e diplomatike, shoqërore, etj te veprimtarisë çlirimtare ne emër te LPK-së brenda dhe jashtë vendit (Ditari i MK).

Veprimtaria ne emër te UÇK-së ishte mjaft e kufizuar. Me anën e komunikatave te saj flitej vetëm për karakterin ushtarak, duke shpjeguar aksionet çlirimtare, veprimtarinë ushtarake te njësive ne terren dhe vetë frontin e luftës. Nëpër to informohej edhe veprimtaria e armikut, masat që ndërmerre, ai etj. Ne komunikata tregohej karakteri ushtarak i veprimtarisë, qëllimi i aksioneve dhe detyrat e UÇK-së si force ushtarake çlirimtare. Shpjegoheshim edhe aksionet kundër armiqve, tradhtarëve e bashkëpunëtorëve te armikut. Pas shpërthimit te frontit flitej edhe për vijën luftarake, forcat që përdorëshin nga armiku ne terren, si dhe tregoheshin sukseset ne luftë. Me komunikata u bëhej thirrje edhe organizmave ndërkombëtarë, për te përkrahur luftën çlirimtare. Edhe vetë subjektet tona politike shqiptare te popullit ftoheshin që te dilnin ne anën e veprimtarisë se UÇK-së.

Pas kësaj pune, ne emër te UÇK-së, Kryesia e Degës lëshonte komunikatat e veta, deklaratat politike dhe thirrjet për popullin tonë. LPK-ja lëshonte edhe informacione ne gjuhë te huaja. Nëpër to përkraheshin aksionet çlirimtare dhe merreshin ne mbrojtje politike, juridike e shoqërore, duke i arsyetuar dhe mbështetur ne aktet ndërkombëtare. Një përkrahje e tille politike u bë mbi bazën e gjendjes politike te krijuar brenda vendit nga pushtimi i gjatë dhe i egër i pushtuesit serb. Me komunikata tregohej se shqiptarët s'kishin rrugë tjetër, veç asaj çlirimtare. Kësaj i ndihmonte edhe analiza mbi gjendjen ne Kosovë, mbi te cilën ishte vendosur diktatura e pushtetit racist serb. Me pas, kjo shpjegohej edhe ne aspektin juridik, duke lëshuar informacione, nëpërmjet te cilave tregoheshin vetë ligjet e qeverisë se Beogradit, me te cilat u sanksionua racizmi serbomadh ndaj shqiptarëve.

Por, përkundër këtyre, ende ishim larg kryerjes se detyrës. Mendimi mbi dy bazat kryesore te mbrojtjes politike e juridike nëpërmjet Fazli Veliut dhe Muhamet Kelmendit, anëtarë dhe përgjegjës te sektorit politik u aprovua ne mbledhjen e Kryesisë se Degës. Ky vendim u miratua edhe nga UÇK-ja. Mbi këto dy baza te mbrojtjes se UÇK-së u punua me vite te tëra.

- Ne anën politike tregohej me fakte se Kosovës i ishte hequr me dhunë autonomia, organet administrative ishin mbyllur e shqiptarët ishin nxjerrë ne rrugë. Edhe ne arsim, kulturë, shëndetësi, etj, ishte vendosur diktatura serbomadhe. Gjuha ishte ndaluar. Shqiptarët s'kishin te drejtë ne jetë. I tërë pushteti politik kishte kaluar ne Beograd.

- Ne sferën juridike kapeshin ligjet. Ne Kosovë ishin futur me qindra ligje raciste dhe terroriste ne fuqi. Ata e mohonin çështjen tonë kombëtare. S'kishte fushë, si ne politike, ne ekonomi, ne kulturë, ne mbrojtje, etj, që nuk u sanksionua pushtimi, dhuna e terrori i egër. Shqiptarët dilnin thjesht qytetarë te cilët duhet te zhdokeshin.

Këto dy baza ishin te forta dhe LPK-ja ne informacionin e vet i sqaronte. Kështu u veprua ne aksionet gjenerale, dy, sa ishin, si dhe ne aksionet e veçanta. Pastaj, me rastet e dhunës, burgosjeve (janar 1997), vrasjet e shokëve ne Vushtrri, janar 1997, me vonë ne Kliqinë dhe ne Drenicë, ne kufi te shteti shqiptar, apo ato ne shkurt-mars 1998, kur u masakruan e terrorizuan me qindra vetë, ose ne kumtesat për demonstratat e studentëve (1997); kudo ne shkrimet e veta këto çështje i trajtonte mbi bazën politike e juridike, duke dalë ne domosdoshmërinë e çlirimit te vendit. Kësaj, kur i shtohej edhe diskriminimi ne sferën e lirive dhe te drejtave njerëzore e qytetarë, te cilat ishin te theksuara, e rrisnin edhe me forcën e tyre. Mbrojtja politike e juridike u mbështet edhe ne veprimtarinë e serbëve si pushtues, ne

konfiskimin e banesave, shtëpive e tokave të shqiptarëve. Edhe djegiet e shkatërrimet masovike ishin objekt shqyrtimi. Ndërsa, masat e dhunës, ato të terrorit, vrasjet e masakrimet, burgosjet, etj, shërbenin si mjet për të treguar shovinizmin fashist serb, qëllimin e tyre për të zhdukur kombin tonë në Kosovë. Mbi këtë mbrojtje politike e juridike të LPK-së, për UÇK-në, kjo e fundit qartësohej si subjekt ushtarak, duke i dhënë peshën juridike e politike kombëtare, atë ushtarake. Natyrisht, kjo e përkrahur në fushën morale dhe diplomatike e rriti UÇK-në në ushtri të Kosovës.

Në dolëm me ato dy baza para qytetarëve tanë, subjekteve e organizatave të ndryshme, në mbrojtje të UÇK-së dhe të aksioneve të saj çlirimtare. Si me shkrim, me komunikata, etj, ashtu edhe në burime informative, në konferenca për shtyp nëpër qendra e në artikuj, apo në kontakte me subjekte të vendit e të huaj, deri edhe me qeveri i mbronim aksionet mbi bazën politike e juridike.

Ndërsa, duke dalë kundër punës pasive që predikonin dhe mbështesnin subjektet legale, nëpërmjet masave çlirimtare tregohej se, pa bashkimin dhe kombinimin e masave pasive me ato aktive dhe çlirimtare, nuk mund të ecej në rrugën e çlirimit të vendit. Tehu i gjithë aktivitet ishte të tregohej me fakte karakteri çlirimtar dhe kjo detyrë e shtetit.

Për të qartësuar këtë, në komunikata sillnim shembuj të shumtë të shteteve tjera, të cilat provuan se vetëm fora ushtarake e kombinuar me atë politike dhe e udhëhequr nga një mekanizëm unik shtetëror, e çliron vendin dhe e shpie çështjen para qendrave në bote, si problem që duhet të zgjidhet, jo kundër tij, po sipas vullnetit të shtetit.

b) Përkrahja diplomatike dhe morale

Në mbrojtjen e UÇK-së nuk mjaftonte vetëm ana politike e juridike. Asaj i duhej edhe një përkrahje morale dhe mbrojtje në arenën ndërkombëtare, para qendrave në bote. Kjo, për të treguar me fakte se UÇK-ja nuk ishte terroriste, organizatë kriminale, raciste a fashiste, por ushtri çlirimtare, e lindur nga populli dhe që i shërbente shtetit të Kosovës.

UÇK-ja, në fillim, vlerësohej në bote si një organizatë me elementë çlirimtare, por edhe terroriste. Kishte politikanë, deri edhe ata amerikanë, deri në fillim të vitit 1998, që e vlerësuan si ushtri me elementë terroriste, e cila duhej të ishte me e kujdesshme në veprimtari, në mënyrë që të mos kalonte në një pozitë të tillë. Kësaj propagande i ndihmonte shumë edhe propaganda e ashpër e Beogradit e cila kudo dilte me akuza për terrorizëm, duke sjellë gjoja edhe fakte të tilla. Kishte shtete që e përkrahnin këtë. Vetë ky fakt paraqiti para LPK-së dhe Kryesisë së Degës një detyrë të madhe në shpjegimin e karakterit të saj në sferën juridike e organizative, të mbështetura në normat ndërkombëtare. Në kumtesat tona dhe në konferencat për shtyp, kudo në veprimtarinë tonë, në e shtjelluam veprimtarinë e UÇK-së mbi bazën e dispozitave ndërkombëtare mbi veprimtarinë çlirimtare. Në tregonim me fakte se terrorizëm nuk është lufta e një populli që lufton për çlirimin e vendit, ku nuk kryhen aksione kundër popullsisë civile, në vende publike, ndaj fëmijëve e grave, objekteve social-kulturore, etj. Te gjitha aksionet kishin vetëm karakter çlirimtar, sepse kryheshin në mbrojtje dhe kundër forcave pushtuese.

Kjo ilustruhej me aktet ndërkombëtare të OKB-së dhe organizmave tjerë, si me aktin përfundimtar të Konferencës së Helsinkit mbi OSBE-në, si dhe me dispozitat tjera mbi luftën, terrorin dhe marrëdhëniet midis shteteve, të sanksionuara edhe në dokumentet e Parlamentit Evropian. Në sillnim prova konkrete dhe të ilustruara mbi terrorizmin serb, të kryer ndaj shqiptarëve mbi baza shtetërore, si dhe pushtetin diskriminues, racist e antinjerëzor të vendosur në Kosovë nga Serbia. Kjo ilustruhej pastaj me aktet e plaçkitjes, të dhunës e bastisjeve të shtëpive shqiptare, etj. Edhe masakrimet e dënimet e rënda zunë vend me rëndësi në këtë kapitull.

Sipas marrëveshjes se shteteve ne luftë kundër terrorizmit ndërkombëtar, parashikoheshin edhe faktet kur një veprimtari cilësohej terroriste, si brenda shtetit, ashtu edhe përballë te tjerëve, ne bote. Kënde, disa hère ne shkrimet e botuara ne "Zërin e Kosovës", ne vitin 1996-1997 dhe 1998 duke folur për terrorizmin si veprimtari kriminale pénale, shkruheshin këto elementë te veprimtarisë dhe bëhej krahasimi e ilustrimi me fakte i aktivitetit çlirimtar te UÇK-së. Lidhur me këtë, me kërkesën e Kryesisë, u shkruan edhe shumë punime. Ato tregonin karakterin e drejtë te luftës. Ndërsa, ne punimin që Nënkryetari i Degës shkroi mbi veprimtarinë tonë çlirimtare, bëhej krahasimi i saj sipas dispozitave ndërkombëtare te terrorit me veprimtarinë terroriste, prej nga nxirreshin fakte se lufta e jonë ishte luftë e drejtë dhe çlirimtare, pa asnjë élément te terrorizmit. Ky punim u botua ne "ZK" dhe, meqenëse u bë bazë e mbrojtjes se UÇK-së nga LPK-ja, po sjell para jush disa pjesë te punimit. Ne punim, mes te tjerash, shkruhej:

"Veprimtaria çlirimtare e njësisve te UÇK-së ne Kosovë nuk i ka elementet e terrorizmit, mbi te cilën mbështetet veprimtaria kriminale, sepse me akte mbi terrorin, te sanksionuara ne marrëveshjen ndërkombëtare duhet te plotësohen disa kushte për te cilësuar si te tille një a shumë aksione te subjekteve luftarake.

1. Aktet te kryhen ndaj popullsisë, te goditen qytetarët, civilët, gratë e fëmijët, pleqtë dhe pjesa e pafajshme e saj, si dhe tek objektet e vendbanimit te tyre.

2. Te goditen objektet social-kulturore, ato shoqërore dhe te karakterit historik e që nuk kanë rëndësi ushtarake.

3. Veprimtaria te kryhet ne vende publike, ku rrezikohet jeta e qytetarëve, si ne aéroporté, ne stacione te trenit, ne lokale, ne rrugë publike, shkolla.

4. Subjekti që i kryen aksionet e tilla te këtë organizim terrorist " Zëri i Kosovës" 1997)

Për këtë çështje pas vizitës se zotit Robert Gelbard ne Prishtinë ne ZK u shkrua një punim tjetër me titull: "UÇK-ja nuk bën veprimtari terroriste". Aty shkruhej:

"Ne kohën e fundit bëri një vizitë ne Kosovë i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan, Bill Klinton, zoti Robert

Gelbard. Gjatë vizitës ne Prishtinë, pasi ky u takua me Z. Rugovën, me A. Demaçin dhe me përfaqësues te tjerë shqiptarë e serbe te instaluar, mbajti një konferencë për shtyp, ne ambientet e Zyrës Amerikane ne Prishtinë.

Duke falënderuar zotin Rugova për "kujdesin që po tregonte ne bartjen e vijës "paqësore", zoti Gelbard foli për bisedimet me shqiptarë e serbo-malazezë, si dhe për mundësinë e dialogut shqiptaro-serb dhe pastaj nxori me nikoqirin e vët, zotin Rugova, edhe konkludimet mbi luftën e popullit shqiptar, përkatësisht mbi UÇK-në e veprimtarinë e saj. Gjatë kësaj vizitë nuk u la pa u përmendur edhe rëndësia e zgjedhjeve te 22 marsit ne Kosovë, jo ne kuptimin e rrezikimit te pushtuesit serb, por te ruajtjes se një lëvizjeje te qëndrueshme përpara veprimtarisë çlirimtare te popullit shqiptar.

Ne deklarimin e tij lidhur për veprimtarinë e UÇK-së, zoti Gelbard theksoi se ai "është i brengosur thellë mbi ciklin gjithnjë e me te madh te dhunës që po ndodh këtu dhe e dënojnë atë. Policia është përgjegjëse për pjesën me te madhe te dhunës që po ndodh ne Kosovë (...) Ne te njëjtën kohë, unë i konsideroj aksionet e UÇK-së, siç kam theksuar me pare, ne aksione terroriste, dhe është politikë e SHBA-së, që plotësisht te kundërshtojmë çdo aksion terrorist dhe te te gjitha organizatave terroriste". Ndërsa zoti Rugova këtë deklaratë e vërtetonte me thënien se "ne jemi te kujdesshëm dhe dënojmë çdo akt dhune dhe terrorizmi ne Kosovë". Për t'i tërhequr masat shqiptarë pas zotit Rugova dhe si përgjigje ndaj kësaj deklaratë antishqiptare, pa e kualifikuar dhe dënuar taksativisht edhe dhunën serbe mbi bazën e terrorizmit, duke e vlerësuar ashtu sikundër ishte ne dhunë terroriste shtetërore, Gelbard i përkrahur nga zoti Rugova, paraqiti zgjedhjet e 22 marsit, pasi sipas tij "ruhet lëvizja paqësore dhe ajo e fiton legjitimitetin e vet, ne akt te rëndësishëm për paqe, përballë gjendjes ne te cilën ndodhet vendi.

Kjo "përkrahje" e zgjedhjeve u bë për të tërhequr vëmendjen e popullit tonë nga UÇK-ja dhe lufta çlirimtare drejt veprimtarisë formate, asaj zgjedhore për gjoja president e parlament, e cila në ato momente ishte e dëmshme, antidemokratike. Ajo nuk e ndihmonte çështjen tonë, përderisa vendi ishte i pushtuar dhe mbahej me dhunë terroriste. Kjo nga njëra anë, pse nuk mund të zhvilloheshin zgjedhjet e lira dhe mbi bazën demokratike, kur Kosova ishte nën pushtetin ushtarako-policor terrorist. Ndërsa, nga ana tjetër, ato zgjedhje po bëheshin për të krijuar kushtet politike e juridike në bote për të dënuar UÇK-në.

Mirëpo, për të kualifikuar UÇK-në dhe veprimtarinë çlirimtare të saj në veprimtari të kriminalitetit terrorist dhe në organizatë kriminale, sikundër bëri zoti Gelbard dhe Rugova, duhej, sipas dispozitave juridike në fuqi të shteteve dhe të së drejtës ndërkombëtare mbi luftën kundër terrorizmit të organizuar, të përmbusheshin disa fakte si për organizatë, ashtu edhe për veprimtarinë e atij subjekti mbi të cilat mund dhe duhej të vlerësohej një organizatë dhe veprimtaria e saj luftarake si veprimtari terroriste kriminale. Për atë vlerësim kualifikues politiko-juridik duhej; së pari, që vendi i kryerjes së veprës penale të bëhej në mënyrë publike dhe në prezencë të qytetarëve; së dyti, objektivi i sulmit kriminal të ishte objektet civil, social e shoqëror, apo kulturor e publik; së treti, koha e kryerjes së veprës terroriste të përputhej me lëvizjen e qytetarëve nëpër objekte a në rrugë; dhe së katërti, nga veprimtaria aksionale, rrezikshmëria e jetës së qytetarëve të ishte e lartësisë së madhe, deri edhe mbytja e tyre. Elementë të tilla janë përcaktuar për organizatën e veprimtari terroriste. Sipas këtyre elementeve për veprimtari kriminale e terrorizëm të organizuar del edhe veprimtaria terroriste e shumë subjekteve sot në bote, madje dhe e shteteve, sikundër ishte ajo e Jugosllavisë së mbetur ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Por, a mundet, që ky rregull juridik ndërkombëtar mbi luftën kundër kriminalitetit dhe terrorizmit, të aplikohet edhe tek lufta e popullit shqiptar, pra, tek UÇK-ja?

UÇK-ja nuk ishte e organizuar mbi bazën e grupit terrorist kriminal dhe as nuk vepronte mbi bazat e kriminalitetit terrorist, qoftë politik, qoftë ekonomik, qoftë social apo racionacional dhe të urrejtjes, por mbi bazat juridike të shtetit të Kosovës dhe të vullnetit të popullit shqiptar për çlirimin e vendit. UÇK-ja ishte ushtri e shtetit dhe jo grup organizativ terrorist i këtij a atij kombi, shtresë a grup qytetarësh. Ndërsa, duke u shtrirë në popull, UÇK-ja ishte bërë ushtri popullore e rregullt, që kishte disiplinë ushtarake, rregulla juridike dhe që mbronte popullin e Kosovës nga sulmet terroriste dhe aksionet fashiste të qeverisë serbe të Beogradit.

Veprimtaria terroriste gjendej tek pushtuesi serb i Beogradit që po kryente terrorizëm mbi popullin shqiptar. Dhe, kjo kryhej çdo ditë. Pushteti serb po terrorizonte shtetin e Kosovës dhe një popull prej me shumë se dy milionësh të cilin e kishte vënë nën rrethimin të egër ushtarako-policor dhe të vullnetarëve çetnikë serbe. A ka terrorizëm me të lartë shtetëror se sa,

me dhjetëra fshatra të Drenicës të bllokoheshin e të liheshin pa ushqim, kujdes shëndetësor, rrymë elektrike, etj? Për të thelluar këtë, pushtuesi i Beogradit mobilizoi çetnikët serbe, malazezë, etj, dhe i armatosi ata. Mbi 50 mijë trupa policore serbe e malazezë u vendosën në Kosovë, përveç mbi 30 mijë ushtarë të sjellë nga viset qendrore e veriore të Serbisë. Policëve dhe vullnetarëve u paguhej mëditje e lartë, sipas suksesit në luftën kundër shqiptarëve. Kishte raste, sikundër u veprua në Prekaz ndaj familjes 30 anëtarësh të plakut Jashari, ku familja u godit me granata për ta zhdukur atë tërësisht.

Vet ky element, zoti Gelbard, tregon terrorizmin serb të cilin ju as që e përmendët, madje e anashkaluat me disa vlerësime kritike, sikurse veproni dhe zoti Rugova, i cili e shihte çështjen e Kosovës nga pozita e personit të tretë, duke e barazuar veprimtarinë mbrojtëse të popullit shqiptar me atë terroriste të pushtetit serb.

Ndërkohë që, për dhunën serbe nuk u veprua sipas dispozitave juridike mbi terrorizmin, a keni të drejtë, atëherë, zoti Gelbard, gjithmonë sipas aksioneve të UÇK-së, të fusni veprimtarinë e saj në kuadër të kriminalitetit terrorist? Ju zoti Gelbard e dini, jeni ekspert dhe

përgjegjës për politikën kundër terrorizmit në SHBA, se kërkohet të plotësohen të katër kushtet e theksuara për terrorizëm si për atë shtetëror, ashtu edhe atë jo shtetëror, në mënyrë që të kemi terrorizëm politik, ekonomik a kombëtar e ndërkombëtar, si dhe kundër njerëzimit. Vetë dokumenti i KS të OKB-së të vitit 1989, kur ndodhi rasti me aeroplanin në Skoci, ku humbën jetën mbi 250 udhëtarë, i ka përcaktuar këto elemente juridikë.

Prandaj, veprimtaria e UÇK-së nuk është terroriste, zoti Gelbard. Ju e dini gjendjen në Kosovë. Nuk mund të pranohet ai vlerësim kur UÇK-ja ishte organizatë çlirimtare. UÇK-ja nuk vepronte nëpër vende ku për asgjësimin e objektivit ushtarak kalonte rruga publike a komunikacioni hekurudhor, ai tokësor a ajror, etj, ishte objekt me rëndësi shoqërore publike e ku kishte frekuentim të lartë të qytetarëve, apo ndonjë vend a objekt me rëndësi kulturore e sociale, me rëndësi shëndetësore, element të parë për kualifikim terrorist. Objekt i sulmit të UÇK-së ishin vetëm forcat pushtuese, ato të armatosura ushtarake e policore serbe të cilat po terrorizonin dhe dhunonin qytetarët shqiptarë, duke rrahur, vvarë e masakruar. Në fakt, UÇK-ja vetëm po mbronte qytetarët e Kosovës nga terrorizmi serb, veprim që zoti Gelbard e vlerësoi për terrorizëm. Kjo s'ka logjikë.

Nëpërmjet këtyre aksioneve nuk përmbushej as elementi i kohës dhe ai i rrezikimit të jetës së qytetarëve civilë, të fëmijëve, grave e pleqve, atyre që nuk merreshin me luftë. Përkundrazi, UÇK-ja mbronte të gjithë qytetarët e shtetit, pa dallim përkatësie kombëtare, gjinie a shtrese. Duke u organizuar dhe vepruar sipas Kushtetutës së shtetit të Kosovës, të gjithë qytetarët ishin të njëjtë, shtetas të Kosovës, ushtri e të cilit ishte UÇK-ja. Edhe koha e kryerjes së aksioneve dhe rrezikshmëria për qytetarët e pafajshëm nuk ekzistonte. Përkundrazi, UÇK-ja i mbrojti qytetarët e shtetit në prag të shtëpisë, ndërsa për t'u mbrojtur edhe ka sulmuar objekte, kur as me i vogli element i rrezikimit të jetës së qytetarëve nuk ekzistonte. Asnjë objekt civil, banesë, shkollë, etj, nuk u sulmua nga UÇK-ja. Pra, kemi të bëjmë vetëm me aksione çlirimtare, të drejta dhe ligjërish të justifikueshme.

Veprimtaria e UÇK-së mbështetej edhe në dispozitat juridikë të shtetit të Kosovës. Në Kushtetutën e Kosovës ishte rregulluar ana juridikë e ushtrisë së shtetit. Aty del se Kosova duhej dhe kishte të drejtë të organizonte ushtrinë e vet të rregullt. Duke u mbështetur në dispozitat kushtetuese u organizua UÇK-ja. Ajo, me vullnet të LDK-së apo pa të e të zotit Rugova, të organizmave ndërkombëtare, etj, ishte shndërruar në ushtrinë e shtetit të Kosovës. Dhe, kjo ushtri duhej respektuar domosdoshmërisht. Ajo ishte kompetente, sepse doli nga vullneti i popullit dhe me luftë mbrojtëse fitoi legjitimitetin politik e juridik në Kosovë. Madje, kjo është e drejtë e çdo shteti. Në të kundërtën, pse shteti i kanë forcat e veta të armatosura? Çfarë i duhen atëherë SHBA-së mbi 3 milionë ushtarë, CIA, FBI-ja, apo pse ekziston pakti i NATO-s? Sikurse çdo shtet ka forcat e veta, edhe Kosova i kishte organizuar forcat e veta të armatosura në UÇK-ë. Kjo ishte e drejtë legjitime.

Mbi këtë bazë juridikë tregohet karakteri çlirimtar i UÇK-së si subjekt i organizuar ushtarak dhe në fushën e aktivitetit të vet në terren. Kjo ishte një mbrojtje e madhe jo vetëm morale, por edhe politike e juridikë e UÇK-së. Kësaj i ndihmonin edhe vetë aksionet në Kosovë. Këto aksione ishin çlirimtare, ndonëse kishte ndonjëherë edhe aksione jo shumë të studiuara dhe jo të kapshme për momentin. Por, parimisht ishte një veprimtari thjesht çlirimtare. UÇK-ja nuk plotësonte asnjë element të veprimtarisë kriminale terroriste, a shoviniste fashiste. Vetë organizimi i saj ishte i përcaktuar në bazë të dispozitave juridike. Edhe aksionet nuk kishin karakter të terrorizmit. Aksionet kishin karakter çlirimtar, sepse kryheshin si ndaj subjekteve fizike, ashtu edhe ndaj objekteve jo të tilla, që ishin vënë në shërbim të terrorizmit shtetëror serb. Asnjë veprimtari nuk u krye ndaj subjekteve, bazave a objekteve me rëndësi për popullin dhe kombin.

Kjo mbrojtje para arenës ndërkombëtare ishte e ashpër. Me vite të tëra, që nga viti 1992, dolëm me ashpërsi provuese në përkrahjen juridike- diplomatike. Me anën e ndihmës sonë, përballë akuzave të mëdha, nuk u arrit kurrë që UÇK-ja të futej në kuadër të organizatave

terroriste e kriminale. UÇK-ja karakterin e vet e mori ne vitin 1997-1998. Fundi i vitit 1997 dhe shpërthimi i luftës frontale e vuri subjektin e jashtëm para aktit te kryer përballë UÇK-së. Tash (viti 1998) askush nuk kishte mendimin se UÇK-ja kishte elemente te terrorizmit. Veç fakti se ajo kishte dalë ne balle te kombit, ne mbrojtje te familjes shqiptare, te jetës se fëmijëve, grave e qytetarëve, i jepte karakterin e një ushtrie popullore. Ky element e vuri UÇK-në ne taban te ushtrisë, si te çdo ushtrie te shteteve, me norma e rregulla juridike pozitive ne bote.

3. Financimi i UÇK-së

Krahas detyrave për të cilat u diskutua më lartë, një punë tjetër e madhe dhe po aq e rëndë sa edhe detyrat në fushat e përmendura, për UÇK-në ishte veprimtaria e Degës së LPK-së në gjetjen e mjeteve dhe të formës së financimit për financimin e UÇK-së.

Më lartë treguam mënyrën e financimit për periudhë të caktuar. Por, theksuam gjithashtu se deri në vitin 1993 mjaftonte në një masë forma e ndihmave nëpërmjet anëtarësisë. Ajo për kohën ishte e mjaftueshme, ndonëse kishte mungesa.

Me ndërtimin organizativo-juridik, si dhe me zgjerimin e radhëve të UÇK-së u thellua edhe nevoja e mjeteve. Tashmë nuk mjaftonin mjetet që siguroheshin nëpërmjet anëtarësisë dhe ndihmave vullnetare të anëtarësisë së Kryesisë dhe KP-së. Duhej, si organizatë, të gjenim forma të ndryshme të financimit për të bërë të mundur funksionimin e saj si ushtri.

Nga diskutimet në Kryesi u përcaktuan dy forma të financimit:

1. Financimi nga LPK-ja dhe mërgimtarët (d.m.th LDK vërejtja jone, se mërgimtarët, në atë kohë, të gjithë ishin anëtarë të LDK)
2. Financimi i UÇK-së nga qeveria e Bukoshit dhe subjektet politike (prapë nga LDK sepse subjekte tjera politike s'kishte në diasporë)

Financimi nga LPK-ja dhe mërgimtarët (lexo mërgimtarët d.m.th LDK).

Ky financim ishte formë që zbatohet, por jo sa kishte nevojë lufta. Për këtë shkak kjo çështje u mor në shqyrtim shumë herë. Madje, u përcaktuan edhe mjete të veçanta financiare për anëtarët e Kryesisë së Degës, të KP-së dhe më vonë për të gjithë anëtarët. Shuma për t'u paguar ishte 1000 Fr. zvicerane. Por, kjo formë e financimit ishte shumë pak, sepse ishte e pamundur të mbuloheshin të gjitha shpenzimet e ushtrisë. Ajo nuk arrinte të mbulonte as një të tretën e nevojave financiare.

Në kuadër të analizave për gjendjen financiare, nga përgjegjësi financiar Gafurr Elshani, në vitin 1993-1995, u paraqitën në organet e organizatës disa propozime për financim. Ato konsistonin në tri drejtime.

1. Financimi nëpërmjet anëtarësisë së anëtarëve të LPK-së.
2. Përcaktimi i shumave vjetore a mujore për anëtarë, simpatizantët e LPK-së, në lartësi prej 1000 Fr. zvicerane, apo në kundërvlerë në DM dhe në valuta tjera.
3. Hapja e një Fondi dhe ndërtimin e Këshillit të Financimit për të pasur mundësi të ndihmohej sipas vullnetit (Vendimi i LPK-së).

Çështje të tilla u shqyrtuan nga Kryesia me disa rregulla, sidomos në formë dhe u paraqitën në KP të LPK-së për t'i miratuar. Por, edhe pse u aprovuan, këto nuk mund të fuqizoheshin pa miratimin e Mbledhjes së Përgjithshme të LPK-së. Kështu që, në M të Katër, në vitin 1993, u aprovuan të tri këto forma të financimit të UÇK-së dhe LPK-së. Vetëm për formën e parë pati fërkime, sepse u paraqitën dy propozime ; ai me shumë të caktuar mujore dhe ai me përqindje. Më në fund u vendos për shumë mujore prej 60 frs dhe në kundërvlerë në DM e monedha tjera të shteteve në Evropë. Ndërsa, financimi vullnetar mbeti në vullnetin e masave. Për atë nuk mund të vendosim. Në një mbledhje e lamë prej 1000 DM. Me vendim të KP prej vitit 1995 e deri në vitin 1998, u ekzekutua pesë herë nga anëtarët e Kryesisë dhe të KP të LPK-së Dega jashtë .vendit, si dhe tri herë nga të gjithë anëtarët.

Nga mjetet e anëtarëve të organizatës bëhej financimi 50% me 50%. Shuma e parë i dedikohej UÇK-së, ndërsa pjesa e dytë ndahej në dy pjesë:

1. Në financimin e radhëve jashtë vendit në shumë prej 20%, dhe
2. Në financimin e radhëve brenda vendit në shumë prej 30% (Vendimi i MP të PLK-së, 1995)

Por, edhe pse u bë ko ndarje, mjetet përsëri kaluan vetëm për UÇK-në. As edhe një përqindje të vogël nuk u shfrytëzua për punën e brendshme të LPK-së, pa bërë fjalë për nevojat e organizatës jashtë vendit. Ati mbuloheshin individualisht. Por, përsëri ishte pak. Me kërkesën e UÇK-së për mjete, nuk kishte rrugë tjetër, veç futja e të tëra mjeteve në fondin e dedikuar për UÇK-në. Por, pikë e dobët në këtë rast ishte, se përgjegjësit nuk raportnin. (D.m.th, edhe anëtarët e LPK-së manipuloheshin, v.j)

Me qëllim të mbledhjes së financave ishte hapur Fondi “Vendlindja Thërret”.

Kjo u aprovua njëzëri në MP të Degës, pa asnjë votë kundër. Para kësaj mbledhjeje kishim zgjedhur edhe Këshillin e Fondit, i cili funksiononte nën përgjegjësinë financiare të LPK-së. Më vonë u zgjodh kryetari i tij, Jashar Salihu, si dhe anëtarë të tjerë të këtij këshilli nëpër nënkëshilla në shtete të ndryshme, që njëherësh ishin dhe anëtarë të Këshillit Qendror të Fondit “Vendlindja Thërret”. Ndërsa, mbledhja e ndihmave bëhej në dy forma:

1. Nëpërmjet nënkëshillave e këshillave të cilët shkonin tek bashkatdhetarët dhe mblidhnin në bazë vullnetare mjete financiare.
2. Nëpërmjet shpërndarjes së çeqeve të plotësuara bashkatdhetarëve, ku mungonte vetëm shumta e cila caktohej nga personi që e paguante atë sipas dëshirës.

Si njëra, ashtu edhe forma tjetër e ndihmave kalonin nëpërmjet Këshillit të Fondit. Ndërsa mbi këto ishin organet e LPK-së, të udhëhequra nga Kryesia. Por, për funksionim për të vepruar, iu la më shumë fushë këshillave të financimit për të vepruar. Kjo, d.m.th. se, deri në shumën prej 5000 DM kishte të drejtë këshilli pa vendim për t'i ndarë për punë të veçanta edhe pa lejen e Kryesisë së Degës. Mbi këtë shumë duhej, sipas qëndrimit të Kryesisë dhe KP-së, të vendosej në organin mbi bazën e kërkesës. (*Vendimet e LPK-së*)

Struktura juridike e organeve financiare

Në dhjetor të vitit 1995 u mbajt Mbledhja e Pestë e Përgjithshme e Degës. Në mbledhje u zgjodh KP i Degës. Ky zgjodhi Kryesinë e tij. Aty u bë edhe organizimi dhe plotësimi i sektorit të veçantë me Azem Sylen që i kishte fituar votat për anëtar të Kryesisë dhe me Jashar Salihin që e zgjodhi Kryesia e KP të Degës së LPK-së si përgjegjës të Fondit. Edhe përgjegjësi financiar u ndryshua në mbledhje. Bashkim Mazreku ishte përgjegjës i tërë veprimtarisë financiare pa dallim nga fusha e financimit.

Tashmë në kuadër të organeve kishim tërë strukturën:

Spektori financiar i LPK-së ishte organ udhëheqës dhe përgjegjës i tërë sistemit financiar.

Këshilli Qendror i Fondit “Vendlindja Thërret” i dalë nga KP, i miratuar në MP të Pestë dhe duhej të raportonte tek përgjegjësit financiar i organizatës.

Këshillat e financimit dhe këshillat të cilat vepronin në terren. (Vendimet e KP dhe të Kryesisë së LPK-së 1995)

Nxjerrja këtyre organeve u bë më vonë. Por, pikërisht plotësimi i këtyre sektorëve me njerëz të rinj nxori probleme. Tani kryetari i Fondit Jashar Salihu nuk raportonte tek përgjegjësi financiar. Jashar Salihu thoshte se sipas vendimit nuk i nënshtrohet Bashkim Mazrekut, por Këshillit të Përgjithshëm, as edhe të Kryesisë. Kjo gjendje nuk u pranua nga Bashkim Mazreku dhe ai dha dorëheqje të parevokueshme. Por, kjo nuk e zgjodhi çështjen në financë. Ne e futëm përsëri Gafurr Elshanin në përgjegjës financiar. Por, Zoti Saliu as këtij nuk i dha raportim financiar dhe as Kryesisë. Për te nuk ekzistonin organet e Degës, sipas gjoja vendimeve. Por, vendim ishte mosdhënia e mjeteve financiare miratim të Kryesisë e cila

duhej të vendoste për shumën dhe vendin ku shkonin. Këtë e shkelte kryetari i Fondit. Prandaj mos dhënia e përgjegjësisë, në njërin anë dhe, në anën tjetër, dërgimi i mjeteve brenda vendit pa informim të organeve të organizatës, por vetëm nëpërmjet sektorit të veçantë e vuri Kryesisë në gjendje të rëndë.

Pse, kur në dokumentet e LPK-së thuhej:

“Kryesia e KP të LPK-së Dega jashtë vendit është organ politik, ekzekutiv, administrativ e udhëheqës i Degës brenda dy mbledhjeve të KP të LPK-së. Para tij përgjigjen të gjitha subjektet që veprojnë në kuadër të Degës, pavarësisht veprimtarisë që kryejnë”. (Statusi i LPK-së dhe Rregullorja e Kryesisë dhe e KP të LPK-së)

Kjo bazë juridike detyronte çdo përgjegjës të jepte llogari para Kryesisë. Por, ai i përkrahur nga sektori i rëndësisë së veçantë deklaronte se nuk raportonte para Kryesisë, veç para KP, pasi ai ishte sektori i veçantë dhe kryetari i tij Xhavit Haliti duhej të raportonte në Kryesi. Ky ishte arsyeja, ndonëse i padrejtë, sepse as në KP nuk raportoheshin plotësisht. Ndërsa, në Kryesi Xhavit Haliti, si kryetar nuk jepte raporte të qarta. Ai tregonte shumën që dërgoheshin në Kosovë, sipas regjistrimit të vet, pa sjellë prova se kush konkretisht i ka pranuar mjetet. Megjithatë, deri në prill të vitit 1997, u pranua në heshtje nga KP kjo formë e financimit, duke u mbështetur në vullnetin se edhe çështje do të rregullohej, nëse do të arrihej të ndërtohej një ushtri çlirimtare e shtetit.

Mënyra e financimit të UÇK-së

Deri në janar të vitit 1997, kur UÇK kishte strukturën e vet të organizimit, financimi bëhej në mënyrë qendrore nga organet e atij subjekti ushtarak. Ndërsa, mjetet financiare nga këshilli i financimit i dërgoheshin ndërmjet sektorit Shtabit Qendror të UÇK-së. Ai bënte ndarjen mjeteve financiare nëpër zona e nënzonat e saj.

Pikërisht kjo formë e mënyrë e financimit në janar të vitit 1997 u dëmtua shumë, sepse disa u vranë e disa të tjerë u kapën, gjë që e dëmtoi financimin e UÇK –së. Ndonëse sektori tregonte para Kryesisë të kundërtën. Kjo edhe besohej, sepse ne, veç anëtarëve të sektorit, për të cilët e dinim se ishin anëtarë të Shtabit Qendror, të tjerët nuk i njihnim. Mirëpo, me kalimin e kohës, diku në mars të atij viti, nga ana e disa shokëve të LPK-së informohej se shumë njësi, zona e nënzona të UÇK-së (këtë e konfirmoi në mbledhje të Kryesisë Rexhë Ibërdemaj, Ali Ahmeti, si dhe Fondi nga RFGJ që kishte dërguar vet mjete financiare në Llap e Prishtinë nuk kishin marrë mjete financiare që nga janari i atij viti (*Raporti i anëtarëve të Kryesisë, prill-maj 1997*).

Kjo çështje futi në lëvizje organin tonë. Për këtë shkak ftuam një mbledhje në muajin prill të vitit 1997 dhe kërkua sqarime nga sektori, sidomos tre anëtarët, përkatësisht Xhavit Haliti, Azem Sylja dhe Ali Ahmeti, lidhur me ato informacione të cilat ishin shpërndarë në radhët e LPK-së. Këta i pranuan këto fakte,. Ata thanë se Shtabi Qendror është dëmtuar dhe se lidhjet nuk janë siç duhet midis zonave e nënzonave. Kjo e vërtetoi faktin që ne na kishin informuar me shkrim dhe me gojë se që nga janari i atij viti, as Llapi, as njësitet e UÇK-së në fshatrat e Prekazit, me komandant Adem Jasharin , as ato të Rrafshit të Dukagjinit, as njësit tjera nën pushtimin maqedon nuk kishin marrë mjete financiare. Veç kësaj, kishim të dhëna për bllokimin e armëve edhe ndaj disa njësisë në Drenicë, të cilat kishin shtruar kërkesën për armë të veçanta, po pa sukses, ndonëse nga sektori u ishte premtuar.

Deri në këtë informim ne si Kryesi, e dinim nga sektori i veçantë s, Shtabi Qendror po i ndante sipas aktivitetit, aksioneve e njësisë mjete financiare gjithandej në vend. Ndërsa, me informacionin e kësaj mbledhjeje, e tërë ajo që ishte thënë me muaj të tërë doli e pavërtetë dhe mashtrim. Mbi këtë bazë, si dhe pas konfirmimit gojor dhe me shkrim që arriti në Kryesinë e Degës edhe nga këshilla të LPK-së, që kishin lidhje me radhët e UÇK-së brenda vendit, i kaluam kompetencat e mjeteve financiare në kuadër të Kryesisë së KP të Degës.

Duke ia hequr Fondit dhe sektorit të drejtën për t'i administruar dhe ndarë mjetet (Vendim i Kryesisë së KP të LPK-së, 1997). Me këtë morëm vendimin për t'i centralizuar të tëra mjetet financiare, pa dallim fondi.

Për rrjedhojë, në maj të vitit 1997 vendosëm t'i ndajmë mjetet financiare vet sipas të dhënave që i kishim. Kështu, ne ndamë mjete financiare për njësitet çlirimtare të Drenicës, për ato të Prekazit, njësitet e Prishtinës dhe Llapit, të Rrafshit të Dukagjinit dhe për Pollog, viset nën pushtimin maqedon. Tashmë ishte Kryesia e Degës së LPK-së j. v. Që vendoste shumën dhe vendin e financimit. Krahas kësaj, sektori i veçantë dhe fondet, sidomos në Zvicër dhe Gjermani, pa dijeninë e Kryesisë financonin dhe dërgonin mjete në terren në Kosovë. Këtë nuk mund ta ndalnim, sepse KP ishte jo funksional në këtë fushë si organ; ajo ishte shndërruar në vegël të grupeve, duke bllokuar vendimet e Kryesisë për centralizimin e mjeteve. Prandaj, deri në mars të vitit 1998, vazhdoi kjo formë financimi e dyanshme: nga Kryesia e Degës, në një anë dhe, në anën tjetër, nga sektorët dhe fondet.

Pra, ekzistonin tri forma të financimit të radhëve të UÇK-së:

Financimi nga Kryesia e Degës.

Financimi nga sektori i veçantë

Financimi nga këshilli i fondit "Vendlindja Thërret".

Veç këtyre formave, edhe shpenzimet ishin në tri a katër forma

Shpenzimet në botën e jashtme

Shpenzimet e sektorit të veçantë dhe grupeve tjera në Shqipëri.

Shpenzimet për logjistikë.

Shpenzimet për financimin e UÇK-së.

Pikërisht llojshmëria e madhe dhe e bërë nga shumë organe krijoi një decentralizim të ashpër në kuadër të mjeteve financiare. Fondi u nda dhe u grimcua nëpër veprimtari dhe individë të cilët, gjithashtu, financoheshin sipas lidhjeve që kishin kërkuar, qoftë me njësitet e UÇK-së, qoftë me grupet e punës në atdhe, qoftë me sektorin që merrej me logjistikë. Të tëra këto veprimtari ishin pavarësisht plotësisht.

Që nga janari 1997 pati konflikte të mëdha me sektorin, këshillat dhe përgjegjësit e Fondit. Ata nuk raportonin, ndërsa kur jepnin raporte, ato ishin të shkurtra, tregonin vetëm shumën dhe jo se kush ishte marrësi i mjeteve. Ndërsa, shumat që dërgoheshin ishin shumë të mëdha; madje kalonin shifrën e 30 mijë DM, kishte edhe 50 e 100 mijë DM, mos edhe më shumë. Kjo e detyroi Kryesinë të paraqiste çështjen në KP të Degës. Aty u diskutua dhe iu la përsëri Kryesisë për të vendosur. Kjo ishte vetëm forma për të ikur nga përgjegjësia, sepse kështu shkohej kah decentralizimi i tërësishëm. Dhe, muajt që pasuan e vërtetuan këtë çështje. Askush nuk përgjigjej për mjetet financiare, në kohë që ato harxhoheshin në forma të ndryshme.

Ky element e detyroi Kryesinë që përsëri më 18 tetor 1997 të paraqiste çështjen në KP. Përsëri kjo ia kaloi çështjen Kryesisë. Duke e parë këtë paaftësi financimi, të përkrahur nga disa anëtarë të tjerë, u shkua në luftë frontale kundër Kryesisë. Kjo u sforcua sidomos pas shpërthimit të konflikteve të armatosura në Kosovë. Në këtë kohë filloi edhe mbledhja e ndihmave në shumë të mëdha, prandaj lufta kundër Kryesisë u bë më e ashpër. Ajo kishte për qëllim marrjen e mjeteve financiare, para se të vihej tek konfrontimi.

Sektori pretendonte t'i kishte mjetet financiare në diskonim të plotë. Ai donte të vendoste vetë për mjetet që dërgonte brenda te UÇK-ja, apo ato më të cilat bliheshin armë në Shqipëri, si dhe për shpenzimet tjera, të cilat e kalonin shumën e dhjetëra-mijëra DM: Pikërisht kjo, në mars të 1998, e detyroi Kryesinë që në tërësi të ndalonte sektorin dhe këshillin e financimit të bënin administrimin apo ndarjen e mjeteve të Fondit "Vendlindja Thërret" (Vendimi i Kryesisë së KP të LPK-së, 1998). Vendimi iu dërgua të gjitha fondeve. Me të tregojë se e tërë administrata, vetë ndarja dhe përcaktimi i shumave kaloi në Kryesi, së cilës i paraqiteshin kërkesat dhe në bazë të tyre vendosej për mjetet. Udhëheqësi i sektorit nga Kryesia për

administrimin e mjeteve u përcaktua Muhamet Kelmendi, ndërsa anëtarë u zgjodhën Ali Ahmeti dhe Adem Grabovci. Në këtë kohë e tërë Kryesia ishte në Tiranë, jo vetëm për çështje financiare, por kryesisht për kontakte dhe për problemin politik, atë të ndërtimit të Frontit Çlirimtar të Kosovës.

Mirëpo, meqenëse konfliktet ishin thelluar, sidomos në Shqipëri, midis sektorit të veçantë dhe grupit të furnizimit të njërive të UÇK-së me mjete luftarake. Kryesia u mor në mbledhjen e vet në Tiranë, edhe me çështjet e tilla. Në Shqipëri, Kryesia e Degës thirri ata (sektorin e veçantë dhe atë të furnizimit) në mbledhje të gjëra dhe caktoi dy baza të furnizimit me mjete, atë të Tropojës, të udhëhequr nga Dema dhe të Kukësit. Grupi i Tropojës, kishte të drejtë edhe për të blerë mjete për UÇK-në, përveçse merrej edhe me dërgimin e mjeteve të luftës brenda vendit, të cilat i sillte sektori i veçantë, përkatësisht Xhavit Haliti dhe Azem Sylja. Armët ua blinte Raif Gashi dhe nëpërmjet tij bëhej dërgimi i tyre në baza të rrethit të Kukësit. Këta ishin kompetentë për të furnizuar edhe bazën e Tropojës me mjete. (Vendimi i Kryesisë, mars 1998)

Kjo formë tregoi suksesin e vet të plotë, sepse bëhej kombinimi i blerjes dhe furnizimit e transportit të mjeteve. Kështu u kënaqën edhe epshtet e veçanta. Sektorët merreshin në mënyrë të ndarë me detyrat e ngarkuara, ndonëse kishte pakënaqësi. Në fund të marsit të vitit 1998, përsëri në Tiranë bëme konfirmimin e kësaj mënyre pune, të ndarë në grupe të veçanta për të rënë dakord të dyja grupet. Por, ajo e futi në luftë frontale klikën kundër Kryesisë dhe formave të tilla të punës. Që nga ky moment filloi fronti për zhdukjen e udhëheqjes politike të LPK-së.

Mënyra e financimit të UÇK-së

Deri në janar të vitit 1997, kur UÇK kishte strukturën e vet të organizimit, financimi bëhej në mënyrë qendrore nga organet e atij subjekti ushtarak. Ndërsa, mjetet financiare nga këshilli i financimit i dërgoheshin ndërmjet sektorit Shtabit Qendror të UÇK-së. Ai bënte ndarjen mjeteve financiare nëpër zona e nënzonat e saj.

Pikërisht kjo formë e mënyrë e financimit në janar të vitit 1997 u dëmtua shumë, sepse disa u vranë e disa të tjerë u kapën, gjë që e dëmtoi financimin e UÇK –së. Ndonëse sektori tregonte para Kryesisë të kundërtën. Kjo edhe besohej, sepse ne, veç anëtarëve të sektorit, për të cilët e dinim se ishin anëtarë të Shtabit Qendror, të tjerët nuk i njihnim. Mirëpo, me kalimin e kohës, diku në mars të atij viti, nga ana e disa shokëve të LPK-së informohej se shumë njësi, zona e nënzona të UÇK-së (këtë e konfirmoi në mbledhje të Kryesisë Rexhë Ibërdemaj, Ali Ahmeti, si dhe Fondi nga RFGJ që kishte dërguar vet mjete financiare në Llap e Prishtinë) nuk kishin marrë mjete financiare që nga janari i atij viti (Raporti i anëtarëve të Kryesisë, prill-maj 1997).

Kjo çështje futi në lëvizje organin tonë. Për këtë shkak ftuam një mbledhje në muajin prill të vitit 1997 dhe kërkua sqarime nga sektori, sidomos tre anëtarët, përkatësisht Xhavit Haliti, Azem Sylja dhe Ali Ahmeti, lidhur me ato informacione të cilat ishin shpërndarë në radhët e LPK-së. Këta i pranuan këto fakte,. Ata thanë se Shtabi Qendror është dëmtuar dhe se lidhjet nuk janë siç duhet midis zonave e nënzonave. Kjo e vërtetoi faktin që ne na kishin informuar me shkrim dhe me gojë se që nga janari i atij viti, as Llapi, as njësitet e UÇK-së në fshatrat e Prekazit, me komandant Adem Jasharin , as ato të Rrafshit të Dukagjinit, as njësit tjera nën pushtimin maqedon nuk kishin marrë mjete financiare. Veç kësaj, kishim të dhëna për bllokimin e armëve edhe ndaj disa njërive në Drenicë, të cilat kishin shtruar kërkesën për armë të veçanta, po pa sukses, ndonëse nga sektori u ishte premtuar.

Deri në këtë informim ne si Kryesi, e dinim nga sektori i veçantë s, Shtabi Qendror po i ndante sipas aktivitetit, aksioneve e njërive mjete financiare gjithandej në vend. Ndërsa, me informacionin e kësaj mbledhjeje, e tërë ajo që ishte thënë me muaj të tërë doli e pavërtetë dhe mashtrim. Mbi këtë bazë, si dhe pas konfirmimit gojor dhe me shkrim që arriti në

Kryesinë e Degës edhe nga këshilla të LPK-së, që kishin lidhje me radhët e UÇK-së brenda vendit, i kaluam kompetencat e mjeteve financiare në kuadër të Kryesisë së KP të Degës. Duke ia hequr Fondit dhe sektorit të drejtën për t'i administruar dhe ndarë mjetet (Vendim i Kryesisë së KP të LPK-së, 1997). Me këtë morëm vendimin për t'i centralizuar të tëra mjetet financiare, pa dallim fondi.

Për rrjedhojë, në maj të vitit 1997 vendosëm t'i ndajmë mjetet financiare vet sipas të dhënave që i kishim. Kështu, ne ndamë mjete financiare për njësitet çlirimtare të Drenicës, për ato të Prekazit, njësitet e Prishtinës dhe Llapit, të Rrafshit të Dukagjinit dhe për Pollog, viset nën pushtimin maqedon. Tashmë ishte Kryesia e Degës së LPK-së j. v. Që vendoste shumën dhe vendin e financimit. Krahas kësaj, sektori i veçantë dhe fondet, sidomos në Zvicër dhe Gjermani, pa dijeninë e Kryesisë financonin dhe dërgonin mjete në terren në Kosovë. Këtë nuk mund ta ndalnim, sepse KP ishte jo funksional në këtë fushë si organ; ajo ishte shndërruar në vegël të grupeve, duke bllokuar vendimet e Kryesisë për centralizimin e mjeteve. Prandaj, deri në mars të vitit 1998, vazhdoi kjo formë financimi e dyanshme: nga Kryesia e Degës, në një anë dhe, në anën tjetër, nga sektorët dhe fondet.

Pra, ekzistonin tri forma të financimit të radhëve të UÇK-së:

Financimi nga Kryesia e Degës.

Financimi nga sektori i veçantë

Financimi nga këshilli i fondit "Vendlindja Thërret".

Veç këtyre formave, edhe shpenzimet ishin në tri a katër forma

Shpenzimet në botën e jashtme

Shpenzimet e sektorit të veçantë dhe grupeve tjera në Shqipëri.

Shpenzimet për logjistikë.

Shpenzimet për financimin e UÇK-së.

Pikërisht llojshmëria e madhe dhe e bërë nga shumë organe krijoi një decentralizim të ashpër në kuadër të mjeteve financiare. Fondi u nda dhe u grimcua nëpër veprimtari dhe individë të cilët, gjithashtu, financoheshin sipas lidhjeve që kishin kërkuar, qoftë me njësitet e UÇK-së, qoftë me grupet e punës në atdhe, qoftë me sektorin që merrej me logjistikë. Të tëra këto veprimtari ishin pavarësisht plotësisht.

Që nga janari 1997 pati konflikte të mëdha me sektorin, këshillat dhe përgjegjësit e Fondit. Ata nuk raportonin, ndërsa kur jepnin raporte, ato ishin të shkurtra, tregonin vetëm shumën dhe jo se kush ishte marrësi i mjeteve. Ndërsa, shumat që dërgoheshin ishin shumë të mëdha; madje kalonin shifrën e 30 mijë DM, kishte edhe 50 e 100 mijë DM, mos edhe më shumë. Kjo e detyroi Kryesinë të paraqiste çështjen në KP të Degës. Aty u diskutua dhe iu la përsëri Kryesisë për të vendosur. Kjo ishte vetëm forma për të ikur nga përgjegjësia, sepse kështu shkohej kah decentralizimi i tërësishëm. Dhe, muajt që pasuan e vërtetuan këtë çështje. Askush nuk përgjigjej për mjetet financiare, në kohë që ato harxhoheshin në forma të ndryshme.

Ky element e detyroi Kryesinë që përsëri më 18 tetor 1997 të paraqiste çështjen në KP. Përsëri kjo ia kaloi çështjen Kryesisë. Duke e parë këtë paaftësi financimi, të përkrahur nga disa anëtarë të tjerë, u shkua në luftë frontale kundër Kryesisë. Kjo u sforcua sidomos pas shpërthimit të konflikteve të armatosura në Kosovë. Në këtë kohë filloi edhe mbledhja e ndihmave në shumë të mëdha, prandaj lufta kundër Kryesisë u bë më e ashpër. Ajo kishte për qëllim marrjen e mjeteve financiare, para se të vihej tek konfrontimi.

Sektori pretendonte t'i kishte mjetet financiare në diskonim të plotë. Ai donte të vendoste vetë për mjetet që dërgonte brenda te UÇK-ja, apo ato më të cilat bliheshin armë në Shqipëri, si dhe për shpenzimet tjera, të cilat e kalonin shumën e dhjetëra-mijëra DM: Pikërisht kjo, në mars të 1998, e detyroi Kryesinë që në tërësi të ndalonte sektorin dhe këshillin e financimit të bënin administrimin apo ndarjen e mjeteve të Fondit "Vendlindja Thërret" (Vendimi i Kryesisë së KP të LPK-së, 1998). Vendimi iu dërgua të gjitha fondeve. Me të tregohesh se e

tërë administrata, vetë ndarja dhe përcaktimi i shumave kaloi në Kryesi, së cilës i paraqiteshin kërkesat dhe në bazë të tyre vendosej për mjetet. Udhëheqësi i sektorit nga Kryesia për administrimin e mjeteve u përcaktua Muhamet Kelmendi, ndërsa anëtarë u zgjodhën Ali Ahmeti dhe Adem Grabovci. Në këtë kohë e tërë Kryesia ishte në Tiranë, jo vetëm për çështje financiare, por kryesisht për kontakte dhe për problemin politik, atë të ndërtimit të Frontit Çlirimtar të Kosovës.

Mirëpo, meqenëse konfliktet ishin thelluar, sidomos në Shqipëri, midis sektorit të veçantë dhe grupit të furnizimit të njërive të UÇK-së me mjete luftarake. Kryesia u mor në mbledhjen e vet në Tiranë, edhe me çështjet e tilla. Në Shqipëri, Kryesia e Degës thirri ata (sektorin e veçantë dhe atë të furnizimit) në mbledhje të gjëra dhe caktoi dy baza të furnizimit me mjete, atë të Tropojës, të udhëhequr nga Dema dhe të Kukësit. Grupi i Tropojës, kishte të drejtë edhe për të blerë mjete për UÇK-në, përveçse merrej edhe me dërgimin e mjeteve të luftës brenda vendit, të cilat i sillte sektori i veçantë, përkatësisht Xhavit Haliti dhe Azem Syla. Armët ua blinte Raif Gashi dhe nëpërmjet tij bëhej dërgimi i tyre në baza të rrethit të Kukësit. Këta ishin kompetentë për të furnizuar edhe bazën e Tropojës me mjete. (Vendimi i Kryesisë, mars 1998)

Kjo formë tregoi suksesin e vet të plotë, sepse bëhej kombinimi i blerjes dhe furnizimit e transportit të mjeteve. Kështu u kënaqën edhe epsheet e veçanta. Sektorët merreshin në mënyrë të ndarë me detyrat e ngarkuara, ndonëse kishte pakënaqësi. Në fund të marsit të vitit 1998, përsëri në Tiranë bëmë konfirmimin e kësaj mënyre pune, të ndarë në grupe të veçanta për të rënë dakord të dyja grupet. Por, ajo e futi në luftë frontale klikën kundër Kryesisë dhe formave të tilla të punës. Që nga ky moment filloi fronti për zhdukjen e udhëheqjes politike të LPK-së.

2. Financimi i UÇK-së nga qeveria dhe subjektet politike

Për këtë formë të financimit të luftës, deri në maj të vitit 1998, po diskutojmë vetëm për të treguar pozitat e tyre (klikës) në këtë fushë, për të mos thënë se dhe qesharake për UÇK-në. Me qeverinë e Kosovës, ne si Kryesi, kishim rënë në kontakt disa herë. Ajo kurrë nuk kishte dëgjuar dhe as që donte të dëgjonte për UÇK-në. Megjithatë, ne nuk e ndalnim interesimin tone. Si Kryesi bëmë disa kërkesa dhe tentuam të vendosnim edhe kontakte. Por, deri në vitin 1996, e gjithë puna jonë në këtë anë ishte e kotë, sepse jo se nuk. ndihmonin, pot as të takoheshim nuk donte zoti Bukoshi dhe të tjerët në qeveri..

E njëjta pozitë ishte edhe me subjektet

Le t'i shqyrtojmë me radhë.

“Ndihmat” nga qeveria në mërgim e B. Bukoshit

Organet e LPK-së kishin ndërmarrë veprimtari të pandërprerë për të bashkëpunuar në fushën financiare, nëse jo në sfera tjera, me qeverinë. Për këtë disa herë dërguam në emër tonë letra tek qeveria: shkuam në zyrat e saj dhe kërkuam bashkëpunim. Por, kjo iniciativë e jona u refuzua kategorish nga B. Bukofshi, madje në mënyrë injoruese dhe pa dhënë shpeshherë as përgjigje për kërkesat tona.

Të mbështetur në qëndrimin e Kryesisë për të bashkëpunuar

e koordinuar veprimtarinë e punën kombëtare, ishin caktuar shokë për të kërkuar forma dhe për të gjetur mundësi të kontakteve me këto forca politike dire me B. Bukoshin, si “kryeministër”. Në këtë kohë flitej se A. Demaçi kishte raporte të mira, mos edhe të thella me B. Bukoshin. Pikërisht, për këtë shkak, kur në nëntor të vitit 1995, erdhi për punë në Hamburg Adem Demaçi, u takova me te. Në fakt, ai erdhi aty për të organizuar “Bashkësinë Demokratike Shqiptare” - shkurt “Lobin Shqiptar”, sikundër e quante ai. Për këtë shkak u takuam në shtëpinë time dhe biseduam për çështjet që paraqiti ai.

Dy tema ishin kryesore:

Bashkësia Demokratike Shqiptare

Gjetja e formave të bashkëpunimit në llogari të UÇK-së, Lidhur me këto dy çështje shtruan mendime të ndryshme. Ai ishte për te shuar tere jetën atë organizative, etj, në llogari të Bashkësisë, ndërkohë që i thashë se edhe nëse unë pajtohem me një propozimin te tillë., jeta politike ka shkuar aq thellë, sa që pa arritur bashkimin politik në Kosove, asgjë nuk mund te arrihej. Kjo, ne fakt, u vërtetua edhe në mbledhjen të cilën e organizoi Demaçi dhe ku të gjithë përfaqësuesit e kundërshtuan, duke thënë se në Prishtinë bëhej bashkimi, e jo në boten e jashtme.

Mirëpo, përveç kësaj teme, ne takimin me Demaçin, shtrova çështjen e bashkimit politik e juridiko ushtarak M sistem, si forme e mundshme për te arritur tek ndërtimi i një sistemi shtetëror. Unë isha i qartë se gjendja do te keqësohej e situata do te mente rrugën e vet çlirimtare. Por, Demaçi as qe mendonte se kishim për t'ia arritur kësaj, duke menduar, gjë qe edhe e theksoi, se "shqiptarët s'kanë aq aftësi sa të kryejnë aksione profesionale". Megjithatë, i propozova që ai të shfrytëzonte lidhjet me B. Bukoshin, në mënyrë qe ai te na ndihmonte financiarisht, nëse nuk donte për të bashkëpunuar a për të koordinuar punën me forcën tone politike e ushtarake. Në këtë kërkesë, zoti Demaçi mu përgjigj pozitivisht, duke me thënë "se sa para doja për një aksion". Natyrisht se ndihma dhe financimi nuk jepej ne këtë formë, pot në mënyrë tjetër, duke mos e lidhur me një aksion. Por, ai përsëri m'u drejtua me pyetjen: "A mjaftojnë. 30 mijë a 50 mijë DM për një aksion?". Këtu i thashë se edhe njëra edhe shuma tjetër, nëse jepen në muaj janë të mirëseardhura, ndonëse në të ardhmen kjo shumë mund të rritej. (Shënimet nga takimi me Adem Demaçin).

Këtu e përfundua takimin, me shpresë se ai do të shfrytëzonte lidhjet me Bukoshin dhe do te hapeshin rrugët e bashkëpunimit në fusha të ndryshme. Nga kjo, në Kryesi, vendosem për t'iu drejtuar me letër zotit Bukoshi. Këtë e bëmë në dhjetor të vitit 1995. Ai nuk u përgjigj fare. Edhe në shkurt të vitit 1996 e diskutuam këtë çështje. - Përsëri e vendosem që t'i drejtohem me letër dhe përsëri asnjë përgjigje nuk ka ardhur nga zotëria. Në qershor ngarkuam E. Xhemailin për ta ftuar dhe kërkuar takim me Bukoshin. Ai e kishte ftuar atë dhe pas tri ditëve Bukoshi dha përgjigjen se donte te takohet me ne në fillim të korrikut, në Ulm për të diskutuar çështjet e shtruara.

Në takim, shkova unë (Muhamet Kelmendi) dhe një shok tjetër (Emrush. Xhemajli. Në anën tjetër vetëm -Bujar. Bukoshi.

Temat e diskutimit i hapa unë. Ato ishin:

1. Bashkëpunim në sferën politike dhe organizative.
2. Ndihma ushtarake.

Për ç'shtien e parë, si unë ashtu edhe Xhemaili, treguam qëllimin e bashkëpunimit, që duhej të shkonte kah koordinimi i aktivitetit tonë politik e aksionar, në mënyrën që shpërthimi i luftës të na gjente të bashkuar në Frontin për çlirimin e Kosovës. Ne kërkuam qe ai t'i vinte në shërbim të luftës institucionet e shtetit sepse pa një sistem çlirimtar mbi bazën shtetërore nuk mund të korrnim sukses. Ky ishte arsyetimi ynë.

Lidhur me këtë ai u përgjigj prerazi:

"Unë nuk guxoj të bashkëpunoj me ju, aq më pak që të lidh ndonjë marrëveshje, apo të vë institucionet e mia në favor të luftës. Ne jemi për format paqësore, ndonëse e di që ato nuk korrrin asnjë sukses, por unë vij nga një bazë e tillë dhe duhet ta përkrah atë". (Shënimet nga takimi, 1996)

Ndërsa për çështjen e dytë, pasi i shpaguam ekzistencën e UÇK-së dhe faktin se aksionet në Kosovë po kryheshin nga njësitet ushtarake, të këtij subjekti ushtarak, të cilën e ka krijuar dhe ndërtuar LPK-ja, kërkuam që qeveria e Kosovës të na ndihmonte financiarisht, sepse nevoja e mjeteve ishte shtuar dhe ne nuk kishim aq mjete financiare sa kërkonte situata

e krijuar. I thamë se UÇK-së i duhen aktualisht 30 mijë DM në muaj për të ekzistuar si subjekt nëpërmjet aksioneve çlirimtare.

Për atë ai u përgjigj se ka biseduar Demaçi dhe se ai është dakord të japë shumën prej 30 mijë DM në muaj, por –vetëm fshehurazi, sepse nuk guxonte nga të tjerët të merrte mjete, pa dhëne llogari e aq me pak për ndonjë subjekt tjetër, siç është Meqë ai tha këtë, me propozimin e Bukoshit, ne ramë dakord dhe e gjetëm mënyrën e komunikimit me pseudonime e shenja kur ai të kishte mundësi të jepte ndihma. I treguam edhe personin që kishte për të shkuar për t'i marrë mjetet në dorëzim. Bukoshi dha dy muaj mjete; njëherë 30 mijë DM, për korrikun dhe në shtator të vitit 1996, 20 mijë DM. Kurrë më, pas vitit 1996 deri në mars të vitit 1998 nuk dha mjete dhe as pranoi të bisedojë me forcat tona të LPK-së. Për te, ne nuk ekzistonim më.

Mirëpo, me shpërthimin i luftës së armatosur, pas dhunës e terrorit masakrave mbi popullatën civile në Drenicë, me 28 shkurt 1998, si dhe ne viset tjera, ne caktuam përsëri shoke për të shkuar e biseduar me te. Për atë kishim biseduar shumë shokë edhe më herët. Thuhej se disa vetë kanë shkuar dhe biseduar me te në emër të UÇK-së në emër personal si shqiptarë. Por, sa qëndron kjo unë nuk jam informuar. E di se në organet e LPK-së, këndeje edhe të UÇK-së, sepse ende ishte Kryesia e LPK-së që vendoste edhe për UÇK-në, është biseduar dhe është caktuar një shok për të shkuar për bisedime me zotin Bukoshi. Ky e kishte edhe autorizimin. Ai ishte Xhemal Fetahu, të cilin e kishim pajisur edhe me vendimin e Shtabit Qendror të UÇK-, vendimin që e kishte lëshuar Kryesia. Këto kompetenca i kishim edhe ne të Kryesisë së Degës. (*Vendimi i ShQ UÇK-së, mars 1998*)

Krahas këtij që shkoi dhe bisedoi me Bukoshi në emër të LPK-së dhe UÇK-së kishte informacione se me të kishin biseduar edhe Shaban Mujaj (Magjupi), Jashar Salih e ndonjë person tjetër. Ata vepruan në kokë të vet. Kishin kontakte me të edhe disa njerëz të tjerë të cilët nuk ishin në

Lidhje me LPK-në dhe as që ishin anëtarë subjekteve që ne udhëhiqim. Nëpërmjet këtyre personave, përkatësisht Gent: Kelmendit, në mars të vitit 1998, B. Bukoshi kishte paguar 300 mijë DM për UÇK-në. Ai mbledhte mjete financiare në emër lutës së Drenicës kundër terrorit serbomadn në emër të masakrave në Kosovë. Edhe pse të dhënat e Këshillit Qendror Emergjencës, të krijuar nga B. Bukoshi, kishin mbledhur me miliona DM për lutën dhe UÇK-në ai dërgoi vetëm 300 mijë DM ndihmë,

Çfarë veprimesh qesharake!

Vetë shuma e tillë ishte injoruese. Ne të Kryesisë ishim në dilemë dhe vetë Kryesia u nda në dysh: njëra palë e kryesisë ishte për të pranuar mjetet, ndërsa pala tjetër ishte kundër. Por, pas analizës së situatës, si dhe duke marrë për bazë qëllimin që i kishim vendosur vetes për ndërtimin e sistemit, pranua mjetet me qëllim që të mos shkëputen lidhjet dhe të jepnim shembull për bashkëpunim në të ardhmen edhe unifikim të luftës sonë në sistemin shtetëror çlirimtar. Ky qëllim ishte shkaku pse ne i pranua mjetet me sasinë qesharake të Bukoshit. Gjithashtu, ishte mendimi se ato mjete duheshin refuzuar, pavarësisht qëllimeve, deri sa ai di dorëzonte të tëra mjetet në fondin tonë.

"Për luftë janë mbledhur mjetet nga Bukoshi dhe vetëm luftës i duhen dorëzuar". Kjo ide teorikisht ishte e drejtë, por për kohën e gabuar, sepse në fakt edhe pse ai për luftë e terror; për Drenicë e Kosovë i kishte mbledhur mjetet financiare, po ende s'ishte koha. për të vendosur një formë të tillë, me ultimatim, dorëzimin e tyre në Fond. Ne si subjekt politik e ushtarak ende nuk i kishim lëshuar thirrjet zyrtare për të ardhur në Kuvend, për të ndërtuar Frontin për Çlirimin e Kosovës, sistemin çlirimtar me të gjitha subjektet politike, organizative pa dallim përkatësie politike e organizative. Prandaj, me këto kushte, dalja me vendim për dorëzuar të gjitha mjetet, apo për të marrë masa të tjera ndaj di, e pengonte kryesisht këtë detyrë të madhe kombëtare, atë të ndërrimit apo të ndërtimit të qeverisë çlirimtare.

Për këtë shkak i pranuar mjetet dhe kështu dhamë të kuptoj se jemi për bashkëpunim, qoftë edhe duke na injoruar me shuma të tilla qesharake. Ne kështu deshëm të tregojmë se, për Kosovën kemi të drejta të barabarta dhe vetëm të bashkuar mund të ecim në rrugën e madhe të lutës për liri.

Nëpërmjet këtij veprimi konfliktet u thelluan në organet tona. Pala që, ishte për t'i kthyer mjetet, përfaqësuesit të Fondit "Vendlindja Thërret", me Jashar Salihun e Agush Bujën në ballë, të përkrahur nga Adem Grabovci, Shaban Muja Bilal Sherifi, Bardhyl Mahmuti e ndonjë tjetër, të cilët ishin organizuar në një grup të vetin, jashtë organizatës, shkuan me këtë edhe ma tej në luftë kundër Kryesisë. Ndërsa, anën tjetër edhe pse bëmë këtë rrezikim, zoti Bukoshi nuk e pa të arsyeshme të kontaktonte me organet, edhe ose u propozua nga ana ime, me porosinë që dërgova nëpërmjet Xhemail Fetahut dhe Dukagjin Kelmendit, për t'u takuar në Bonn apo në Tiranë, ku të donte ai. Përkundrazi, mjeteve financiare dhe kërkonte lidhje individuale me ndonjë person, sikundër bëri më vonë, duke dhënë mjete individëve, jashtë strukturave organizative.

Flitet tek aktivistët e ndryshëm të UÇK-së e LPK-së në Tiranë e jashtë, se Ahmet Krasniqi, në emër të zotit Bukoshi ka pasur një transaksion me Xhavit Halitin në emër të UÇK-së në muajt korrik-shtator 1998. Ky transaksion, sipas atyre të dhënave, e kalon shumë më 7 milion markave gjermane. Por, pavarësisht nga ajo se nuk dua të besoj në lidhje të tilla individuale, nëse besohet në të dhënat e aktivistëve, mjafton ky fakt për treguar qëllimin e qeverisë. Së Bukoshit. Megjithatë, nuk dihet a është fjala për mjete të gatshme financiare, apo për mjete të investuara në ndonjë veprimtari a transaksion ekonomik, pasi për këtë nuk flitet. Po të lëmë lëmë këtë çështje në një anë, ashtu sikur flitej nëpër Tiranë.

Pra, si konkludim del: qeveria e Kosovës deri në maj-qershor të vitit 1999, zyrtarisht i ka dhënë vetëm 350 mijë për UÇK-në. Ajo gjatë tërë kësaj kohe, sikundër edhe më vonë, mbledhi mjete për Kosovën, madje lëshoi thirrje për vetëfinancim, etj, por asnjë qindarkë më shumë nuk ka dhënë për luftën. Ky është "financimi" nga qeveria.

"Ndihma" nga subjektet politike

Kjo çështje as që duhet të diskutohet, sepse asnjë subjekt politik a organizatë, për periudhën që flasim, nuk e ka financuar UÇK-në, ndonëse këtë e kanë ditur dhe kanë pasur mundësi dhe mënyra për të bërë, sepse janë informuar me kohë.

Mirëpo, edhe pse kjo dihet, këtu duhen treguar disa veprime të cilat Kryesia edhe në emër të UÇK-së i ka bërë ndaj subjekteve tjera, brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë që të gjendet mënyra e financimi të kësaj force ushtarake që ishte në ndërtim. Kjo shërbeu njëherësh edhe si mjet për të ofruar bashkëpunimin tonë në drejtim të bashkimit të, forcave tona, në luftë kundër pushtuesit, formë kjo që do të krijonte terren edhe për luftë të përbashkët çlirimtare, duke ndërtuar Frontin Çlirimtar të Kosovës.

Prej viteve të '90, disa here janë lëshuar kërkesa në adresë të LDK-së, më vonë edhe ndaj subjekteve tjera, si LBD-ja,

në mënyrë që edhe ata të dilnin me qëndrimin për të përkrahur

Fondin "Vendlindja Thërret". Edhe në kontaktet me ta, qoftë

dypalëshe, apo shumë pakëshe, si në Zvicër, FGJ, në Austri, nuk lamë asnjë rast pa e kërkuar këtë bashkëpunim. Madje, ne hoqëm dorë, nga shumë çështje që na ndanin, nga ato politike, organizative, etj, çështje të karakterit kombëtar dhe të platformës së subjekteve në llogari të bashkimit tonë në fushën financiare për UÇK-në. Edhe kjo mendonim se krijonte terren për bashkimin tonë, sepse nëpërmjet kësaj pune, krijohet terreni për bashkimin e të gjitha forcave shqiptare edhe në fushën politike e ushtarake në një sistem çlirimtar e shtetëror.

Më kujtohet nëntori i vitit 1997. Në atë kohë u organizua në BPSH-ja një mbledhje me subjektet organizative e shoqërore për çështjen e arsimit shqip në nivelin e subjekteve në botën e jashtme, në RFGJ, në Hamburg. Në mbledhje ishin tërë delegacionet e partive. Ishte edhe ministri i arsimit të qeverisë së Bukoshit. Edhe aty u kërkua bashkëpunimi politik e

organizativ me subjektet. Të dyja këto u refuzuan. U kërkua edhe ndihma në anën financiare. Por, edhe kjo formë e punës së përbashkët u refuzua nga përfaqësuesit e subjekteve politike (LDK-ja, PDJ-ja etj). Për më tepër, ato akuzuan LPK-në, sikundër bëri LDK-ja në Prishtinë, se po dilte në mbrojtje të një subjekti (kupto UÇK-në) që nuk "dihet" se kush e ka organizuar, perse lufton dhe për kë lufton, duke aluduar se atë forcë ushtarake e ka "krijuar" shteti serb e jo shqiptarët (Rilindja, 1997).

Edhe në këtë tubim, nga përfaqësuesit e LDK-së u paraqit mendimi i udhëheqjes se kësaj partie, se gjoja UÇK-ja mund të jetë forcë e vetë Serbisë, e organizuar nga ajo për t'i krijuar terren forcave policore e ushtarake serbe për të bërë masakra, etj, etj, sepse shqiptarët na qenkan vetëm për format e aktivitetit paqësor. De, mbi këtë bazë të akuzës subjektet e tjera nuk u futën fare në deklarimin e tyre. Përkundrazi, heshtën ndaj thirrjeve për të ndihmuar njësitet e UÇK-së së bashku financiarisht dhe e sabotuan. Ata krijuan frontin e rezistencës politike përballë mbledhjes së mjeteve për UÇK-në.

Subjektet politike e organizative e gjenin të udhës të mblidhnin ndihmë për veprimtari të ndryshme, si për veprimtari partiake, për arsim, për studentë, për raste të ndryshme, si familje, cilat ishin të mirëpritura dhe u përkrahën edhe nga ne, po nuk e gjetën të udhës të bashkoheshin në financimin e UÇK-së. Vetëm pas shpërthimit të luftës frontale, masakrave të rënda dhe kur dhuna e terrori u thellua në vend, filloi një bashkëpunim, por edhe ky ishte shumë i kufizuar, më tepër deklarativ, se sa faktik. Ndërsa mërgimtarët për çdo ditë i përgjigjeshin më shumë thirrjes së vendit, jepnin ndihma dhe e ndihmonin Fondin, duke mos parë se, kush e ka organizuar dhe kush e administronte. Falë ndihmës së tyre u bë edhe financimi i UÇK-së.

Për UÇK-në shumë subjekte politike lëshuan thirrje dhe dhanë edhe deklarime publike për të ndihmuar e përkrahur Fondin "Vendlindja Thërret", po përsëri nuk u futën nëpër këshilla, si dhe as që krijuan forma të ndihmës për këtë subjekt ushtarak. Ata as më vonë nuk e financuan UÇK-në, por mbetën vetëm në deklarime.

KAPITULLI III

SHPËRTHIMI I LUFTËS DHE GJENDJA POLITIKE NË KOSOVË

Dihet se Kosova kishte kohë që jetojnë nën pushtimin e egër fashist serb. Asaj ia kufizuan, mohuan dhe ia ndaluan me ligj, që në vitin '80, të gjitha të drejtat autonome. Gjatë atyre viteve u krijua një situatë e rëndë, ku të gjitha të drejtat politike, juridike shoqërore, duke e shndërruar Kosovën në koloni tipike serbe. Në vitin 1989 u bë edhe faktikisht likuidimi i statusit të krahinës. Kosova me ligj u bë pjesë e Serbisë, u tjetërsua në vend serb.

Ky likuidimi juridik krijoi ndarje midis pushtuesit dhe populli shqiptar. Forcat serbe shkuan duke e thelluar veprimtarinë e tyre diskriminuese. Përveç mohimit të të drejtave në sfera të ndryshme, ndaj popullit tërë u thelluan masat politike, atë policore mbi baza raciste, duke vrarë e terrorizuar nga pozitave shtetërore. Për shtetin serb mjaftonte përkatësia kombëtare, si fakt, për të dhunuar, vrarë dhe masakruar. Me këtë bazë u vranë gjatë viteve 1990-1997 mbi 250 shqiptarë, rreth 2 mijë u burgosën dhe mbi 500 mijë u detyruan të lëshonin Kosovën. E tërë kjo veprimtari, diskriminuese fashiste u krye zyrtarisht. Populli shqiptar u soll, nga masat shtetërore serbe, buzë likuidimit. (Raporti i KMLDN i RFGJ 1998). E gjithë kjo veprimtari u përcoll edhe me ligje, akte nënligjore e masa diskriminuese. Shteti serb sanksionoi pushtimin në fushën politike dhe kolonializmin në atë ekonomike. Ai e ndaloi arsimin, kulturën e shkencën shqiptare. Kjo veprimtari zgjoi kundër reaksionin, idenë për vetorganizim dhe për gjetjen e forcave për të rezistuar kundër zhdukjes sonë kombëtare. Populli ynë nuk mund të qëndronte vetëm në rezistencë paqësore, përballë masave të egra

raciste, atyre zhdukse, etj. Atë ishin te pasuksesshme, sepse nuk mund të ndalnin masat fashiste serbe dhe të çlironin vendin.

Janë dy faktorë që shprien tek lufta ne Kosove.

- Se pari, ne njëhën ane ishte armiku, qe shkoj duke e thelluar luftën diskriminuese. Ai kishte kohe që ishte futur ne veprimtari për te zhdukur kombin tone. Qeverise serbe te Beogradit i duhej. lufta, gjë që thelloi diskriminimin, dhunën e terrorin, masat shfarosëse e deri tek shpërthimi i luftës, me qëllim te serbizimit te Kosovës, dhe;

- Se dyti, ne anën tjetër ishte populli ynë, ai qe nuk mund te jetonte si me pare, nen pushtim dhe diskriminim, nen dhunën e egër dhe i terrorizuar, pa mbrojtje. Kjo solli vetorganizimin. dhe fillimin e luftës për vetëmbrojtje dhe për çlirim. Këtë dy elemente çuan deri tek krijimi i kushteve për shpërthimin e luftës me pushtuesit dhe organizimin tonë ushtarak, i cull u zgjerua me shpejtësi ne pranverën e vitit 1998.

1. Shpërthimi i luftës se armatosur ne Kosove

Thamë me lart se përgatitjet paraprake për shpërthimin e luftës se armatosur ishin bere. Kosova nuk mund te mbetej ne gjendje të tulle, as ne lufte dhe as ne page. Faktet për te ardhur deri tek shpërthimi i luftës se hapur te armatosur ishin prezent.

Armiku kishte sjelle forca te mëdha ne Kosove. Krahas ushtrisë se rregullt serbo-malazeze, që sipas te dhënave, në fund te vitit 1997 kishte mbi 35 mije veta, ne Kosove kishin sjelle edhe 40 mije forca speciale policore, deri edhe 3 mije vullnetare ruse e ukrainas. Ne territorin e Kosovës u vendosen edhe vullnetarë çetnike serbe te Arkanit dhe te të ashtuquajturit kapiten Draganit, te cilët kishin luftuar ne Kroaci dhe ne Bosnjë e Hercegovinë. Veç këtyre forcave, pushteti serb beri edhe armatimin e forcave vullnetare serbe e malazeze ne Kosove, të cilët e kalonin shifrën e 10 mijë. Në dhjetorë te vitit 1997 dhe ne fillim te vitit 1998, pak para se te shpërthente lufta frontale, ne Kosove ishin mbi 100 mije forca te armatosura serbe. *(Të dhënat nga vjetari anglez Militär 1997).*

Ky fakt tregonte se armiku se shpejti do te shkonte ne sulme frontale ushtarake e policore, për te bere spastrimin e territorit shqiptar nga shqiptarët, qëllim historik, ky, i shovinizmit serbomadh. Mirepo, paraprakisht, pushteti serb ne vitin 1997, beri disa provokime te armatosura, ne emër te luftës kundër • njërive te armatosura te UCK-se, si ne Lalushë, ne Prekaz e ne disa fshatra te tjerë që me vonë, në janar te vitit 1998, edhe ne Rrafshin e Dukagjinit, me qëllime te caktuara ushtarake. Me ane te kësaj, armiku donte te shihte edhe te konstatonte disa çështje te cilat, për te shkuar tek lufta e armatosur ishin te një rëndësie te madhe. Pushteti serb donte te dinte edhe reagimin e faktorit te jashtëm:

1. Te konstatonte organizimin e popullit tonë ne UÇK dhe shtrirjen e saj ne nivel territori;
2. Armët, me te cilat ishin te armatosur njësitet ekzistuese te UCK-se, si dhe aftësinë ushtarake te ndjesive te armatosura, strukturën dhe komandimin e tyre ne nivel shteti;
3. Te vërtetonte reagimin e shqiptareve dhe aftësinë mobilizuese te popullit tonë, si ne sferën politike e diplomatike, ashtu edhe ne atë ushtarake e te vetëmbrojtjes;
4. Të shihte reagimin e faktorit te jashtëm, si atij te organizmave ndërkombëtare, te OKB-se, OSBE-se, UE-se, etj, ashtu edhe të shteteve, sidomos te SHBA-se përballë Kosovës.

Për këtë qëllime, ai beri disa provokime te ashpra te armatosura ne viset e ndryshme te Kosovës, sidomos ne Drenice, duke shkuar ne shatër, tetor e nëntor te vitit 1997 me njësitë e veta si dhe duke u tërhequr, pas sulmeve e bombardimeve me arme te renda mbi fshatrat e këtij rajoni, prej nga bërë analizën ne çështjen e përmendura dhe me 28 shkurt te vitit 1998, me sulme te armatosura te nivelit me te larte ushtarak kundër popullit tonë, duke sulmuar me forca te mëdha policore e ushtarake dhe me atë vullnetare serbe fshatrat të cilat ishin shndërruar ne qendër te rezistencës dhe te luftës se popullit tonë për liri, shtet e pavarësi. kombëtare.

Ky sulm ushtarako-policor me arme ne dore; me tanke, me jashtëm:

Te konstatonte organizimin e popullit tonë ne UÇK dhe shtrirjen e saj ne nivel territori;

Armët, me te cilat ishin te armatosur njësitet ekzistuese te UCK-se, si dhe aftësinë ushtarake te ndjesive te armatosura, strukturën dhe komandimin e tyre ne nivel shteti;

Te vërtetonte reagimin e shqiptarëve dhe aftësinë mobilizuese te popullit tonë, si ne sferën politike e diplomatike, ashtu edhe ne atë ushtarake e te vetëmbrojtjes;

Te shihte reagimin e faktorit te jashtëm, si atij te organizmave ndërkombëtare, te OKB-se, OSBE-se, UE-se, etj, ashtu edhe të shteteve, sidomos te SHBA-se përballë Kosovës.

Për këtë qëllime, ai beri disa provokime te ashpra te armatosura ne viset e ndryshme te Kosovës, sidomos ne Drenice, duke shkuar ne shatër, tetor e nëntor te vitit 1997 me njësitë e veta si dhe duke u tërhequr, pas sulmeve e bombardimeve me arme te renda mbi fshatrat e këtij rajoni, prej nga bërë analizën ne çështjen e përmendura dhe me 28 shkurt te vitit 1998, me sulme te armatosura te nivelit me te larte ushtarak kundër popullit tonë, duke sulmuar me forca te mëdha policore e ushtarake dhe me atë vullnetare serbe fshatrat te cilat ishin shndërruar ne qendër te rezistencës dhe te luftës se popullit tonë për liri, shtet e pavarësi. kombëtare.

Ky sulm ushtarako-policor me arme ne dore; me tanke, me

minahedhëse, me praga, me arme automatike dhe te kalibrit te larte, deri edhe me aviacion, shënon datën e fillimit te luftës armatosur ne Kosove me forcat pushtuese serbe.

Kundër këtyre sulmeve barbare mbi fshatrat e Drenicës u vunë njësitet e UCK-se. Atë i dolën përballë armikut dhe me një heroizëm te pashoq, ndonëse pak te armatosura, ne numër gjithashtu jo te madh, thjesht si familje, u përballen me banditet serbe, të cilët bombardonin dhe Benin shkumb e hi çdo gjë qe gjenin. Duhet domosdo te përmendet këtu heroizmi i familjes Jashari, me komandantin legjendar Adem Jasharin ne ballë, të cilët me shembullin e familjes dhe të jetës se tyre, pa u tërhequr as edhe një milimetër nga beteja me armiqtë shume me te forte, me arme dhe njerëz, sfiduan armikun dhe i treguan popullit tonë rrugën e luftës për liri, pavarësi dhe demokraci. Familja Jashari veproi pa pare demin qe po pësonte, humbjen e me te afërmve, fëmijëve e nenave, baballarëve te tyre.

Ky fakt i heroizmit te larte tregon, se përkundër analizave, armiku nuk e kishte bërë llogarinë se populli ynë, pavarësisht nga organizimi jo i mire, gjendja dhe armatimi, atë dhune te egër si mbi fshatrat e Drenicës martire, nuk mend të pranonte ne heshtje. Duke marre shkas nga kjo dhune e papare masakruese dhe me brutalitet te larte sakatues, kur nga dora gjakatare serbe u vranë brenda disa ditëve, ne mënyrën me barbare, mbi 100 fëmije e gra, burra e pleq, familje te tera u vetorganizuan UCK-e dhe, me një shpejtësi te rrufeshme, u armatosen me atë arme qe patën mundësi dhe u dolën përballë banditeve te Beogradit.

Lidhur me këtë LPK-ja lëshoi një thirrje drejtuar popullit dhe një deklaratë politike, ne te cilat tregohej shpërthimi i dhunës terroriste e masakrave. Atë treguan me fakte diagonalen e shpërthimit te konflikteve te armatosura. Me të i behej thirrje popullit për bashkim, unitet e heroizëm, duke i treguan rrugën e bashkimit nen flamurin e lirisë te udhëhequr nga UCK-ja. Natyrisht, tregoheshin edhe detyrat e çdo subjekti përballë armikut dhe, shprehej mendimi për bashkimin politik e aksional ne luftime çlirimtare. Këtë dokumente u shpërndanë ne shkurt e mars te vitit 1998, ne Kosove (Dokumentet e LPK-se; viti 1998, mars).

Me këtë thirrje, masat shqiptare, ne qytet e ne fshat, u organizuan ne njësi dhe shpallen vendin e tyre te lire. Ishte kjo një revolte e përgjithshme e cila brenda dy muajve çoi deri tek kryengritja e përgjithshme popullore. Tashme, kishim neper fshatrat shqiptare shtabe të vetorganizuar te UCK-se, njësi luftarake, si. dhe atë për logjistike, furnizim e ndihma tjera. Nëpërmjet këtij vetorganizimi, nga luftëtarët e atyre vendeve u shpall e lire një tërësi e gjere territoriale e Kosovës. Me vullnet dhe heroizëm u shtri territori qe kontrollonin forcat e UCK-se ne mbi 50 % te Kosovës.

Vija e frontit ne muajin prill te vitit 1997 shkon nga fshatrat e

Skenderajt, ne kufi me Mitrovicën, deri ne kufi me shtetin shqiptar, duke kaluar neper komunën e Glllogocit, atë te Malishevës, te të Deçanit, shumë fshatra te brezit kufitar, deri ne kufi.

Keshtu forcat vullnetare arritën te ngrihen ne kryengritje te përgjithshme popullore, duke krijuar zonat e lira shqiptare, nen kontrollin e njësive te UÇK-se. Meqenëse kishim te bënim me ngritje spontane popullore, ne propagande flitej për "mbrojtje te pragut të shtëpisë" e jo për lufte çlirimtare.

E vërteta është se armiku e imponoi luftën, ndërsa populli ynë e pranoi jashtë dëshirës se vete ketë gjendje lufte, sepse u sulmua barbarisht. Shqiptaret u futen me shpejtësi ne UÇK-e, pavarësisht prej organizimit qe kishte si subjekt ushtarak, sepse kishte frike se do te masakrohej. Me ketë shënohet fillimi i luftës ne Kosove.

2. Gjendja organizative e UCK-se

Shpërthimi i luftës se armatosur ne Kosove e gjeti UÇK-ne ne një gjendje organizative jashtëzakonisht te rende. Ky subjekt ushtarak nuk kishte organizim dhe nuk kishte as komande te veten unike qendrore. UÇK-ja nuk ishte riorganizuar pas burgosjeve dhe vrasjeve qe iu bene ne vitin 1997, ndonëse njësitet e saj ishin shtuar, por pa krijuar një ushtri te organizuar dhe te centralizuar.

Qe para luftës frontale, UCK-ja kishte pësuar dëme te mëdha. Asaj i mungonte organ udhëheqës, Shtabi Qendror. UÇK-ja nuk kishte strukture te vete organizative. Qëndrimet i kishte te papërcaktuara dhe shume zona i kishin mbetur jashtë kontrollit të vet.

Në këtë gjendje, nga Kryesia u morën shume iniciativa por u bllokuan te gjitha. Ajo donte te ndihmonte me atë mundësi qe kishte UÇK-ne. Tani ajo e përkrahte politikisht, e mbronte me mjete juridike dhe ne arenën ndërkombëtare, e financonte, madje dhe u fut edhe ne veprimtari për te ndihmuar ketë force ne ndërtimin ushtarak te saj. Ajo donte te ndihmonte edhe ne ndërtimin e sistemit çlirimtar shtetëror.

Për këtë qëllim dolën disa detyra.

1. Ndërtimi i organizativ i UCK-se dhe i Shtabit Qendror.
2. Ndërtimi i sistemit çlirimtar te përbashkët ne Kosove.
3. Profesionalizimi i UCK-se me kuadër ushtarak, politik etj.
4. Krijimi i bazës unike te financimit. (Shënime nga mbledhjet e Kryesisë se KP LPK-se; 1997-98).

Lidhur me ketë çështje, fill pas janarit te vitit 1997, filluan bisedimet ne kuadër të organit tonë. Për këtë shkak ne e këshilluam sektarin e veçante dhe nga ai kërkua qe, brenda një kohe prej disa javësh (shkurt 1997) te na informonte, se deri ku ishte UÇK-ja ne çështjet e shtruara. Vetë sektori, (Azem Syla dhe Xhavit Haliti), deklaruan se ne UÇK-e është rregulluar çdo gjë. Asaj i duhen vetëm mjete. Ndërsa, anëtari tjetër, Ali Ahmeti u shpreh se UCK-ja është dëmtuar ne shume sfera te veta. (Shënime nga mbledhja). Ajo është pa organ udhëheqës dhe nuk ekzistojnë lidhje midis zonave e nenzonave. Atë veprojnë te pavarura. Kjo u vërtetua edhe nga te dhënat ne fushën financiare, qe u diskutua e ku dilte se, shume zona nuk kishin marre ndihma financiare.

Kjo gjendje e qartësoi Kryesine për shume probleme te UCK-se. Për këtë shkak, ky organ autorizoi sektarin politik te caktonte projektin e letrës për SHQ te ushtrisë sonë. Sektori u mor me atë heshtje dhe nga ai doli projekti për anën politike e organizative, si dhe për kërkesat te cilat u mbështetën ne katër çështjet e theksuara me lart ne Kryesi te KP te LPK -se Dega j.v. Letra jone ishte thjeshte, informative, pa akuza dhe kërkonte një konsultim dhe lidhje me te forte midis organeve. Ajo shprehte mendimin për anën politike e organizative dhe kërkonte informacion mbi situatën luftarake ne vend (Projekt letra e Kryesisë, 1997).

Kjo letër me kërkesat e Kryesisë iu dërgua Shtabit Qendror të UCK-se. Ndonëse, kishim të dhëna se SHQ ishte jo funksional, apo se nuk ekzistonte fare pas rasteve të janar-shkurtit 1997, ne e pranuan atë organ. Kjo letër iu dha Azem Syles. Aty u caktua edhe afati. Por, nuk erdhi asnjë përgjigje. Në vend të saj, erdhi informimi, nga ai, se UCK-ja ishte rindërtuar, funksiononte mire dhe se asaj i duheshin ndihma (Shënimet nga Kryesia).

Pikërisht kjo, shkonte ndesh me kërkesat e zonave për ndihma financiare dhe me vete informimin se, Shtabi Qendror dhe drejtuesit e tij ishin vetëm Kryesia, pasi UCK-ja nuk kishte udhëheqje, sepse ende nuk ishte organizuar Shtabi Qendror. Për këtë shkak, ne morëm mjetet financiare dhe i ndamë vete, ashtu sikundër u tha. Veç kësaj, vendosem të dërgonim një kuadër politik, organizativ dhe ushtarak në vend. Por, e gjithë kjo u refuzua. Madje, në korrik, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli sollën kërkesën e SHQ për përjashtimin e Ali Ahmetit nga anëtar i Shtabit.

Në arsyetim thuhej:

"Kërkohet nga Kryesia e KP të LPK-se Dega j.v. të miratojë vendimin e Shtabit Qendror të UCK-se për përjashtimin e Ali Ahmetit nga Shtabi dhe të Emrush Xhernailit nga organet, sepse këta pa lejen e Shtabit dhe në kundërshtim me sektorin, kanë dërguar Fehmi Lladrovcin me shoqe në Kosovë, duke krijuar e shkaktuar kështu vrasjen e dëshmorit Luan Haredinajt" (Kërkesa e Sektorit, shënime nga mbledhja e Kryesisë së LPK-se).

Këtë kërkesë e refuzuan në mënyrë kategorike si jo reale, të dëmshme dhe armiqësore. E bëmë këtë, sepse ata kishin vepruar në bazë të vendimit të Kryesisë së KP. Ndërsa, nga të dhënat e dëshmitarëve okularë, që kishin qenë në grup dhe letra e vëllait të Haradinajt, Smajlit (Ramush Haradinjt v.j.) delte se kjo akuzë ishte e pavërtetë, sepse, grupi, gjatë kalimit të kufirit kishte rënë në pritë të armikut dhe në luftë e sipër ndodhi dhe rënia e dëshmorit (Këtë e dëshmon deklaratën e Fehmi Lladrovcit dhënë Kryesisë së KP në qershor 1997)

Këtë gjendje e patën dëshmuar edhe dëshmitarë tjerë, Ali Ahmeti, Emrush Xhemaili, etj. Nga të gjitha këto vërtetohet se grupi kishte rënë në pritë.

Mirëpo, edhe pse rasti ishte ndriçuar, u kalua në sulme nga anëtarë të Kryesisë për të larguar vëmendjen nga puna jonë për ndërtimin e UCK-se. Kjo tani ishte qarte. Prandaj insistuam me këmbëngulje në realizimin e kërkesës sonë. Mirepo shokët e sektorit ikën nga mbledhja dhe për muaj të tere u vendosen në Tiranë. Për këtë shkak u dhamë edhe vërejtje, duke u bere të qarte se nëse nuk vinin në mbledhje do të nxirreshin nga organizata (Shënime mbi vërejtjen që Kryesia ia shqiptoi Xhavit Halitit e Azem Syles.) Kjo gjë i solli ata në mbledhje, ku folën kundër grupit të furnizimit me mjete luftarake, të cilët ishin të vendosur në Tropojë. Kjo ishte vetëm një orvatje dhe asgjë tjetër, sepse nga të dhënat ata vepronin shumë mire dhe kishin arritur suksese të mëdha në detyrat që kishin marrë për të kryer.

Në mbledhje të Kryesisë së KP u diskutua përsëri gjendja jone. Tashme ishte periudha e nëntor-dhjetorit 1997. Disa muaj ata nuk morën fare pjese në mbledhje dhe as që dinte kush ku ishin, përveç që thuhej në Tiranë. Kështu që, në mbledhjen e 20 dhjetorit 1997, u kalua në vendime për çështjen që preokuponte LPK-ne. Në mbledhje u vendos që të mos zbatohet asnjë veprim pa u takuar në nivel me të lartë UÇK-ja me LPK-në, ndërsa sektorit iu kufizua aktiviteti. Lidhur me këtë iu shkrua përsëri SHQ edhe një letër. Këtu po sjell projektin e letrës, sepse origjinali i saj iu është dërguar anëtareve që thuhej se i takonin Shtabit Qendror të UCK-se. Në projekt thuhej:

***"Shtabit Qendror të UCK-se nga
Kryesia e KP të LPK -se D.j.v***

Te dashur shoqe!

Që nga krijimi i UCK-se raportet midis nesh kanë qenë shumë mira. Zyrtarisht LPK-ja kishte dale në përkrahje politike, morale, juri dike e diplomatike, si dhe po e financonte atë, ndërsa

në realitet marrëdhëniet tona ishin me të afërta, derisa mund themi se i takonim të njëjtit subjekt.

Mirepo, duke a nisur nga situata e krijuar ne viset tona te pushtuara, nga detyrat qe dalin para nesh dhe nga gjendja e krijuar ne fushën ushtarake e politike-organizative, paraqitem kërkesën qe të dy organet tona udhëheqëse takoheshin.

Pet këtë takim propozuam:

1. Shqyrtimin e gjendjes aktuale ne vend (asaj politike, organizative edhe ushtarake).

2. Shqyrtimin e raporteve midis LPK-se dhe UÇK-së.

3. Gjetjen e rrugëve për të ndërtuar sistemin çlirimtar të luftës së përgjithshme çlirimtare në Kosovë. Këtu është fjala për perspektiven tonë luftarake.

Takimi ynë për t'i shqyrtuar çështjet e paraqitura a kërkuar të realizohet për shkak të gjendjes ne prag shpërthimit të konfrontimeve luftarake dhe luftës sonë çlirimtare.

LPK-ja mendonte se viti 1998 ishte viti i aksioneve të mëdha: viti i një lufte të gjerë çlirimtare; viti prej te cilit do te varej e ardhmja e kësaj pjese kombit, organizimit tonë politiko-ushtarake, etj, duke përcaktuar edhe taktikat dhe strategjinë e luftës sonë.

"Pra, takimi ka vetëm këtë pikësynim. Ai mund të mbahet brenda janarit.

Vendin dhe kohen mund ta përcaktoni dhe vendosni ju. Përshëndetje revolucionare nga Kryesia e LPK-se Dj.v."

20.121997

(Letra e Kryesisë. se KP të LPK-si)

Kjo letër iu dha anëtareve te sektorit për ta dërguar te shokët Shtabit Qendror. Afati u përcaktua, por as ndaj kësaj letre nuk përgjigj. Për ne ishte e qarte, se nuk kishte Shtab Qendror, përveç individëve te çilet vetëthirreshin Shtab, përkatësisht Hashimit, Kadriut, Azemit, Xhavitit dhe ndonjë personi brenda vendit, ne të cilin mbështeteshin këta. Prandaj, as qe iu dha përgjigje letrës sonë. Për me tepër, dy anëtarët e sektorit (Azem Sylja dhe Xhavit Haliti) u vendosen ne Tirane dhe as qe merrnin pjese ne mbledhje.

Gjate kësaj kohe, ndodhen sulmet barbare dhe masakrat e renda ne Drenice. Ajo e gjeti UCK-ne ne një gjendje te rende, pa asnjë lloj organizimi. Dhe konkretisht mund te thuhet se gjendja ishte si me poshtë:

1. UCK-ja ishte pa strukture organizative, hallka te lidhshmërisë midis bazave te veta dhe pa Shtab Qendror, si organ komandues dhe udhëheqës ne luftën tonë.

2. Zonat dhe nenzonat, njësitë luftarake nuk ishin te lidhura njëra me tjetrën dhe zonat, njësitë a bazat ushtarake, pa asnjë lidhje vepronin vetëm sipas situatës.

3. Lufta ne Kosove zhvillohej pa një komande qendrore, as të karakterit komandues dhe as te karakterit operativ, si dhe pa asnjë plan paraprak ushtarak, por vetëm mbi bazat e reagimit popullor te masave shqiptare ndaj dhunës, forma te cilat i jepnin forcave pushtuese lehtësi te madhe ne terren, sepse transportimi i mjeteve behej pa asnjë rrezik nëpër Kosove, deri tek fronti ku sulmoheshin forcat tona popullore, ne vend qe atë te goditeshin gjate tërë rrugës dhe ne gjerësi.

4. UÇK-j a nuk kishte as vije te veten politike, ndonjë subjekt politik e mbronte politikisht, apo që ia përcaktonte vijën dhe i paraqiste kërkesat politike para atyre ushtarake, brenda ne vend, përballë subjekteve, armikut dhe ne bote, ndërkohë qe ishte organizuar një "bërthamë" hashimse e cila as qe e dinte situatën aktuale.

5. Në mungese të kësaj u vetorganizua populli ne baze te lagjes e fshatit, rrethit e krahinës, duke shkuar edhe ne aksione sipas bazës përkatëse. Me moton "fshati ndihmon fshatin" u vetarmatosen me mjete luftarake te cilat gjithashtu i transportonte vete deri ne destinacion.

edhe ne fushën financiare kishte mungesa te mëdha, keqpërdorim e. harxhime te panevojshme, pa ditur se çka po blihej, sepse ne vend qe te bëhej riorganizimi i logjistikes, si dhe i ushtrisë me njerëz profesioniste, me te merreshin .njerëzit analfabete për atë çështje, me

teorinë se "vetëm hekur po blejnë". Ngaqë ishte kështu, ishte e pa mundur të kontrolloheshin se ç'kalonin neper xhepat e tyre ne mënyre diletante.

7. E gjithë lufta ne Kosove behej ne mënyre vullnetare, me tipare te kryengritjes se përgjithshme popullore, jashtë çdo kontrolli te forcës ushtarake. (Shënime mbi analizën e bere Kryesi për gjendjen ne vend.) (Konstatim me vend)

Ne këtë gjendje ishte UÇK-ja kur ndodhi shpërthimi i luftës. Ne këtë kushte, përsëri u thirr mbledhja e Kryesisë se Degës me këtë teme. Por përsëri mungonin dy anëtare: Azem Syla dhe Xhavit Haliti, te cilat ne janar dhe shkurt, nga dhjetori i 1997 qëndronin ne Tirane. Zaten këta nga dhjetori i vitit 1997, as qe vinin ne mbledhje. Por edhe pa ata, me te shpërthyer lufta frontale, me 28 shkurt të vitit 1998 u mblodh Kryesia e Degës j.v dhe i lëshoi, si çdo here, komunikatat në emër te Shtabit Qendror të UCK-se (Komunikata 43, 44 e SHQ të UCK-se). Po në një mbledhje të tillë u vendos për te shkuar ne Tirane, sepse atje i kishim edhe dy anëtarët, të cilët nuk vinin për të marre pjese ne mbledhje. Kështu, ne fillim te marsit udhëtuam si Kryesi ne Tirane, ne mënyre (le te shqyrtojmë gjendjen dhe te dalim me qëndrime politike, organizative dhe ushtarake. Qe ne mbledhjen e pare te Kryesisë, me 10 mars, u vendos qe te diskutohej pozita organizative e UCK-se, sepse për ne kishte mungesa të mëdha te cilat veç u theksuan. Atë mund te kaloheshin vetëm me riorganizim, si dhe me dërgimin e kuadrit ushtarak, politik e me ndërtimin e Frontit për Çlirimin e Kosovës (Shënime mbi punën e Kryesisë; mars-qershor 1998 ne Tirane)

Gjate kohës ne Tirane u lëshuan disa komunikata. Gjithashtu u mbajt edhe një mbledhje informative, ne Hotel Rogner, mbi situatën ne Kosove dhe luftën e popullit tonë. Ne Tirane ishin edhe shume oficerë, të cilët kishin ardhur e me te cilet u caktua te punonte një komision. Edhe ne aspektin e logjistikes gjendja ishte katastrofike. Për te gjitha këtë çështje u diskutua dhe u vendos mbledhje te Kryesisë se cilat do te kapeshin e shqyrtoheshin ne veçanti. Këtu duhet te kthehem tek heshtjet e paraqitura me sipër, sepse ne këtë kohe doli ne shesh ndërtimi grupor i cili e kishte mbërthyer UCK-ne dhe nuk lejonte ndërtimin e saj.

Kryesia e KP e dinte se UCK-ja ishte ne gjendje shume te rende. Edhe sektori e dinte këtë, por për te mos lejuar ndërtimin Frontit për Çlirimin e Kosovës, bënë bllokimin e tërë punës tjetër, gjë qe popullit tonë ne vitin 1997-1998 i kushtoi shume rende. Si me herët, sektori kërkoi qe te vinte deri tek kontakti me Shtabin Qendror, për te cilin thuhej se ekzistonte, ndonëse edhe syri i thjeshte e provonte te kundërtën. Gjatë kësaj kohe, në Shoqatën e Shkrimtareve te Shqipërisë, ku ishim duke mbajtur mbledhjen e Kryesisë, u futen ne mbledhje Azem Syla e Xhavit Haliti, Hashim Thaci e Kadri Veseli si përfaqësues te Shtabit Qendror te UÇK-se. Ne këta i njihnim si ndërlidhës midis LPK-së dhe UÇK-se, ndërsa tani na dilnin si anëtarë te atij organi i cili kurrë nuk është dëmtuar, ndonëse ishte gjendja tjetër, e kundërta asaj. Dhe, për me tepër vinin për te thane se UÇK-ja e ka bazën e vet politike, prandaj asaj nuk i duhej asnjë organizim tjetër politik, aq me pak Fronti. (Shënime nga Puna e Kryesisë)

Ky ishte për Kryesine një "sihariq" jo edhe i papritur. Kjo loje e sektorit ishte vene re, por, qe ne emër te luftës te shkohej kaq thelle, pa marre parasysh as viktimat, as demet materiale dhe shkatërrimet, kjo ishte e pakuptimte. Te gjithë e kishim kuptuar se këta zotërinj gënjenin. Nuk kishte organ te ndërtuar te UÇK-se; ai u kooptua formalisht pas disa muajve, kur Azem Syla futi si zëdhënës të tij Jakup Krasniqin, por nuk ekzistonte as baza politike, përkatësisht subjekt i organizuar politiko-organizativ, për te mos folur për ndonjë Front të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, përkatësisht te Azem Syles dhe Xhavit Halitit. Ata donin thjesht ne këtë mënyre te bllokoni punën dhe ndërtimin e atij subjekti ne mënyre ushtarake, duke dale kundër bashkimit te subjekteve dhe organizimit te popullit tonë, pa dallim partie, bindjeje e krahine ne Frontin Çlirimtar të Kosovës. Dhe, forme me e mire për këtë bllokim ishte kjo: thirrja ne atë organizma.

Mbledhja ne Tirane me këta zotërinj përfundoi me vendim që për këtë do te diskutohej e vendosej ne mbledhje te KP të LPK-se, e cila ishte vendosur te mbahej ne gjysmën e dyte te

muajit mars. Prej këtij momenti, pasi lëshuan disa komunikata, deri ne atë te 49, sektori ndaloi lëshimin e tyre. (Komunikatat 44-49). Prandaj UÇK-ja mbeti për me tepër se dy muaj (prill-qershor 1998) pa asnjë informacion. Ne këtë kohe u bllokua edhe dërgimi i kuadrit politik e ushtarak, përdeq atyre qe viheshin ne shërbim te tyre, apo qe kishin lidhje te ndryshme, krahas atyre familjare edhe shoqërore, me këta anëtarë. Askush nuk mend te depërtonte ne radhët e UCK-se pa u vene ne shërbim te klikës, ose pa pasur lidhje individuale me zonat ne vend.

Në Tiranë lëshuam edhe vendimin për grupin e furnizimit, ku ngarkuam Mërgimin e Demin udhëheqës, ndërsa atë te furnizimit ku ishte Xhaviti udhëheqës, ndihmës Azemi e Raifi, si dhe grupin me pune me oficeret, ku ishte udhëheqës Ali Ahrneti dhe anëtarë Ibrahim. Kelmendi e Naser Idrizi (Projektvendimet e Kryesisë). Përveç këtyre punëve, nuk është kryer tjetër veprimtari ne emër te UCK-se. Ndërsa, me UCK-ne merreshim vesh vetëm nëpërmjet mjeteve te informacionit te cilat me moton "mbrojtja e pragut te shtëpisë", tregonin ne televizionin shqiptar (TVSH) kryengritjen popullore. Dhe, ne fakt, kjo lufte e popullit shqiptar ishte duke u vetorganizuar, fshat pas fshati e lagje pas lagjeje, ne formacione ushtarake te UCK-se. Kjo lufte edhe u vetarmatos, sikundër edhe u financua nga populli ynë.

Me këtë nuk u ndërtua as UCK-ja dhe as sistemi çlirimtar ne Kosove. Ndërsa, grupi qe ishte organizuar, ne maj beri kooptimin e njerëzve ne Shtabin Qendror dhe me vone doli edhe me përfaqësues politike, sikundër i kemi dëgjuar ne mjetet e informimit.

KAPITULLI - IV VEPRIMTARIA DHE PENGESAT PER NDERTIMIN E FRONTIT ÇLIRIMTAR NE KOSOVE

Periudha 1997-98 paraqet kohen me te rende ne terë lëvizjen tonë çlirimtare te dekadave te fundit. Në këtë kohe u diskutuan dhe u kapen shume çështje nga ana e organeve te LPK-se dhe se. Atë kalonin nga mbledhja ne mbledhje, here tek UCK-ja dhe here te LPK-ja, si dy organe kryesore ne tabanin e organizimit tonë çlirimtar ne Kosovë. Por, as njeri dhe as objekti tjetër nuk arritën te kryejnë detyrën e vet.

Ne kuadër te diskutimeve u kapen disa çështje. Atë konsistonin:

-Së pari, ne përforcimin e UÇK-se me kuadër politik, organizativ e ushtarak, nëpërmjet te cilëve do te ndërtohej një ushtri pak. a shume, kuptohet sipas kushteve, profesionale.

-Se dyti, në punën e madhe qe kish bere LPK-ja, jo vetëm ne prag a pas shpërthimit te luftës se armatosur, por shume me beret, qe ne themelimin e saj, ku ishte përcaktuar Fronti Çlirimtar i Kosovës, si forme e organizimit te luftës çlirimtare ne vend.

Se treti, ne përfshirjen e tere masave shqiptare ne këtë lufte çlirimtare.

Me ketë çështje ne balle ia filloi punës Kryesia. Ajo ishte e bindur se pa bashkimin e masave ne një subjekt çlirimtar nuk fitohej liria dhe pavarësia. Ky paraqitej si faktor përcaktues për fatet e çlirimit dhe të bashkimit mbarëkombëtar te të gjithë shqiptareve.

1. Veprimtaria politike e juridike e LPK-se për ndërtimin e sistemit çlirimtar

Histeria e luftërave çlirimtare te shqiptareve ne periudha të. ndryshme, pot jo vetëm fe shqiptaret, por të të gjithë popujt e robëruar, ka treguar se pa bashkim s'ka fitore. Çdo here kur populli shqiptar ka arritur te bashkohet, ai ka treguar force te madhe dhe është bere i pathyeshëm përballë armiqve. Pa bashkim shqiptaret nuk do te kishin ekzistuar si komb, përballë armiqve te shumtë qe kane pasur gjate histerisë se vet te lavdishme.

Një ide e tille kombëtare ishte sanksionuar ne dokumentet e organizatës, përkatësisht ne program dhe ajo Me vendim kishte dale si çështje kryesore neper çdo mbledhje te saj. Ne e

dinim se bashkimi i popullit shqiptar ne trojet e pushtuara, ne një Front çlirimtar te Kosovës (ky bashkim mund t'i quhej edhe me emër tjetër, si sistemi çlirimtar, sepse vetëm kjo kuptohet) nuk mund te arrihej lehte dhe menjëherë. Ai do te krijohej dhe forcohej ne lufte me regjimin pushtues serb, me te cilin ishte duke u konfrontuar qe prej një shekulli duke bërë sakrifica të mëdha dhe te çdo sfare.

Ne luftën tone te madhe duheshin kapërcyer ndarjet he subjekte politike, ne organizim e ne ideologji te ndryshme, ne llogari -te bashkimit tone ne një Front. Kjo mund te arrihej, por kërkohej pune këmbëngulëse, si me forcat politikë e me masat shqiptare, ashtu. edhe me vetveten, sepse ne ishim ata qe e iniciuam atë bashkim, prandaj ne duhej ta ndërtonin atë bashkim ne sistemin çlirimtar te Kosovës, duke dhenë shembullin tone.

Me këtë ide ia nisëm punës sonë të madhe.

a) Veprimtaria politike-shoqërore

Për te ardhur deri tek krijimi i terrenit për bashkimin e te gjitha energjive te kombit tonë, ne punuam ne shume drejtime; u angazhuam ne bazën politike e shoqërore, për te vene themelet politike, nëpërmjet te cilave qartësohej politikisht bashkimi ynë ne Frontin Çlirimtar te Kosovës. Këtu dhe për atë qellim, asnjë lloj demagogjie nuk lejohej. Dihej se pa atë bashkim nuk mund te tërhiqeshin masat me vete. Prandaj, lypsej një platforme politike e cila te përcaktonte vijën politike te kombit tonë për realizimin e aspiratave te lirisë dhe te pavarësisë se shumëpritur kombëtare

Me anën e këtyre dokumenteve, sidomos duke u lidhur me ane te veprimit te zjarrte, aksionit dhe shembullit te trimërisë, sakrificës, përkushtueshmerisë, mendonim se mund te kapërceheshin pengesat e krijuara gjate jetës shumëpartiake, atë midis veprimtarisë paqësore, aktive e luftarake dhe te çlironim vendin. Ne ishim te bindur se pa kombinimin e tyre, beshtja jone s'kishte ardhmëri.

Pikërisht për këtë, fill pas rënies se: shokëve, janar 1997, e kapem këtë heshtje për ta shqyrtuar. Kryesia ngarkoi sektorin politik e juridiko-shoqëror (Muhamet Kelmendin, Fazli Veliun dhe Emrush Xhemailin) si përgjegjës për te përgatitur anën politike te bashkimit te popullit tonë, pa dallim subjekti e krahine ne Front. Prandaj, pas një periudhe te shkurtër, beshtja u paraqit përsëri ne Kryesi. Mirepo, tash ishte veç. materiali. Ne këtë material politik paraqitej përparësia politike, organizative dhe ushtarake e sistemit unik çlirimtar ne Frontin Çlirimtar te Kosovës, përballë formës aktuale, ku kishim ndarje dhe konflikte midis politikës, organizimit c armës, midis forcave bëna. Ne plan u kap se pari, ana politike e juridike:

1. Baze e platformës politike e shoqërore duhet te jete vullneti i popullit shqiptar te shprehur ne Referendumin e vitit 1992, pa lënë mënjane aspiratën histerike te kombit tonë për bashkimin e tij, ne një shtet kombëtar e demokratik te shqiptareve.
2. Ky përkufizim juridik duhet te shkoj kah krijimi i platformës unike kombëtare, pavarësisht prej asaj qe është sanksionuar ne programor e subjekteve, si forme e bashkimit, duke përcaktuar vijën unike të bashkimit politik shqiptar.
3. Nëpërmjet saj lypset qe subjektet politike, pavarësisht organizimit të pavarur juridik, të heqin dorë dhe të shpallin maratorium mbi veprimtarinë e vete politike, ne llogari të vijës politike qe do te dale riga bashkimi i tyre ne sistemin për çlirimin Kosovës.
4. Ky vullnet për çlirimin e viseve tona. dhe për realizimin e shtetit dallon ne mjete e forma të veprimtarisë, të cilat mund të tejkalohen, nëse kemi kërkesa unike, sepse çdo subjekt e di se pa kombinim të mjeteve e të formave të punës, midis atyre paqësore, aktive e luftarake nuk mund të çlirojmë vendin dhe të arrijmë aspiratën e kombit.
5. Ne këtë bashkim ne Front, me rendësi është qe të mos kemi konflikte midis partive, subjekteve e forcave qe bashkohen, por të gjithë duhet të përfshihen ne platformën ne atë të çlirimit të shtetit dhe te bashkimit të popullit.

6. nëpërmjet kësaj lypset ndërprerja e luftës politike kundër subjekteve politike, politikaneve e organizatave, ne mënyrë që me shembuj konkret të tregojmë qëllimin tonë politik, se mendojmë drejt dhe se shembull për këtë është veprimi ynë.

7. Platforma politike, me këtë pika kryesore, duhet të nxirret në mbledhje të përbashkët (Kuvend), si vend ku do të marrin pjesë të gjitha subjektet me delegacionet e veta, pa përjashtuar as njerëzit e shkencës, të kulturës dhe me influence në terren, dhe cilët duhet të ftoheshin dhe të merren pjesë si delegate pa baze organizative" (Plani për ndërtimin e sistemit çlirimtar Ditari i MK).

Pas përkufizimit të tillë politik u kalua në anën organizative dhe ushtarake të platformës. Në këtë dokument tregoheshin çështjet që e forconin luftën tonë, kur të bëhej unifikimi i të gjithëve, duke përfshirë edhe kuadrot ushtarake, atë organizative, politike e juridike, të gjithë. Me një dokument të tillë tregoheshin edhe rëndësia e përhapjes së luftës çlirimtare në tërësi, në popull dhe vend. Dokumenti tregonte:

1. Me sistem krijohet bashkimi forcave politike dhe të popullit tonë, pa dallim vendi e territori, ideologjie politike dhe ndarjeve tjera.
2. Me këtë bashkim shtrihet rezistenca në tërësinë e Kosovës, gjë që e detyron edhe armikun të grimcohet, forme kjo shumë e përshtatshme për luftën tonë çlirimtare.
3. Arritje e profesionalizimit të njësisve ushtarake dhe armatimi cilësor, me arme moderne, jo të nivelit që i kishte armiku. Por të përafërta me të,
4. Të goditej armiku shumë me ashpër dhe tërësi, duke i shkaktuar dëme të mëdha në njerëz dhe në material, si dy forma shumë të forta për të detyruar qeverinë serbe të pranonte shtetin e Kosovës,
5. Të përfitonte peshën e vetë pala shqiptare përballë qendrave në botë" (Projektplatforma e Kryesisë, 1997-98).

Paraqitja e këtyre ideve u miratua nga Kryesia dhe u vendos që mbi këtë bazë të përgatitej arsyetimi dhe të dilet para KP të LPK-se Dega për të marrë vendim dhe për të zgjidhur grupin e punës që do të vazhdonte punën me subjektet. Paraprakisht u vendos të thirrej për konsultim Shtabi Qendror, mbi këtë bazë dërguam edhe dy letra, të parafundit në dhjetor të vitit 1997, nëpërmjet Azem Syles dhe të fundit, në prill të vitit 1998, kur kërkuam kontaktim me ta. e, në vend të tyre në mbledhjen e Kryesisë erdhi Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli dhe ku me ndihmën e Azem Sylës dhe Xhavit Halitit u nda tërësisht UÇK-ja nga sistemi dhe u shndërrua në ushtri të grupit. Mirepo, para kësaj janë kryer edhe shumë veprime. Qysh në vitin 1997, në Kryesi dhe jashtë saj në formë të ndryshme, në biseda me anëtarët e sektorit, u paraqiten edhe dy pikëpamje nga sektori: Se pa, ajo e Xhavit Halitit i cili ishte që UÇK-ja të dilte me përfaqësues politik, jashtë sistemit, duke caktuar Adem Demaçin si përfaqësues gjeneral. Kundër këtij vendimi, ishte Azem Sylë i cili ishte për lidhje me disa forca, jashtë UÇK-se, me atë që me vone u ndanë nga LDK-ja dhe u riorganizuan në LBD (Shënimet në Ditar nga MK). Por, pavarësisht nga kjo ndarje e sektorit të veçantë në dysh, kur ishte fjala për të ndërtuar Sistemin Çlirimtar në Front, në mbledhje këta ranë dakord me anëtarë të tjerë të Kryesisë, ndërsa prapashpine e kishin rindërtuar klikën çështja e sistemit u paraqit zyrtarisht në tetor të vitit 1997 në KP të LPK-se, Dega j.v. Por, anëtarët e KP-se, me arsyetimin se nuk ishin të përgatitur për këtë çështje, kërkuan shtyrjen e saj. Natyrisht, sektori politik duke u mbështetur në dëshirën që kjo çështje të dilte sa më e përgatitur, propozuam që ajo të shtyhej. Ajo u bart në mbledhjen tjetër, duke kërkuar që në këtë mbledhje, kjo të shqyrtohej domosdoshmërisht. Por as në mbledhjen janarit të vitit 1998, në Wiizburg, nuk u shqyrtua kjo çështje. Edhe këtu e shtynte këtë çështje për mbledhjen tjetër, e cila do të mbahej në Wintertur të Zvicrës, me datën. 31.02.1998. Në atë mbledhje u fol për sistemin, por jo gjerësisht, sepse si në mbledhjen e mëparshme, ashtu edhe këtu, u futën çështje të raporteve midis grupeve të krijuara, gjë që bëri që të caktohej një mbledhje e një niveli tjetër, me shokët e caktuar dhe të interesuar për të kontribuar e marrë pjesë nënkas për këtë çështje.

(Mbledhjet e KP Nentor 1997, shkurt 1998). Mbi këtë vendim mbajtëm mbledhjen. Aty u analizua situata dhe u përcaktua vija politike. Mbledhja ishte dy ditore, me 20-22.02.1998 ne Bruksel. Aty u shqyrtua ne tërësi platforma politike, u dhëne mendimet mbi çështje t e paraqitura dhe u vendos qe, te lëshohej një deklaratë e cila u hartua nga komisioni i zgjedhur ne mbledhje. Mbledhja dha kahet e ardhshme te LPK-se dhe la të hapur çështjen e Frontit për Çlirimin e Kosovës. Pra, as këtu nuk u arrit qe te merrej vendimi mbi çështjen e madhe luftës sonë çlirimtare, sepse kundërshtimet ishin jashtëzakonisht te mëdha. Kishte edhe fërkime te thella. edhe mosmarrëveshje ndryshme. Ne mbledhje ishin pothuajse te gjithë anëtarët e KP. Kishte edhe të interesuar.

Sistemi çlirimtar u shtrua ne forme te Frontit ne mbledhjen e marsit te vitit 1998 te KP të LPK-se Dego. j.v. Në atë mbledhje, edhe pse ishim ne Tirane paraprakisht, sikundër edhe u fol me lart, ata të sektorit nuk erdhën fare. Te gjithë e dinin qëllimin e kesaj mbledhjeje, por tashme klika politike ishte ndërtuar, pavarësisht se nuk ishte shpallur. Atyre u duhej kooptimi anëtarëve ne Shtabin Qendror te UCK-se, zëdhënësi, qe doli me vone, bëri te njohur grupin (le doli nga deklarimi i Hashim Thaçit me shoke ne mbledhjen e .Kryesisë ne 'Tirane, ne mars 1998. nëpërmjet kësaj, u pa se po punohej për ndërtimin e një subjekti jashtë sistemit çlirimtar.

Në mbledhje te KP te Degës, ky grup e kishte klikën e vet, atë te udhëhequr nga Bardhyl Mahmuti, Jashar Salihu dhe Agush Buja, te përkrahur nga disa te tjerë. Vija e pare, ajo e sistemit çlirimtar u mbrojt riga unë, ne emër të Kryesisë, ndërsa vija e dyte, ajo e përfaqësimit politik, duke dale Shtabi Qendror me deklarate autorizonte personat me atë detyre, doli nga Bardhyl Mahmuti, Për këtë dy vija politike u diskutua dhe me shumice votash u vendos ndërtimi i sistemit ne .Kosove me emrin Fronti çlirimtar i Kosovës. Vija e. përfaqësimit u refuzua. Kjo u vendos me vota. *(Shënime nga mbledhja e KP të LPK-se, mars 1998)*

Për te arritur deri tek ky vendim, unë po sjell pjese te diskutimit tim të 'here ne emër të Kryesisë se KP të Degës, si dhe mbi bazën e planit te bërë nga ai organ, për sistemin çlirimtar. Kau, si tërësi plani është i gjate, mirëpo për shkak se elementet janë te njëjta me atë që përmenda më lart, po ndalem ne disa çështje , të cilat i theksova ne mbledhjen e .KP për Frontin. Aty, midis te tjerash thashë:

"Te dashur anetarë te KP-së!

Shteti i Kosoves nuk mund të çlirohet, nëse kemi ndarje midis forcave politike, atyre organizative e ushtarake (...) Çështja nuk është te krijimi i një force te re, pot te një subjekti çlirimtar qe i bashkon të gjithë shqiptaret, pa dallim subjekti, vendi ne luften e madhe te kombit tëne per clirimin e vendit. Per te realizuar kete, ju e dini. se LPK-ja ka te sanksionuar nëprogram Frontin çlirimtar te Kosoves, si forme te organizimit. Ajo gjendet në program,.ndërsa ne e kemi për detyre për realizuar.

Po si do te arrijmë tek çlirimi i vendit nëse nuk e fusim kombin ne një kryengritje te përgjithshme popullore? Dhe, as kjo nuk mjaftën, po qe se nuk e kemi një udhëheqje dhe nuk zhvillohet një lufte ne emër të shtetit dhe kombit. Po, në këtë ndarje, kur dhe institucionet aktuale shtetërore nuk do te futen ne veprimtari luftarake, s'ka tjetër mënyre, përveç ndërtimit te një Fronti çlirimtar te Kosovës. Me këtë do te arrijmë të shtrijnë rezistencën e kombit ne tërësi, ne masat tona popullore dhe te fitojmë mbi armikun. Ne nuk duhet te lejojmë qe populli ynë te jetë i përçare. Nëse ne luftën politike tolerohen fërkimet, kundërthëniet a mosmarrëveshjet, ne atë te armatosur, atë janë te tmerrshme dhe e dobësojnë frontin e rezistencës kundër armikut. E këtë ne nuk duhet të tolerojmë si. organizate. Ne kemi perspektive vetëm nëse bashkohemi. Ne këtë qëndron e ardhmja e luftës sonë dhe kombit shqiptar, qe është futur ne luftën e vet te madhe, ne atë çlirimtare.

(...) Sistemi çlirimtar nuk u ndërtua deri tash në Kosovë. Atë po e pengojnë shume forca, midis tjerash, edhe shume nga. "shokët" tonë, te cilët nuk janë këtu prezent (...) Ata nuk duan te "dine" se Kosova dhe viset tjera shqiptare, pavarësisht se ku janë atë, janë te gjithëve dhe velem të bashkuar ne një Front unik çlirimtar, pa dallim bindjeje politike, shtrirjeje terriore feje, vendi a lokaliteti kemi mundësi për te çliruar vendin tonë nga pushtuesit (...)

Nëse, pra, bëjmë përjashtime ne organizimin tonë, padyshim arrijmë tek:

1. Ndarja e politikës me ushtrinë, e institucioneve te shtetit nga arma e vet, ajo e luftës, duke krijuar keshtu ndarje, ne kohen kur duhet bashkimi i tere forcës sonë.

2. Pa sistem do te thellohen. konfliktet ne kuadër te subjektit shqiptar e atij politik, pikërisht ne kohen kur Kosovës i duhet uniteti politik, si organizativ dhe ushtarak, nen sistemin çlirimtar, duke u bashkuar ketë subjekte, ne një baze çlirimtare te forte.

3. Me mosndertimin e shtetit çlirimtar po dalim para. bores te pa ngritur dhe të paafte për te ndërtuar një shtet me parti e sistem demokratik, me liri te gjera politike e demokratike, si një shtet do te ndërtohet dhe zhvillohet me forcat e veta.

4. Mosndertimi i sistemit çlirimtar po bëri ndarjen e kërkesave politike, atyre shoqërore e kombëtare, duke krijuar vija te ndryshme te çështje sonë, sikur me qenë fjala për dy a me shume popuj a shtete, te cilët nuk kane gjë te përbashkët me njeri-tjetrin.

5. Ndarja e mjeteve financiare neper fonde e subjekte, si dhe te mjeteve te tjera luftarake, gjë qe e dobëson dhe do te dobësojë edhe me shume bazën luftarake, si ne financa, ashtu edhe ne mjete, te cilat ne kushtet tona kane rol dominues.

6. Ky mosunitet, me siguri, do te krijoje dëme me te mëdha, me shume viktime e terror, e masa te tjera masakruese shume te renda, te cilat pas bashkimit do te bëhen përsëri, por me një intensitet me te ulet, sepse vete kompaktësia dhe uniteti ne lufte e krijon mbrojtjen tonë me te mire krahasuar me mungesën e sistemit.

7. Ky mosunitet dobëson edhe frontin e luftës, sepse ushtaret e vullnetaret nga ky mosbashkim, humbasim besimin tek forcat tona politike, madje edhe ushtarake, sepse shohin se edhe ne lufte nuk po behet bashkimi, gjë qe e dobëson vullnetin

8. Njëpërmjet kësaj dobësohet edhe me shume pala shqiptare ne bote, tek subjektet te cilat do te intervenojnë dhe dobësohemi edhe përballë palës serbe, etj.

Natyrisht, ketë çështje nuk mund te arrihen për një dite. Atë duhet të vihen nën bazat e tilla te sistemit, duke lënë mundësi dhe kohe qe gjate zhvillimit te luftës, ai te ndërtohet. Fronti për Çlirimin e Kosovës ndërtohet dhe profesionalizohet vetëm gjate luftës, gradualisht dhe shkalle-shkalle, duke u ndërtuar juridikisht. Sistemi nuk është diçka qe krijohet brenda ditës. Ai do pune, unitet dhe veprimtari konkrete luftarake. Te tera ketë virtyte i ka lufta jone. Ne kemi forca te mjaftueshme, qofte politike, qofte organizative, qofte ushtarake, qofte te tjera. Atë duhet vetëm t'i bashkojmë ne një tërësi politike e juridike-ushtarake. Për këtë jemi te përcaktuar si organizate dhe jashtë kësaj nuk kemi te drejte programore për te vepruar" (Diskutimi mbi Prvjektregulloren e FÇK mars 1998).

Çështja e sistemit u hap si problem kryesor për diskutim ne KP te LPK-se Dega j.v. Pati ide e mendime te kundërta. Kishte edhe propozime dhe miratime -re kërkesës Kryesore te Degës për FCK-ne. Dhe, përveç kësaj, u paraqiten nga disa anëtarë edhe kundërpropozime, te cilat shkonin ne ekstremitete te thella. Por, mendimi me i ashpër dhe kundër propozimit për sistemin e shprehur, u paraqit ne emër grupit, ne mbledhjen e KP te Degës nga Bardhyl Mahmuti. Madje ai, si kundërpërgjigje dha shpjegime dhe beri edhe propozime, ku përveç diskutimit, tha:

"Ky sistem është i mire, duke i marre për baze dhe anët juridike, po nuk mund të ndertëjme, sepse subjektet jane kunder, sikunder edhe shumE politikane të tjere, prandaj propozoj qe Shtabi Qendror i UCK-se te dale me komunikate a deklarate politike dhe te autërizoje grupin e njerezve per te mbrojtur politikisht UCK-ne, si perfaqesues politik". (Sbenimet nga cliskutimi ne KP të LPK-së .

Këto dy çështje u diskutuan dhe me vota u vendos ndërtimi i sistemit me emrin "Fronti Çlirimtar i Kosovës". Për te realizuar këtë u caktua edhe grupi i punës nën udhëheqjen time (Muhamet Kelmendit). Natyrisht, për shkak të punës së madhe u caktua edhe ndihmesat, si Emrush Xhemaili, Adem Grabovci e Ali Ahmeti, të cilët do të punonin për këtë çështje (Vendimi i KP mars 1998). Këta edhe ia nisën punën për ndërtimin e sistemit çlirimtar, por menjëherë u be bllokimi nga sektori i rëndësishëm së veçantë. Për te realizuar atë deklarorin "UCK-ja e ka Shtabin Qendror, e ka bazën e vet politike, juridike e organizative, udhëheqjen politike jashtë LPK-se, si bërthamë udhëheqëse e saj". (Shënimet nga mbledhja e KP.) Me këtë bazë ata bllokuan ndërtimin e FCK-se.

Por, përkundër kësaj, mbi vendimin e KP, para MP të LPK-se, më 14.04.1998, iu shkrua nga ana ime, në emër të sektorit politik të KP, të vetë Kryesisë dhe të grupit të punës të cilin unë e udhëhoja, Shtabit Qendror të UCK-se, kjo letër:

**"Kryesia e KP të LPK-se Dega j. v.
për
Shtabin Qendror të UÇK-se**

Te dashur shokë!

LPK-ja duke e përcjelle me vëmendje aktivitetin luftarak të UCK dhe varësi nga ajo gjendje i ka vene në shërbim të luftës dhe të UCK-se tera forcat e saj mendore, politike, fizike e ushtarake, veç atyre financiare. Por, kjo nuk mjafton në luftën tonë të madhe, përballë organizimit, armës dhe forcës që ka armiku ynë.

Ai është përgatitur për të na zhdukur. Masakrat e Drenicës dhe vrasjet në kufirin shqiptaro-shqiptar (në rrethin e Gjakovës dhe Deçanit) flasin se kemi të bëjmë me një armë profesionale serbe, dhe vetëm të unifikuar politikisht, të organizuar në bazë kombëtare, ku të kemi bashkimin e të gjithëve, pa dallim subjekti, krahine e ideje, kemi mundësi të shndërrojmë Kosovën në varr për forcat pushtuese serbe. Në të kundërtën do të kemi kufizime në luftë, në forca dhe bllokime të medha në vend.

Kjo nuk duhet lejuar

Shokë,

Çështja jonë pas shpërthimit të konfliktit të armatësuar ka marrë rrugën e vështirë atë të një lufte mbarëkombëtare. Kjo na detyron që takohemi dhe diskutojmë për detyrat që dalin para nesh. Ne, në LPK-ë mendojmë se duhet të punojmë:

1. Për te here bashkimin politik e shtetëror-ushtarak të tere popullit tonë në sistemin çlirimtar (Front (çlirimtar të Kosovës), si forme e vetme e organizimit, adekuat për të luftuar me sukses armikun.

2. Nëpërmjet kësaj kërkohet që të caktojmë qartë vijën politike të luftës, mbi të cilën duhet të bëjmë mobilizimin e të gjitha masave shqiptare, madje edhe të tjerëve në sistem çlirimtar.

3. Të punohet për profesionalizimin e radhëve të UCK-se me forca të kualifikuara ushtarake (oficerë), të cilat i ka populli ynë, për te cilat nga qeveria e Bukoshit dhe sektori i rëndësishëm së veçantë që është edhe i UÇK-se nuk po lihen t'i angazhojmë

4. Të arrijmë ndërtimin e sistemit të logjistikes.

5. Të bëjmë ndërtimin e sistemit të financave mbi një bazë unike.

6. Të punojmë së bashku, në emër të LPK-së dhe ju në emër të UCK-se për te realizuar këto detyra të mëdha, të cilat janë e domosdoshme për luftën tonë.

7. Për këtë qëllim të organizojmë grupin e punës, grup që duhet të dalë pas diskutimeve të çështjeve të theksuara, në bashkëpunim mes subjekteve tona.

Çështje të tilla domosdoshmërisht duhet të shqyrtohen bashkërisht. Që ketej, vimë tek mendimi se popullit tonë i duhet domosdo një organkim në nivel shteti. Luftes sonë flirimtare i

duhen të tëra fircat, çdo subjekt dhe çdo njeri, prandaj kërkohet të punohet ne bashkimin tonë, ne mënyrë që lufta çlirimtare të fitojë karakter shtetëror.

Presim përgjigjen tuaj. Takimi mund të bëhet në Kosovë.

Për grupin e punës

nënkryetari i Kryesisë M. Kelmendi"

(Letra e derguar në emër të Kryesisë, pill 1998)

Kjo letër iu dërgua Shtabit Qendror nëpërmjet Xhavit Halitit. Por as kësaj kurrë nuk i janë përgjigjur. Ndoshta, edhe kjo e ka pësuar fatin e letrave të tjera.

Asnjëra prej këtyre veprimeve nuk korri sukses. Puna për ndërtimin e sistemit u bllokua. Ndërsa, fill pas kësaj u mbajt MP e LPK-së Dega j.v..ne datën 01 dhe 02.05.1998..Ajo, sikundër do të shohim, shërbeu thjesht si vend për të shkatërruar çdo gjë, kuptohet ne emër të Shtabit Qendror, i cili deri në kooptimin e anëtareve, maj-qershor, nuk ekzistonte. Ne shtab ishin dy a tre-kater veta që vertiteshin në Tiranë.

b) Veprimtaria juridike dhe organizative

Krahas punës që u bë në aspektin politik e shoqëror, nga sektori politik u punua edhe në fushën juridike e organizative. Kur përmenden ketë sfera, zakonisht mendohet se çështje të tilla rregullohen dhe përcaktohen juridikisht, me dokumente dhe e sanksionojnë atë organizativisht, duke i dhënë karakterin e subjektit.

Ne këtë anë dolën disa detyra. Kush do të merrte pjesë në mbledhje? Dhe, çka po organizonim?

Pyetjes së parë iu dha përgjigje nga vetë jeta politike dhe shogerore shqiptare. Vete fakti se donim të krijojmë një sistem të përbashkët çlirimtar, duke organizuar Frontin Çlirimtar të Kosovës, paraqiti si të domosdoshëm pjesëmarrjen e të gjitha forcave politike të organizuara, pavarësisht riga koha. e organizimit, madhësisë dhe, pozitës që kishte subjekti. Kuptohet Se ishim edhe për pjesëmarrje të disa forcave me influence në jetën shoqërore, kulturore e shkencore të vendit, si të shkencëtarëve, intelektualeve me zë dhe veprimtareve të vryshëm të jetës, duke i dhënë vend në Front për pjesëmarrje në Kuvend, si dhe pleqve me influence në tere hapësirën shqiptare..

Por, nga kjo rregull kishte edhe një përjashtim. Në fakt duhej, në marrëveshje me subjektet e tjera, të përcaktoheshin kushtet kur nuk kishte të drejte të merrte pjesë një subjekt a individ në bashkim, duke përcaktuar edhe shkaqet. Ne mendonim në ketë kushte, për të cilat duhej të merrej edhe akordimi i subjekteve. Atë ishin:

1. Subjekti a individi të jete për pavarësinë e Kosovës dhe të popullit shqiptar.
2. Atë të mos jene kundër masave a formave që lejon etika kombëtare dhe ndërkombëtare e aktivitetit kur një popull a shtet është i pushtuar dhe luftën për lirin e vet.
3. Nëse njeri a tjetri subjekt janë vene në shërbim të armikut dhe bashkëpunon me të në fusha të ndryshme, duke i shkaktuar dëme popullit tonë dhe luftës së tij.
4. Shpallja publike e moratoriumit politik për subjekt, pa e shuar atë, por duke ndaluar veprimtarinë për një kohe, deri sa të realizohet çlirimi i vendit dhe të shkohet në zgjidhje *(Projektvendimet e LPK-se, 1997/98)*.

Me anën e këtyre kushteve. përcaktohej edhe mënyra e pjesëmarrjes. Çdo subjekt që i plotësonte këto kushte, pavarësisht se ishte subjekt politik a organizativ, si person me influence dhe vete qeveria, a ndonjë institucion tjetër i shtetit, kishte të drejte të merrte pjesë në Kuvend të Frontit për Çlirimin e Kosovës me delegatet, për të ndërtuar sistemin çlirimtar. Kufizime të tjera juridike e politike, apo shoqërore nuk kishte. Duhej të ishte edhe vullneti për sistem çlirimtar i subjektit. Ndërsa, atë subjekte, individë, etj, që nuk i plotësonin ketë kushte, duhej të mos ftoheshin në mbledhje.

Por, përveç kësaj, duhej caktuar edhe vendi dhe koha e mbledhjes. Për atë duhej të kishim rregullore, komisione e grupe pune. Për çdo gjë duhej të kishte edhe dispozita të veprimit. Në këtë dokument duhej të përcaktohej forma e zgjedhjes së udhëheqjes së mbledhjes, numri i Kryesisë së punës së mbledhjes, komisionet, si ai i çështjeve politike dhe shoqërore, ai i anës statusore e programe, ashtu edhe komisioni i rezolutave, i deklaratës politike për sistem, si dhe vete. i zgjedhjeve të organeve të pushtetit. Në veçanti, duhej të përcaktohej mënyra e zgjedhjes.

Te gjitha këtë çështje duhej të rregulloheshin me rregullore. Prandaj, u autorizua grupi i punës i cili duhej të vihej në kontakt me subjekte të tjerë, me njerëz me influence etj. Grupi i punës kishte për detyrë vetëm sjelljen deri në Kuvend të delegatëve të subjekteve pjesëmarrëse. Të gjitha gjerat e tjera, ndërtimi i sistemit, vete Fond Çlirimtar i Kosovës, zgjedhjet e qeveria çlirimtare, ishin çështje që duhej të diskutoheshin e të vendoseshin në Kuvend. Nëpërmjet kësaj jepej edhe përgjigjja në anën juridike të ndërtimit të sistemit, ajo çka po ndërtonim, por këtë duhej të dilnin vetëm në mbledhje. Grupi i punës kishte për detyrë përgatitjen, mund edhe të propozonte, por fjalën e fundit e kishin delegatet.

Në këtë procedurë të përcaktuar juridike u bë bllokimi i punës. Mbeti e tere puna përgjysmë, pa ndërtimin e sistemit çlirimtar, kurse në anën tjetër u bënë ndërtime grupore, ndërtime që shkuan duke i keqësuar e ashpërsuar marrëdhëniet.

2. Lufta për marrjen nën kontroll të UCK-se

Fill pas janarit të vitit 1997, u pa se në kuadër të forcave të ndryshme linden ide të kundërta. Atë shkuan duke u fërkuar njëra me tjetrën dhe, arritën deri në ndarje dhe krijimi të veprimeve të kundërta, të cilat çuan edhe tek organet e vecanta.

Nëpërmjet kësaj u krijuan gradualisht tre grupe:

1. Grupi që vepronte në baze të programit të LPK-se për të ndërtuar Frontin Çlirimtar të Kosovës, si formë e mjet që të realizonte bashkimin e tere forcave shqiptare:

2. Grupi që ishte i lidhur me forca që u ndanë nga LDK-ja, që ishin kundër atij sistemi, por që thirreshin në qeveri, në mënyrë që të përfitonin në kohë për t'i vendosur forcat e veta në udhëheqje të UCK-se.

3. Grupi që u ndërtua mbi bazën e përfaqësimit politik, i cili edhe korri sukses në bashkëpunim me grupin e dytë, për kompromise për të zhdukur vijën e luftës çlirimtare.

E tere analiza e çështjeve që do të pasojnë do të behet nëpërmjet analizës së këtyre grupeve. Atë, që kanë qenë faktorë që nuk u ndërtua sistemi çlirimtar, janë bashkëvepruesit e tere gjendjes së rëndë të krijuar në fushën organizative, atë ushtarake dhe financiare. Natyrisht se, kësaj i kanë ndihmuar edhe shume forca të tjera, të cilat do të vihen në pikamë me poshtë, kapitujt e tjerë, të këtij libri.

a) Lufta për mosndërtimi e sistemit çlirimtar

Lufta për të mos ardhur deri tek ndërtimi i sistemit çlirimtar, organizimin e Frontit si organizimin më të lartë, Brenda të cilit do të ndërtohej qeveria çlirimtare, në kuadër të LPK-se, u duk në fillimit të vitit 1997. Fill pas janarit të atij viti, u bë një luftë jashtëzakonisht e madhe dhe në mënyrën më të fshehtë, jashtë çdo rregulli organizativ, shoqëror e luftarak. Ajo ishte, thjesht, luftë shkatërrimtare:

a) Se pari, në dëmtimin e luftës sonë çlirimtare, duke moslejuar ndërtimin e sistemit dhe përforcimin e UCK-se me kuadër ushtarak, politik, etj.

b) Se dyti, ndaj vete shokëve të LPK-se, të çilet kishin merita të padiskutueshme për ndërtimin e UCK-se, ndaj të çileve në formën me të ulet u hapen thashethemet mbi akuzat me monstroze, si "tradhtarë", "elemente destruktive" e "vrasës".

Për të realizuar dhe ndërtuar grupin politik e organizativ individualist jashtë çdo rregulli organizativ e luftarak, ata zyrtarisht, deri në mars të vitit 1998, nuk dolën kundër Kryesisë së Degës. Përkundrazi, ishin vete ata që i mbronin pikëpamjet e LPK-se, qëndrimet e vendimet të cilat dilnin nga mbledhjet. Deri në këtë kohë u bë një luftë shumë konspirative, sepse kërkohesh ndërtimi i grupor në emër të organizatës e kundër saj dhe, pastaj pritja e momentit për të shkuar në luftë frontale.

Gjate kësaj periudhe u krijuan dy grupe në formën me të fshehte, të çilet mund të kuptoheshin vetëm nëpërmjet diskutimeve, jo nëpërmjet votës, as qëndrimeve zyrtare që mbanin. Kështu, u krijuan grupi i Xhavit Halitit, në të cilin Benin pjesë Adem Grabovci, Bardhyl Mahmuti e Jashar Salihu. Në grupin tjetër ishte Azem Sylja udhëheqës, prapa kishte Hashim Thaçin, Mehmet Bislimin, Kadri Veselin dhe Agush Bujen. Vete ky ndërtim i këtyre dy grupeve, ndau dhe krijoi edhe grupin tjetër, i cili nuk ishte grup, por udhëheqja e Degës kundër se citës u bë një luftë e madhe. Qëllimi i përbashkët i tyre ishte: likuidimi i udhëheqjes së Degës, për të shkuar në përjetësimin e interesave individualiste, të ngushta e armiqësore, kuptohet në emër të UCK-se dhe luftës, por kundër saj sa edhe vete armiku.

Dy grupet e para bënë bllokimin e tere aktivitetit në drejtim të realizimit të planit politik të LPK-se për ndërtimin e sistemit çlirimtar. Ato, në mbledhje, (deri në MP të LPK-se; madje as aty nuk dolën kundër ndërtimit të Frontit), bllokuan tere punën në ndërtimin e tij. Për të arritur tek kjo, në mars të vitit 1998, në Tiranë, në mbledhjen e Kryesisë, dolën nëpërmjet gojës së Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit ideja se "UCK-ja tashme ndahet nga LPK-ja jashtë vendit. Në Kosovë e kemi krijuar LPK-në dhe prandaj nuk e kemi nevojën tuaj. UCK-ja e ka bërthamën e vet, prandaj nga sot e tutje nuk kepi të drejte të veproni në emër të UCK-se" (Nxjerre nga shënimet e mbledhjes së Kryesisë së LPK-se Dega j.v. të vitit 1998).

Me këtë deklaram u pajtuan të dy udhëheqësit e grupit, si dhe vet Adem Grabovci i cili deri në këtë kohë nuk e kishte treguar pozicionin e vet. Në këtë moment ai doli kundër e hyri në grupin e Xhavitit. Kundër ishte Fazli Veliut, Muhamet Klemendi, Emrush Xhemali, Ali Ahmetit dhe Rexhë Iberdemaj. Por, pavaresisht kësaj, ketu u bë bllokimi i tere i punës. Në për këtë shkak thirrëm mbledhjen e KP të por as në mbledhje nuk erdhën zotërinjtë udhëheqës. Ndërsa, veglat e tyre, Hashimi e Kadriu nuk ishin anëtarë.

Në mbledhje të KP të Degës së LPK-se doli vendimi për të vazhduar punën për ndërtimin e sistemit çlirimtar. Ata, nëpërmjet Bardhylit, Jasharit, Bislimit e Agush Bujës nuk arritën të ndalin çështjen e ndërtimit të sistemit. Paraqiten edhe propozim të kundërt, por nuk u aprovua. U nxor vendimi për ndërtimin e Frontit Çlirimtar të Kosovës. Vetë ky fakt i tmerroi se tepërmi, prandaj, ata ndërmorën aktin me të skajshëm, atë të thirrjes së MP të LPK-se, jashtë vendimit të Kryesisë, ndërkohe që ajo ishte ende në punë në Tiranë mbështetur në Statutin e saj, ku përcaktohet mbajtja e saj në dy vjet. Natyrisht, ai propozim u kundërshtua, jo pse ishim kundër, por pse ishte gjendje e jashtëzakonshme, e tere Kryesia nuk kishte marrë pjesë në mbledhje dhe nuk kishim kohë për të përgatitur mbledhjen. Por, kjo të zotërinjtë politikanë nuk luajti rol, sepse veglat e të dyja grupeve, të cilët ishin anëtarë të KP të Degës, kishin vendosur zhdukjen e organizatës. Ata ishin futur edhe në komisione të programeve të verifikimit të mandateve, vetëm e vetëm për të krijuar terrenin për zhdukjen e të tërë vijës së LPK-se. Kete nuk e arritën.

U thirr Mbledhja e Gjashtë e Përgjithshme. Ishte caktuar edhe komisioni për përgatitjen e dokumenteve dhe të vete mbledhjes.

Dhe, sikundër thashë, përsëri në "udhëheqje" doli Bardhyl Mahmuti, Billal Sherifi, Agush Buja e Jashar Salihu. Koha ishte shumë e shkurtër. Ishte thuhet një muaj. Por, edhe gjate kësaj kohe, Kryesia mbajti mbledhje dhe i futi në veprim tere mekanizmat e veta, për të

shpejtuar procedurën e thirrjes së subjekteve në diskutim. Në iu drejtuar përsëri kompetenteve të UCK-së. Ata nuk dhanë përsëri përgjigje. Duket se ishte zgjedhur rruga e bllokimit të çdo iniciative deri në mbledhje. Por, përkundër kësaj, në këtë kohë u lëshua thirrja e LPK-së drejtuar tërë subjekteve politike shqiptare, brenda e jashtë atdheut. Me këtë thirrje kërkohet që të gjithë të dilnin në anën e luftës për çlirimin e vendit tonë, të UCK-së, dhe bëhet thirrje që subjektet politike, organizative, etj, të përgjigjeshin kërkesës për ndërtimin e Frontit për Çlirimin e Kosovës. Kërkohej, gjithashtu, që atë të bënin presion. Për këtë u përcaktua koha edhe vendi i mbajtjes së Kuvendit themelues. Në thirrje tregohet edhe pozita ushtarake dhe ndërkombëtare e Kosovës. (Thirrja e LPK-së mars 1998).

Në thirrjen e tillë nuk u përgjigjën. Duke vepruar kështu në fakt iu dha përkrahje grupit politik anti-Front që po ndërtohej. Jo vetëm subjektet shqiptare politike në Kosovë, atë nën sundimin maqedon e malazez që nuk u përgjigjën, por me punën e vetë qeverisë së Bukoshit kjo u luftua. Qeveria e Bukoshit bëri bllokimin e UCK-së në çështje të kryesore. Ajo, si me mjete financiare dhe me veprimtari politike parciais, .anti-Front, ashtu edhe me kuadër ushtarak, të cilët i futi nën kontroll dhe nuk i la për të shkuar brenda vendit, në Kosovë në kuadër të UCK-së, krijoi situatën konfliktuale dhe shumë të përshtatshme për grupet që ndërtoheshin. Me atë, ajo e hapi dhe e përforcoi me shumë luftën kundër nesh. Në veçanti, kur zoti Rugova e cilësoi UCK-në "vepër të huaj", në mos edhe të qeverisë serbe të Beogradit, tërësisht jashtë interesit të Kosovës, dhe kur në luftë u mbajtën zgjedhjet për Kuvend e president të Kosovës (mars 1998), ra shumë vullneti për Front. Pse? Sepse, këtë dy elemente u morën si shkak dhe u hap akuza kundër nesh me thënien: "Ja se me cilat forca duan të ndërtojnë Frontin".

Kuptohet se këto akuza nuk thuheshin në mbledhje, por rrugëve, neper këshilla, në UÇK-e, në Tiranë, etj. nëpërmjet kësaj u hap urrejtja ndaj nesh dhe filloi lufta e ashpër.

Në mbledhjen e Përgjithshme të LPK-së doli KP i saj. Në emër të akuzave ndaj Kryesisë së vjetër, mbi bazat e "vrasjeve të shokëve, mos nënshtrimit ndaj organeve brenda vendit, keqpërdorimeve dhe konflikteve të brendshme" të bëra nga Hashim Thaçi, tani udhëheqës i klikës që i futi nën ombrellë të dy grupet, pushoi së vepruari dhe u zgjodh Kryesia Teknike me kryetar Beri islamin, anëtarë Bardhyl Mamutin, Jashar Salihun, .Agush Bujen, Mehmet Bislimin, Sabri Kiçmari dhe Rrahim Ramen. U "zgjodh" kjo Kryesi për një periudhë prej disa javë, maksimalisht një muaj, 'deri në shqyrtim të akuzave. Por ajo vazhdoi për muaj, deri në korrik, kur unë dhashë dorëheqjen nga organet e zgjedhura të LPK-së. Madje, kjo .Kryesi, me këtë kryetar kishte si qëllim të saj vetëm bllokimin e punës së ndërtimit të sistemit çlirimtar në Kosovë (FÇK), çështje e sanksionuar në Programin e LPK-së.

Me këtë, faktikisht, përfundoi veprimtaria për ndërtimin e Frontit. Në nuk kishim më kompetencë, ndërsa Kryesia Teknike për tre muaj, pas mbledhjes së fundit, më 7 maj 1998 në Shtutgard, nuk mbajti asnjë mbledhje. Ishte i kotë intervenimi, sepse në fakt kryetari i saj kishte marrë për detyrë mosthirrjen e mbledhjes, në mënyrë që grupet të konsolidoheshin. Kjo periudhë shendon edhe rënien e LPK-së si organizatë. Në fakt, kështu edhe u bë. LPK-ja mbeti si organizatë vetëm formalisht (Shënime nga mbledhjet e KP të Degës).

Ndërsa, në UCK-E u kooptuan anëtarë të rinj, ata që i shërbyen asaj klikë. Shumë prej tyre u angazhuan në detyra të reja, ndërsa LPK-ne e shndërruan në servis financiar. Për çështje politike doli grupi prej pesë vetash si përfaqësues politik, ku u fut edhe Bardhyli e Jashar Salihu. Po në këtë moment doli edhe zëdhënësi i

Kjo shënon datën e fillimit të fundit për sistemin çlirimtar në Kosovë.

b) Dega e LPK-së vepronte kundër programit të vet politik

Lufta për ndalimin e ndërtimit të Frontit Çlirimtar të Kosovës dhe të zhdukjes e likuidimit të LPK-së, është bërë pothuajse njëherazi. Unë e shtjellova sistemin paraprakisht, sepse ka rëndësi më të madhe, ndonëse prej kësaj (LPK) varej edhe ajo.

Megjithatë, ne kete lufte te ashpër u hap edhe lufta kundër LPK-se. MP e Gjashte e LPK-se Dega j.v. u be edhe per te shkatërruar vetëm. Komisionet nuk kishin punuar fare. Asnjë dokument nuk ishte përgatitur. Çdo gjë kishte mbetur si me pare, prandaj qe ne ditën e pare, me 01.05, ashtu edhe me 2.05.1998, u pa se behej .fjale per grusht politik kundër Kryesisë, ne mënyrë qe ketë dy grupe te krijonin mundësinë per te ndërtuar bashkërisht një klike politike ne emër te Shtabit Qendror te .UCK-se, duke shkatërruar edhe LPK-ne. Por, meqë kesaj klike i duheshin mjetet financiare dhe njerëzit e LPK-se ne bote, lypsej ekzistenca e saj, deri sa te arrihej tek pavarësia e Fondit "Vendlindja Thërret". Prandaj u kalua ne qërim hesapesh vetëm me Kryesine.

E vlerësoj te rëndësishme te them disa fjalë mbi zhvillimin e punimeve.

Mbledhja filloi me 01.05.1998. Vazhdoi dy dite, edhe me 02.05.1998. Me "vota" u zgjodh Kryesia e punes. Udhëheqës i saj u "zgjodh" Bedri Islami dhe Bardhyl Mahmuti. Ne Kryesine e punes nuk u arrit te futeshin njerëz sipas rregullores qe ishte caktuar: një nga Kryesia, dy nga KP dhe dy delegatë nga mbledhja.

Kjo rregullore u shkel dhe grupashët propozuan këto dy zotërinj udhëheqës, si edhe Mehmet Bislimin Agush Bujën dhe Ramizin anëtarë. Bedri Islamin e caktuan kryetar per te treguar se janë asnjansës, forme kjo jo e drejte, sepse ai nuk e njihnte fare organizatën, problemet dhe nuk ishte në rrjedhojat e organizatës (Shënimet nga MP e gjashtë LPK-se maj 1998). Vetë ky fakt flet se ai ishte vetëm vegël e tyre.

Në fakt mbledhja përfundoi pa asnjë rezultat. Ajo mund te theksohet është "zgjedhja" e anëtarëve te KP, pa kritere, sipas idesë: "kush propozon edhe futet ne lufte". U nxorën edhe disa rezoluta politike, por atë ishin formate, sa per te thënë se është punuar diçka, krejtësisht ne fushën e njohur te përkrahjes dhe vazhdimit te veprimtarisë çlirimtare. Ndërsa, KP nuk paraqiti fare referat mbledhje, sepse ai që ishte përgatitur nga unë ne baze te vendimit KP Degës u ndalua, si i ashpër përballë UCK-se dhe Tiranës zyrtare, ndonëse nuk kishte fare ashpërsi, veçse përmendeshin disa ane negative. Por, duke iu frikësuar hapjes se problemeve brendshme, u tha se duhet ndryshuar e meqë unë nuk pranova, ndaj as qe u lejua lexohet. Pikërisht per kete shkak po sjell ne tërësi referatin. Ne te thuhej:

" Të nderuar delegatë e delegate"!

Gjendja ne Kosove dhe viset e pushtuara shqiptare nga e Mbledhja e Përgjithshme e deri kete MP te LPK-se Dega j.v. ka pësuar ndryshime thelbësore në thyerjen e "rezistencës" pasive, asaj nënshtruese, duke dal ne lëmin politik, aksionar e çlirimtar, prej nga është duke u zhvilluar në Kosove lufta çlirimtare. Nga kjo, edhe ne aspektin ndërkombëtar ka kthesa pozitive, sepse çështja e Kosove tani e disa muaj është bërë çështje kryesore politiken e organizmave e të shteteve në bote:

Në vitet qe i kaluam, konstatohet nga LPK-ja se gjendja politike ne Kosove dhe vise, ka shkuar duke u kristalizuar politiko-organizativisht dhe ushtarakisht. Me aksionet që aktualisht po kryhen brenda periudhës së marrë në shqyrtim, në territorin e ngushtë të Kosovës, shumëçka është sqaruar tek populli ynë. Me këtë duhet thënë se aksionet çlirimtare të UÇK-së në vitet 1996/97 e 1998 kanë krijuar situatë shumë të favorshme politike për forcat çlirimtare, duke krijuar terren për veprimtari më të gjerë çlirimtare, si dhe duke ua vështirësuar punën "forcave" pacifiste. Ata duket se po shkojnë duke humbur e likuiduar vetë, por në këtë gjendje, për mos gjetjen e mekanizmit të duhur luftarak, politikisht po mbijetojnë.

Në këtë gjendje luftarake çlirimtare, edhe LPK-ja ka ngelur jashtë rrjedhøjave. Kryesia dhe KP i LPK-së Dega j.v nuk ka asnjë informacion zyrtar nga radhët e UÇK-së, pikërisht "Shtabi Qendror" i saj. Prandaj, duhet të përkujtojmë se analizat për gjendjen në

terren vijnë jo mbi bazën e raporteve zyrtare, sepse nga Sektori i Veçantë i Kryesisë, nuk është raportuar, por mbi bazën e vrojtimit anësor të veprimtarisë çlirimtare.

Vëllezër motra!

Tani në shtetin tonë është vendosur nga pushtuesit gjendja e jashtëzakonshme. Ka territore (Drenica dhe Rrafshi i Dukagjinit me Deçan e Gjakovë , pastaj Malishevë e Klinë, ku veç ka shpërthyer lufta e armatosur. Dhuna e terrori po vazhdon. Por, pas thyerjes së disa aksioneve të forcave pushtuese kundër UÇK-së në Drenicë dhe në fshatrat e brezit kufitar me shtetin amë në nëntor e dhjetor të vitit 1997 dhe mars e prill të 1998, rezistencës kundër rrethimit ushtarako-policor, si dhe sulmit që po bëhet mbi 100.000 forca serbo-malazeze mbi Drenicën e fshatrat e Dukagjinit, këto të dyja janë bërë qendër e rezistencës dhe luftës çlirimtare.

Veprimtaria çlirimtare, përveç këtij territori ku po zhvillohet lufta, është zgjeruar dhe pritet të thellohet edhe në Llap duke u zgjeruar e shtrirë në Gollakë e në viset tjera shqiptare të pushtuara nga sllavët e jugut. Tani atje kemi veprimtari aktive, veprimtari e cila i paraprinë asaj çlirimtare. Dhe, për të kaluar tek ajo, po punohet shumë edhe në viset e tjera të Kosovës: Prandaj, pritet që lufta të marrë hov më të theksuar çlirimtare dhe shtrihet në tërë territorin e shtetit tonë.

Delegate të nderuar!

Sulmit te forcave pushtuese serbo-malazeze po i ndihmon shume politika pacifiste ne Kosove: Ajo duke e shfrytëzuar gjendjen luftarake dhe moskonsolidimin e radhëve tona, po shfrytëzon gjakun e popullit tonë per interesa vetjake,, per te arritur gjoja ndonjë fitore si ajo e arsimit. Madje, per të treguar se është kundër forcave fitimtare ka organizuar G.15, një grup per bisedime me palën serbe, qe ehte tërësisht kundër luftës çlirimtare dhe nuk ka te drejte e përfaqësojë popullin tonë.

Kjo gjendje po shkon ne favor te pushtuesve. Që klika serbomadhe arrinte te. sulmonte terroristet shqiptarë, lëshoi pak ne arsim dhe filloi sulmin fashist mbi Drenicën me rrethina dhe disa komuna tjera, si Klinën, .Malishevën e Deçanit, fshatrat ne brezin kufitar me shtetin ame, duke vrarë e masakruar me qindra shqiptare: Por, krahas dhunës, Beogradi dërgoi delegacione pas delegacioneve ne Kosove dhe zhvilloi edhe referendumin ne Serbi, kundër palës se trete per ndërmjetësim ne bisedime, vetëm e velem qe të përgatitej brenda dhe jashtë; ne bote; terreni per sulme të armatosura mbi shqiptaret. Dhe k/o veprimtari u krye dhe po zhvillohet ne emër te. luftës kundër "terrorizmit", se me "demokratet" shqiptare ka mundësi per bisedime dhe per te arritur tek ".zgjidhja" e çështjes pa pale te tretë.

Forcat politike ne Kosove; ende nuk po e përkrahin luftën çlirimtare nuk mund te tolerohet, jo pse jemi kundër sistemit plural, por pse ky sistem kërkon unitet te' plote politik dhe çlirimtar. Prandaj; mbi te gjitha subjektet bie përgjegjësia politike e penale, sa kohe qe nuk përkrahet dhe nuk, ndihmohet politiko-ushtarakisht lufta fitimtare nga ketë forca, sepse pa një ndihme konkrete velem luhet me interesat kombëtare te popullit tonë.

Pjesëmarrës të nderuar!

Edhe pse ka mungesë të informacioneve ne formë të raporteve zyrtare, LPK-ja ka dale hapur në përkrahje dhe mbrojtje te UCK-se, kuptohet edhe aksioneve çlirimtare. Prandaj, e përkrah UCK-ne moralisht, politikisht e financiarisht. Per kete edhe ka krijuar fondin: "Vendlindja Thërret". Veç kesaj, disa here ka dale me qëndrime dhe ka lëshuar disa thirrje e dekorime

publike drejtuar popullit shqiptar per te ndihmuar UÇK-në me mjete, njerëz e forma te ndryshme qe e shihen të nevojshme.

Tani mund te themi lirisht se forca kryesore, qofte ushtarake, qofte vendore është bere UÇK-ja dhe LPK-ja. Populli shqiptar po e lidh fatin e vet me ne. Prandaj, na mbetet ne qe edhe të ndihmojmë atë; përveç përcaktimeve tona të njohura edhe duke ndërtuar sistemin politik e shtetëror në formën e Frontit Çlirimtar te Kosovës. Duke mos vepruar keshtu, sektori i veçante po e lufton vetë LPK-në, sepse po shkel mbi Programin tonë dhe ne vend te atij sistemi po ndertën grup!

Kjo nuk tolerohet.

Lidhur me këtë, flet vetë situata aktuale. Ne Kosove po luftohet, vriten e masakrohen shqiptaret, por nuk informohet askush, as opinion i vendit; nuk, lëshohet asnjë komunikate, nuk përfaqësohen forcat çlirimtare ne vend dhe bote: Ndërsa, LPK-ja po nga ky grup i caktuar per lidh-mbajtje, jo nga UÇK-ja, pasi nuk DIMË GJË është lënë tërësisht anash, sikur te mos ekzistonte si organizate qe ka bartë barrën kryesore per shumë çështje qe nga organizimi i UCK-së.

Kjo nuk duhet te lejohet. Përkundrazi, duhet kërkuar qe, urgjentisht, të veprohet nga LPK-ja mbi bazën e vendimeve të KP per organizimin e Frontit Çlirimtar të Kosovës i cili do te jetë bartësi kryesor i lutës. Mirëpo, për të ndërtuar kete mekanizëm, duhet te ndërtohet edhe LPK-ja brenda vendit e cila per shkak të neglizhencës se sektorit te lidh-mbajtjes, nuk është ndërtuar. Per me tepër, çështja ka shkuar duke u vështirësuar, saqë aktualisht jemi ne një pozite kur nuk kemi organizatë. Tani po punohet per te shkatërruar edhe Degën j.v.

Per kohen, pra, qe po kalojmë; çështja e Frontit dhe e LPK-se duhet te jetë detyrë mbi detyrat dhe veprimtari kryesore.

Të nderuar delegate e delegate!

Aksione politike e luftarake janë kryer edhe ne viset shqiptare ne Maqedoni. Atë u përshëndeten nga LPK-ja sepse kemi mendimin se atë i ndihmojnë çështje se çlirimit te vendit tonë; sepse me atë veprime dhe aksione politike e kombëtare, po tregohet uniteti politik e organizative, forca dhe rëndësia e zgjidhjes se çështjes shqiptare ne mënyre unike.

Kemi mendim gjithashtu, se vazhdimi i veprimtarisë politike të shqiptareve ne Maqedoni e Mal të Zi, sikundër ne Shqipëri e ndihmon dhe e shpejtën procesin e zgjidhjes se çështjes se Kosovës dhe nëse nuk realizohet bashkimi kombëtar, realizohen te drejtat konkrete politike kombëtare, shteti i Kosovës. Te tregohet uniteti politik e kombëtar i kombit tonë, kjo ka rëndësi për te treguar rrezikun qe mund deri tek ;zgjerimi problemeve dhe konflikteve të gjëra luftarake ballanike dhe prandaj edhe intervenimi nga bota per zgjidhjen e çështjes do të jetë me i shpejte; nëse pikërisht veprohet me unitet të plate: Por, edhe kjo veprimtari, koha dhe vendi i saj duhet analizohen mire: Kete e provon situata aktuale. Dhe, në fund, veprimtaria ne gjerësinë tonë kombëtare duhet të behet tamam mbi përcaktimin tonë politik.

Edhe veprimtaria e masave gjera të popullit të Kosovës ka ndikuar në ndryshimin e gjendjes kuptohet në favor forcave çlirimtare.

Mirëpo, përveç qe është përkrahur kjo veprimtari, LPK ka kërkuar dhe pa punon, qe ajo veprimtari te zgjerohet edhe fushën shoqërore e luftarake, duke paraqitur kërkesa politike e shogëtëve-kombëtare, si dhe vetë aksionet luftarake, d.m.th. që protestat të jenë aktive, të zgjerohen dhe shtrihen ne tërë Kosovën dhe ne masat shqiptare.

Një çështje tjetër qe e ka përcjellë LPK-ja janë "zgjedhjet" e "lira dhe demokratike" presidenciale dhe parlamentare në Kosovë. Të gjithë ne e dimë qëndrimin e LPK-se mbi zgjedhjet, sepse disa here kemi dalë me qëndrime kundër tyre. Edhe ne maj të vitit te kaluar është thënë nga LPK-ja se nuk ka zgjedhje te lira dhe demokratike, përderisa vendi është i

pushtuar dhe lëngon në dhunë e terror. Ky mendim mendojmë se ka fuqinë e vet juridike edhe sot. Edhe para zgjedhjeve dolëm kundër tyre. Kjo, për shkak të luftës në vendin tonë:

Ne, jo vetëm që jemi kundër "zgjedhjeve", por edhe nuk mund të pranojmë forcat legale të përfaqësojnë Kosovën përballë subjekteve në bote; sepse ashtu u krijohet terreni forcave nënshtruese për të vepruar në emër të Kosovës: fitojnë ato legjitimitetin për të vendosur, qoftë edhe kundër vullnetit të kombit, si dhe duke mohuar forcat çlirimtare.

Natyrisht, këtu mund të thuhet se duam që të lënë Kosovën pa qeveri, organe politike e parlamentare, duam të luftojmë vetë shtetin. Por, kjo nuk qëndron. LPK-ja mendon se aktualisht Kosovës i duhet një sistem qëndrueshëm juridik, politik e shoqëror, si dhe ushtarak. Nuk i duhen shtetit tonë organet shtetërore sa për formë; por i duhen organet shtetërore për veprim të vendosur politik e ushtarako-çlirimtar. E kjo arithet me ndërtimin e sistemit politik shtetëror mbi bazën ushtarake dhe sipas gjendjes së jashtëzakonshme, asaj çlirimtare, duke ndërtuar Frontin për çlirimin e Kosovës. Velem në këte kuadër mund dhe duhet të punohet.

Pjesëmarrës të nderuar!

LPK-ja ka mendimin se ky vit do të jetë viti vendimtar për çështjen tonë kombëtare. Ne mendojmë se as shqiptarët, sikundër as pushtuesit nuk mund të durojnë situatën aktuale, por do të veprojnë.

Tani shihet botërisht se çështja jonë ka marrë hov të theksuar çlirimtar, e prandaj edhe armiku do të veprojë kundër forcave çlirimtare. Mu për këtë, duhet që veprimet të intensifikohen, duke vepruar jo vetëm në fushat e deritanishme, por edhe në ndërtimin e sistemit dhe duke e ndihmuar konkretisht luftën çlirimtare, duke i ndihmuar forcat brenda me njerke me ide politike, organizative e shtetërore.

Dihet se problemet ekonomike e sociale, sanksionet dhe lufta e gate i kanë dobësuar pushtuesit. Dhe, ky dobësim i pushtuesve është faktor me rëndësi në luftime: Kesaj po i ndihmojnë edhe marrëdhëniet konfliktuale malazeze-serbe. Por, posaçërisht në favor të festës shkon pozita strategjike e viseve shqiptare pushtuara dhe interesat e shteteve të ndryshme përballë hapësirës ballkanike, të cilat e kanë shtuar interesimin e qendrave në bote:

Pikërisht kjo, dhe sidomos aksionet çlirimtare kundër forcave pushtuese kanë rritur interesimin e qendrave ndërkombëtare mbi çështjen shqiptare, sepse këtu po bëhet gradualisht edhe populli ynë force serioze. Falë luftës sonë çlirimtare, çështja jonë është futur si problem edhe në kuadër të Grupit të Kontaktit. Ky organizëm (shiko: SHBA-ne, Rusinë, Francën, Gjermaninë, Anglinë, Italinë) mbajti tre mbledhje, të fundit më 29. 04.1998 në Romë; por nuk arriti rezultate. Mirepo kjo solli këto. Është vetë Rezoluta e KS mbi Jugosllavinë për armët një Rezolute kundër Kosovës, se sa kundër Jugosllavisë. Edhe sanksionet tjera të G.K. nuk janë frytdhënëse, sepse nuk e detyrojnë pushtuesin të bëjë lëshime.

Megjithatë ka rëndësi futja e Kosovës si problem i GK dhe KS të OKB-ës dhe të organizmave të tjera botërore. Prandaj po vizitohet kohe pas kohe Kosova nga delegacionet e huaja; po intervenohet mbi forcat në konflikt dhe po kërkohet që palët të tërhiqen nga porcionet politike, sidomos Kosova nga pavarësia. Pritet që ky lloj presioni të thellohet ende me shume kuptohet sipas luftës që do të zhvillohet në vendin tonë

Ne bote është duke u krijuar një dualizëm mbi luftën tonë çlirimtare. Ka forca, shtete e institucione që ende nuk kanë dhënë vlerësim politik mbi veprimtarinë tonë çlirimtare, sikundër që ka forca që e vlerësojnë UCK-ne si force: "terroriste". Dhe, pikërisht, pse forcat legale kanë dhënë vlerësim negativ mbi aksionet çlirimtare në Kosovë e në Maqedoni, ka filluar të lëkundet pozicionimi politik në Kosovë e në Maqedoni, ka filluar të lëkundet pozicionimi politik në bote; tek qendrat e vendosjes, përballë UCK-se Por, ky pozicion do të varet kryesisht nga forcimi i subjektit shqiptar në luftime kundër pushtuesve sllavë. Sa më i forte të

behet subjekti ynë politiko-organizativo-ushtarak, aq shumë pyetet dhe vlerësohet pozitivisht zgjidhjen e çështjes dhe anasjelltas.

Ende, as SHBA-te nuk kane qëndrim per UCK-ne, sikundër as UE e shtetet, OSBE, etj. Por, rreziku per vlerësim negativ (terrorist,) do të rritet, per aq kohe sa ne nuk do të ndërtojmë sistemin e tërësishëm çlirimtar me të gjitha organizmat dhe mekanizmat, per aq kohe sa lejohet sistemi formal politik e shtetëror në Kosovë: Pse? Sepse nuk mjaftën velem ekzistenca e një fuqie ushtarake, pa ndërtimin e sistemit politik, shoqëror e juridiko, diplomatik, atij organizativ dhe qe vepron bashke me atë ushtarak, ne mënyre që çështja e çlirimi të rrjedhe si tërësi politike.

Delegate të nderuar!

Edhe qëndrimet e shtetet shqiptar i ka përcjellë me vëmendje LPK-ja. Ketu duhet te përmendim pozicionin dualist dhe frikësues te shtetit shqiptar përballë forcave çlirimtare, përkatësisht UÇK-se LPK-ja ka ftuar dhe bënë thirrje ne Tiranë qe zyrtarët atje të mos nguten me deklaratë të pastudiuara, duke vlerësuar forcat çlirimtare me epitete "kriminale" e të përgatitura nga shërbimi sekret serb. Nga zyrtarët, atje, LPK-ja kërkon qe çështja jonë të vlerësohet drejt, si çështje çlirimtare dhe të ndihmojnë ne organizimin e UCK te cilën nuk po e përkrahin.

Por, edhe përkundër lëshimeve të tilla politike, LPK-ja mendon se shteti shqiptar po luan një rol pozitiv ne informimin e opinionit të gjere botëror, përballë subjekteve ndërkombëtare, etj. Ndërsa, per kohën kalon kombi ynë, kërkohet qe informimi nëpërmjet RTSH-se të jete objektiv dhe real, pa frikësime e devijim të luftës çlirimtare. LPK-ja ka kërkuar i tere informacioni mbi luftën tonë të pasqyrohet drejt nga ana e mjeteve informative, sidomos nga nuk po ndodh keshtu. Edhe ne kontaktet me shtetet ne rajon i ftojme zyrtaret e Tiranë, që të kenë kujdes ne qëndrime, sepse prej tyre del edhe uniteti ynë.

LPK-ja nuk do konflikte me Tiranen, por nuk:, do të lejoje qe çështja kombëtare të injorohet e mohohet, ne llogari të kesaj apo asaj politike. Para kombit nuk ka asnjë interes tjetër me të madh se liria e bashkimi i vendit.

Vëllezër e motra!

Duke e kapur çështjen shqiptare ne tërësi, ashtu si është paraqitur me lart, vijmë në përfundim:

Ne gjendemi ne fazën e ndërrimeve të mëdha politike e kombëtare; ne prag te luftës së përgjithshme popullore, prandaj para LPK-se shtrohen detyra të mëdha ne fushën politike e juridike dhe aksionale si, atë të ndërtimit sistemit, të cilat urgjentisht duhet të kryhen. Kemi mendimin se bashkërisht do të realizojmë pikësynimet tona.

Lavdi të rënëve për liri!

Rroftë UCK-ja!

Rroftë LPK-ja!

Rroftë populli shqiptar!

27.04.1998 Kryesia e KT të LPK-se Dega j.v;

Unë doja qe me ane te këtij diskutimi te hapja edhe ne MP te ILK-se temën mbi sistemin, vështirësitë e problemet e ndjeshme, doja te hapja temën e ndërtimit të Frontit dhe te punes antilevizje te disa grupeve, ne mënyre qe delegatet te futeshin ne diskutime. Me kete tërhiqja vëmendjen edhe ne purine aspak normale ne favor te zyrtareve nga Tirana, sidomos ne drejtim

të disa deklaratave që i kishin bërë si dhe në çështjen e bashkimit të forcave shqiptare në luftë të përbashkët, për të cilën në kisha fakte se ata po e luftonin këto ide madhore historike.

Për këtë shkaqe nuk u lejua leximi.

Në mbledhje ishin pranuar edhe dy të ardhur, gjoja si të "deleguar" nga brenda, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli. U hap diskutimi për pjesëmarrjen e tyre në mbledhje. Ndërkohe që ata ishin prezent në mbledhje, pasi m'u drejtuan disa pyetje, në thashë: "Kota të dy duhet me qenë këtu në mbledhje si vëzhgues, sepse janë persona nëpërmjet të çileve po bëhen shumë gjera, qofte të dëmshme, qofte të mira, prandaj duhet lejuar" (Shënime nga MP e gjashtë e LPK-si). Me këto doja të tregoja se temat do t'i hap në mbledhje. Por, kryesia e punës, nuk e lejoi atë. Kota u pranuan në mbledhje, ndonëse ishte e qarte se deklarimi im, pro a kundër, nuk luante as edhe një rol, deri sa ata ishin lejuar dhe futur brenda në mbledhje dhe komision i verifikimit të mandateve, i udhëhequr riga Agush Buja, i kishte lejuar kundër rregullores.

Mbledhja e Përgjithshme përfundoi me "zgjedhjen" e anëtarëve të KP U "zgjedhën" 31 anëtarë. Si zakonisht, pas kësaj mbledhje, thirrret mbledhja e KP-se, me përbërje të re dhe anëtarët e KP të vjetër. Mbledhja behet e përbashkët dhe në të behet kalimi i punës nga KP i vjetër në KP të ri, të zgjedhur. Por, në vend të kësaj, këtu filloi lufta e ashpër, ende pa shkuar tek zgjedhja e organeve në kuadër të KP të Kryesisë dhe udhëheqjes. Madje, Kryesia e punës së MP nuk lejoi sipas rregullores së KP të Degës, që Kryesia e vjetër e KP të udhëhiqte mbledhjen e parë të

përbashkët të KP të Degës, siç ishte e drejte ligjore para dorëzimit të punës së KP, për të udhëhoqi vetë si Kryesi e -punës së MP, kundër dispozitave në fuqi të organizatës sonë (Shënimet nga mbledhja e parë e KP, maj 1998). Ajo u bë me qëllim që të mënjanohej tërësisht udhëheqja e vjetër e LPK-se. Nëpërmjet kësaj krijohet terreni për grupe të punës, sepse u hapën çështje të cilat ishin aq të rënda, sa nuk ecej përpara.

Këtu nuk ishte fjala nëse ishin të vërteta akuzat, insinuatat e gënjeshttrat që i përdoren, por vetë fakti si paraqiten aty. Sipas rregullores shqyrtimi i tyre bëhet nga një komision asnjans, që dike nga mbledhja dhe i përgjigjej asaj. Ky ishte edhe

klikës, me akuzat monstruoze, tejet idiotësie dhe pa asnjë baze reale. Qëllimi ishte krijimi i terrenit për të likuiduar Kryesinë e vjetër dhe për të mos shkuar në zgjedhje të reja, por për të zgjedhur një udhëheqje të përkohshme. Kështu edhe u veprua, sepse vetëm kështu krijohet terreni për punë të pëlleshme për grupin.

Klika e kishte përgatitur Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin për të akuzuar. Ata nuk u futën fare të gjendjen aktuale, në çështjet të cilat e kaplonin situatën, por shkuan tek çështjet, të cilat i kishin rregulluar vet, në mënyrë që të akuzonin dhe të hapnin probleme për të arritur tek krijimi i "fakteve" anti-Kryesisë.

Hashim Thaçi, nga shënimet që kam marrë, midis tjerash, tha:

"Në kemi shumë për të thënë, por këtu. po ndalem vetëm në çështjet që akuzohen nga baza jonë politike brenda vendit. Nuk akuzohet tete Kryesia, por.. vetëm një pjesë e saj (..)".

Baza brenda vendit dhe UCK-ja akuzojnë një pjesë të Kryesisë së vjetër (kupto këtu: Ali Ahmetin, Muhamet Kelmendin, Emrush Xhemailin, Rexhe Iberdemaj, në mos edhe Fazli Veliun), Ali Ahmetin dhe Emrush Xhemailin i akuzonin përgjegjës për vrasjen e shokut Laun Haradinajt në kufi, në muajin maj të vitit 1997, kur ishte duke kaluar grupi i Fehmi Ldrovcit me shokë nga Shqipëria në Kosovë.

Ndërsa, një pjesë tjetër e Kryesisë akuzohej edhe për vrasjen e shokëve, në janar të vitit 1997 afër Vushtrrisë, Zari Parazitit, me shokë. Veç kësaj, nëpërmjet LPK-se kanë dashur të krijojnë sistem të veçante jashtë organizimit që është në Kosovë.

Pjesa e kësaj Kryesie ka bërë "harxhime" të mjeteve materiale pa kritere, pa qene kompetente dhe pa pasur të drejte të administroje mjetet financiare të Fondit. Duke vepruar kundër

organizatës, ne kundërshtim me te, shkuan ne Tirane dhe atje luajtën rol "anarkik", duke krijuar "konfuzion" ne radhët e organizatës "sonë". Këta (Kryesia) i kane dhëne përkrahje grupit të furnizimit ne Tropojë, forme kjo qe nuk është përkrahur nga UCK-ja dhe baza politike" (Shënimet nga diskutimi ne KP, maj 1998).

Natyrisht, ketë akuza ishin shumë te renda dhe kuptohet se, unë, si nënkryetar i ish-Kryesisë se deriatëhershme, e mora fjalën dhe një nga një i shpjegova çështjet ne shqyrtim. Mirepo, pjesëmarrësit nuk u "binden", por thirren një mbledhje pas një jave ne Shtutgard, me 09.05.1998. Ne mbledhje u "zgjodh" Kryesia Teknike, ajo qe ne fakt ishte klika e krijuar ne organizate.

Per çështjet qe u akuzuam thashë:

"Me vjen shumë keq pse unë duhet te diskutoj lidhur me çështje te tilla. Është normale qe ose kryetari ose unë duhet te shpjegojmë gjendjen, nëpërmjet se çiles shihet e pavërteta e akuzave të tilla monstruoze. Prandaj, pasi kryetari nuk po e merr fjalën, po filloj unë me radhe sipas akuzave:

Lidhur me vrasjet qofte ne Vushtrri ne janar te vitit 1997, qofte per burgosjet po ne atë muaj, dua te them se ne si Kryesi, përveç ndoshta anëtarëve te sektorit, nuk i kemi njohur. Deklaroj me përgjegjësi se askush prej nesh ata shoke nuk i ka njohur. Ne kemi njohur vetëm organin, Shtabin Qendror, vendimet qe kane dale prej tij dhe raportet tona i kemi ndërtuar nëpërmjet sektorit dhe pikërisht, si bartës te qëndrimeve ka shërbyer Hashim Thaçi e Kadri Veseli; këta te dy, qe po akuzojnë, kane bashkëpunuar me Xhavit Halitin dhe Azem Sylen. Nëpërmjet tyre ka qene e ndërtuar lidhja e Kryesisë se Degës me UÇK-në. Duke e ditur kete, nëse ndokush duhet te përgjigjet, duhet këta të përgjigjen, si edhe vetë anëtarët e sektorit, te cilët po përkrahin. idenë se ne kemi te bëjmë me kete ngjarje. Duhet te përgjigjeni vete per ata qe i keni njohur dhe keni pasur kontakte me ata qe rëne ne Vushtrri.

Ndërsa, kur është fala e vrasjes ne kufi, te dëshmorit Haredinajt, duke e kaluar Fehmi Ladrovcin, duhet te themi se ne si Kryesi., nuk jemi marrë me kete çështje . Me te janë marrë anëtarët e sektorit, te çilet i kane dërguar shokët deri ne Shqipëri, i kane përcjellë deri ne një baze dhe pastaj, ata kane vepruar ne mënyrë te pavarur, nen. drejtimin e grupit per bartjen e shokëve brenda vendit. Mund të akuzojmë vetëm per forme, fjala është pse me te është marre edhe Emrush Xhemaili, i cili nuk i ka takuar sektorit. Po, pavaresisht formës, sipas informatave qe i kemi nga shokët, po sidomos nga letra e Rarnush Haredinajt, del se ky grup, duke kaluar ne kufi ka rënë ne kontroll te armikut dhe gjate asaj lufte ka rënë dëshmor, ndërsa grupi është tërhequr prapa.

Por kur është fjala per organizimin e radhëve brenda vendit duhet gjithashtu te themi se, ne nuk kemi LPK-e brenda vendit. Ne kemi atje këshilla te organizuara. Këta duhet te riorganizohen dhe te thirret mbledhja per organizimin e organeve udhëheqëse. Ndërsa, ajo qe thuhet ketu, është gënjeshtër. Asgjë s'ka te beje me realitetin. Ne Kosovë UCK-ja. nuk ka asnjë baze politike. Ajo s'ka as organ te vetin Shtab Qendror, i cili vetëm tani ka, filluar te ngrihet me njerëz te kooptuar nga këta qe po akuzojnë.

E tere kjo po behet me qellim, per te mos lejuar riorganizimin e LPK-se, te UCK-se dhe ndërtimin e sistemit çlirimtar, sepse vetëm pa të këta zotërinj dhe klika e tyre kane mundësi per t'u forcuar dhe per te mos lejuar një lufte tamam çlirimtare.

Kesaj çështje je i shërben edhe akuza per grupin e punes ne Tropojë, i cili nuk ka bere gjë tjetër, veç se ka barte mjete nga Tropojë ne Kosove, atë mjet qe Xhavit Haliti dhe Azem Syla nëpërmjet Raif Gashit i kane dërguar ne baze atje dhe në bazat e tjera afër. Kosovës. Nuk dua te them se nuk ka fërkim midis tyre, pot atë .ne mbledhjen e Tiranës, ne Kryesi janë zgjidhur dhe ne përpikëri janë ndare punët midis këtyre dy grupeve. Grupi i Tropojë merret vetëm me transportin e mjeteve luftarake ne Kosove, ndërsa grupi i Tiranës (Xhavit, .Azemi, Raifi dhe te tjerët rreth tyre), i blejnë dhe i transportojnë deri ne Tropojë. Kjo është e tera. Dhe, nga kjo

klike po vlerësohet si veprimtari "anarkiste", "konfuze". Kjo ndarje e punes po vlerësohet kështu nga këta, sepse duan të likuidojnë, në mënyrë që të bëhen të plotfuqishëm.

Në Tiranë, gjithashtu, patëm bërë centralizimin e mjeteve financiar, sepse harxhimet nga sektori si dhe nga përgjegjësi i Fondit "Vendlindja Thërret" ishin pa kriter, si dhe askush nga ne në organ, as Kryesia. dhe KP nuk kishte të dhëna se ku po shkonin mjetet financiare, po kjo Kryesi. duhej të raportonte për mjetet financiare, si është e mundur që ne si organ të raportojmë dhe të mos kemi as edhe një të dhënë se ku po shkojnë mjetet nga Xhaviti, Azemi dhe Jashar Salihu, ose nga nënfondet, Si ai i (Gjermanisë, me I.Kelmendin udhëheqës, ai i Austrisë, etj etj. Për të ndaluar këtë decentralizim dhe harxhim pa kriter, sipas dëshirës dhe pa dhënë asnjë raport, kur dihej se çdo gjë blihej në të zezën, u bë centralizimi i mjeteve. Tashme çdo kush duhet të paraqiste kërkesë me shkrim për mjete financiare duke e arsyetuar.

Këtu folam edhe për shkaqet pse në si Kryesi, mjetet financiare, në vitin 1997 i patëm ndarë vetë ne për bazat e *sive luftarake të gjithandej në Kosovë bërë e kemi bërë sepse shumë rrethe, njësi e luftëtarë nuk kishin marrë me muaj të tërë mjete financiare, as edhe arme. Prandaj në vitin 1997 e bëmë ndarjen e mjeteve sipas kërkesave dhe nevojave të rrethit. Atëherë patëm thënë sektorit se në atë moment kur ndarja e mjeteve të bëhej proporcionalisht, në hiqim dorë nga kjo punë. Kështu vazhdoi deri tani.

Ja shokë, këto çështje po vlerësohen "armiçësore". Dhe, me ndërgjegje të plotë po deklaroj se ky është vetëm mjet për të penguar punën tonë nga tri çështje :

1. Ndërtimi i LPK-se brenda vendit,
2. Organizimi, riorganizimi dhe profesionalizimi i UÇK.-se dhe,
3. Nga ndërtimi i sistemit çlirimtar

Po e përfundoj: Të gjitha këtë akuzë këtu drejtohen me të vetmin qëllim se ata duan të ndërtojnë UÇK për klikën e vet" (Diskutimi në mbledhje të KP)

Por, zotërinjtë të Kryesisë së Mbledhjes së Për të KP LPK-se, këtë shpjegim nuk u bënë punë. Ata propozuan një mbledhje tjetër, pas një jave në Shturgard. Nuk mbeti tjetër veç se edhe unë dhe shokë tjerë të pajtohemi. Në këtë mbledhje u "zgjodh" Kryesia Teknike e Degës, në përbërjen e njohur me lartë.

Në mbledhjen e Shturgardit të dy KP të Degës u hapën përsëri për çështje të theksuara. Nga udhëheqja teknike, Bedri Islami, përsëri ia dha fjalën akuzuesve (Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit). Tash fjalën e mori Kadriu. Edhe ai akuzoi mbi atë bazë. Mbledhja zgjati dy ditë. U diskutua për këtë problemë dhe pati mbi 30 diskutime. Shumë kush e mori fjalën dy a tri here. Por, fundi arriti pa vendim për çështje të. U "zgjodh" një komision për t'i analizuar akuzat dhe in dha "mandati" Kryesisë Teknike për të vazhduar me udhëheqje deri në mbledhjen tjetër, e cila duhej të mbahej pas tri javësh.

Nga diskutimet doli se mbledhja u nda në dy tabore:

Në kuadër të taborit akuzues, të cilin e udhëhoqte Kadri Veseli u bë njëfarë rrëshqitjeje. Ata i kishin zbutur pakëz akuzat. Grupi u largua nga akuzat e vrasjes së shokëve nga tradhtia, duke kaluar vetëm tek organizimi dhe anarkia e krijuar në Tiranë. Kësaj iu bashkua edhe kundërveprimi për ndërtimin e sistemit, i cili u kundërshtua dhe u paraqit si element destruktiv në luftën që po zhvillon UÇK-ja në Kosovë.

Në favor të grupit diskutoi Hashim Thaçi, Azem Syla, Agush Buja, Ramadan Avdiu, Shahan Muja, Jashar Salihu, Bilal Sherifi. Në veçanti ofendues dhe pa ndërgjegje dhe aspak shoqëror u tregua Agush Buja. Ai, duke akuzuar, tha: "e vlerësoj këtë pjesë të Kryesisë të pandërgjegjshme, gënjeshtare, antiradheve të organizuara brenda vendit (KP të LPK-se), si dhe vete UÇK-se, kundër të çiles po luftohet nga ana e tyre". Këto ide e përkrahu Shaban Muja, Jashar Salihu e Ramadan Avdiu.

Në veçanti Jashar Salihu doli me akuzë të ashpër. Ai e vlerësoi tërë aktivitetin e Kryesisë "të dëmshme, si në organizimin e radhëve, ashtu edhe në dërgimin e kuadrove, oficerëve dhe

ndërtimin e sistemit, po edhe armiqësorë, për vetë qëndrimin e saj Tirane, atje ku veç ka krijuar vështirësi dhe probleme".

Të tjerët, kush me shume dhe kush me pak mbështetën akuzat, vlerësimet dhe kërkuan shkarkimin e Kryesisë dhe vazhdimin e punës nën udhëheqjen e Kryesisë Teknike. Ata dolën tërësisht kundër Kryesisë së vjetër, në emër të asaj, se ajo ka devijuar luftën çlirimtare, duke u futur në organizim të LPK-se brenda vendit dhe në ndërtimin e sistemit çlirimtar. Kishte ashtu edhe akuzonin për keqpërdorim të mjeteve, ndonëse përgjegjës ishte vetëm Jashar Salihu, sepse ai i kishte administruar mjetet dhe me vite nuk kishte dhënë as edhe një raport („Shënimet nga mbledhja e KP, maj 1998).

Për të nuk kishin me asnjë rëndësi vendimet e LPK.-se, as programi dhe as statuti i saj, sikundër as rezolutat e nxjerra që nga themelimi i organizatës nuk vlenin. As raporti i dhënë nga Kryesia për punën në Tirane nuk vinte. Por, vetëm e kundërta e asaj, ajo që në ishëm fajtor për të tjerë. Çështje. Pse? Vetëm pse Kryesia vepronte në baze të vendimeve të organizatës, bëri centralizimin e punëve dhe të mjeteve, si dhe ndarjen e detyrave, duke ndaluar kompetencat atyre. Në fund të fundit, e tërë puna jone rridhte nga programi i LPK-se, i cili kishte përcaktuar

125

Frontin për e Kosovës, e jo nga ne. Kryesia vetëm e aktualizoi çështjen dhe vepronte. Kjo ishte e qarta. Por ata kishin kaluar në shërbim të klikës, prandaj asgjë pozitive, as programi dhe statuti nuk kishin rëndësi. Dëshira për fitore i bënte qesharake, të pandërgjegjshëm dhe arrogante.

Edhe në ditën e dytë, menjëherë pas diskutimit akuzues të grupit, në emër të Kryesisë përsëri i tregova faktet dhe bëra thirrje, që për hir të luftës brenda vendit, t'i linim çështjet që na ndanin, atë të luftës për pushtet punonim në ndërtimin e sistemit, të vetë organizatës sonë brenda vendit, sepse ajo që thuhej aty nuk ishte reale. Bëra thirrje të punonim duke u mbështetur në programin tonë dhe në vendimet e LPK-së. Por, kjo nuk u dëgjua.

Prandaj vazhdoi diskutimi nga anëtarët e KP.

Në taborin e dytë të diskutuesve u fol shkarazi kundër akuzave, ndërsa shume mbi gjendjen në përgjithësi, por pa dalë në diskutime konkrete mbi të cilat u hap biseda. Ketu diskutoi Gafurr Elshani, Ujkan Nikçi, Ibrahim Kelmendi dhe Naser Idrizi. Pyetjet i paraqiti Ali Ahmeti dhe Emrush Xhemaili, të cilët po nuk diskutuan. Këta të gjithë, kush me shume e kush me pak, ishin për mbajtjen e vijës së organizatës, duke kërkuar që të respektoheshin dokumentet e LPK-se, puna dhe programi i saj.

Në diskutimin e vet, Gafur Elshani foli vetëm pse ka dhënë dorëheqje nga Kryesia., duke i përcaktuar dy momente:

1. Moscentralizimin e mjeteve financiare nën kompetencat e përgjegjësitarit financiar, për të cilin i fajësonte dy fondet, atë në Zvicër me Jashar Salihun udhëheqës, si dhe atë të Gjermanisë., me Ibrahim Kelmendin udhëheqës.

2, Mosfunksionimin në nivel të organeve të Degës, Kryesisë dhe të KP të LPK-se."

Ndërsa, Ibrahim Kelmendi me shume u përqendrua në punën e gjatë të tij, në aktivitetin dhe veprimet e bëra në Tirane, gjatë kohës që ishte ai atje, për devijimet etj. Tha, gjithashtu, se lufta në formën aktuale të organizimit nuk ecte përpara, sepse pa i futur forcat e afta, sidomos oficerët, UÇK-ja. nuk mund të dilte përballë, me sukses, kundër pushtuesve serbe, etj, si dhe të korrte suksese në luftë kundër armikut. Folli në pika të shkurtra edhe mbi gjendjen në organizate dhe për çështjet e tjera, si raportet me Xhavit Halitin, Azem Sylen, etj. Folli negativisht edhe për tërë Kryesinë e vjetër të KP.

Edhe të tjerët shprehën mendime të biseduan. Ali Ahmetin e kishin dërrmuar në mënyrën më jonjerëzore, duke e akuzuar për vrasës dhe kriminel. Prandaj, kaloi në heshtje dhe nuk diskutoi fare. Por, diskutimet e tjera ishin të gjata. Të gjithë folën në lidhje me punën e kryer,

akuzat dhe kërkuan llogari riga sektori i veçantë, i cili nuk kishte punuar ne baze të vendimeve, duke mos e përjashtuar as Kryesinë, te çilen e vlerësonin si etatiste dhe tejet centraliste. Sektori u akuzua per keqpërdorim te mjeteve, ndërsa u kap edhe puna e oficerëve, te cilët klika i ofendonte dhe i bllokonte per te shkuar ne Kosove. Pati edhe konflikte te ashpra, sidomos ne anën e ndërtimit te UÇK-se.

Ne mbledhje diskutoi edhe Dema ne cilësinë e përfaqësuesit te grupit per furnizim me mjete te njësiteve te UCK-se. Ai i ngarkoi .me përgjegjësi, si per mjete luftarake, ashtu edhe per mjete tjera; deri edhe per ushqim te luftërave, te cilët vinin ne Tropojë per te marre arme kryesisht sektorin e veçantë, drejtpërdrejt Azem Sylën dhe Xhavit Halitin. Por, krahas kesaj, ai falënderoi pjesën e Fondit, atë ne Gjermani, i cili kishte bore te mundur zbutjen e situatës, pasi kishte dërguar mjete financiare dhe me atë ishin blerë arme e municion. Ai ishte ne mbledhje ne cilësinë e pjesëmarrësit nga brenda (Shënimet nga mbledhja e KP, maj 1998).

Dhe, pikërisht ne ditën e dyte, ne mbledhje u informuam se "Mërgimi" ishte vlarë ne rrugë e sipër, ne Qafë të Malit, nga grupet kriminale, duke transportuar mjete per në Tropojë. Kjo e qiti jashtë kontrollit Demën, i cili ishte ftuar si dëshmitar i ngjarjeve ne Shqipëri dhe përveç se akuzoj Zekën (Xhavit Halitin) dhe Dajën (Azem Sylën) per sabotim të luftës e shpërdorim te mjeteve materiale dhe bllokim te furnizimit me mjete luftarake per UÇK-ne, ngarkoi personalisht këta dy persona si vrasës të "Mërgimit" (Irir Konushëfcit). Madje ai përdori fjalët "...ja, gjarpërinjtë, mos te shkojnë me tutje ne kërkim te fajtorëve, sepse këta janë fajtores"... Ketu ky e humbi kontrollin dhe ofendoj edhe te tjerët. Atij iu dha vërejtje. Megjithatë, ai u bë dëshmitar dhe provoi tërësisht veprimtarinë e dëmshme te sektorit, kundër te cilit kishte qenë edhe "Mërgimi". Por, vrasja e "Mërgimit" ishte goditje per te gjithë, sidomos per forcat e sistemit çlirimtar, per punën ne Shqipëri dhe per UÇK-n. Ai ishte luftëtar i kesaj ideje të madhe çlirimtare dhe kishte kontribuar jashtëzakonisht shume. UÇK-ja humbi një luftëtar jashtëzakonisht te zellshëm.

Në fund te ditës se: dyte te punes se KP te Degës u propozua qe mos te vendoset, po te shkohet kah krijimi grupit te planës prej tre vetave. Kundër këtij propozimi. ishin shume, po vete akuzat kërkonin një analize te gjere. Përsëri ketu, nga dy ketë baza "zgjodhën" Bedri Islamin kryetar. Ketu qëndron edhe dëmi me i madh, sepse kete tani e kishin ne dorë, sepse ai tani ishte vegël, i cili .me kohe, do t'iu jepte mundësi ne lufte per te ndërprerë punën e ndërtimit te sistemit çlirimtar. Zaten ketu ishte edhe qëllimi. Ndërsa, ky njeri nuk e dinte as gjendjen, dhe nuk e njihte LPK-ne brenda vendit, sikundër as UCK-ne dhe detyrat qe dilnin para forcave tona. Ai dhe anëtarët e KT e KP te Degës nuk e njihnin punën e kryer nga Kryesia, detyrat qe ishin shtruar përpara organizatës ne ndërtimin e Frontit. Dhe, përkundër këtij shpjegimi, ky fare politikani me paturpësi e mori detyrën e kryetarit dhe, ne fakt, e likuidoi organizatën, këndeje edhe bazën e luftës, Frontin Çlirimtar te Kosovës. Në fakt, ata, si KT e Degës, klikën ne fortonim e organizim ishin me te përshtatshmit. Ne emër të tyre mund te behej shume.

Ky grup kishte per detyre te shqyrtonte akuzat dhe ne mbledhjen tjetër, pas dy-tri javësh te raportonte per atë çka. akuzohej Kryesia e KP te Degës. Veç kesaj, iu "zgjat" mandati Kryesisë Teknike qe doli pas MP te Gjashtë te Degës. (Shënime nga mbledhja.) Keshtu, ne fakt, korri sukses ky klan, sepse edhe te beret ne mbledhje kush me vetëdije, kush riga frika dhe mashtrimet,, përfitimet individuale, si dhe te frikësuar sidomos nga gjendja, dolën dhe e përkrahen atë vendim, i cili ndaloi dhe zhduku punën e madhe per luftën çlirimtare ne Kosove. Ndërsa, klika kete donte, përkatësisht punonte per të fituar në kohe, sa të ndërtohej grupi politik i UCK-se dhe pastaj pavarësohej edhe si subjekt. Klika e dinte se asnjë nga akuzat nuk do te vërtetohej. Por, faktikisht, ajo përfitoi tre muaj nga mospuna. ape vetëdija e vete Kryesisë Teknike, me mire te themi, vete Kryesia Teknike dhe Këshilli i Përgjithshëm i Degës, ia krijoi kete gjendje dhe tërësi u ndërtua klika e tillë si brenda ashtu edhe jashtë. E tere veprimtaria ishte drejtuar ketu. Me vendimet e u hap rruga e

shkatërrimit të LPK-se. Pas kesaj mbledhjeje të KP të LPK-se nuk u mbajt një tjetër për tre muaj. Dhe, përgjegjës për këtë është drejtpërsëdrejti kryetari i Kryesisë Teknike, njëfarë personi nga Shqipëria, Bedri Islami, i përgatitur për dërdhi, me fjalor ledhatar, e duke u mbështetur në atë se "akuzat janë shumë të rënda, që kërkojnë kohë dhe punë për t'i verifikuar", nuk thirr fare mbledhje të KP për shumë muaj, edhe pse u kërkua nga tërë anëtarët e ish-Kryesisë. Ne, çdo thirrje përgjigjeje: Ja, se shpejti ne do të ftojme mbledhjen e KP. Kemi shumë punë. Mos keni frikë. Po punojmë shumë" (Shënimet nga Ditari i MK). Por, duke mos e ftuar me se tre muaj mbledhjen, ai me këtë la kështu kohë për të shpëputur tërësisht LPK-në nga vija e vet politike, e përcaktuar në programin e vet politik dhe në status. Nëpërmjet kësaj, e tërë Kryesia Teknike doli kundër organizatës, formë kjo që u përkrah edhe nga KP i Degës në mbledhjen e korrikut të vitit 1998, duke krijuar terren të përshtatshëm politik kundër vetes si organizate, sepse u shkatërrua pavarësia dhe humbi vete LPK-ja. Këtu në fakt mori fund çështja e bashkimit të të gjitha forcave shqiptare në sistemin çlirimtar si pikësynim programor i LPK-se. Me këtë edhe organizata u likuidua si subjekt luftarak, sepse u shkelen atë ide politike madhështore, atë që në organizatë i kishim sanksionuar. Fronti çlirimtar i Kosovës. Por, me qëllim që të dalë në skenë e tërë armiqtësia e KP, sidomos e Kryesisë Teknike, do të flasë me vone, si për shembull, për mbledhjen e fundit të KP të korrikut 1998, ku unë (Muhamet Kelmendi) dhashë dorëheqje të parëvokueshme nga të gjitha organet e LPK-se. Aty përfundon tërësisht çështja dhe klikat fiton.

c) Ndërtimi i klikës dhe baza e saj juridike

Për ndërtimin e klikës që uzurpoi UÇK-në në aspektin politik, ushtarak, juridik e financiar, në një mënyrë bëme fjale edhe me sipër, por, duke u mbështetur në faktin se, kjo klikë lindi dhe u ndërtua nëpërmjet dy grupeve, të cilat ishin të pavarura dhe kishin interesa të kundërta, do të futem edhe një herë në këtë çështje . Kjo, edhe për faktin se kështu kuptohet edhe kuadri i tashëm i UÇK-se si subjekt.

Deri në fillim të vitit 1998 në kuadër të radhëve të organizuara, i kishim tri baza të cilat ishin krijuar vetvetiu në kuadër të LPK-se dhe UCK-se, por (në përmbajtje) me vetëdije të plote. Deri në një fazë të caktuar synimet e tyre nuk u përputhen, por kur rreziku i tyre për të humbur nga Kryesia u rrit, dy grupimet që kishin pretendime të kundërta, për të ftuar kundër pjesës së mbetur të Kryesisë, të çilen unë e kam vlerësuar si grupim i ndaluar nga Kryesia e vjetër, u bashkuan në mendime dhe kërkesa. Atë dy grupime se bashku vepruan kundër organeve tona, përkatësisht

130

KP dhe Kryesisë së Degës, vete qëndrimeve politike e organizative.

Pa të ardhur deri tek rrëzimi i vijës politike të LPK-se që ishte edhe e UÇK-se dhe të ndërtimit i saj, në mars-prill, u bë bashkimi i dy grupeve të krijuara, atij të Azem Sylës dhe të grupit të Xhavit Halilit në një mekanizëm. Këtë dy grupe u shndërruan në një dhe se bashku arritën të mundin LPK-ne. Por, kjo klikë e lindur nga këtë dy grupe kërkonte konsolidim të vete politik e juridik, prandaj bëme kompromise në mes tyre, në sferën e kuadrove e me vone edhe politike dhe se bashku, arritën të formojnë klikën e cila doli në bane të UCK-se si forcë politike, ushtarake dhe diplomatike. Në maj-qershor të vitit 1998 përfundimisht arrihet konsolidimi i klikës si me kuadër, ashtu edhe me sferën juridike, kuptohet pas zhdukjes së Kryesisë së KP të degës, por në atë kohë ende nuk ishte krijuar organi udhëheqës i UCK-se. U desh edhe një kohë që të dilte edhe udhëheqja e saj politike, ushtarake e organizative etj.

Konsolidimi dhe rregullimi juridik i saj u bë në dy ane:

1. Në përcaktimin e "kuadrit" politik, ushtarak, financiar dhe diplomatik për UCK-ne.

2. NE rregullimin juridik të UCK-se si subjekt jo vetëm ushtarak, po edhe politik, duke shndërruar LPK-ne, Degën dhe tete kete subjekt, vetëm ne servil financiar.

Këto dy baza u arritën duke bërë kompromise. Grupit të Xhavitit iu dha udhëheqja e përgjithshme politike, si Adem Demaçi dhe ai vet me Bardhyl Mahmutin, i cili qëndronte si kuadër për të dyja grupet. Ndërsa grupit të Azem Sylës iu dha pozita e zedhenesit të UCK-se, duke mundësuar edhe futjen e tyre në Shtab Qendror, me vone të Përgjithshëm. Kishin mbetur të vetëm udhëheqësit e të dy grupimeve Hashim Thaçi e Kadri Veseli, të çilet i ndihmonte Adem Grabovci dhe Agush Buja. Te dy këtë grupe e vendosën edhe me tej si përgjegjës financiar Jashar Salihun.

131

Ndërsa, Hashim Thaçit iu dha pozita e koordinimit të tyre, dhe me vone edhe e udhëheqjes (Vendimet e SHP të UCK-se). Pas kësaj zgjedhjeje futet rregullimi i ri juridik si subjekt. Me të shndërrohet LPK-ja në servil, duke ia hequr kompetencat në fushën politike, ndërsa SHP shndërrohet edhe në organ politik, juridik e shoqëror, veç atij ushtarak.

Ky rregullim i kuadrit dhe i sferës juridike sjell deri tek dalja në mënyrë zyrtare para opinionit publik shqiptar dhe atij ndërkombëtar me udhëheqje politike, ushtarake, diplomatike e financiare. Në këtë kohë u kooptuan edhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UCK-se nga tabori i lidhjeve miqësore. Shtabi tash krijoi edhe drejtorin e ndryshme neper sfera, ku tera ato u mbuluan nga personat që u kishin takuar grupimeve politike. Edhe Ramë Buja rrjedh si rezultat i grupimit, i cili nëpërmjet Shukri Bujës, person në shërbim total të Hashim Thaçit, u fut nga pozita e qytetarit të Prishtinës, (pa asnjë lidhje me UÇK-ne, pa qenë as anëtar i saj) në Shtab të përgjithshëm. Me vone iu dha atij edhe pozita e udhëheqësit politik e juridik.

Ky "rregullim" e largoi me dispozita UÇK-ne nga fusha e luftës institucionale, ndonëse ishte e mbërthyer në front të ashpër me armikut. Këndej u dobësua udhëheqja ushtarake e saj. Por, kjo për klikën s'ka rëndësi, përballë faktit se me këtë ligjësohet klika si ana kadrovike e udhëheqjes së UCK-se. Këta e shndërruan LPK-në në servil, në mjet që mbledh mjete financiare për Fondin, e cilin e udhëhiqte Jashar Salihu, si person i besuar i tyre në organizatë. Ndërsa, si përfaqësues kryesor politik jashtë vendit (Caktuan Bardhyl Mahmutin, me ndihmën Agush Bujen e Ramadan Avdiun. Me vone edhe Sabri Kiçmarin etj. Por, krahas kësaj politike kadrovike, i tërë ky konglomerat u rregullua me rregullore dhe, iu dha Adem Demaçit e drejta për të ftuar Ansambleve dhe për të ndërtuar qeverinë çlirimtare. Kjo ishte vetëm sa për formë, në mënyrë që mos të duket grupimi i krijuar në kokë të UCK-se.

Me këtë edhe përfundoi çështja e ndërtimit të klikës. Ajo doli në ballë dhe u bë udhëheqëse e UCK-se.

d) Lufta për marrjen e mjeteve financiare dhe të logjistikes

Një lider faktorët e tjerë të konflikteve të ashpra midis grupimeve të organizatës ishin padyshim çështja e financave dhe ajo e logjistikes. Këtë dy çështje shkonin së bashku, sepse ai që e kishte logjistiken në fakt dispononte edhe mjetet.

Financat

Nga njësite me të larta pame mënyrën e mbledhjes së mjeteve financiare për UCK-ne. Ndërsa, tani po flasim për ndarjen e tyre deri në vendin e destinimit, duke kapur këtë fushë në kontekst të të dhënave që ka disponuar vetëm Kryesia.

Organi financiar, Këshilli Qendror i Financimit të Fondit, vet J. Salihu në rolin e kryetarit, në vitet e fundit nuk raportoi, përveç se dha shifra të mjeteve që kalonin neper fond. Në fakt edhe

ne vitin 1997 ishte here ndarja e një përqindjeje te mjeteve nga Kryesia neper njësitet e UCK-se, por administrimin, përkundër kesaj e kishte kryetari. Dhe mosdhënia e llogarisë bëri, sikundër thamë, qe ne mars te vitit 1998 përfundimisht iu deshtë Kryesisë se Degës te beje centralizimin e mjeteve financiare të të gjitha strukturave te financimit. Ai veprim rrodhi si i domosdoshëm edhe per faktin se, as bartësit e mjeteve, sektori i rëndësisë se, veçante, nuk i kishte dhëne as vete Këshillit ndonjë informacion (raport) me shkrim a goje mbi mjetet qe i kishte marre ne dorëzim nga fondi ynë. Ndërsa ne vend filloi diskutimi se mjetet po shkonin djathtas e majtas, pa asnjë kontroll te organit udhëheqës. Vete shifrat ishin te mëdha, shifra qe kalonin shumat e qindra mijëra markave, por atë ishin pambulesë, vetëm si te tilla, duke treguar mallin dhe vendin ku kane shkuar atë mjete ("Shënimet nga mbledhjet e Kryesisë se" Degës 1997-1998).

Per Kryesine ky lloj raportimi per mjetet e popullit, qe mblidheshin ne mënyrë vullnetare dhe me vete ndihmat e anëtareve te LPK-se, ishte i pamjaftueshëm. Mërgimtarët filluan te japin ndihma te mëdha, ndërsa anëtarët dy-tri e katër here ne vite nga 1 mije marka per UCK-ne. Pra, nuk ishte me fjala per mijëra marka, por per qindra e mijëra marka, franga e dollarë amerikane, te çilet mblidheshin neper fondet e Fondit "Vendlindja Thërret" kudo ne bote, deri edhe përtej oqeanit.

Deri ne dhjetor të vitit 1997, ne si Kryesi e bëmë investimin. e një sasi të përqindjes, me ato mjete qe na vinin ne emër te njësive ushtarake në Kosove. Shuma nuk e kalonte shifrën prej 88 -mije markash, kuptohet te atyre mjeteve qe i ka ky organ. (Shënimet nga të dhënat financiare në Kryesi.) Por, flitej se ne Fond, si ne atë të Zvicrës, ashtu edhe ne atë te Gjermanisë, nëpërmjet kanaleve te ndryshëm, sektorit, kryesisht kane kaluar rreth 500 mije marka brenda vendit. Kishte te dhëna qe shkonin deri ne 1 milionë marka. Dikush nga anëtarët e KP kishte deklaruar se shifra e mjeteve e kalonte shumë prej 1 milion e 200 mije marka. Per te gjitha ketë, organi nuk kishte asnjë informacion.

Pikërisht kjo gjendje beri qe përkundër kundërshtimit te

te behet centralizimi i mjeteve ne kuadër te Kryesisë, ndërsa, për administrimin e tyre, nga ky organ u caktua komisioni prej tre vetash. Por, ky nuk ishte centralizimi i tërësishëm. Jashtë Kryesisë kalonin me shume se 70 % mjete. Ndërsa, përgjegjës financiar nuk kishte. Ai (Gafurr Elshani) ishte larguar nga pozita e anëtarit re Kryesisë mu per shkak te mos centralizimit te mjeteve financiare, të cilat u aplikuan ne pune pa kontroll.

Nuk mjaftonte vetëm shifra per te raportuar. Tash, pas dhjetorit, ne muajin shkurt e mars 1998, hynë me shume mjete.

Raportet me shkresa me dy a tri te dhëna, qe jepte sektori rëndësish se veçantë dhe fondi, pa vërtetim të palëve, nga nuk delte as vendi, dorëzuesi a marrësi, dedikimi i mjeteve etj., per shpenzimet qe e kalonin shifrën e 300 a 500 mije markave gjermane, ishin jo të mjaftueshme. Ishte koha kur duhej te intervenonim me force per te venë ne binar financimin. Fjala ishte per mjetet e popullit. Ne nuk kishim te drejte të lejonim kete çrregullim kaq të ashpër te sektorit te financave dhe tejkalimin e. shumë prej 5 mije markave gjermane, qe kishte te drejte per te dhëne përgjegjësi financiare pa vendim te Kryesisë se KP te Degës (Vendim i Kryesisë 7997). Po ja qe fondet, pavaresisht se cili (ai i Zvicër dhe i Gjermanisë) nuk pyetnin me askënd. Kjo duhej ndalur. Ishte koha e fundit per te vepruar me vendosmëri.

Edhe një fakt e zgjoi interesin tonë: mjetet luftarake, atë te transportit etj, harxhimet e ndryshme, ushqimi, fjetja ne Shqipëri dhe ne boten e jashtme dhe blerjet pa prova. asnjë prove (dëftese), nuk paraqiste sektori per mjetet qe shfrytëzonte per blerjen e mjeteve dhe per harxhimet tjera. Ne anën tjetër, kureshtja e njerëzve u zgjua ndaj mjeteve. Rrugët e Tiranës ishin mbushur me njerëz qe financoheshin nga Fondi. Ata rrinin lokaleve duke harxhuar, ushqeheshin neper kafe etj, Te gjitha ketë harxhime barteshin nga Fondi.

Dhe, meqenëse mjetet bliheshin nëpërmjet Xhavitit, Azemit, Raifit dhe Ilirit e Demes se bashku, midis tyre kishte filluar një lufte e ashpër. Azemi dhe Xhaviti thoshin se vetëm ata

(Xhavit-Azem) kishin kompetenca per te blerë mjete dhe financuar UCK-në. Si te tillë nuk raportinin fare, duke deklaruar se i përgjigjen vetëm Shtabit. Ne anën tjetër, Raifi deklaronte se pa te asnjë mjet nuk mund të blihet ne Tirane dhe ne Shqipëri, pasi edhe mjetet e transportuara deri tash kishin kaluar nëpërmjet tij. Kurse grupi i trete, i udhëhequr nga Dema-Mërgimi, financohej nga Fondi ne Gjermani, kuptohet jashtë kontrollit të Kryesisë, sepse as këndej nuk respektoheshin vendimet. Edhe këta, sikundër thoshin, per shkak se nuk kishin mjete ne Tropojë, u detyruan vete të merren me mjete, jashtë vullnetit te tyre, vetëm e vetëm qe populli qe vinte vullnetarisht ne Tropojë, te kete mjete dhe te mos kthehej i paarmatosur dhe te rrezikohej.

Kjo gjendje u ashpërsua. Prandaj, centralizimi u be per disa shkaqe:

1. Te mjeteve te mëdha te cilat filluan te futen ne llogarinë tonë.
 2. Ndarjes proporcionale dhe sipas nevojës te mjeteve neper leme dhe fusha qe i kërkonte lufta jone çlirimtare.
 3. Mbajtjes nen kontroll te mjeteve financiare qe u përdoren per blerjen e armeve ne Shqipëri.
 4. Per te futur nen kontroll mjetet e popullit, ne mënyrë qe të mos bëhej keqpërdorimi i tyre, si nga këshillat e financimit, ashtu edhe nga përgjegjësit financiare, ata te logjistikes etj.
- Me ketë ide u nxor vendimi ne Kryesi dhe ne mars, (me 07) të atij muaji u bë centralizimi i mjeteve. Këtij vendimi iu përgjigjen nenfondet nëpër shtete, por jo ai me qendër ne Zvicër, as mjetet të cilat vinin nga SHBA nëpërmjet aktivisteve ne Shqipëri. Ndërsa, përgjegjës kryesore nga Kryesia, te çilet edhe duhej te nënshkruanin per mjetet qe hynin dhe dilnin nga Fondi qe ishte nen kontrollin e Kryesisë se Degës u caktuan: Muhamet Kelmendi, Ali Ahmeti dhe Adem Granovci. Udhëheqës u zgjodh M. Kelmendi. Këta duhej te nënshkruanin dëftesën per financimin e çdo veprimtarie. Pa nënshkrimin e tyre nuk mund te financohej asnjë fushe.

Duhet thënë, ne mënyrë qe te shihet se per dare shumash është fjala, se cilat mjete financiare brenda periudhës prej 07.03. e deri me 15-20.04.1998 kane hyre tek Kryesia dhe te cilat i ka Administruar ky organ. Fjala është ketu vetëm per kete periudhe, sepse Kryesisë iu deshtë te marsit dhe ne prill e maj te vitit 1998. Pas kesaj date, sidomos pas mesit te prillit ne nuk kemi as edhe një të dhëne.

Ne Kryesi kane ardhur:

Nga Gjermania fondi dha dy here mjete financiare. Një here shuma prej 130 mije markave dhe herën tjetër kane ardhur 60 mije marka. Ndërsa nga Austria janë futur 210 mijë marka gjermane. Nga qeveria Bukoshit 280 mije marka. Nga Hamburgu 61 mije marka i solli Muhamet Elshani. Ka pasur shuma qe kane ardhur nga. Belgjika, Franca e viset e tjera. Por, per fat te keq per atë nuk ka shënime, sepse me lëshimin e Tiranës, përsëri ai regjistër, si dhe vete mjetet kalojnë ne sektor. Ai i ka ato te dhëna dhe kurrë më nuk ka dorëzuar mjetet dhe dokumentet.

Duhet thënë se gjate kesaj periudhe kane hyre dhe iu kane dhëne përfaqësuesve te sektorit, kryesisht Xhavit Halitit dhe Azem Sylës edhe disa shuma te tjera, edhe pse ata me vendim nuk kishin. te drejte t'i pranonin mjetet. Nga Gjermania i ishin dorëzuar Xhavit Halitit 200 mije marka nga Xhemail Duraku, me vendim te lëshuar nga Kryesia e Degës, ne emër te Shtabit Qendror të LPK-se, prej nga ngarkohej ai me detyrën e tille, i kishte mbledhur ne Ceki. Nga SHBA-ja i ishin dorëzuar te njëjtit nëpërmjet një aktivisti rreth 300 mije dollarë, nuk dihet saktësisht shuma. Dhe, jemi njoftuar edhe per një shume prej 170 mije dollarësh qe i kane marre këta ne dozim ne Rinas. Nuk kemi te dhëna te tjera per asnjë fond. Nuk i dimë te hyrat ne Zvicër, Austri, SHBA etj, as te hyrat per grupet e punes ne Tropojë, Tirane etj, te cilat bëheshin nga Fondi ne Gjermani. Ketë mjete nuk kane byre ne evidence te Kryesisë dhe nuk kemi as edhe një shënim per atë. Kryesisë nuk i ka dhëne raport, ndërsa ne pyetjen dhe

insistimin tonë që të jepet raport me shkrim dhe të dorëzohen mjetet nga sektori, mu nga përgjegjësit në Tiranë (Xhavit Halitin) na e tha në mbledhje:

"Ne kemi blere hekura! Kosova po mbushet!"

137

Mjetet në këto kohe janë shfrytëzuar për blerjen e mjeteve për luftë. I janë dhënë dy here Fadil Demirit mjete financiare për transaksionet në Bosnje e Hercegovinë. Dy here nga 150 mijë marka. Pastaj për oficeret, rrugët e tyre, janë dhënë 20 mijë marka. Kurse, për shpenzimet e tyre në Tiranë 10 mijë marka. Rreth 200 mijë marka iu dhënë Azem Sylës dhe Xhavit Halitit, si dhe Adem Grabovcit për mjete. Shuma tjetër ka mbetur dhe është dorëzuar para se të bëhet grushti politik.

I thashë këto për të parë se me darrë kishim të bënim, ndonëse ishte vetëm fillimi, sepse me vone ka të dhëna se janë futur mjete shumë me të mëdha.

Mirepo, megjithatë, kjo e bëri efektin e vet. U arrit që deri në prill 1998 rreth 70% të mjeteve të centralizohen. Mbeten vetëm dy baza. E Zvicrës dhe ajo e Tiranës, nën drejtim të Xhavit Halitit, Jashar Salihut e Azem Sylës, të cilët nuk i dorëzonin mjetet sipas vendimit. Një përqindje nuk e dorëzonte as fondi nga Gjermania. Këtu është edhe baza, pse pas MP të LPK-se, në mbledhjen e Partisë së KP të ri të Degës, nga Hashim Thaçi u bë akuza për keqpërdorim të mjeteve financiare nga Kryesia, në kohën kur ky organ, me bazën e vet të re, si dhe me përgjegjësinë financiare ishte përgjegjës i tërë punës, edhe i mjeteve financiare të mbledhura. Por, tash zotërinjtë nuk kishin mundësi për të bërë harxhime pa kritere, pa mbuloje etj, ndaj ngritën akuza të tilla. Ata donin të vazhdonin administrimin e mjeteve pa asnjë kriter dhe kontroll.

Shpenzimet ishin të mëdha. Sikundër dihet, nëpërmjet sektorit dhe grupeve të punës në Shqipëri kalonin financat në Kosovë, bliheshin mjetet në Shqipëri e jashtë, mbuloheshin shpenzimet e veprimtarive kudo, në Shqipëri, jashtë vendit etj. Për të gjitha këto, deri në centralizimin, nuk kishte Kryesia as edhe një informacion, përveç shumave të dhëna fiks dhe pa mbulose. Me centralizim, Kryesia nuk dilte kundër grupeve të tilla, punës dhe aktivitetit tjetër, por kundër keqbërësve plëngprishës të mjeteve nëpër rrugët e Shqipërisë, pranë qendrave jashtë etj. Ato ishin shuma jashtëzakonisht të mëdha. Prandaj, u kërkua me centralizim që çdo sektor, grup e individ, të paraqesë kërkesë me shkrim, duke treguar vendin, mjetet dhe qëllimin e mjeteve financiare që kërkonte. Në bazë të saj vendosej nga Kryesia për mjetet financiare. Ky ishte zaten edhe vendimi i këtij organi.

Ky centralizim i veprimtarisë financiare i ndaloi deri në prill të vitit 1998 harxhimet e mjeteve pa kritere dhe i vuri nën kontroll këta zotërinjtë, duke i detyruar ata të paraqesin kërkesa dhe të japin raporte të metalizuara me shkrim për shpenzimet. Duke thënë se me këto vendim u akorduan të gjitha këshillat e financimit. Ndërsa, si shkak për decentralizim, nga vete sektori

veçante dhe Jashar Salihu, edhe me tutje paraqitej Fondi nga Gjermania, duke akuzuar këto këshill si vend që po bënte investime pa kritere, nëpërmjet Dëmës dhe Mërgimit. Po, këta kishin dhënë raporte konkrete dhe nga marsi e nën dorëzimin e një përqindjeje të madhe të mjeteve në Kryesi (*Shënimet nga Puna e këshillat të financave të Kryesisë së Degës, mars -prill 1998*). Kishin mbetur vetëm mjetet që kalonin nëpërmjet fondit në Zvicër jashtë kontrollit, ato që vinin nga SHBA-ja për të cilat mendonim se gradualisht do të vihen nën kontroll. Përkundër kësaj dobësie, ky centralizim i mjeteve vazhdoi deri në fund të prillit, kur u ftua mbledhja dhe u bë grusht politik ndaj udhëheqjes së LPK-se.

Mirepo, me të dalë përsëri Kryesia Teknike në balle të LPK-se, pas "zgjedhjeve" të reja, 01-09.05.1998 në KP, me financat dhe fondet në përgjithësi vazhdoi kënga e

vjetër, ajo e financimit pa asnjë kontroll nga organet, te sektorit (klikës) qe i kishte ne dore mjetet. As pas tre muajve nuk u dha asnjë raportim (*shiko mbledhjen e KP to korrikut, to pare pas asaj date kur nuk u raportua*). Tash, nga fondi ne Gjermani, finançohej grupi i punes ne Tropojë, bliheshin arme per Kosove dhe ushqeheshin vullnetaret qe shkonin atje me urdhër te njërive të UÇK-se per te marre mjete dhe dërgoheshin mjete financiare ne terren. Mesa, mjetet e tjera shkonin nëpërmjet atij te Zvicrës, si dhe te sektorit tash te përgjithshëm ne Tirane, te cilat e furnizonin sektorin ne Kukës, te tjerët ne Tirane, e ku jo. Por, e përbashkëta është se para KP te LPK-se, deri ne korrik te vitit 1998, nuk iu paraqit asnjë informacion mbi mjetet financiare.

Pikërisht kjo anarki e ngrinte kete çështje me force per diskutim dhe ne te ardhmen me siguri s'do te shqyrtohet. Pse? Sepse, është jashtëzakonisht jo njerëzore per Fondin, sektorin e veçantë, LPK-ne dhe UCK-ne lënia ne situatë te anarkisë totale, përveç dy muajve, te te gjithë gjendjes financiare. E ardhmja do te flasë qarte.

Logjistika

Një çështje tjetër, qe u paraqit me ashpërsi ne kuadër te punes sonë to organizuar, ishte logjistika. Per kete sferë patëm brenda periudhës qe është marre ne shqyrtim fërkime, mosmarrëveshje dhe konflikte te mëdha. Çdo njëra force, sidomos ato te sektorit veçante, e bene bllokimin e tërësishëm te kesaj sferë te rëndësishme te luftës. Ata donin qe, asgjë pa ata te mos blihet dhe t transportohet ne vend.

Me kete veprimtari sektori u shndërrua ne force kryesore. Duhej vetëm vula e tyre. Pikërisht per kete shkak, është dashur shumë me beret per te intervenuar. Por, per shkak se anëtarët e sektorit te veçante nuk erdhën ne mbledhje te Kryesisë, kjo nuk pan Mundësi per t'u zgjidhur. Ketu u be gabimi me i madh, pse ky organ nuk arriti dhe lejoi deri ne mars te vitit 1998, këta persona te sektorit te veçante te merren edhe me kete çështje, me logjistike, te çilen ata e shfrytëzuan si mjet per te ndikuar ne radhët I trendë vendit, tek UCK-ja dhe te bëhen vete anëtar te Shtabit, pikërisht nëpërmjet kesaj mase. Ata i shfrytëzuan mjetet financiare mase per te futur nen tutele UCK-ne.

Edhe nëpërmjet logjistikës, ky sektor i keqpërdori radhët e UCK-se dhe atë e futi nen kontrollin e vet. Per atë shkak nuk u ndërtuan as organe udhëheqëse e komanduese ushtarake. Si u zhvillua kjo veprimtari?

Deri ne janar to vitit 1997 nuk patëm probleme to kesaj natyre. Ndonëse, sektori i caktuar nga Kryesia nuk kishte kompetenca per kete fushe te punes, Kryesia e pranoi ne heshtje edhe kete veprimtari, si veprimtari e sektorit .te veçante. Mirepo, vendim lidhur me kete heshtje ne organin tone nuk është nxjerre. Vendimi i pare ne Kryesine e Degës per kete çështje arrihet ne muajin qershor te vitit 1997, kur u nxor vendimi per mjetet materiale (luftarake), te cilat iu dedikuan rrethëve te veçanta ne vend (Llapit, Drenicës, Dukagjinit, Pollogut etj), sepse nga te dhënat e terrenit del se, ata nuk kishin mjete te mjaftueshme, as financiare dhe as luftarake. NE kete muaj u blenë, me vendim te organit to Degës, disa mjete per Drenice (Prekaz), pastaj per disa -vise te pushtuara nga shteti maqedon, si dhe per njësitet e Llapit.

Ky vendim Ben fërkimin e pare. Nga ky moment u thellua kontrolli mbi sektorin qe merrej me kete çështje. Nëpërmjet këtij organi dhe ne kete organ, u caktuan muaj pas muaji mjetet luftarake, përveç atyre qe blinin ne mënyrë tjetër, nga sektori. Ne dhjetor te vitit 1997, këtij sektori iu shtua edhe një grup i punes, i cili vinte nga Brenda me Leman dhe Mërgimin udhëheqës. Ne kuadër te këtij grupi ishin edhe disa te tjerë, si Gania, Lumi etj, te cilët

vepronin ne grup. Edhe këta fillimisht kishin kompetenca per te blere mjete per UCK-ne. Mirepo, detyre parësore e këtij grupi ishte kryesisht transportimi i mjeteve përtej kufirit, ne Kosove, tek njësitet luftarake. Dhe, duke u mbështetur ne suksesin e madh te tyre, sidomos ne transportim përtej kufirit dhe ne mjetet qe i gjenin ne territorin e shtetit shqiptar, ky grup u be shume i njohur. Ai arriti nga dhjetori 1997 deri ne maj, qe te kryej një pune kolosale.

Por, ky grup kishte edhe vështirësi. Ato ishin kryesisht te natyrës se mjeteve luftarake, si dhe te financave, te cilat nevojiteshin grupit. Ky grup, pikërisht per shkak te suksesit, nuk furnizohej si duhet, ndërsa vete nuk kishte mjete te mjaftueshme. Ky bllokim i punes se tyre, kishte bare qe ky grup i punes te financohej, sikundër kemi dëgjuar me nga Fondi ne Gjermani. Edhe këta pa e informuar Kryesine paraprakisht, përveç pas investimit, duke raportuar me shkrim, dhanë mjete. Nga raporti qe u dha ne Kryesi nga Fondi doli se deri ne mars me mjete te ardhura nga ky Fond kishin blere mjete luftarake per njësitet luftarake. te UCK-se. Nga ky Fond financohej edhe ushqimi per vullnetaret qe vinin ne atdhe per mjete nga Kosova. Njëpërmjet këtij behej edhe furnizimi i ca radhëve ne Kosove, te cilët, sipas raportit, ishin lënë pa mjete.

Ndërsa, sektori "kompetent" si ne punët e tjera, as ketu nuk dha asnjë informacion a raport me shkrim per punën e vet. Grupi i punes ne veri dha me shkrim raport, ndërsa këta me goje. Per sektorin mjaftonte te thuhej se, kane blere hekura per Kosovën! 'Po sa kane kushtuar ata hekura, ku i kane blere dhe a ishin ne rregull, sektori nuk dinte, sikurse edhe vete grupi qe i transportonte, sepse te dy palët ishin laike dhe nuk kishin njerëz te kualifikuar per kete veprimtari. Te vetmin njeri qe e mori sektori ishte Raif Gashi dhe atë, per shkak te lidhjeve qe i kishte ne Tirane dhe ne shtet (Shënimet nga puma ne Tirane deli ne prill 1998).

Ne kete gjendje e gjeti lufta logjistiken. Me te shkuar ne Tirane, Kryesia e Degës u mor edhe me kete pune. NE mbledhjen e pare

trajtua kjo çështje. Aty u pa se konfliktet janë vetëm per te administruar mjetet financiare, si baze per te vendosur. Prandaj u krijuan fërkimet ne kete fushe me rendësi per luftën se kush to marre atë ne dore. Lufta per logjistiken u be per disa qëllime me rendësi:

a. Se pari, njëpërmjet logjistikës shtrihej ndikimi tek zyrtaret ne Tirane, duke krijuar lidhje e kontakte me ta, lidhje te cilat nuk ishin aspak ne bazë organizative.

b. Se dyti, shtrihej ndikimi tek radhët e organizuara to UCK-se, duke fituar pozicione ne strukturën e saj, si ne Shtab Qendror, ne sektorët e drejtoritë e tjera, organe to cilat tash veç kishin filluar nga klika per t'u rindërtuar njëpërmjet kooptimit;

c. Se treti, njëpërmjet logjistikës arrihej ndikimi absolut mbi mjetet financiare, te cilat kishin rol dominant ne tërë gjendjen vend. Teoria: kush i ka parat e ka gjendjen, zotëronte;

d. Se katërti, me logjistikë krijohej terreni edhe per te përfshire nen ndikimin e vet edhe te kadrove ushtarake, -LE cilat veç kishin shprehur dëshirën per t'u futur ne radhët e UCK-se.

Per shkak te këtyre elementeve ishte e pamundur per te ulur sektorin ne bisedime. Te gjitha kompetencat ne Tirane i kishte marrë Xhavit Haliti dhe Azem Sylja. Zeka nuk linte asnjë kontakt me asnjë nga zyrtaret, pavaresisht nivelin. Ne ane tjerët, Azem Sylja ishte i ashpër, ofendues edhe aspak tolerant, njeri qe nuk donte per te dëgjuar per organet dhe nevojat e luftës. Çdo gjë qe nuk kalonte njëpërmjet atij e Xhavit Halitit dhe njëfarë mjekut (Shaip Mujes) ne Tirane, nga Kosova, qe merrej me shitblerjen e medikamenteve, ishte jo e drejtë dhe luftohej ashpër (*Shënimet nga diskutimet e tyre nga mbledhjet e Kryesisë*) Asnjë grup tjetër i punes nuk pranohej. Per ata madje nuk kishte kompetenca as Kryesia e Degës.

Megjithate jane dy shkaqe qe i detyruan ata te nenshtrohen ne organ:

1. Anëtarësia ne Kryesi to KP të Degës dhe,

2. Dhënia me shumice e armeve falas nga shteti, ndërsa nga sektori është dhëne shuma e mjeteve që gjoja janë blere këto arme, edhe pse del e kundërta (Dëshmitë e dëshmitareve në Tirane).

Këto dy fakte për kohën e detyruan ata të ndalen dhe në Kryesi të Degës arritëm të bëjmë kompromise me grupin tjetër që vepronte në veri të Shqipërisë. Mbeti që sektori i veçantë (Xhavit, Azem) të blejë arme në popull, gjithandëj në shtet, që thoshin se aty po i marrim, e, jo tek shteti. Për kohën u caktuan llojet e armeve, duke kërkuar antitanke, mjete kundër aviacionit dhe topa të kalibrave të ndryshëm. Këto mjete u tha se i duhen UÇK-se për të bërë balle në luftë me forcat pushtuese serbe. Ndërsa, mjetet e blera u vendos, përveç atyre që shkojnë në rrethin e Bukësit, pas transportit të tyre në veri, të merret grupi i Mërgimit me to. Ai duhet për mjetet të kujdeset, duke e bërë largimin e tyre në vend -LE sigurve, pastaj pastrimin dhe shpërndarjen në vendet e caktuara, sipas kërkesave të njësiteve të UÇK-se.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë, më 07 mars 1998.

Përveç kësaj ndarjeje të punëve, në mbledhjen e marsit, në lokalitetin e Raifit në Tirane, pastaj në mbledhjet e mbajtura në 'Universitetin e Tiranës dhe në Lidhjen e Shkrimtareve të RP të Shqipërisë, ku ishte stacionuar për kohën Kryesia, u caktuan edhe disa grupe të tjera, të cilat futeshin në logjistike dhe mendonim se këto grupe të punës do të kompletoheheshin për këtë fushë shumë të rëndësishme për luftën tone çlirimtare. Ky lloj organizimi të logjistikës ishte menduar të vepronte deri në ndërtimin e sistemit çlirimtar, ku edhe kjo fushë mendohej të ndërtohej mbi baza shtetërore, në sistem, duke e gjetur mekanizmin adekuat. U krijuan këto grupe të punës:

1. Grupi për gjetjen dhe transportimin e rrobave ushtarake.
2. Grupi sanitar, ai për gjetjen e mjeteve sanitare dhe transportin e tyre, deri në Tirane, si të medikamenteve ashtu edhe të mjeteve për intervenimin kirurgjik etj.
3. Grupi për kujdesjen ndaj Vullnetareve.
4. Grupi për të plagosur.
5. Grupi i punës për llogarinë e mjeteve në Tirane, (Vendimet e Kryesisë mars 1998).

Edhe këto vendime u futën në fuqi menjëherë. Ato filluan edhe të realizohen neper fushat që u zgjodhën. Tani çdo grup punës merrej profesionalisht me punën e vet. Kështu u gjeten rrobat ushtarake, mjetet medicinale, medikamentet etj. 'Te tjerët kujdeseshin për vullnetaret. Mjetet që siguroheshin për UÇK-ne i transportonin vetë grupet e punës deri në Durrës. Aty i merrte dorëzimin sektori i veçantë; tash i logjistikës. Sipas të dhënave, këto grupe, me ndryshime të vogla kanë funksionuar deri në vitin 1999. Por, askush deri në korrik të vitit 1998 nuk ka patur të dhëna për punën e logjistikës.

Sipas këtij vendimi u punua në shumë fusha. Por, çdo grup i punës kishte urdhër që, pa dijeninë e Kryesisë dhe pa vendimin e saj të mos ia dorëzonte mallin Xhavit Halitit a Azem Syles, as edhe "mjekut" Shaip Muja në Tirane. Edhe pse ky vendim ishte në fuqi, në u detyruam të pranohim të kundërtën, sepse sektori bllokoi punën tek organet e shtetit shqiptar. Nëse nuk veprime kështu bëhej bllokimi i punës nga sektori tek organet e shtetit. Për të mos ardhur deri tek bllokimi i punës, pranuan në heshtje. Ndërsa, vendimi mbi blerjen e anëtarëve, transportin e tyre dhe sigurimin e vendit, me zyrtaret, nuk u zbatua nga sektori. Ata ishin të plotfuqishëm, sepse vetëm ata e kishin lejen e shtetit. Mirepo, ata donin t'i kishin edhe mjetet financiare, në mënyrë që të vepronin të pakontrolluar, si dhe vete të mbanin lidhjet me qeveritaret në Tirane, jashtë organizatës. Pengese ishin mjetet. Ndërsa, financat me vendim i dispononte dhe i administronte vetë Kryesia, ndonëse nuk i kishte të gjitha. Kjo e tmerroi atë sektor, i cili filloi të mos blejë arme dhe të lere pa e furnizuar grupin e punës në veri, sidomos në kohën kur atje kishin filluar të shkojnë vullnetare, të organizuar nga rrahët e UÇK-se edhe me qindra e tjera vetë. Në këtë gjendje, kërkuam që në sektor të futen edhe forca të kualifikuara ushtarake, ato teknike, si Fadil Demiri, një ish ushtarak, shok e i burgosur dhe besnik për luftën çlirimtare, të cilin veç e angazhuam me punë të veçanta sidomos jashtë

vendit. Me te dhe kuadro to tjera mendonim te profesionalizonin gradualisht kete sferë shume te rëndësishme te luftës. Kërkuam gjithashtu te futen ne grup edhe Xhemal Fetahu dhe Naser Idrizi, përndryshe anëtare te KP to LPK-se, pot as këta dhe asnjeri nuk u pranuan nga grupi i logjistikes.

Kishte raste kur mjetet e blera nga sektori, si: pushkët, kallashnikovët, pushkomitrolozet, pushkët 10 e 20-e, armët antitanke etj., bliheshin pa kritere. Kishte gjithashtu taste, sidomos topat 75 mm, apo minahedhësit 20, nuk funksionon si duhet. Ato mjete ishin shpeshherë ne rregull, po iu mungonte ndonjë pjesë, si shenja optike a mekanike e operimit. Kjo gjendje e rriti rendësin e Kryesisë qe domosdo sektori i logjistikes te zgjerohet me teknike ushtarake, me forca qe kishin njohuri per armët. Prandaj, u nxor një vendim i tille (*vendimi mbi logjistikën, mars 1998*). Ai hyri pas faktit, i cili erdhi nëpërmjet informacionit se shume arme nuk po funksionojnë, si edhe me faktin se tash duhej te paraqiteshin me shkrim kërkesa per mjetet qe u blenë, ne mënyrë qe Kryesia te jetë ne gjendje per te vendosur pro a kundër kërkesës per armët e veçanta. Lidhur me kete ishin edhe shkresat nga terreni, ku theksoheshin llojet e armeve ne lufte. Duke u mbështetur ne kete, nxorr vendimi, i cili e tmerroi sektorin e vecante. Ata, ne vlugun veprimtarive per furnizimin me mjete te UCK-se, tere mjetet qe i kishin ne disponim i bllokuan. Dolën edhe ne emër të Shtabit Qendror me vendim se vetëm ata janë kompetente per te gjitha çështjet ne sferën e logjistikes, ku i futnin edhe veprimtaritë qe thashë. Por, kjo nuk ishte e keqja, sepse edhe përkundër kësaj, ata nuk blinin mjete dhe nuk dëgjonin te tjerët per t'i blere mjete efektive per lufte, si dhe nuk i kryenin as punët e tjera. Kjo e detyroi Kryesine që jashtë vullnetit te vet, te ndaje mjete dhe te dërgojnë jashtë vendit persona per te blere mjetet luftarake to domosdoshme per njësitet UCK-se. (*Shënimet nga veprimtaria ne Tirane.*) Por, kjo nuk ishte e mjaftueshme. Ne njerëne, se mjete financiare nuk kishim sa duhet, sepse ato vinin kohe pas kohe, te cilat edhe u morën nga sektori dhe nuk u dorëzuan ne grupet e punes dhe, ne anën tjetër, nuk i kishim krijuar lidhjet me organet e vendit ne Shqipëri. Me këta i kishte lidhjet vetëm Xhavit. Ai kishte leje të veçante, prandaj i mori tërë mjetet dhe u lidh me zyrtaret ne Tirane jashtë organizatës, duke u dale dërguesve të mjeteve financiare ne Rinas, ne aeroport, apo ne Limanin e Durrësit dhe duke ua marre ato, to cilat ai nuk i dorezonte ne Kryesi.

Lufta per logjistikë e ndau ne tërësi klikën nga organizata. Ky ishte gjoja faktori pse urgjentisht u thirr mbledhja e KP to Degës, pa u konsultuar me Kryesine. Mbledhja u thirr me anën e Nëndegës se LPK-se ne Zvicër. Thirrjet ishin lëshuar, prandaj Kryesia u detyrua per to lëshuar Tiranen, sepse nga thirrja dilte se ishte mbledhja paraprake e KP, ajo qe kishte per qellim per to krijuar terrenin per përgatitjen e MP to Gjashte të Degës, nëpërmjet se citës u be grushti politik mbi Kryesi (*Thirrje për MP gjashte te Degës*). Është pikërisht, kalimi i kompetencave ne kuadër to Kryesisë, edhe per logjistikë, qe i tmerroi përtej mase këta zotërinj dhe e shtynë kete organizëm ne kete veprim antistatuore. Pas mbledhjes se .KP u kthye një pjese e Kryesisë se KP ne Tirane. Atje kishte mbetur çdo gjë ne vend. Sektori nuk pranonte me kontakte me Kryesine, edhe pse ende ishin ata (Xhavit Haliti e Azem Sylja) anëtare to saj.

Ne situatë to tille lindi ideja: "fshati financon fshatin". Kjo erdhi thjesht nga moskryerja e detyrave sektorit to logjistikes përballë luftës. Pse? Sepse, shume qytetare qe vinin nga viset e ndryshme to Kosovës ne Tropojë per armatim, ktheheshin ne vendlindje pa arme. Ky fakt beri qe shume rrethe, lagje e vende to vetorganizohen. Keshtu filloi mbledhja e ndihmave financiare ne devize nga luftëtarët e Kosovës. Ata i kishin dërguar njerëzit e vete dhe blinin arme neper fshat, lagje e qytete, ne kazerme etj, si dhe i transportonin mjetet ne vendin e vet. Ishte ne Tirane një çrregullim i përgjithshëm. Askush nuk përgjigjej per asgjë. Kishin mbërritur radhe to organizuara dhe jashtë saj. Me qindra e mijëra qytetare shqiptare nga Kosova endeshin rrugëve to Tiranës e Shqipërisë. Çdo kush prej tyre .kishte mjete financiare.

Ata kërkonin, blinin dhe transportonin arme ne veri, e prej andej ne Kosove (*Dëshmitë e dëshmitarëve, Tirane. 1998*).

Prandaj, per to ndaluar kete gjendje, nga Kryesia e Degës u kërkuar me force qe tere sektori i veçante të vije ne mbledhjen e saj. Ne donim qe me organizim t'i dilnim përballë kesaj gjendjeje. Por, sektori ne emër to Shtabit Qendror, atij shtabi qe vetëm ne **letër ekzistonte**, sepse ende ishte ne kooptim e sipër, e refuzoi kete organ udhëheqës. Me herët Kryesia e pate bore centralizimin c tere mjeteve ne mënyrë qe to detyroje sektorin dhe grupin e punes per to vepruar sipas vendimeve. Por, ishte e kote. Ata nuk erdhën me jave ne vendin ku rrinte Kryesia, ndërsa per here të fundit erdhën ne fillim to prillit. Erdhën per të marre mjete financiare. The, Kryesia me qellim to afrimit me kete sektor, pa u paraqitur kërkesë ia dha mjetet e kërkuara. Por, me të marre ata mjete përsëri u larguan nga organi. Me kurrë Kryesia, sa kohe qe ka qenë ne udhëheqje, deri ne mbledhjen e pare, pas MP, kur u bënë akuzat, nuk i ka pare këta anëtarë të Kryesisë. Ne fakt ishte koha kur sektori veç e kishte mare tërë punën e logjistikes në dore dhe vepronte pa asnjë kontroll. Per atë veprimtari e kishin marre ata "lejen" e organeve ne vend.

Edhe per mjetet qe vinin nga bota e jashtme u be një lufte e ashpër. Ata kalonin vetëm nëpërmjet dorës se Xhavitit dhe Azemit. Xhaviti kishte leje per to marre ne dorëzim mjetet ne kufi (*Leja hyrëse zyrtare*). Te tjerët nuk lejoheshin nga organet e shtetit per t'u futur brenda dhe per t'i pranuar mjetet e mallin, sepse nuk leshohej leje tjeter. Edhe pse ishte keshtu, Kryesia nuk kundërshtoi. Qëllimi ishte uniteti ne pune, por ajo qe e shqetësonte ishte fakti se as per këto, qofte mjete financiare, qofte medikamente, qofte arme nuk ka të dhëna, sepse kurrë nuk është raportuar ne Kryesi. Per to thuhej nga sektori (Xhavit-Azem) se janë ne dore te "sigurte" ne atdhe dhe se po shkojnë brenda, tek njësitet e UCK-se, ndërsa nga brenda i kërkonin mu ato mjete, te cilat u thoshin se nuk kane ardhur ende nga atdheu ne vend.

Duhet gjithashtu per to theksuar sidomos fundin e prillit, ditët midis 20-25 prill te vitit 1998. Ne atë kohe, vjen ne Tirane lajmi nga grupi i furnizimit se atje, ne veri te shtetit, ne Tropojë gjenden mbi 4 mije vullnetare shqiptare nga Kosova, te cilët kane shkuar te organizuar nga njësitet e UCK-se per të marrë mjete. Ky fakt na detyroi qe se bashku me Adem Grabofçin, i cili ende qëndronte pranë Kryesisë, per të udhëtuar ne kufi. Atje e gjetëm grupin, i cili ishte shume nervoz. Me ta ishte I. Kelmendi. Ata ishin përpjekur per to zgjidhur atë çështje, po pa sukses, sepse nuk kishte financiare, te cilat i kishte marre sektori nga fondet. Grupi ishte i shqetësuar. Ata nuk kishin as mjete financiare per te blere ushqim per vullnetaret.

Kryesia i kishte ne disponim vetëm 50 mije DM. Ato i morën me vete. Te njëjtat ia dhamë grupit per ushqim, sepse per t'i ushqyer 4-5 mije veta duheshin shume mjete, aq me tepër kur buke nuk kishte mjaftueshëm dhe vete ne duhej t'i ushqenim. Mjetet luftarake per çka kishin ardhur nuk kishte. Ishin qytetaret tanë nga te gjitha viset e Kosovës. Çdo grup e kishte shkresën nga komandanti i zonës, nenzones a vendit ku gjendej per te ardhur per te marre arme. Por, arme nuk kishte! Mbërritëm ne ora 20. Shkuam me Ademin dhe Mërgimin ne baze, mbi Tropojë, ku ishin te vendosur vullnetaret. E pame vete gjendjen e tyre. Pa arme Atje dhe shume te uritur. Kishte disa dite që nuk ishin ushqyer. Zyrtaret nuk lejonin ushqimin e tyre. E vullnetaret kishin udhëtuar me dite e net te tera per te ardhur, ndërsa aty nuk kishte mjete.

U pritem nga Dema shumë ashpër. Pati edhe ofendime, por ato i morëm si te momentit, nga gjendja qe ishte ne vend. Ndërsa, as unë dhe as Ademi nuk kishim mundësi per te zgjidhur çështjen. Ne nuk kishim as mjete financiare per ata.

U takuam të nesërmen me zyrtaret ne Bajram Curr. Ata nuk donin te dërgonin buke per vullnetaret. Me intervenim arritëm qe ne marrëshje te dërgohet buka. Po, arme nuk kishte. Kërkuam arme. Ne baze nuk kishte mjete luftarake. Para nuk kishte. Ne kontakt me zyrtaret, te nesërmen erdhën edhe nga Tirana, shefi i SHIK-te, Fatos Klosi, me te cilin ishte edhe një

përfaqësues i shtetit amerikan. Pas bisedimeve u lejua blerja e mjeteve vetëm në vend, përkatësisht në rrethin e Bajram Currit. Po mjete financiare nuk kishim, ndërsa shteti vet nuk jepte arme për vullnetaret që ishin në Tropojë. Për atë shkak, vetë A. Grabocvi e thirri me telefon ajror Azem Kullën dhe Xhavit Halitin. Me ta bisedoi Adem Grabocvi. Edhe pse u tha se me mjete financiare mund të gjinden arme, gjë që Mërgimi kishte premtuar se i gjente në vend, ata nuk u përgjigjen në kërkesën tone për mjete financiare. Mbeti baza dhe tere vullnetaret pa mjete luftarake. Kete ia thamë zyrtareve të Tiranës në Bajram Curr, duke menduar se ata, do ta kuptojnë gjendjen dhe do të japin mjete. Po mjete nuk dhanë. Shume vullnetare duke u kthyer në Kosovë edhe u vranë (*Shënimet nga ngjarjet e prill 1998 në Bajram Curr.*)

Tërë kete çështje e kam shkruar në letër dhe ia kam dërguar KP në mbledhjen e fundit të përbërjes së vjetër. Ajo u mbajti disa ditë para MP të Gjashtë të Degës, pikërisht në fund të prillit. Por, edhe pse në këtë punë unë fajësoja sektorin, i cili kishte marrë mjetet financiare edhe ishte larguar, KP nuk mori masë ndaj tyre, por përsëri akuzoi Kryesinë. Ndërsa fakti se prej vullnetarëve në Tropojë, rreth 20 ranë në minat dhe në pritë të ushtrisë serbe, sektori nuk bëri as edhe një vërejtje për të reflektuar drejt. Në kishim mundësi, po nuk kishim mjete financiare për të blerë arme, por ato nuk u dhanë nga sektori dhe Fondi, prandaj mbetem pa arme dhe vdiqën këta qytetarë. **Kjo është akuza. (pushkatim!!!)**

Mirepo, çështja në përgjithësi shkoi në ahje tjetër. Për atë akuzë nuk u morr askush në përgjegjësi. Përkundrazi. Mbi vendimet e **Shtabit fiktiv të UCK-së**, pas mbledhjes së Përgjithshme, Kryesia e Degës nuk kishte me kompetencë për çështje politike, logjistike, mjete financiare etj. Ajo në fakt u grushtua edhe nga kompetencat në fushën politike e organizative. Të tëra punët kaluan në Kryesinë Teknike dhe ajo ia la tërë punën në dorë sektorit të veçantë, i cili në bazë të vendimit të atij Shtabi fiktiv, vepronte pa asnjë kontroll mbi çdo fushë që kishte të bënte me mjete, sende e arme, duke pasur kompetencë absolute. Kryesia Teknike e Degës nuk vepronte si organ dhe u shua. Prandaj, të gjitha mjetet financiare nga Fondi i Zvicrës, Gjermanisë në shumicë, Austrisë, Norvegjisë, SHBA-ve dhe nga shtetet e tjera, kalonin tek sektori i veçantë. Ky i mori në dorë punën me mjetet. Sektori i veçantë ishte i plotfuqishëm për gjithë çështjet në Tiranë e kudo, për logjistike e finance. Në Duhet ndriçuar gjithashtu fakti se mjetet luftarake kërkoheshin.

Kosovë nga radhët e UCK-së. Unë jam informuar se grupin në Tropojë, prej majit e deri në shtator 1998 e ka financuar Fondi nga Gjermania. Nëpërmjet këtyre mjeteve financiare janë blerë armë dhe janë furnizuar njësitet e UCK-së. Ndërsa si ka shkuar puna e logjistikës nëpër sferat e punës nuk dihet. Ata nuk kanë raportuar për kete çështje. Edhe në mbledhjen e fundit, ku mora pjesë, nuk u paraqit fare raport për atë veprimtari të rëndësishme të luftës. Po, natyrisht, duhet thënë se mjete luftarake, sidomos të renda kërkoheshin në Kosovë, ndërsa radhët e UCK-së në Drenicë nuk kishin as mjete të lehta të mjaftueshme. E tash kjo ngarkon me përgjegjësi sektorin i cili ishte i gjithëfuqishëm.

e) Lufta për të përvetësuar kuadrin (oficeret) për klikën e UCK-së

Krahas ndërtimit të strukturës së UCK-së, duke filluar nga njësitet luftarake e deri tek Shtabi, komanda operative, etj, u punua deri në maj 1998 edhe në profesionalizimin e kësaj force me kuadër ushtarak, perverse me ata politike, organizative etj., por kjo punë u bllokua nga sektori dhe kuadrot nuk arritën të futen në veprimtari.

Dihet se edhe në kete anë pati vështirësi të mëdha. Duke u mbështetur në faktin se sektori i kishte rrëmbyer të gjitha kompetencat në emër të Shtabit Qendror fiktiv të UCK-së, pas janarit të vitit 1997, kur ra ky organ, çështja e punës me oficeret kaloi në kompetencë të Kryesisë së Degës së LPK-së. Deri në kete kohë ishin dy grupe, ai politik e juridik dhe ai i rëndësishëm së veçantë që ishin caktuar për të rënë në kontakt me kuadrot ushtarake. Por,

përballë rëndësisë se veçante për lufte çlirimtare, sektori politik kishte pak shanse për të kontribuar në këtë fushë ushtarake, sepse ishte i zënë me shumë punë të tjera, për të cilat ishte kompetent. Kjo ishte arsyeja pse kaluan kompetencat në Kryesi të Degës për këtë çështje kaq të rëndësishme.

Qysh prej janarit 1997, Kryesia u mor në mënyrë aktive me këtë çështje. Ajo u takua me shumë oficerë shqiptarë. Lidhi kontakte me oficeret shqiptarë në Kroaci, në Slloveni, në Bosnje e Hercegovina dhe në vendet e perëndimit. Me ta u shqyrtua edhe gjendja ushtarake. Prej tyre pad edhe këshilla që edhe u pranuan nga UÇK-ja. Mirepo, qëllimi i kësaj punë me oficeret, nuk ishte roli këshillues përballë luftës sone çlirimtare, por ai aktiv, duke i lutur këto kadro profesioniste në UÇK-e në udhëheqje, në mënyrë që lufta jone të korrtë sukses. Me oficeret patën kontakte gjatë vitit 1997 edhe shokë të tjerë të KP të Degës, përveç sektorit të veçante, i cili përsëri nuk raportonte në organ (Kryesi). Kur Kryesia takohej me oficeret thoshin: "Kato çështje ua kemi përcjelle nepermjet kontakteve me shokët tuaj". Dhe, në fakt kontaktet realizoheshin nga Ali Ahmeti Adem Grabovci Fehmi LLadrovci Rexhe Iberdemaj, Xhavit Haliti, Shaban Muja, Jashar Salihu, Naser Idrizi, etj, por ata për çudi nuk informonin me kohë detalisht. Prandaj, nxorëm vendim për të ndaluar punën individuale me oficeret, përveç anëtarëve të Kryesisë së Degës. Nga shokët e lartë u organizuan edhe tubime publike, konferenca, etj, duke menduar se kështu po shkohet në dasmë. Një kesi tubimi u mbajt në Munchen, në fund të vitit 1997, ku mori pjesë sektori i rëndësishëm së veçante, por jashtë dijenisë së Kryesisë. Kjo nuk që informuar fare për atë takim me oficeret, sepse as që do të lejonte publicitetin e tij.

Pikërisht kjo gjendje anarkike e shtyu Kryesinë e Degës të lidhte kontakte të drejtpërdrejta me oficeret shqiptarë. Kishim kontakte dhe këshilla edhe me oficeret gjermane, austriake, etj. Por, tashmë biseda u koncentrua me oficeret, me ata që prisnin futeshin në Kosovë, sepse shumë prej tyre vetëm nepermjet qeverisë kërkonin të vihejshin në shërbim të UÇK-se. Kështu Kryesia pati kontakte me Naim Malokun, Bislim Zyrabin, Agim Celen etj. Nepermjet Ali Ahmetit e Rexhe Iberdemajt kishte kontakte edhe me oficeret në botën e jashtme, me Fadil Demirin, apo me ata në Bosnje e Hercegovinë, si me z. Bicaj, zotin Kastrati, etj. Por, përkundrazi gjithë kësaj, oficeret perseri nuk u afruan në gjirin e UÇK-se. Duke parë këtë, në zgjedhëm rrugën tjetër, atë të organizimit kjo të oficerëve në këshilla, duke i afruar ata pranë organizatës, mënyrë që i ngarkoi ata me kompetenca dhe vetiu u riorganizuan në dy grupe, sipas lidhjeve për UÇK-se a kundër saj, me qeverinë e B. Bukoshit. Tani ishte grupi i oficerëve të diet pavaresisht nga rrethanat kishin vendosur të futeshin në lufte për çlirimin e Kosovës. Kishte edhe luftëtarë të shumtë, luftëtarë që kishin luftuar në Kroaci dhe në Bosnje e Hercegovinë, të cilët gjithashtu e shprehën vullnetin për t'u futur në radhët e UÇK-se.

Një punë të radhe në riorganizimin e radhëve të oficerëve kanë luajtur dy oficerë, Naim Maloku dhe Fadil Demiri. Këta ishin të përkrahur nga oficeret luftëtarë të ish-republikave jugosllave, nga ata që kishin luftuar në Kroaci e Bosnje e Hercegovinë kundër pushtuesit Serb, por jo edhe nga oficeret që nuk kishin marrë pjesë në luftërat e atyre shteteve. Këta e ndihmuan shumë punën e Kryesisë në organizimin dhe riorganizimin e oficerëve.

Por, krahas punës së Kryesisë, kishte edhe forca të tjera që punonin me oficeret:

1. Qeveria e Bukoshit me organizatën e oficerëve, e cila nuk lejonte që ata të punonin jashtë institucioneve të qeverisë, përkatësisht ajo kishte ndaluar që oficeret të futeshin në shërbim të UÇK-se dhe të luftonin.

2. Sektori i Rëndësishëm së veçante bënte çmos që oficeret t'i lidhte pas qerres së vet, në emër të Shtabit Qendror, duke shkelur parimet baze të ndërtimit të një ushtrie profesionale, sepse në atë formë mund të merrte njeriu disa vete, por nuk mund të ndërtonte një ushtri të afte çlirimtare, të denjë për të luftuar kundër pushtuesit.

3. Kryesia ishte e interesuar qe ata te futeshin sa me shume ne kuadër te UCK-se, forme kjo e -vetme per te profesionalizuar kete Fora ushtarake. Krahas, kesaj punohej me ta edhe ne institucionalizimin e luftës çlirimtare, nëpërmjet ndërtimit te sistemit çlirimtar.

Në kuadër te kesaj pune ndikim shume te madh ne oficeret kishte Bukoshi. Ai u paguante atyre edhe rroga dhe i mbante financiarisht. Prandaj, ndikimi i tij ishte evident mbi kuadrot ushtarake, ndonëse kishte prej tyre qe ishin edhe kundër, sepse ishin thjesht per te ndihmuar UCK-ne, pavaresisht gjendjes qe do të vinte ne skenën politike, bashkimi i forcave a ndarja e tyre. Në këto kushte filloi lufta e armatosur ne Kosove. Prandaj, u ftuan oficeret ne Tirane. Te tri këto grupe shprehen mendimin per takuar ne Shgiperitu, qofte edhe me B. Bukoshin, qofte me përfaqësuesit e UCK-se. Mirepo, kuptohet se ndikimin e kishte kryesisht Bukoshi, i cili i kishte organizuar ata. Ardhja e oficerëve ne Tirane, diku me shume se 30 veta, hapi një lufte te madhe midis grupeve te përmendura. Bukoshi i la ata nen mëshirën e fatit, si ne kuptimin. financiar, ashtu edhe në ndërtimin dhe ne drejtim te futjes se tyre ne strukturën e UÇK-se. Ndërsa ne, si Kryesi .ishim te interesuar per kete kuadër ushtara.k, d.m.th. per futjen ne strukturën organizative to ushtrisë sonë, sepse ende nuk kishte UÇK-ja struktura reale, komandë të veten, prandaj i duheshin forcat profesionale per te ndërtuar një ushtri te shtetit te Kosovës. Ky ishte pikësynimi ynë ne fushën ushtarake, sepse ishim të bindur se UCK-ja pa kuadrot ushtarake, nuk mund të ndërtohej dhe nuk mund te ecnim .ne rrugën e madhe te luftës per çlirimin e Kosovës.

Mirepo, kishte forca te tjera, te cilat e shfrytëzuan këtë situatë per t'i afruar oficeret tek vetja. Klika i donte, jo per te ndërtuar një ushtri te mirëfillte, po per t'i futur neper strukturat e veta, mënyrë qe te ndihmoheshin prej tyre. E kjo në emër të profesionalizimit dhe operimit ushtarak, pa u përziere ne çështjet politike, ne ato te udhëheqjes se kesaj force.

Ne këto kushte, u mbajt një tubim me oficeret ne Tirane. Atë tubim e udhëhoqi B. Bukoshi. Ne tubim, mars 1998, ai u tha. atyre: "Nuk ka Kosova mundësi per to futur ne 146 çlirimtare dhe se ata duhet te kthehen nga kane ardhur, neper vendet e tyre" (Deklarata e Ali Ahmetit ne Kryesi, mars 1998). Kate gjendje e shfrytëzuam si Kryesi dhe menjëherë a lidhem nëpërmjet grupit me oficeret. Z. Bukoshi edhe ketu doli kundër luftës. Ai jo vetëm ne sferën politike, juridike e financiare qe ishte kundër, por as kuadrot nuk i la, duke i urdhëruar te kthehen neper vendet e veta. Ky ishte kulmi.

Tash mbeti puna jone me oficeret. Ne angazhuam Demirin në veprimtari të veçante, Naim Malokun ne Këshillin per Luftë, i cili pastaj u fut ne Kosove. Filluam kontaktet dhe arritëm marrëveshjen me oficeret nga Bosnja e Hercegovina, te udhëhequr nga Hall Bicaj, te cilin e konsideronim kuadër shume te afte per lufte. Këtyre u dhamë edhe mjete financiare, sepse donim qe te tjerët, ata qe ishin ende ne Kroaci e ne Bosnje e Hercegovina te vijnë ne Kosove. Po ne kete kohe u krijuan lidhjet edhe me Bislim Zurapin te cilin e kishin lënë oficeret ne Tirane si udhëheqës te grupit te oficerëve në vend, derisa te vinte person tjetër, qe ishte ne hierarki ushtarake me lart se ai.

Me këta oficerë u morën zyrtarisht Ali Ahmeti, Rexhe Iberdemaj, Ibrahim Kelmendi dhe Xhavit Haliti (*Vendimi i marsit 1998*). Por, ky grup i punes i caktuar nga Kryesia, kishte shume vështirësi. Pse? Sepse ne bisedat me oficerë te tullë, sidomos me Bislim Zurapin, Xhavit Haliti, me vonë edhe Azem Sylja, flisnin ne emër te Shtabit Qendror, qe ende nuk ekzistonte, ne kohe qe me oficeret ishte përcaktuar te bisedohej shtruar, pa dorashka e gënjeshtër, sepse vetëm keshtu ndihmonin UCK-ne dhe luftën tonë. Natyrisht se oficeret duhej te zgjidheshin, sepse jo te gjithë ishin to mirëseardhur ne UCK-e. Pra, me ta duhej to bisedonim mbi pozitat e një ushtrie ne ndërtim e qe kishte nevojë per ta. Ky ishte vendimi i Kryesisë, dhënë anëtarëve qe duhej te punonin me bishtaraket. Ata nuk kishin to drejte te gënjenin, sepse keshtu nuk i ndihmonin luftës.

Mirepo, duket se përveç disa oficerëve, të cilët shkuan nëpërmjet Ali Ahmetit, grupit në Tropojë dhe Kryesisë, disa të re u vune në shërbim të Xhavit Halitit e Azem Sylës, që bisedonin me ta në emër të Shtabit Qendror. Këtë lloj baze politike e mori Bislim Zyrapit me disa oficerë. Duket se kanë qenë rreth 7-8 veta. Kërta, lidhja e këtij grupi, i dergoi në Kosovë dhe disa i futën në Shtab Operativ, të tjerët i çuan në terren, neper zona e nenzona

operative, por jo në SHP, sepse pas kooptimit të anëtareve të Shtabit të Përgjithshëm, anëtarët mbeten të njëjtë, me përjashtim të B. Zyrarit, të cilin me vone e futën në këtë organ. Por, kjo është çështje tjetër, sepse për kohën ky vendim i Z. Zyrarit është i drejtë, sepse shkuarja e tyre në Kosovë ka ndihmuar shumë pozitivisht në luftë, pasi ata atje i organizuan dhe riorganizuan njësitet e UCK-së dhe me ndihmën e tyre, u arrit një shkallë e mirë e organizimit të luftës.

Përkundër kësaj, duhet thënë se, megjithatë, në këtë fushë nuk u arrit sukses. Duke mos e ndërtuar Frontin për Çlirimin e Kosovës, në fakt u bllokua puna me oficerët, si nga qeveria e Bukoshit, ashtu edhe nga grupi që vepronte në emër të Shtabit Qendror të UCK-së, Xhavit Halitit, Hashim Thaçit dhe Azem Sylës. Në fakt erdhi koha kur ndaj Kryesisë u bë grushti politik dhe ushtarak i luftës çlirimtare. Edhe kjo gjë mbeti në mëshirën e grupit, anëtarët e të cilëve për të ndërtuar klikën e vet në UCK, paraqiteshin edhe si komandantë gjeneralë të UCK-së në Tiranë (*shih: Deklarata e Xhavit Halitit në Hotel Rogner, apo ajo e Azemit Sylës mbi rolin vendor në UCK-ne*). Kjo shërbeu si mjet për t'iu treguar kuadrove (oficerëve e zyrtarëve në Tiranë) se kush vendos në emër të UCK-së, duke treguar kështu se ndaj tyre duhet të përkulën. Ishte kjo puna me e dëmshme përballë kësaj force ushtarake, e cila kishte nevojë për çdo forcë, qofte politike, qofte ushtarake, etj. UCK-ja ishte duke u rindërtuar, prandaj duhej ndihmuar e jo vënë nderskamcat, duke dalë si gjeneralë, komandantë dhe diktatorë të UCK-së.

Qëllimi këtu nuk është për të kundërshtuar atë pozitë të zotit Xhavit, sepse nuk e di a ka qenë apo jo komandant, apo të zotit Azem se a ka qenë i plotfuqishëm, qofte edhe të zotit Hashim, gjoja udhëheqës i këtij subjekti, duke shkelur çdo rregull të brendshëm. Mirepo, e di se me atë u bllokua puna me oficerët, sepse, përveç disave që shkuan me B. Zyrarin në Kosovë (shih: shkuarjen e shtatë oficerëve në prill 1998), të tjerët mbeten neper rrugët e Tiranës, shumë u kthyen prej nga kishin ardhur dhe nuk dëgjuan të shkonin në vend, në njësitë e UCK-së. Ishte koha kur tere ata u vunë në shërbim të B. Bukoshit, si dhe ministrit të tij, Ahmet Krasniqit, i cili edhe pse lufta zhvillohej në Kosovë, vazhdonte të qëndronte në Tiranë etj, duke i riorganizuar në njësi të tjera, si formacioni i FARK-ut të ri, si dhe duke u lidhur me grupin ushtarak të Kosovës.

Është e njohur lidhja e Xhavit Halitit dhe Ahmet Krasniqit në emër të UCK-së dhe Qeverisë së B. Bukoshit. Këta u ndihmuar reciprokisht dhe dhanë edhe mjete financiare. Por, ato mjete nuk i shkuan radhëve të UCK-së. Kjo veprimtari u bë për grupe dhe interesa individualiste. Askush nuk di se sa mjete financiare japë keqpërdorur. Nuk ka të dhëna as se si ka shkuar në UCK Tahir Zema, apo pse ai e tërhoqi ushtrinë nga Rrafshi i Dukagjinit. Duket se kjo çështje këtu e ka lidhjen.

Ky ishte kulmi.

Dy fakte pra, ishin shkaktarët për këtë çështje: Qeveria e Bukoshit dhe grupi i Xhavitit-Hashim-Azem ishin ata që e bllokuan shkuarjen me shurnice të oficerëve në radhët e UCK-së. Mund të akuzohet dhe të thuhet gjithçka në llogari të këtij apo atij kuadri ushtarak, por e verteta është se, lufta midis tyre për UCK-ne, e ka ndaluar shkuarjen e oficerëve në vend.

3. Pengesat tjera për ndërtimin e sistemit çlirimtar

Me lart folëm për pengesat nga ana e brendshme për ndërtimin e sistemit çlirimtar në Kosovë (FCK). Folëm për shumë fusha të veprimtarisë nga ana politike, financiare e kuadrore, deri

tek interesat tjera te cilat kishin karakter te dëmshëm. Këndeje folëm dhe per forcat qe u organizuan dhe riorganizuan, te cilat arritën, ne lidhje a jo, apo vetëm ne heshtje, te lidhen me forca te tjera politike, ne mënyrë qe to marrin udhëheqjen politike to UCK-se. Këto futen ne radhën e faktorit te pare per mosndertimin e një sistemi çlirimtar ne Kosove. Por, nuk janë vetëm keta e ky fakt, qe ka ndikuar te mos arrihet ndërtimi i Frontit per Çlirimin e Kosovës.

Ky qellim nuk do te arrihej nëse nuk do te shkonin edhe disa faktorë te tjerë ne dobi te grupit qe ishte organizuar ne kuadër te LPK-se dhe UCK-se dhe, qe tash po dilte si kërpudha pas shiut. Ketu, është fjala per forcat e tjera, ato politike e organizative ne Prishtine, pastaj per Qeverinë e Bukoshit, per Tiranen zyrtare, ngase forcat tona te brendshme te cilat me interesa te ndryshme, thjesht te veta dhe te ngushta politike, kush me vetëdije te plote, e kush pa te, kush nga pozitat karrieste interesat individualiste, etj, vepruan dhe e përkrahen një grupim to tille, te ndërtuar brenda .UCK-se, duke ndaluar punën me te radhe, atë te ndërtimit te Frontit tone çlirimtar.

Një rol po kaq te pakuptimte ka luajtur edhe faktori i jashtern, i cili siç duket per te mos ardhur deri tek pavarësia e Kosovës, beri shume pune qe te mos lejoje bashkimin e forcave politike me ato ushtarake e organizative ne një sistem çlirimtar. Faktori i jashtëm e dinte se, po qe se vinte ky bashkim i shqiptareve, populli ynë kishte forca te mjaftueshme' per t'u çliruar nga hordhitë sllave ne Ballkan.

a) Forcat politike ne Kosove

Marsi i vitit 1998 e gjeti popullin shqiptar te papërgatitur politikisht-organizativisht e ushtarakisht. Ai ishte i ndare ne subjekte dhe me veprimtari te ndryshme. Kishte edhe ndarje lokale. Edhe ne kuadër te vete subjektit dhe te sakrificës se kombit tone, problemi me i madh ishte tek mosekzistenca e një subjekti te përbashkët politiko-ushtarak, si mjet per t'i vene ne shërbim te luftës çlirimtare te gjitha forcat e popullit dhe çdo energji te kombit tone.

Pa kete, fronti i luftës u dobësua, sepse forcat u ndanë. Dile, padyshim, ne kete kane ndikuar shume subjekte, per te mos thene te gjitha forcat politike, perderisa ato nuk dolen ne anen e ndertimit te sistemit unik clirimtar ne Kosove. Ne kete kohe, e pa.raqiti zyrtarisht kerkesen Kryesia e Deges per ndertimita e sistemit clirimtar (Fronti per c7lirimin e Kosoves) (Vendimi i KP Degës, mars 1998). Nje kerkese e tille i qe drejtuar subjekteve politike, organizative etj. Ajo u be edhe zyrtarisht publike, duke dale me punime e deklarime, sikunder beri me deklaraten publike LPK-ja ne mars te vitit 1998, kur iu drejtua popullit tone me thirrjen per bashkimin e te gjitha forcave ne Front (Deklarata e LPK-se). Në thirrje, shpjegohej pozita e kombit pas shpërthimit te luftës frontale dhe ajo kërkonte bashkimin e kombit ne një organizëm politik e ushtarak unik, duke shpallur moratorium mbi subjektet politike e organizative, deri sa vendi te çlirohej.

Megjithatë, kjo u kundërshtua. Kush dilte me deklarata, kush e kundërshtonte atë, duke thënë se e kemi shtetin, organet, etj. Dhe, e vërteta. është se, asnjë subjekt nuk u bashkua me luftën faktikisht, pa bere fjale per çështjen. e ndërtimit te sistemit. Té shohim tani veprimtarinë e subjekteve.

Lidhja Demokratike e Kosovës

LDK-ja e kishte te qarte se Kosova ne vitin 1998 po futej ne një situatë .te jashtëzakonshme, ne lufte me forcat pushtuese serbe. Kjo shihej nga aksionet me te hershme, sidomos ato to vitit 1995-1997. Mirepo, edhe pse rreziku i luftës ishte rritur dhe nga kjo parti ishte deklaruar, LDK-ja nuk ndërmori asnjë mase politike e organizative, si dhe shtetërore per t'i dale përballë çështjes se madhe, luftës çlirimtare. Per me tepër, ajo u angazhua per te ndërtuar terrenin politik e juridik, ganizativ dhe ushtarak.

LDK-ja e priti situatën në Kosovë sikur kjo parti politike të mos jetonte me kohën, për të mos thënë me të ashprën, të mos i takonte si subjekt shtetit të Kosovës dhe kesaj pjesë të kombit. Ndonëse, kjo parti ishte partia me e "madhe" dhe e kishte organizuar "shtetin", nuk i kreu detyrat e veta shtetërore në organizimin unik të popullit dhe mobilizimin e tij. Si vetë udhëheqja e partisë, ashtu edhe organet që dolën nga ajo, nuk ndërmorën masa përgatitore dhe nuk filluan organizimin e qytetareve në baze të dispozitave juridike të shtetit. Për më tepër dhe në kundërshtim me faktet dhe analizat 'e gjendjes për vendet e shtetit të pushtuara, ku shteti organizon popullin në front për mbrojtjen e çlirimit të vendit, kjo detyrë imediate e luftës çlirimtare u kundërshtua. Pra, dhe me tej mbeti ndarja nëpër subjekte të veçanta politike e organizative.

Një ndarje e tulle shkaktoi probleme të mëdha. Ishte pikërisht kjo parti politike legatë, e përkrahur nga subjektet që e futën në koalicion gjatë "zgjedhjeve" të vitit 1998, që doli me format paqësore, kundër atyre aktive të çlirimtare. Partitë politike u futën në koalicion dhe ndërtuan gjoja qeverinë, pikërisht në kohën kur vritej e masakrohej populli shqiptar në Kosovë. Në këto baze e kundërshtoi LDK-ja mobilizimin e përgjithshëm të kombit. Ajo edhe vetë luftën çlirimtare e injoroi dhe bëri thirrje për "paqe" me pushtuesin, duke dalë kështu edhe kundër luftës sonë popullore. Me këto tregohet se të tjerët (shiko: UCK-ne) janë kundër paqes dhe luftënxitës, duke luajtur rol negativ edhe në vetë prestigjin politik të luftës çlirimtare.

Mirepo, përveç kesaj forme të veprimtarisë, LDK-ja hapi luftë për të mos lejuar ndërtimin e sistemit çlirimtar edhe në formë tjera të aktivitetit politik-aksional. Ajo e "vlerësoi UCK-ne në subjekt jo shqiptar, të organizuar nga armiqtë për të provokuar forcat e okupatorit, etj, që të bënin dhunë, masakra e terror mbi shqiptarët e pambrojtur". Ndërsa, për të luftuar kundër saj, organizoi "zgjedhjet" në mars të vitit 1998, pikërisht në kohën kur ishte momenti për bashkimin të tone, pa dallim përkatësie politike, ideje e vendi në luftën e përbashkët (shih: deklaratat e Z. Rugovës për UCK-ne dhe veto zgjedhjet e marsit 1998 për Kuvendin e Kosovës). "Zgjedhjet" dolën si bumerang kundër kërkesës së forcave çlirimtare, sidomos kërkesës dhe thirrjes së lëshuar nga LPK-ja për ndërtimin e Frontit Çlirimtar në Kosovë. Këto se bashku me punën për mosmobilizimin e përgjithshëm të kombit mbi bazën e gjendjes së luftës, bëri ndarjen totale të forcave politike, atyre ushtarake e organizative.

Puna e tulle u bë nga frika se me sistemin çlirimtar të bashkuar rreth UCK-se, kufizoheshin kompetencat e LDK-se, në mos po dhe humbiste pushtetin formal, pushtetin edhe ashtu inekzistent në Kosovë. Për të ruajtur atë pozite politike të shtetërore formale, tek LDK-ja dukej se nuk luante rol, as dhuna e as terrori i gjere, vrasjet, masakrat e shkatërrimet masive, sikundër as thirrjet e subjekteve të tjera për bashkimin të tone politik e ushtarak në një subjekt të përbashkët, në sistem. Me qëllim të vetëm, mbajtjen formale të pushtetit, u deklarua kundër çdo bashkimi, pavarësisht nga vinte ai.

Lidhur me këto, në prill të vitit 1998, I. Rugova, në një konferencë për shtyp, pasi foli për format e veprimtarisë dhe qëllimin e LDK-se, përveç tjerave, pati deklaruar:

"LDK-ja është parti demokratike e paqësore e cila vetëm me mjete jo violente, kuptohet jashtë çdo dhune e veprimtarie (detyrimore, përveç marrëveshjeve politike, si dhe duke u mbështetur në format paqësore të aktivitetit ka vepruar dhe. vepron edhe tash" (Rilindja, prill 1998).

Ndërsa, për bashkimin politik-organizativ, ai deklaroi:

"Në Kosovë e kemi shtetin e ndërtuar. Edhe zgjedhjet presidenciale e parlamentare janë kryer (...). Këto janë baza e shtetit, i cili doli nga "zgjedhjet" e marsit të këtij vitit (1998). Mbi këto "zgjedhje" se shpejti do të rindërtohet edhe qeveria"

Nepërmjet këtyre deklarimeve del qartë edhe shkaku i mos bashkimit politik, sikundër edhe atij organizativ e ushtarak në Kosovë. Kjo parti, sikundër u tha, nuk punoi në mënyrë aktive për çlirimin e vendit duke i futur tërë mjetet që njihen. në vendet dhe popujt të gjenden të

pushtuar apo janë në lufte çlirimtare. LDK-ja ishte që në emër të sovranitetit, shtetit e pavarësisë, të neutralitetit etj, të qëndronte në ballë, po pa u futur në konfrontim për çlirimin e atij shteti me armikun. Ndersa, dihet, se shteti çlirohet me bashkim në sistem dhe duke i futur në zbatim të gjitha masat a veprimtarisë, të gjitha ato mjete që janë të njohura tek shtetet e organizuara.

Duke e shtjelluar çështjen në keto ane, kam mendimin se janë disa fakte që kanë ndikuar tak kjo parti dhe aleatet a saj për të mos ardhur deri të ndertimi i sistemit çlirimtar në Kosovë. Faktet janë:

- Se pari, frika nga armiku ka bërë kjo parti, organet e politikës saj të mbesin vetëm në format paqësore, si forme për të jetuar si forca në vend.

Së dyti, nga futja në udhëheqje të shtetit edhe të kadrove të tere, të cilët do të dilnin nga ndërrimi i sistemit të përbashkët çlirimtar në Kosovë, duke u bashkuar të gjitha subjektet, në dem të tyre.

- Së tretë, lidhja me subjektet e jashtme, vetëm në baze të kësaj veprimtarie, nëpërmjet se cilës u punua për t'i futur nën kontroll forcat ajrore.

- Se katërti, interesat e ndryshme si dhe jeta pa probleme me forcat pushtuese, duke vepruar vetëm në format e lejuara nga armiku serb, brenda kornizave të Beogradit.

Ja shkaqet pse u injorua kërkesa dhe thirrja e Degës së LPK-së për sistem dhe natyrisht pse LDK-ja nuk e angazhuan në ndërtimin e sistemit çlirimtar, qoftë edhe duke mos e marrë për baze thirrjen e Degës, por vetëm mbi bazën dhe detyrën që shtronte gjendja. Në fakt, kjo dilte si detyrë për këtë parti edhe nga Kushtetuta e shtetit të Kosovës, nën 97-118 të saj, ku del. d.etyra. e bashkimit të popullit për lufte unike çlirimtare. Shpreh, thuhet se, duhet të shpalle gjendjen e luftes, të bëjë dhe të udhëheqje popullin në lufte. Por, as kjo baze nuk e vuri në levizje LDK-në.

Çështjet a theksuara. e gartësojnë teresisht pozicionin a saj si. subjekt. Ato tregojnë edhe shkaqet pse nuk u bashkuan me luftën dhe nuk e ndërtoi sistemin. Dihet se ajo si force politike, në kushtet e krijuara mund të ndihmonte në ndërtimin e Frontit për Çlirimin e Kosovës e me këtë edhe të një lufte të përgjithshme popullore, me tipare shtetërore sipas dispozitave kushtetuese, si forme prej nga populli ynë dhe shteti do të kishin forcë politike, ushtarake e diplomatike. Me siguri se edhe lufta e armatosur do të ishte shumë me e suksesshme, sepse do të kishim bashkim me të fortë të popullit, unitet në veprim, disiplinë të lartë, logjistike profesionale dhe financa të shëndosha.

Dhe, në kohën kur në Kosovë kryhej një terror paparë: në histori, një dhunë e shfrenuar, LDK-ja nuk u bashkuan me luftën çlirimtare. Masat e okupatorit shkuan duke u thelluar. Ato bënë zhdukjen e mbi 3 mijë shqiptarëve deri në shtator a shkatërrimin e mbi 60 mijë objekteve të ndryshme, pa llogaritur mbi 600 mijë të dëbuarve në vitin 1998 dhe të mijëra të tjerë të mbyllur në burgjet serbe (*Verejtje: në punim shqyrtohet gjendja vetëm sa isha unë në udhëheqje, maj - qershor 1998, me disa të dhëna deri në shtator të atij viti.*) Edhe keto fakte nuk ndikuan tek LDK-ja që të përkrahte luftën çlirimtare të udhëhequr nga dhe të merrte rolin udhëheqës në ndërtimin a sistemit çlirimtar, mbi bazën e shtetit të pushtuar Kosovës.

Nëse si parti politike me e "madhe" donte të kryente atë detyrë, pa ia lënë subjekteve të tjera, këtë rast LPK-ja kishte thirrje, LDK-ja e kishte mundësinë të merrte rolin udhëheqës në luftën tone çlirimtare. Asaj, askush nuk i dilte përballë. Për më tepër, LPK-ja do të përkrahte iniciativën e formimit të Frontit Çlirimtar të Kosovës. Kam mendimin se pas do vinin edhe subjektet e tjera politike e organizative. Një rrugë e tillë do të ndiqej edhe nga UCK-ja. Pra, sera forcat do të unifikohehin. Këto detyra ishin në dorë të LDK-së. Por, nuk u veprua kështu. Përkundrazi. Kjo parti gradualisht u nda edhe me shumë nga populli, sidomos nga pjesët e shtetit që ishin në lufte të cilat me atë ndarje dobësuan dhe vendin në tërësi, sepse forcat çlirimtare të UCK-së nuk e kishin unitetin e përgjithshëm dhe përkrahjen e këtij

subjekti. Nëpërmjet kesaj, nuk u be as bashkimi i institucioneve te shtetit me luftën, kuadrove dhe mjeteve. Populli ynë dhe shteti nuk u bashkua as ne punën diplomatike.

E gjithë kjo e vështirësoi edhe me tepër gjendjen ne Kosove. Por, as gjendja e rende e popullit nuk e shtyu kete parti ne aktin e madh historik. Përkundrazi, LDK-ja gjate vitit 1998 mbeti ne vend dhe per asnjë moment nuk u bashkua me luftën dhe nuk punoi per ndërtimin e sistemit çlirimtar ne Kosove. Nëpërmjet kesaj, ne vend u krijua një gjendje qe karakterizohej nga:

1. Dobësia përtej mase e organizimit te përgjithshëm te kombit, sepse nuk u be bashkimi i përgjithshëm, as mobilizimi i te tera forcave te kombit e shtetit ne luftime.

2. Formimi grupor i Mikes politike ne organet udhëheqëse te UCK-se, duke mos u përgjigjur ne thirrjen e LPK-se per ndërtimin e sistemit çlirimtar, e cila ishte fakt i madh dhe me rendësi ne luftime kundër forcave çlirimtare te LPK-se dhe UCK-se.

3. Dobësia e frontit te luftës kundër armikut, per shkak to mospërfshirjes se te tëra forcave shqiptare ne luftën çlirimtare.

4. Dalja me kërkesa te ndryshme dhe organizim to ndare para botes, gjë qe e dobësoi përtej mase çështjen ne përgjithësi, ku edhe nga ata qe nuk e donin fare unitetin tone, e kritikuan kete, duke thënë se tek shqiptaret nuk kemi një subjekt unikal.

Ja se si u duk gjendja ne vitin 1998.

Gjendja e tillë krijoi ne kete vit një ndarje te ashpër ndërmjet forcave tona politike dhe atyre ushtarake. Kjo ndarje solli deri tek ndërtimi i veçante i te tere jetës politike e luftarake, te çdo organizmi, deri edhe te vete UCK-se, jashtë sistemit unik çlirimtar (Frontit per Çlirimin e Kosovës). Ne kete mënyrë u krijua një baze e forte dhe e rëndësishme per forcat e UCK-se per një luftime jashtë sistemit, mbi bazën politike, grupore e partiake, edhe pse luftëtarët e UCK-se dhe populli ynë ishin per një luftime te gjere çlirimtare, per Frontin, prandaj dhe u futen si lume ne kryengritje popullore. Pot, as kjo dëshire historike e mbështetur ne aspirata kombëtare nuk u respektua.

As edhe ne kohen kur organizmat ndërkombëtar, jo per to krijuar sistemin per çlirimin e Kosovës, sepse qendrat e vendosjes e kishin përcaktuar autonominë per Kosovën nen Jugosllavi, por me qellim qe te krijohej një subjekt qe to delte para botes, ne emër te Kosovës, nuk u be bashkimi. Këso kërkesash patën paraqitur shume subjekte tjera. Edhe nga LBD-ja e përfaqësuesi polik i UCK-se u kërkuar ndërtimi i një qeverie te koalicionit, zgjidhje kjo, jo mbi bazën e sistemit, pot vetëm te përfaqësimit, u kalua ne heshtje. Kjo kërkesë e dy aneve u mohua, pa dhënë asnjë përgjigje. Mund te themi se LDK-ja kurrë nuk u ul ne tabanin e vullnetit te popullit per te arritur pikësynimin historik te tij, bashkimin e kombit, pa dallim shtrese e ideje.

Kjo sa i përket LDK-se.

a) Lëvizja e Bashkuar Demokratike (Rexhep Qoses)

Ne drejtim te mos ndërtimit te sistemit çlirimtar ne Kosove kane ndikuar edhe subjektet politike te bashkuara ne kandër kesaj lëvizje. Ato, si parti te veçanta, ashtu edhe ne bashkimin krijuar politik, nuk punuan ne drejtim te këtij qëllimi.

Partitë e bashkuara ne kete bashkim e dinin se çlirimi i vendit pa bashkim nuk mund te arrihej, sikurse e dinin se, vetëm krijohej një force e cila do te ishte ne gjendje per te dale përballë organizmave ne bote. Ne aspektin historik, ky bashkim ka dale me qëndrime e deklarime formale per bashkimin politiko-aksional, duke kërkuar edhe ndërtimin e një qeverie te koalicionit, sikundër i paraqiten kërkesat ne pjesën e dyte te vitit 1998 (Deklaratat per shtyp ne vitin 1998). Mirëpo, ne realitet as njëra prej këtyre subjekteve te bashkuara ne LDB-ne dhe vete kryetari i saj z. Qosja, nuk i konkretizoi qëndrimet e shprehura edhe ne jetën politik ne çështjen e ndërtimit te sistemit per çlirimin e vendit. Ato si subjekte as që kaluan praktikisht

ne anën e luftës çlirimtare, përveç deklaratave politike të shprehura, duke mos luajtur as riga Prishtina.

Si Lëvizja e Bashkuar Demokratike, ashtu edhe PPK, si dhe partitë e tjera në këtë bashkim demokratik, qofte nëpërmjet kryetarit të saj zotit Rexhep Qosja, qofte edhe nga nënkryetarët 3 a 4 sa janë, kanë proklamuar vetëm bashkimin teorik me luftën. Madje, vetë LBD-ja u nda nga LDK-ja me këtë qëllim politik. Shumë subjekte e përshëndeten, duke u mbështetur në besimin se kjo Lëvizje do të angazhojë në këtë çështje. Në skenën politike u krijua kështu mendimi se, pas moratoriumit të vendosur mbi ato parti që formuan LBD-në, ato do të punojnë së bashku me UCK-në, LPK-në e subjektet e tjera çlirimtare në drejtim të krijimit të Frontit Çlirimtar të Kosovës. Këtu duhet parë shkakun pse përkrah krijimi i kësaj partie dhe bashkimi i tyre në Lëvizjen e Bashkuar Demokratike. Por, edhe pse mendohej kështu, kjo Lëvizje e Bashkuar nuk beri asnjë hap përpara në drejtim të bashkimit real juridik e politik-aksional në luftën çlirimtare. Në fakt, Kosovës iu shtuan subjekte dhe një bashkim i ri politik, por vendit tone nuk iu shtua një forcë motorike, një lëvizje e vërtete çlirimtare. Ajo nuk u bashkua në kërkesën e Degës për ndërtimin e sistemit çlirimtar. As në punë dhe as në aspektin organizativ LBD-ja nuk u lidh me lëvizjen çlirimtare. Ndërsa., kërkesave për ndërtimin e sistemit çlirimtar e përkrahte vetëm sa për sy e faqe, mënyrë deklarative, duke mos u futur në punë për organizimin e saj. Kjo mbeti vetëm në formë lëvizje, po në realitet ishte parti pacifiste legale.

Për të konstatuar qëllimin e këtyre partive dhe të kësaj LBD-je duhet të sjellim deklaratën e kryetarit të këtij bashkimi politik, sikundër edhe të A. Demacit se ishte kryetar i PPK, si dhe me vone kur u shadërrua në perfaqësues të përgjithshëm politik të UÇK-së.

Duke folur për qëllimin politik të LBD-se kryetari i saj pati thënë:

"LBD -ja është për pavarësinë e Kosovës ...). Në e përkrahim UÇK-në dhe kërkojmë që ajo forcë të përfshihet në të gjitha strukturat që organizohen (...). Populli shqiptar dhe UCK-ja në Drenicë dhe në Dukagjin nuk kanë zgjedhur kryengritjen me qef, por pse ia ka imponuar dhuna e shumëllajshme e regjimit serb duke e bërë jetën padurueshme dhe të padenjë për njeriun? (*Koha Ditore, maj 1998, përsëritur dhe në shtator*).

Ndërsa, pas bashkimit në LBD, kryetari i saj përsëri deklaroi:

"Lëvizja e Bashkuar Demokratike nuk është parti, por Lëvizje. Prandaj, nuk jam njeri partiak por veprimtar i Lëvizjes sonë kombëtare (,,). LBD-ja është për një udhëheqje të përbashkët. Ajo udhëheqje duhet të përbejë prej gjithë perfaqësuesve të subjekteve të rëndësishme politike dhe kombëtare të Kosovës, duke përfshirë (...) edhe UCK-në dhe subjektet që terrori serb i ka nxjerre në ilegalitet. Ai bashkim mund të quhej si të dojë: (Qeveri e uniretit kornbetar a ndryshe" *Koha Ditore, shtator 1998*).

Qendrimi perafersisht të njëjta, për çështjen ka pasur edhe Adem Demaçi. Në fillim ai paraqiti mendimet e veta në emër të PPK-së, me vone si perfaqësues politik i UCK-se. Por ai ka pasur të tjera ide, pse edhe kur e pati mandatin nga SHP i UCK-se nuk u angazhua në ndërtimin e qeverisë së koalicionit me UCK-në. Në fillim, nga pozita e kryetarit të partisë dhe me vone edhe nga pozita tjetër, ajo e perfaqësuesit të UCK-se. Deri sa ishte në parti deklaroi: "Këta djelmusha nuk mund të presin me. Ata janë organizuar dhe ia kanë filluar aksionet luftarake (...) UÇK-ja do të vazhdojë aktivitetin çlirimtar në format me ilegale duke goditur çdo kund armikun, si dhe duke iu ikur formave frontale" (...).

Ndërsa, duke folur për bashkimin politik e juridik në një subjekt, sikundër e quajti ai qeverinë e koalicionit, ai kundërshtoi, si kryetar i PPK-se, me vone edhe si perfaqësues politik i UCK-se, "zgjedhjet" e marsit dhe u deklarua kundër Kuvendit dhe formacioneve të tjera formale të shtetit që dolën nga ato gjoja zgjedhje. Ai e cilësoi I. Rugovën si burrë frikacak, të dëmshëm dhe të paafte për bërë shtet, duke ia bashkangjitur tërë përgjegjësinë për gjendjen e rëndë dhe konfliktet në kuadër të kombit tone. Me vone nga pozita e perfaqësuesit të UCK-se pati then:

"UCK-ja është për ndërtimin e një qeverie të koalicionit të gjere të të gjithë subjekteve politike në një subjekt të përbashkët shtetëror politik" (Koha Ditore, shtator 1998).

Ndonëse në formë të ndryshme, nga këto forca politike u deklarua bashkimi, ato mbeten vetëm qëndrime teorike, pa veprim praktik. Këto parti nuk u bashkuan me luftën në sferën politike e organizative, për të ndërtuar sistemin unik çlirimtar. Ato, as fizikisht nuk shkuan në lufte, sikundër nuk i bene thirrje popullit për t'u bashkuar në lufte. Të këta politikane të bashkuar në kuadër të LBD-se, e dinin se pa bashkimin e të gjitha forcave politike të kombit tone dhe shkrirjen e energjisë në sistem (FCK), si të atyre politike, ashtu edhe të atyre organizative dhe çlirimtare, nuk gjendeshin mekanizmat e çlirimit të vendit. Por, përkundër kësaj baze juridike-ushtarake e politike, këta mbeten në konstatime, duke i numëruar gabimet e të tjerëve dhe duke i falënderuar luftëtarët e UCK-se, pa ndërmarre as edhe një iniciativë konkrete, për të ardhur deri tek ndërtimi i sistemit çlirimtar. Edhe thirrjes së LPK-se nuk iu përgjigjen.

Ndërsa, iniciativat e mëvonshme për ndërtimin e një qeverie të koalicionit, nuk erdhën si rezultat i vullnetit të këtij bashkimi partiak për ndërtimin e sistemit çlirimtar. Në fakt, ky bashkim nuk kishte për qëllim krijimin e sistemit, por ndarjen e pushtetit midis subjekteve. E kësaj natyre ishte edhe kërkesa e Demaçit, për qeverinë e koalicionit.

Kërkesa për qeveri të koalicionit u paraqit në kohën kur ishte paraqitur kërkesa për unifikimin e forcave shqiptare nga qendrat e vendosjes në bote. Kjo domethënë se, përsëri nuk ishte qëllimi i një unifikimi në lufte çlirimtare me anën e ndërtimit të qeverisë së koalicionit, por kënaqja e dëshirave karrieriste dhe dalja para botës si subjekt gjoja unik, duke i "edukuar" forcat çlirimtare me politike të moderuar. Aq më tepër, kjo u kërkua nga ndërmjetësi Kristofer Hill, pra që shqiptarët të kishin unitet në diskutimin e planet për autonominë substanciale. Shpërthimi i luftës ishte momenti më i përshtatshëm, por edhe i fundit, për të bere bashkimin tone politik, organizativ e ushtarak në Front. Ky moment u lëshua, sikurse edhe disa shanse të mëvonshme, duke dale vetëm me deklaramë formale, pa asnjë veprim praktik.

Po, cilët ishin shkaqet?

1. Mosedukimi i kuadrit shqiptar në drejtim të ndërtimit të sistemit unik çlirimtar, qoftë edhe duke e zhdukur partinë e vet, si Hogan të çlirimit të vendit dhe të ndërtimit të shtetit të lire 1^o, mbetar e demokratik.

2. Ruajtja e pozitës së ngushtë politike në kuadër të subjekteve llojesh: ishin organizuar dhe mbyllja e portave të atyre partive.

3. Mosekzistenca e sakrificës, ndjenjes së lartë kombëtare vullnetit për të çliruar vendin tone, qoftë edhe duke dhënë jute!

4. Interesat e ngushta karrieriste, për të mos thënë, pasurore.

5. Bajraktarizmi i lartë tek politikanët.

Përballë këtyre dobësive të mëdha të partitë dhe politikanët, arsytimi i paraqitur se, ky apo ai subjekt, politikan etj, nuk është përgjigjur nuk qëndron. Nëse nuk do të ishin këto dobësi, sistemi mund të krijohet edhe me pak forca; ashtu sikundër u krijuan nga disa parti LBD-ja, do të krijohet edhe Fondi çlirimtar i Kosovës. Ashtu sikurse dinte LDK-ja, dhe zoti Rugova në kushtet e luftës për të organizuar "zgjedhje", dinte edhe për të vepruar për bashkimin tone në Front. Por, thjesht: ata nuk donin, sepse ishin mësuar me jete pa vështirësi, ndërsa Fondi kërkonte kushte tjera, angazhim në lufte, duke kaluar në terren, atje ku luftohet dhe vdiset për atdhe. Prandaj, politikanët e shtetit të Kosovës nuk shkuan me tutje. Ata mbeten në veprimtari politike, duke gjetur rrugën tjetër, atë të ndarjes politike e cila, sikundër do të shohim, e dobësojnë frontin e luftës dhe Kosova nuk arriti krijojë sistemin çlirimtar unik, një sistem që do të ishte i aftë të ecte në rrugën e vështirë të çlirimit të Kosovës.

Subjektet tjera politike

Ne pozite me to favorshme nuk janë as subjektet e tjera politike ne Kosove dhe ato nen sundimin maqedon e malazez. Ketu nuk dua te futem dhe te komentoj veç e veç qëndrimet, përveçse duhet te deklaroj se te gjitha subjektet, si PDK, PSK, Prosperiteti, PDSH, etj, dhëne përkrahje deklarative per luftën çlirimtare, por nuk morën iniciative dhe nuk u bashkuan dhe as qe u deklaruan per Frontin.

Nga veprimtaria e partive dalin dy grupime lidhur me qëndrimet politike mbi luftën e popullit shqiptar dhe sistemin çlirimtar ne Kosove. Ato janë:

- Se pari, grupi i subjekteve qe iu bashkua. LDK-se dhe bashkimit politik rreth kesaj;
- Se dyti, grupi politik i subjekteve qe ishin me afër me LBD-ne, duke bere deklarime publike., por pa u bashkuar ne fakt me luftën çlirimtare.

S'dua te jap mendime se cilat ishin subjektet qe ishin me njërin grup apo me grupin tjetër politik, sepse per çështjen nuk ka rendësi aspak kjo, kur dihet fakti. se, qe te dy këto grupe kane shume pak dallime ne mes veti presa i përket ndërtimit te sistemit, përkatësisht punes çlirimtare. Edhe ajo qe dallon është vetëm ana formale, e cila del nëpërmjet deklarimeve pompoze politike dhe plot me nacionalizëm romantik, pa asnjë veprim konkret. Ato nuk kane as dallim ne organizim, ne fushën e aktivitetit dhe as ne mjete. Edhe ne aspektin e formave s'ka lidhje.

Nga qëndrimet e subjekteve del se, te dy këto grupe politike kane përshëndetur luftën çlirimtare, por nuk u bashkuan me te. Ato nuk shkuan dhe nuk. iu. përgjigjen thirrjes se LPK-se per ndërtimin e sistemit Frontit, ne mënyre qe te arrihej bashkimi i forcave politike, organizative dhe ushtarake e atyre njerëzore ne një sistem çlirimtar. Duke mos vepruar keshtu, përveç deklarativisht, ne fakt, u dobësua fronti luftarak dhe armiku kishte shume me pak rezistence ne frontin e luftës kundër UÇK-se. Forcat tona ne lufte mbeten pa mbrojtje politike, nuk u forcuan me kuadër politik, organizativ e ushtarak, me kuadër qe subjektet politike kishin ne gjirin e tyre, as me mjete te nevojshme luftarake, etj.

Ky mosbashkim i subjekteve dobësoi luftën çlirimtare. Askush nuk mund te thotë të kundërtën, sepse po te vinte ky bashkim, shume me shume forcohej lufta dhe krijohet një peshe e madhe e çështjes sonë kombëtare përballe botes. Subjektet politike shqiptare mbeten jashtë luftës, tamam sipas ndarjes se grupeve ishin. Ehe keto do vetem me qëndrime deklarave, mbledhur as ndihma, pa ndihmuar e pa u bashkuar faktikisht me luftën çlirimtare. Ne fakt, subjektet e tjera politike legale shkuan tamam siç thotë populli: "si Muça pas Dajise", duke u futur ne skenarët politike te LDK-se dhe LBD, vetëm pse ishin subjekte te "mëdha". Pas qëndrimeve te tyre dilte njeri dhe here grupi tjetër me vendime. Ato e humben tërësisht pavarësinë, ndërsa ne kohen e kërkesës per qeveri te koalicionit, përsëri u ndanë sipas lidhjeve me këto dy parti. Por, pavaresisht nga kjo, duhet thënë se dy janë tiparet qe i karakterizojnë ato:

- Se pari, varësia totale nga LDK-ja dhe LBD-ja.
- Se dyti, per shkak te kësaj varësie, ato nuk dolën .ne anën e sistemit çlirimtar.

Prej tyre u dobësua edhe me shume lufta dhe u krijua terreni i mosunitetit ne shume subjekte, pa bashkim ne sistem, e ku vendos çdokush dhe askush s'është i pavarur, pavaresisht se Kosova gjendej ne lufte dhe i duhej bashkimi. Kjo per kombin ishte shume e rënde, tmerrësisht anakronike, per te mos thënë edhe fatale, sepse ajo ne fakt ishte mosrealizim i ndonjë pozite me te larte to pavarësisë, se sa vete autonomia substanciale, pavaresisht se nen cilin administrim politik e ushtarak.

Asgjëkund nuk duhet lypur shkakun perverse tek subjektet politike dhe organizative te kombit tone.

b) Qeveria e Bukoshit

Ne mos ndërtimin e sistemit çlirimtar ne Kosovë ka ndikuar edhe Qeveria e Bukoshit dhe personalisht ai. Ne, te Kryesisë, e kishim lidhur qeverinë e tij me vete kete njeri, prandaj nga ai pritej bashkimi ne sistem. Kishte shume qe mendonin se ai do te bashkohej dhe do te futej si qeveri ne kuadër te sistemit. Per atë shkak atij iu patën dërguar shume shkresa dhe neper biseda iu kërkua kjo çështje.

Kryesia e Degës kishte bore edhe para shpërthimit te luftës se armatosur presion mbi Qeverinë, përkatësisht ndaj vete z. B. Bukoshi. Ne i patëm lëshuar thirrje dhe ne kontakte ia patëm paraqitur idenë tone politike e ushtarake. Ne kontakte me ne dhe ndaj te tjerëve ai e kundërshtoi çështje e ndërtimit te sistemit. Z. Bukoshi pat deklaruar se institucionet e shtetit, përkatësisht vete Qeveria, duhej domosdoshmërisht te futej ne shërbim te luftës, sepse vetëm kjo forme, bashkimi ne sistem dhe lufta çlirimtare qe zhvillohej ne emër te shtetit, e legjitimonte luftën tone çlirimtare përballe botes. Ndërsa, mbetja anash si Qeveri, e dëmtonte përtej mase çlirimin e vendit, duke lënë hapësire edhe per akuza ndaj UCK-se. Ajo tregonte gjithashtu edhe dobësinë tone organizatave para te tjerëve.

Ne kontakte u trajtuan edhe çështjet e ndërtimit te mekanizmave te përbashkëta shtetërore e luftarake ne sistemin çlirimtar. Kryesia e Degës ishte qe t'i paraprihej bashkimit në sistem me deklarata te përbashkëta dhe nëpërmjet institucioneve te "qeverise" se Bukoshit, deri ne ndërtimin e sistemit, te punohej ne unitet. Shembullore per kete ishte puna me Mërgimtarët dhe veprimtaria diplomatike ne emër te Kosovës tek qendrat ndërkombëtare. Me "qeverinë" u bisedua edhe per qëndrimet politike, ato shoqërore dhe per ndihmën financiare ndaj luftës çlirimtare. Edhe më vone patëm kontakte ne emër te Kryesisë me z. Bukoshi dhe autorizua edhe kolege per te kontaktuar me "kryeministrin" per çështjet e përbashkëta.

Kryesia pati ngarkuar Sabri Kiçmarin per te shkuar ne mbledhjen qe bënte Qeveria ne Bon, ne fillim to vitit 1998, per te Lie si komb me deklarate kundër dhunës, terrorit e masakrave; per te përkrahur luftën çlirimtare. Kjo ape politike qe biseduar paraprakisht dhe per kete e patëm autorizuar kete shok tonin. Mirepo, edhe pse u diskutua, me iniciativën e LDK-se, kjo çështje ndryshua dhe ne vend te kesaj pune, Qeveria doli me një deklarate per te ndërtuar fondet e emergjencës, forme kjo, thjesht per te mbledhur mjete financiare, jo per luftën çlirimtare, po per qeverinë. Ndërsa, mbledhja synonte per te dale bashkërisht kundër dhunës (*Vendimi i Kryesisë së Degës, mars 1998*). Këtë çështje ia pata deklaruar Sabriut, kur i komunikova vendimin e Kryesisë per te shkuar ne mbledhje. Ai veptoi ashtu ne Bon.

Mirepo, as kjo deklarate nuk do te kundërshtohet, sikur ato mjete te shkonin tek UCK-ja. Qeveria kishte mjete financiare dhe ne kërkesat tona per to, prej vitit 1996, nuk iu përgjigj, as kur shpërtheu lufta. Prandaj ishte e pamundur te kihej besim, pa e ndërtuar sistemin çlirimtar. Ne ishim qe deklarata politike te shërbente si mjet i afrimit te subjekteve ne drejtim te kesaj pune te madhe per popullin tone. Nga organizatorët e kesaj mbledhjeje u falsifikua nënshkrimi i Zefit (Sabri Kiçmarit), sepse edhe ne emër tone dolën, per te mbledhur mjete financiare neper këshilla te emergjencës. Kjo korri sukses to madh, kuptohet duke mashtruar e falsifikuar unitetin politik. Por, duke pare se mjetet financiare nuk po ia dedikonin luftës, ndonëse ato u mbledhën per atë çështje, dërguam tash edhe Xhemajl Durakun per te kërkuar mjetet tek ai. Z. Bukoshi i mbledhte ato ne emër to luftës, dhe prandaj duhej t'ia jepte luftës. Por as këtij, ndonëse ky e kishte autorizimin e UCK-se, nuk iu dhanë mjetet financiare. Per, me tepër ai u përqesh nga ai.

Edhe me vone Qeveria e vazhdoi rrugën e vjetër, atë te ndarjes midis subjekteve si dhe afrimin me subjekte te tjera, duke u mbështetur ne lidhjet.

Para kesaj pata një kontakt dhe diskutim te ashpër me z. Muje Rugova. Me kujtohet mbledhja ne janar to vitit 1998 ne Ludwigsburg te RGJ-se. Në atë mbledhje shkova me shokët e këshillit popullor te Ludwigsburgut. Ai aty kundërshtoi çdo organizim tjetër të luftës se popullit tone, jashtë sistemit te "qeverise" se Bukoshit. Edhe vete UCK-ne dhe forcat e tjera i

injoroi. Edhe pse ne mbledhje isha si degjues, ky lloj diskutimi me irritoi pertej mase, sepse ai tregonte arrigoancen e te ashtuquajtures "qeveri e Bukoshit" dhe luften e tyre ndaj forcave çlirimtare. Prandaj, e kundërshtova duke i kërkuar që si Qeveri t'i kryej detyrat nabi dispozitat kushtetuese. ...A.ty i permenda edhe nenet e saj dhe detyrat që dalin nga ajo si. Qeveri. Midis to tjerash kërkova publikisht:

"Ju duhet si "qeveri" të dilni në anën e UCK-se, të vini shërbim të luftës institucionet dhe mjetet financiare të cilat po i mblidhni. "Qeveria" nuk duhet të ndahet nga lufta çlirimtare e cila është në prag. Urdhëro dhe bisedo me z. Bukoshi për detyrën e bashkimit të tone në kuadër të një organizimi, në mënyrë që të korrim sukses. Propozimet tona për sistemin çlirimtar, duke u bashkuar të tëra forcat, z. Bukoshi i ka" (*Diskutimi në mbledhje me Rugovën.*) Por sikundër në kontaktet me z. Bukoshi, as ky diskutim, nuk bëri punë. "Qeveria" e Kosovës nepërrnjë Bukoshit thirrë në luftë, madje në emër të unitetit të tregonte forcën e kombit të tone. Z. Bukoshi jepte intervista dhe shifra prej 200 a 250 mijë luftëtarë shqiptarë, duke thënë gjithashtu se shqiptarët do t'i përgjigjen luftës me luftë dhe si komb unik, pa dallim nga vendi që gjenden ato. Ndërsa në anën tjetër, Bukoshi në pozitën e kryeministrit ishte kundër çdo bashkimi me luftën mbi bazën e sistemit çlirimtar. Arsyetimi i Qeverisë ishte:

"Në si qeveri jemi përcaktuar për format paqësore të veprimtarisë sonë. Për këtë unë jam "zgjedhur" kryeministër. Prandaj, nuk kam të drejtë të kryej një 'veprim të tillë dhe, nëse veproj kështu, mua do më largojnë menjëherë nga pozita e kryeministrit" (*Deklarata e Bukoshit përballë M.K dhe E.Xh.*)

Kjo deklaratë dha të kuptonte se nuk kishte interesë, as nga kjo forcë të punohej për ndërtimin e sistemit unik çlirimtar. Për më tepër nga "qeveria" u kryen disa veprime konkrete politike e juridike të cilat e dobësuan se tepërmi çështjen. Ato përmblihen në disa:

1. Refuzimi kategorik i veprimtarisë aktive e çlirimtare, përveç asaj pasive, si forme për të çilën janë përcaktuar, pavarësisht pse në dispozitat juridike janë përcaktuar edhe mjetet e tjera, të cilat shërbejnë si mjet i diferencimit të masave por edhe kundër UCK-se.

2. Diferencimi praktik i Qeverisë nga lufta çlirimtare e UCK-se, duke e vlerësuar luftën e UCK-se me thënien: "rezistenca e shqiptarëve për të mbrojtur prapë e shtëpisë nga sulmet e forcave policore dhe ushtarake serbe", forme kjo që mohonte edhe emërtimin e UCK-se.

3. Refuzimi kategorik i kërkesës për të vënë "qeverinë" në shërbim të luftës, duke u mbështetur në arsyetimin se "qeveria", sikundër organet e tjera të shtetit të Kosovës janë kundër luftës, si dhe çdo formë tjetër të dhunës, përveç asaj paqësore.

4. Refuzimi i "qeverisë" për ndërtimin e sistemit unik çlirimtar në Kosovë, në arsyetimin se Kosova e ka "shtetin" e vet, qeverinë" dhe institucionin e vet, qoftë të Kryetarit, qoftë të Kuvendit, si dy instancat më të larta shtetërore dhe me kompetenca absolute për të ndërtuar edhe qeverinë.

5. Bllokimi i mjeteve financiare, i mjeteve të cilat "qeveria" e Kosovës në mërgim i mblidhte në emër të Kosovës, luftës dhe terrorit serbomadhi në Drenicë. Vetëm me aksionin: "te ndihmojmë Drenicën me mjete" u tubuan sipas Këshillit Qendror të Emergjencës mbi 100 milion marka, por ato nuk shkuan në luftën e popullit.

6. Bllokimi i kuadrit ushtarak (oficerëve) për të mos u futur në radhët e UÇK-se, forme kjo që bëhej në emër të shtetit, institucioneve dhe luftës.

7. Bllokimi total i mjeteve informative, sidomos të RTSH-se, emisionit të SAT-it, ku as komunikatat e UCK-se, thirrjet, deklaratat dhe informacionet tjera (*si konferencën për shtyp të Kryesisë në Tiranë; mars 1998, mbi luftën e UÇK-ës*) nuk e informuan, madje as që i lexonin ato, ndërkohë që në emisione informative gjenin vend për gjëra të parëndësishme.

Me veprime të tilla u nda tërësisht "qeveria" e Bukoshit nga lufta e popullit shqiptar. Për më tepër, e dobësoi luftën veprimet e veta, sa që bëri një punë jashtëzakonisht të

dëmshme, si ne çështjen politike duke mos e venë veten si "qeveri" to luftës dhe ne ballë të saj, ashtu. edhe duke mos i vene mjetet financiare ne shërbim te UCK-se. Një pune jashtëzakonisht negative kreu edhe përballë subjekteve. "Qeveria" e Z. Bukoshi, jo vetëm që deklaronte se nuk kishte lidhje me luftën, por me nihilizëm nuk e përmendte as UCK-ne, duke identifikuar luftëtarët e UCK-se me djelmosha, dhe luftën si reagim dhunes serbe.

Mund te themi pa e tepruar se kjo veprimtari e "qeverise" e dëmtoi përtej mase luftën e popullit shqiptar te udhëhequr nga UÇK-ja.... Duke e ndare veten nga lufta, kjo e dobësoi dhe e veshtiresoi pertej mase internacionalizimin e çështjes se Kosovës në bote. Para botes u zbeh lufta çlirimtare, ndërsa UCK-ja kuptohej si force e imagjinuar, pa ndonjë rëndësi dhe ndikimin, por thjesht si reagim ndaj dhunës. Ndarja e "qeverise" nga lufta dhe mosbashkimi i saj me sistemin, i dha rast te forte grupit ne krijim e sipër ne kuadër të LPK-se dhe UCK-se per te devijuar punën ne ndërtimin e sistemit ne llogari te veprimeve grupore. Kjo veprimtari e "qeverisë" se z. Bukoshi, e ndare nga lufta çlirimtare e dobësoi edhe iniciativën e Kryesisë se Degës ne rindërtimin e Frontit Çlirimtar ne Kosovë, sepse as subjektet tjera,, sikundër i pame, nuk u bashkuan.

Me këtë pozicion "qeveria" e z. Bukoshi luftonte ne dy anë:

- Së pari, tregohej se as ky subjekt nuk donte te bashkohej në Frontin Çlirimtar dhe se, forcë e vetme qe mund te ecte ishte UCK-ja dhe LPK-ja.

- Se dyti, kjo krijoi terren qe ideja e Kryesisë të luftohej dhe te mohohej per sistemin clirimtar (FÇK), dhe mbeti ndarja midis politikës, organizimit, financave dhe armës, tamam si me qenë dy, a tri, a me shume kombe e shtete. Edhe mbi këtë subjekt, per te mos thëne se është kryesor, bie përgjegjësi e mosbashkimit te kombit tone.

c) Tirana zyrtare

Pengese tjetër e madhe per mosunifikimin e te tera forcave ne sistem është edhe Tirana zyrtare. Ajo, duke dale ne emër te shtetit, deklarativisht nuk u perzie ne punët e brendshme te Kosovës, por ne realitet me veprimet qe bënte, forconte grupin e Xhavit Halitit dhe te Azem Sylës ne ato përmasa, sa që LPK dhe UÇK i identifikonin me ta. Ky qëndrim, pavaresisht se nga vjen, bëri forcimin e klikës dhe ndikoi ne mosndertimin e sistemit çlirimtar, duke ndihmuar edhe ne likuidimin e LPK-se.

Kryesia, duke e ditur se Xhavit Haliti kishte ndërtuar lidhje me Tiranen, jo mbi bazat politike dhe organizative te përcaktuara, përkatësisht ne emër te LPK-se, qysh ne korrik te vitit 1997, pas zgjedhjeve ne Shqipëri, mori vendim per të shkruar një letër dhe per te kërkuar takim me zyrtaret ne Tirane. Qëllimi ishte i krijimi i kontakteve zyrtare dhe me nivel me te lartë me shtetin ame. Natyrisht, u diskutuan edhe disa çështje te tjera te cilat iu ngarkuan delegacionit te LPK-se te Degës, per t'i shtruar ne Tirane. Ne mbledhje te Kryesisë u tha dhe u vendos se, duhej te bisedohej mbi çështjen ne Kosove dhe mbi detyrat tona si organizatë përballë saj dhe gjendjes e cila vinte çdo dite duke u keqësuar.

Fazli Veliu, kryetar i Degës se LPK-se u ngarkua per t'i shkruar kërkesat drejtuar Presidentit to shtetit, Prof. Dr. Rexhep Mejdani, Kryeministrit te shtetit, z. Fatos Nano, Kryetarit te Parlamentit te Shqipërisë, z. Skënder Gjinushi dhe disa ministrave te tjerë (*Vendim i Kryesisë, korrik 1997*). Z. Fazli Veliu ne baze te vendimit te Kryesisë se Degës i lëshoi. kërkesat dhe nga zyrtaret e Tiranës iu paraqit afati i shtatorit te vitit 1997, per t'u takuar dhe biseduar mbi çështjet te cilat kishim paraqitur. Ne bisede telefonike, me marrëveshje, u përcaktua pjesa e pare e shtatorit. Dhe, ne fillim te këtij muaji shkoi pjesa e Kryesisë, pese veta sa ishin ne Tirane. Ne delegacion ishin: Fazli Veliu - kryetar, Muhamet Kelmendi - nënkryetar, Emrush Xhemajli - sekretar dhe Xhavit Haliti - anëtar i Kryesisë. Ne Tirane ishin edhe disa anëtare

tjerë të Kryesisë me detyra tjera, to çilet gjithashtu ishin dëshmitare. (*Shënime nga vizita ne Tirane, 1997.*)

Shkuam ne Tirane dhe me kërkesën e Fazliut u takuam me Kryeredaktorin e "Zërit të Popullit", si person ndërlidhës për t'u takuar me zyrtaret. Ne bisede, edhe njëherë i përmendem shkaqet e kontaktimit, duke treguar dëshirën tone që përveç kontakteve jashtë mjeteve informative, të kishim kontakte edhe me publikun. Mbi 10 dite qëndruam ne Tirane dhe nuk u arrit të kontaktohej me zyrtaret e atjeshëm. Arsyetimi nga z. Rama ishte "Udhëheqësit e shtetit nuk kanë kohë për të kontaktuar, sepse janë shumë të zëna dhe se ne kishim ardhur në kohë të papërshtatshme" (*Deklarata e Z. Rama, dhënë ne Hotel Tirana, para tërë delegacionit të LPK-së*).

Ky arsyetim u mor parasysh nga ne. Mirepo, ne shtruum kërkesa të tjera, në dhjetor të vitit 1998. Por, intervenimi ynë i madh me shkrim dhe me telefonata, duke folur me sekretarët dhe këshilltarët e zotit president, kryeministër dhe kryetarit të parlamentit, u bë në mars, prill dhe maj të vitit 1998. Ne, si Kryesi e Degës, me kërkesa, treguam shkaqet se pse donim të bisedonim me zyrtaret në Tirane. Shkresat përsëri, në emër të LPK-se dhe UCK-se, i shkroi Fazli Veliu. Tashme adresën e kishim në Tirane. Aty e dhame edhe numrin e telefonit ku mund të gjendeshim për të biseduar.

Në shkresat të cilat Fazli Veliu i drejtoi. udhëheqësve të shtetit kërkohej takim urgjent për me biseduar mbi gjendjen në Kosovë, situatën pas shpërthimit të luftës, raportet e forcave dhe mbi bllokimin e informimit, që i ishte bërë luftës clitimtare në Kosovë (*Shkresat e Kryesise se Degës*).

Kërkeses sone, përveç Prec Zogajt, edhe pse atij nuk i ishim drejtuar i ishim drejtuar presidentit, nuk iu përgjigjen. Me z. Zogaj u takuam në mars 1998, në zyrën e tij në presidencë. Unë, Muhamet Kelmendi, isha me Fazli Velion. Atij i treguam situatën në vend dhe kërkuam kontakte me presidentin. Na tha se, shumë kush kishte ardhur në emër me luftës, gjë që e kishte vështirësuar situatën. Natyrisht, kjo ishte e vërtete, pasi dilte edhe nga RTSH-ja, prandaj i kërkuam kontakte për të biseduar, në mënyrë që të mos kishte manovrim në emër të luftës dhe gjendjes në vend. (*shih: Biseda me z. Zogaj, Shënime.*)

Mirepo, pas këtij takimi as nga presidenca nuk u ftuam me. Në paraqitem gjatë atyre muajve edhe kërkesa të tjera tek organet e Marta të shtetit, por pa sukses. Disa here edhe telefonuam. Madje nga një telefonate në Parlament, ku u bisedua me një këshilltar të z. Gjinushi, na u tha se z. Kryetar gjendej në Turqi, po me t'u kthyer do t'u jepej përgjigje shkresave tona. 'dhe me kabinetin e kryeministrit biseduam, por nuk na u dha përgjigje. Na u tha se do të lajmërohet kryeministri. Çfarë është bërë me tutje nuk dihet. Të tri këto institucione e injoruan subjektin tone. Ata, si parlamenti e kryeministri, ashtu edhe kryetari i shtetit, kurrë nuk u dhanë përgjigje kërkesave të Kryesisë së Degës. Ku qëndronte shkak, nuk dihet.

Kryesia donte të diskutonte me zyrtaret e Tiranës mbi dy baza të forta dhe për disa çështje që e preokuponin kombin tone në përgjithësi. Bazat ishin:

- Së pari, mbi vendimet dhe rezolutat e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë mbi Kosovën, prej të cilave dilte pranimi

i Republikës së Kosovës si shtet, dhe e drejta e vetvendosjes së kësaj pjese të kombit.

- Së dyti, ishte përkatësia kombëtare, kultura, arsimit, historia, formimi unik i kombit, pra, ishin elementet e kombit tone të cilat ngritën shtetin në përgjegjësi me të lartë për Kosovën, si atdhe i të gjithë shqiptarëve.

Duke u mbështetur në këto dy baza të forta politike kishim këto çështje për diskutim:

1. Gjendja në Kosovë pas shpërthimit të luftës në Kosovë.
2. Pozita politike dhe luftarake e luftës çlirimtare të udhëhequr nga UCK-ja.
3. Informacioni dhe çështja e logjistikës.

4. Ndërtimi i Frontit Çlirimtar të Kosovës (shih: shkresat drejtuar zyrtareve ne Tirane).

Këto baza politike dhe çështje ishin disa nga anët që i kishim përcaktuar vetes për me: biseduar me zyrtaret e Tiranës. Këto ia patëm thënë edhe këshilltarit të presidentit, si dhe i kishim cituar në pika të shkurtra nëpër kërkesat me shkrim, edhe të tjerëve, por jo të detajuara si këtu, por të përgjithësuara, duke lënë të kuptohet se, mbi këto çështje, do të bisedohej me zyrtaret. Aq më tepër, kur rezolutat e parlamentit të shtetit, realizoheshin vetëm me sistemin çlirimtar unik. Kënde, kishim nevojë për të ndërruar mendime mbi situatën në botë, mbi vlerësimet e zyrtareve ndaj UCK-së mbi mënyrën e bashkimit të kombit tone në sistem, përkatësisht në FCK, etj. Ky veprim ynë si organ udhëheqës ishte edhe me i kuptueshëm, po të merrej për baze pozitive si organizate, si dhe njihet reciproke që ishin, pikëpamjet e mbi luftën, etj. Ne, si Kryesia, na njihete fare mirë Tirana zyrtare. Ky organ i kishte kompetencat. Dhe, në vend që të këto forca kompetente të Kryesisë së Degës së LPK-së për të biseduar mbi çështjet që na preokuponin si komb, sidomos në mars, prill e maj 1998, atëherë kur Kosova ishte në luftë, zyrtaret e atdheut tone takonin persona inkompetentë, si Xhavit Halitin, Azem Sylen, etj, të cilët i kishim shkarkuar nga detyra e mbajtjes së lidhjeve dhe të kontaktimit politik me zyrtaret atje, sikundër dhe me subjektet tjera në vend dhe botë. Këtë ia kishim komunikuar edhe zyrtareve në Tirane, në kohën kur u paraqit delegacioni për bisedime në presidencë. Në shkresë e kërkesë kishim treguar se Kryesia e Degës është kompetente, askush tjetër, aq më pak individët. Këtë vendim të zyrtareve në Tirane e bane qesharak edhe fakti kur dihet se, këta takoheshin edhe me subjekte politike, shoqërore, deri edhe me shoqata e njerëz të parendesishëm, pa ndikim dhe private, veçse jo me anëtarët e Kryesisë, të cilët ishin për kohën me kompetentët.

Zyrtaret në Tirane shkelen rezolutat e Kuvendit të tyre. Tirana përkundër këtyre vendimeve, doli me qëndrime për "zgjidhje demokratike të çështjes së Kosovës, duke dhënë ide për mos ndryshimin e kufijve me dhunë" (shih: ZP, mars-prill 1998), deklarim që për mendimin tone atëherë shkante ndeshur me Kuvendin e shtetit. Në anën tjetër, këta zyrtarë e vazhduan kontaktin me individë, duke e identifikuar Xhavit Halitin e Azem Sylen, me vonë edhe Hashim Thaçin me LPK-në dhe UCK-në. Zyrtaret atje e kishin të qartë se, nëpërmjet një grupi të tillë nuk ndërtohej sistemi, nuk bëhej bashkimi i forcave politike e ushtarake, e atyre shtetërore në Frontin për Çlirimin e Kosovës. Mund të them se ndoshta kanë qenë edhe kundër, por vete fakti i përkrahjes së këtij grupi bëri të pamundur ndërtimin e atij sistemi. Aq më tepër, kur forcat politike legale ishin tërësisht kundër, sikundër edhe vete "qeveria" e Bukoshit. Në këto situata, pra, kur luftohej Fronti në Prishtinë, kjo rrugë e Tiranës e forcoi edhe me shumë grupin politik në ndërtim e sipër në kundërshtim të UCK-së.

Ky grup politik i kishte territorin e lirë në Shqipëri për të vepruar, shtetin e kishte pas dhe në emër të kesaj bënte bllokimin e iniciativës për ndërtimin e Frontit Çlirimtar të Kosovës. Tirana zyrtare autorizoi vetëm Xhavit Halitin për të vepruar në shtet, gjë që ia mundësoi edhe me mjete, financa, etj. Nuk lejonte asnjë veprim, qoftë politik, qoftë ushtarak, qoftë të logjistikes, të tjerëve, jashtë këtij. Edhe ata që u vendosën në veri, duhej të merrnin mjetet nëpërmjet atij. Ndërsa, këto lehtësira ai i shfrytëzoi në emër të Tiranës dhe arriti që me grupin e vet të shkatërronte tërë mundin për ndërtimin e një lufte të mirëfillte çlirimtare kundër armikut në Kosovë.

Kjo lidhje e forcoi atë. Tirana zyrtare, ndoshta pa vetëdije, apo edhe në mungesë të informacionit të plotë, e ka bërë këtë veprim, por e vërteta është se pikërisht ky bllokim i Kryesisë së Degës, në llogari të grupit të Xhavit Halitit e Azem Sylen, ka bërë që të mos realizohej bashkimi i forcave në sistem çlirimtar. Për këtë shkak, paraqitem disa here shkresë. I patëm treguar edhe z. Rama, z. Zogaj, etj, por pa sukses. Xhavit Haliti ishte tani "zoti" në Tirane. Ai vendoste mbi çdo gjë. Për zyrtaret atje, ai ishte UCK-ja, Kosova, LPK-ja etj. Këtë e keqpërdori ky zotëri, duke e kthyer këtë terren në luftë kundër shokëve, LPK-së dhe

Frontit, vete UCK-se, deri sa ne fakt e ndaloj me shoke ndërtimin e sistemit çlirimtar ne vend dhe ndërtoi grupin politik to UCK-se. Ne balle te saj vuri Hashin Thaçin, të cilin ai e kishte ne dorë dhe e udhëhiqte politikisht.

Ndoshta, mosinformimi ka luajtur rol me rendësi ne Tirane. Por, përveç kesaj ane, mund te thuhet se ka edhe disa faktorë te tjerë, faktorë politikë, shoqërorë e ndërkombëtarë, ndoshta edhe ekonomike, te çilet kane ndikuar ne faktin pse u përkrah grupi. i Xhavit Halitit nga zyrtaret e Tiranës. Ato fakte a elemente, rrethana te tilla janë:

1. Përqendrimi strikt i qendrave nderkombetare per poziten autonome te Kosoves ne kuader te shtetit te Jugosllavise, pavaresisht sakrificave te kombit.

2. Mbajtja me fanatizëm e aktit të Helsinkit mbi mosndryshimin e kufijve me dhune.

3. Inatet dhe lidhjet ideopolitike e shoqërore midis subjekteve politike të Kosovës me zyrtaret ne Tirane, me forcat politike atje e organizmat e ndryshëm.

4. Interesat ekonomike të vendit dhe presioni mbi shtetin shqiptar nga UE, Banka Ndërkombëtare per Rindërtim dhe SHBA-te, të cilat e ndërlidhen çështjen e Kosovës me ndihmat ekonomike, pozitën e saj ne botë dhe investimet.

5. Ndërlidhjet financiare te ndonjë zyrtari ne Tirane nga ky grup.

6. Ndikimi nëpërmjet kesaj lidhjeje ne jetën e juridike ne vend, sidomos tek UCK-ja..

Këto janë faktet. Ndoshta, ne nivel shtetëror, e tërë kjo është here nga "pavetëdija". Pikërisht per kete patëm kërkuar shume here takime me zyrtaret ne Tirane. Ne donim qe Tirana to informohej realisht mbi gjendjen tone. Per atë shkak i dhamë ne takime edhe informatat qe i dinim nga terreni per situatën dhe bufen. e popullit tone, por pa u lëshuar ne detaje. Per me tepër, Kryesia i ka lajmëruar zyrtaret ne Tirane me kohë mbi rreziqet e luftës se armatosur në Kosove. Ka kërkuar edhe ndihme konkrete ne ndërtimin e Frontit çlirimtar Kosovës, si baze kryesore politike e juridike të sistemit çlirimtar. Të gjitha këto i kemi kryer zyrtarisht. Po ndihme nuk u dha. Ajo iu dha vetem individeve, prej cileve u ndertua klika.

Zyrtaret ne Tirane e lidhen fatin e Kosovës me kete grup politik. Ky ishte gabimi me i madh i tyre si shtet dhe Qeveri ishte. Nuk dua to them se nuk ka pasur interesa vetjake, por vete qeveria, duke e njohur pozitën e kombit, ndarjet qe ishin ne kuadër të organizmit duhej të ishte per Front. Pse kjo u mohua?! Kush ishte ajo force zyrtare qe e ndihmoi kete grup, me ndihmen e cilit organizuan dhe kapën UÇK-ne. Të gjitha këto çështje lidhen me grupin e Xhavitit. Nuk mund të them se Tirana nuk e ka njohur gjendjen politike, atë organizative dhe ushtarake ne vend. Përkundrazi, ajo ndihmoi Xhavitin dhe ai kapi UÇK-në e LPK-ne per fyti me urdhrin e saj. Me kete veprim, ky grup fitoi dhe u devijua lufta ne Kosove, ndërsa korren sukses anët e tjera, ato qe kombi ynë të mos arrinte to bashkohej ne Front dhe to çlironte Kosovën. Ajo e humbi karakterin e vet popullor e çlirimtar.

Duke u pranuar nga Tirana grupi i Xhavit Halitit si udheheqes UCK-se, u kalua nga pavaresia e Kosoves, perkatesisht shteti, në pozite shume me të ultë, tek autonomia substanciale, me administrimin politik e ushtarak nga jashtë. Ky ishte çmimi i kësaj ndarjeje, ndonëse per kushtet e krijuara është i kapshëm. Pse? Sepse, me kete ndarje të ashpër midis forcave tona politike e ushtarake shqiptare, nuk u bashkuan shqiptaret ne Front, ndërsa me atë nuk arriti kombi i ynë per to imponuar vullnetin e vet as si shtet ne union të shteteve dhe as si republike konfederatave, me të drejtë të shkëputjes se plotë, pa bere fjale per pavarësinë e Kosovës dhe shtetin tone sovran.

Ja, pse Tirana zyrtare merr pergjegjesi.

d) Organizmat nderkombetare

një fakt tjetër qe ka ndikuar tek forcat shqiptare per to mos ardhur deri tek ndërtimi i sistemit unik çlirimtar ne Kosove është padyshim edhe faktori i jashtëm. Ky ne forma e mënyra të t

ndryshme arriti qe to kete një rendësi të madhe, sepse bëri forcimin në deklarata, mendime e kërkesa to subjekteve to veçanta, të cilat ndien veten të forte, mjaft to forte përballë të tjerëve dhe bllokuan çështjen e sistemit.

Per to realizuar pikësynimin e vet në kete pjese to botes, pikësynim qe nisej nga ideja e mosndryshimit të kufijve të jashtëm të ish-Jugosllavisë me shtetet e tjera, duke mos njohur as te drejtën e vetëvendosjes deri ne shkëputje të popullit te Kosovës, gjithherë te mbështetur ne Aktin Final te Helsinkit, u përcaktua pozita e Kosovës nen serbojugosllavi. Organizmat ndërkombëtare kishin mendime te ndryshme per çështjen e Kosovës, të cilat vinin ne varësi me pozitën, raportet e interesat ekonomike, ushtarake mbi kete pjese të kontinentit tone. Ne varesi nga këto interesa dhe fërkime te kundërta u krijua edhe lidhshmëria dhe u përcaktua pozita e vendit ne kuadër te këtij shteti sllav. Ne kete ane dalin tre qëndrime para shteteve:

- Se pari, njohja e një autonomie kulturore e Kosovës, të çilen e kishte përcaktuar vete qeveria e Beogradit, autonomni te ellen e perkrahu edhe Moska dhe Greqia. Kishte edhe ca shtete të tjera sllave te cilat dolën ne anën e saj dhe të vetë klikës.

- Se dyti, njohja e autonomisë kulturore e territoriale, te çilen e përkrahen shtetet evropiane, sikurse ishte autonomia e Tirolit Jugor ne Itali, ku ekziston tërësia territoriale dhe organet e shtetit me kompetenca shume to kufizuara dhe me te drejta te gjera kulturore, shoqërore e liri dhe te drejta qytetare.

- Se treti, përcaktimi i Kosovës me status te autonomisë politike, ekonomike e shoqërore juridike, me elemente te organizimit federativ to vendit dhe me kompetenca to tilla, mbi te cilat u mbështet edhe plani i K. Hillit, qe e paraqiti para GK dhe ai u be edhe plan i UE. Mbi këto qëndrime u ndërtuan qëndrimet e organizmave ndërkombëtare mbi Kosovën. Si vete OKB-ja, ashtu edhe OSBE-ja, Parlamenti Evropian dhe vet UE-ja e pranuan planin e fundit te zotit Hill, pra, atë amerikan dhe ky u fut ne fuqi. Mbi kete plan zhvilluan edhe diskutimet ne Rambuje te Francës dhe ky u be baze e gjithë punes per Kosovën. Nga ky del autonomia me elemente te republikës e shtetit. Edhe aktualisht mbi kete po punohet (kjo çështje nuk eshte per objekt ketu).

Duke u mbështetur ne këto qëllime, përkatësisht ne faktin se Kosovës nuk i duhet lejuar pavarësia ne organizimin e shtetit dhe as bashkimin me shtetin ame, u ndërtuan edhe raportet me subjektet shqiptare ne Kosove. Ne fakt kjo çështje nuk u deklarua taksativisht, por ne realitet dhe ne diplomaci ky element ishte pikëmbeshtetës per qëndrimet ndaj Kosovës dhe ajo ishte teme kryesore e diskutimeve. Te gjithë zyrtaret nga perëndimi, neper mbledhje e kontakte, qofte te organizmave ndërkombëtare, qofte të Grupit te Kontaktit nga marsi i viti 1998, kur ky organizëm. e mori çështjen e Kosovës, e deklaruan autonominë si forme te vetme per Kosovën ne kuadër te serbojugosllavisë (shih: planet mbi Kosovën në organizmat ndërkombëtare te nënshkruar nga përfaqësuesit shqiptar). kundërthëniet qëndronin vetëm tek kompetencat neper fusha te ndryshme. Pati diskutime edhe per ndarjen e vendit tone.

Megjithatë, qëndrimi i pare gjeti terren te mire tek subjektet politike shqiptare ne Kosove. Atë e përqafoi shume shpejt LDK-ja e cila veç kishte shenja to një zgjidhjeje te tillë. Me te ishin edhe lisa subjekte tjera qe ishin ne "koalicion" me kete parti. Kundër ishte LBD dhe partitë qe gjendeshin rreth saj, ndaj te cileve u deshtë te veprohej ne forma te ndryshme, duke ofruar e larguar, dhënë pozita, deri duke kërcënuar e lavdëruar per punën e mire në terren, forme qe bëri afrimin dhe luftën kundër idesë se sistemit për të frikësuar UCK-ne u përdor edhe arma e armikut kundër njësive te UÇK-se, ndërsa brenda saj iu dha përkrahje grupit politik te "moderuar" përballë ushtarakëve, te cilat u forcuan dhe e morën rolin udhëheqës ne ushtri.

Kjo "domosdoshmëri" e pranimit to autonomisë ishte e lidhur me vete luftën kundër sistemit unik çlirimtar - FCK-se. Sikur të kishim ndërtuar kete sistem, natyrisht qe, pesha e luftës sonë do ishte shume me e madhe, prej nga edhe mbrojtja e masave shqiptare, dëmtimi i armikut e çlirimi i vendit do te ishte shume më i lartë. Edhe pozita jone do te ishte me siguri më me

peshë në bote. Kjo për shkak se kombi ynë do të ishte i teri në lufte, pra me disa milion dhe, nuk do të kishim kundërtënie politike, po unitet të plotë për pavarësinë e Kosovës dhe këndej do të ndërtohej edhe një shtet çlirimtar, formë kjo shumë e rëndësishme për lufte. Po, pikërisht kjo forcë që do të ishte e rëndësishme që Kosova vetë të çlirohej, me apo ndoshta pa ndihmën e jashtme, bëri që në kundërshtim me vullnetin e popullit të veprimeve edhe ndaj UÇK-se. Në vend që ky subjekt të forcohej ushtarakisht, me mjete të profesionalizohet, mbi të u vendosën masa të kontrollit të rreptë.

Pikërisht në kohën e lulëzimit të UÇK-se, atëherë kur ishte edhe duke u ndërtuar Fronti në Kosovë, kemi luhatur në qëndrime, përkundër faktit se ajo ishte forca e vetme mbrojtëse e popullit. Lufta e popullit tone zgjerohej dhe shtrihej në tërësi gjithë andej. Shumë forca shqiptare, anëtarët e partive politike, të organizatave etj, i gjithë populli ishte bashkuar pa dallim partie, shtrese e gjinie me luftën popullore. Nuk kishte as dallime në ide politike midis luftëtarëve të UÇK-se. Të gjithë u bashkuan në lufte. Pritej edhe bashkimi i subjekteve politike dhe i vetë "qeverisë" së Bukoshit, në mënyrë të ndërtohet një shtet me sistem unik çlirimtar në Kosovë. Në këtë kohë, pra, në prag të ndërtimit të një kryengritjeje të përgjithshme çlirimtare në Kosovë, e ndërmerren punën për të "edukuar" udhëheqjen e UÇK-se. Lidhur me këtë, organizmat ndërkombëtarë e zhvilluan veprimtarinë në disa ane:

1. Filluan presionin ndaj UÇK-se duke e cilësuar si subjekt jo unik, shpeshherë edhe terrorist, pa një strukturë komanduese dhe të paaftë për lufte kundër shtetit serb.

2. Bënë përkrahjen e politikaneve të LBD që ishin gjoja politikisht afër kërkesave të UÇK-se, të çilet punuan kundër forcave që ishin për sistem, në llogari të grupit politik në kuadër të UÇK-se. Të lidhur me LBD-në, duke bërë bllokimin e forcave të LPK-se që ishin për ndërtimin e sistemit çlirimtar.

3. Bënë presion mbi Tiranën për të bërë bllokimin e tërësishëm forcave politike të LPK-se që ishin për sistem dhe të forcave UÇK- se në atdhe, që ishin afër tyre.

4. U dhanë përkrahje në UÇK forcave të grupit politik, kundër forcave që ishin për të, ndërtuar sistemin, në mënyrë që këto të humbin dhe pa vështirësi të arrijnë tek realizimi i autonomisë.

5. E shfrytëzuan gjendjen e brendshme dhe forcat e shtetit serb për të treguar paaftësinë e luftëtarëve tone përballë Serbisë, si mënyrë për të bërë presion dhe për të pranuar ofertën amerikane mbi autonominë substanciale, duke i treguar popullit paaftësinë e luftëtarëve për të mbrojtur vendin dhe çliruar Kosovën.

6. I dhanë përkrahje LDK-se dhe I. Rugovës, "qeverisë" së Bukoshit, vet Kuvendit të Kosovës, si formë e krijimit të konflikteve të brendshme, në mënyrë që të vinin deri tek kompromiset, duke i pranuar UÇK-ja ato organ për Kosovën.

7. Krahas kësaj në terren organizmat ndërkombëtarë nuk lanë anash as armën e shtetit serb. Sa herë që i duhej presioni mbi shqiptarët, ata i dhanë dritën jeshile pushtuesit, në mënyrë që ai të godiste me forca të shumëfishta.

Nëpërmjet këtyre punëve u dobësuan forcat çlirimtare, ato që ishin për çlirim e bashkimin e vendit tone dhe natyrisht forcoheshin ato që ishin për zgjidhje tjetër, të moderuarit të çilet korren sukses dhe në fakt edhe u futën në një bashkim për autonomi, perkatesisht me forca të tilla të moderuara të LDK-se dhe me ato, të cilat me presion edhe do të shkonim kah pranimi i autonomisë së Kosovës. Zaten e tërë puna për mosbashkimin e faktorit shqiptarë e kishte këtë qëllim. Tani i kishin në dorë LDK –në, Kuvendin dhe shumë subjekte të tjera. Ata vepronin siç u diktohej. Duhej të vepronin ndaj forcave tjera politike, grupit të partive politike të organizuara në LBD, Dhe, vetëm pas edukimit që i bënte LBD-se, vetë forcave "nacionaliste" shqiptare; si Rexhep Qosës, Bajram Kosumit, Hidajet Hysenit, etj, arriten të bëjnë edhe edukimin e "udhëheqjes" politike të UÇK-se, në fillim duke bërë grusht politik mbi udhëheqjen politike të saj, që vinte nga Dega e LPK-se, me vonë edhe ndaj Demaçit, duke hapur rrugën për diskutimin e autonomisë së Kosovës.

Pas krijimit të këtij terreni, në tetor madje edhe me herët, dolën organizmat ndërkombëtar nëpërmjet z. Hill dhe Petric me kërkesën se duhet të behet bashkimi i faktorit shqiptar, i atij politik, shtetëror dhe ushtarak. në një subjekt, përkatësisht grup për bisedime. Por, ky bashkim në një grup politik, nuk ishte për ndërtimin e sistemit çlirimtar, të një sistemi që do të organizonte luftën çlirimtare, udhëhiqte atë dhe do të shtrinte çështjen e rezistencës në vend, në fshat e qytet, kudo në Kosovë, po të një subjekti politik, i cili në bisedime do të pranonte autonomin substanciale. Ata donin një unitet politik të shqiptareve për të arritur tek gjuha e pranimit të planit mbi Kosovën. Dhe, në fakt e arritën këto pikësypnim.

Organizmat ndërkombëtare me punë të veçanta, duke ofruar ide e mendime, kercenime etj., deri edhe ndonjë pozite "shtetërore" (*shiko: marrëveshjen për autonomi dhe qeverinë e saj*) arritën që të mos kemi bashkim të forcave në sistem, i cili me siguri planin e autonomisë do të kundërshtonte. Pozita e Kosovës, ishte caktuar që në shpërbërjen e Jugosllavisë, atëherë kur në Mbledhjen e Londrës të vitit 1992 vendi ynë (Kosova) dilte në pjesë serbojugosllavise (*Konferenca e Londrës për ish-Jugosllaninë e vitit 1992, Frankfurter Allgemeine Zeitung*). Për atë pozite ndikuan në format e permendura dhe nuk lejuan bashkimin e mirefillte të kombit tone, me tere aftësitë e mundësitë e veta njerezore, politike e materiale ushtarake në një luftë të gjere çlirimtare. Ndërsa, për t'i treguar edhe në këto anë përparësitë, duhet shtuar se, nëse me anë të bashkimit politik në sistem çlirimtar nuk do të arrihej tek perfundimtar i vendit, mendoj se me një status shumë me të fortë Kosova do të merrte pjesë në bisedime.

Mbi këto baze do të krijoheshin terreni edhe për realizimin e të drejtave të gjera politike e shoqërore, atyre ekonomike e demokratike, si dhe ushtarake. Me të edhe mbrojtja e vendit do ishte në nivel me të lartë. Ai status i Kosovës do të ishte baze e fortë për pavarësinë e vendit tone dhe për bashkimin kombëtar shtetin amë, Shqipërinë.

KAPITULLI V

VEPRIMTARIA PËR LIKUIDIMIN E SUBJEKTEVE PËR NDËRTIMIN E FRONTIT

Veprimtaria për të zhdukur forcat politike, atë të Kryesisë së Degës, që punonin për një luftë të përgjithshme çlirimtare, kishte filluar shumë me herët. Në pame se si u zhvilluan çështjet deri në periudhën pas majit të vitit 1998. E përbashkëta është se kjo veprimtari nuk u bë e pavarur, veç e veç nga subjektet, ose vetëm në kuadër të LPK-se, si forca ende udhëheqëse e luftës brenda vendit. Për më tepër, ajo shkoi duke u lidhur me subjekte të tjera, qeveri dhe organizma ndërkombëtare.

Kjo lidhshmëri dhe përputhshmëri në mendime bëri që të korret sukses në grushtin politik kundër LPK-se. Tashme, ishte koha kur forcat politike, besniket e sistemit çlirimtar, ishin rrezuar, por ata ende vepronin, prandaj po ndërmerrej likuidimi i tërësishëm i këtyre forcave në një anë dhe, në anën tjetër, ndërtimi grupit në kuadër të UÇK-se, duke mohuar karakterin e përgjithshëm çlirimtar dhe ndërtimin e sistemit unik të çlirimit të vendit tone. Kjo arrihej duke likuiduar ish shokët e LPK-se, vete organizate, në mënyrë që të fusnin në të personat që varehin prej tyre, ata që ishin për një luftë të mbështetur në interesat e ngushta të grupit, por gjoja mbi bazën e kombit.

Për të realizuar këto lufte të ndyre nuk u la veprim e punë pa u ndërmarre. Grupi doli edhe me akuza të ashpra, deri edhe me emërtimin "tradhtar" ndaj Kryesisë. Muajt që pasuan pas mbledhjes së Dytë të KP të Degës, më 09 dhe 10.05.1998 e deri në korrik të 1998-es, si dhe më pastaj, janë muajt ku, përveç pasivitetit politik e organizativ të saj, përshkruhej kjo kohe

edhe me akuza te fshehta, jashtë organeve, etj. Asgjë me shume nuk gjejmë ne aktualitetin e tyre përveçse luftës per likuidimin politik te shokëve dhe te LPK-se.

Mirepo, kjo periudhe shënon edhe kohen kur u kooptuan organet e UCK-se, si dhe u be ndërtimi i plote i klikës politike, asaj organizative e juridike. Me këtë ndërtim e rindërtim, ne fakt, mohohet kategorikisht lufta per sistem, ndonëse ngandonjëherë doli edhe ideja e ndërtimit te tij. Por, kjo forme ishte thjesht formale 'përballë veprimtarisë konkrete, organeve te ndërtuara dhe punes se kryer.

a) Likuidimi a LPK-se

Një pune jashtëzakonisht te madhe, pas mbledhjes se KP te Dyte te Degës, u be ne drejtim te likuidimit total te LPK-se. Pengesa ishin ende ish-udhëheqësit e saj, anëtarët e Kryesisë. Natyrisht, nuk ishte lehte per t'i luftuar. Akuzat i kishin shpallur. Per atë shkak nuk u be as rizgjedhja e tyre, por u përcaktua një Kryesi Teknike, e cila kishte si qellim, te ftonte mbledhjen e KP te Degës. Ndërsa, ne mbledhjen e 09. dhe 10.05. 1998 te KP, ishte caktuar komisioni per te shqyrtuar akuzat dhe çështje t tjera që dolën. Mbledhja tjetër ishte përcaktuar të mbahej brenda një periudhe prej 2-3 javësh, ne fund te muajit (shih: vendimet e KP Dege:r, nxjerre. nga Ditari i MK).

Kjo rruge vetvetiu tregonte se ishte koha e ndërrimeve te mëdha dhe shume negative. Vete fakti se gjerat e tilla ecnin shpejt edhe ne duhej shume shpejt te konsolidoheshin, per te qenë ne gjendje te kapnin çështjen ku e kishin lënë dhe, per te ecur ne rrugën e madhe, ne atë çlirimtare. Prandaj, me propozimin tim u përcaktua kjo kohe, duke menduar se brenda saj do të shqyrtoheshin çështje t dhe ne mbledhje do te merreshin masa Adekuate, ne përputhshmëri me situatën dhe dokumentet e organizatës. Ky ishte mendimi im dhe i atyre që e përkrahen një te tille. Keshtu menduam logjikisht, por pa e përjashtuar edhe faktin se, e tere kjo vinte si rezultat i një lufte te ashpër karrieriste, lidhur me interesat financiare dhe lokale. Kjo çështje duhej domosdoshmërisht, sa me shpejt. Mirepo, per fat te keq, para dhe pas MP u pa qartë ekzistenca grupeve ne te dy bazat kryesore, ne atë. te Kryesisë Teknike dhe një komisionin e shqyrtimit te akuzave, baza ketë te rëndësishme te çuar çështjen përpara. Ne të u fut një person me një tete panjohur per organizatën. Ai u "zgjodh" ne dy vendet udhëheqëse, pa i takuar organeve udhëheqëse dhe pa e ditur ne organizate. Qëllimi ishte lenia e organizatës pa organe, në mënyrë që grupi i krijuar ne kauter te UCK-se dhe LPK-se, te konsolidohej juridiko-politikisht. Kesaj i duhej edhe bartja e tërësishme e Këshillit te Financimit ne kuadër te forcave te grupuara rreth klaneve ne ketë dy subjekte. Me një fjale, "zgjedhjet" u bënë per të humbur funksionalitetin organizata, kuptohet nen arsytimin e punëve te "vështira", te "renda" e te "komplikuara" (*diskutimet e udhëheqësit teknik te Kryesisë Teknike ne mbledhjet te" KP-ditari i MK*). Koha ishte faktori që paraqitej si shkak për mosmbajtjen e mbledhjes.

Ne udhëheqjen teknike ishin: Bedri Islami kryetar, ndërsa anëtarë Jashar Salihu, Bardhyl Mahmuti, Mehmet Bislimi, Rrahim Sabri Kiqmari dhe Agush Buja. Ne komisionin per shqyrtim Bedri Islami kryetar, Naser Idrizi që zëvendësoi Ujkan Nikqin dhe Sejdi Gega (Vendimi i KP te. Degës). Vete kjo përbërje e Kryesisë Teknike tregonte vështirësitë qe kishte organizata. Por, Kryesi do te luante një rol aq armiqësor kundër vete LPK-se UCK-se, sidomos luftës çlirimtare dhe FCK-se ne Kosove.

Nuk kishte mendime te kundërta, duke u bazuar ne idenë se qëndrimet politike, atë juridike, etj, mbi luftën ekzistonin dhe se, nuk mund te ktheheshim me prapa per te ecur si gaforrja, ne dem te luftës sonë çlirimtare, përkatësisht te Frontit per çlirimin e Kosovës. Ky ishte vendimi i vete KP me përbërje te vjetër. Ajo delte edhe nga programi dhe rezolutat e LPK-se.

Por, çfarë beri Kryesia Teknike?

Ky organ nga vete emërtimi tregon se kompetencat i kishte te karakterit teknik, përkatësisht vetëm për të lëshuar thirrje për mbledhje, për të gjetur vendin dhe për të përcaktuar edhe kohën e orën. Dhe, në vend që pas 2-3 javë të ftohej mbledhja e KP për të shqyrtuar raportin e nxjerre nga komisioni, i cili e kishte kohën e afatizuar riga 1-2 javë, kjo Kryesi pa dijeninë e KP e shndërroi veten në Kryesi të Përkohshme dhe nuk e fitoi mbledhjen e KP LPK-ja .mbeti pa asnjë veprim. Ajo nuk kishte me asnjë funksion dhe nuk lëshonte as komunikata, deklarata e shkresa.

Në anën tjetër, komisioni nuk e paraqiti fare materialin deri në mbledhjen e korrikut, pas afër tre muajsh, kur u "zgjodh" Kryesia Teknike e Përkohshme. Ky material ishte shumë i shkurtër. Aty kishte vetëm konstatime se nuk ishin të vërteta akuzat dhe se për anëtarët e Kryesisë nuk kishte as edhe një fakt se ishin të implikuar në veprimtaritë që i kishte akuzuar grupi nëpërmjet Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit (shih: raportin e komisionit të KP). Duhet thënë se këtë akuzë ishin përkrahur edhe nga Xhavit Haliti, Ozena Sylja, Jashar Salihu, Agush Buja e Bardhyl Mahmuti. Kishte anëtarë që në heshtje i pranonin. Ky qëndrim i komisionit mbi pavërtetësinë e akuzave ishte i qartë, sepse nuk kishte rrugë tjetër veç kësaj, sepse nuk kishte asnjë provë që të provonte akuzat monstruoze të grupit të tullë. Por, në çastet që kalonte organizata dhe lufta jone, të pritej 2-3 muaj për të nxjerre këto konstatime ishte me tepër se qëllimor, sepse ashtu u krijohej terreni grupeve për të vepruar pa asnjë kontroll politik, gjë që edhe ndodhi.

Për të arritur këto konsolidime të organeve, këtë dy çështjeve të mëdha i lidhen me njëfarë anëtar të quajtur Bedri Islami, të cili shumë pak e njihnin, sepse kishte jetë të shkurtër në organizatë. Përkundër kësaj, ky u përcaktua udhëheqës i të dy organeve të KP të Degës. Si udhëheqës i Kryesisë Teknike ai dhe vete organi nuk thirren fare mbledhje të KP për disa muaj dhe nuk reagueshan në korrik si organ.

Duke lënë organizatën pa KP, përkatësisht pa organe, doli nevoja për të shqyrtuar çështje të, sepse detyrat që dilnin ishin:

1. Krijimi i terrenit për anarki në kuadër të LPK-se.
2. Ndërtimi me kooptim dhe legalizimin e grupit politik në UCK-në, duke ndaluar ndërtimin e sistemit çlirimtar në FCK si formë kryesore të luftës çlirimtare.
3. Ajo krijoi terrenin për ndarjen politike e organizative të kombit tone, veç të subjektit që i takonim, pa krijuar asnjë terren për bashkim të popullit në luftë.
4. Bënte pengimin përfundimtar të komisionit të caktuar për ndërtimin e sistemit çlirimtar me bashkimin e të gjitha subjekteve organizative e ushtarake në Frontin për Çlirimin e Kosovës.
5. Hapte rrugë për çrregullim, anarki e dezorganizim të Fondit dhe Logjistikes.
6. U lejua shtruarja e terrenit për kërkesat politike të reja në terren.

Të mbështetur në këto qëllime Kryesia Teknike e (*Përhershme*) nuk thirri fare mbledhje të K.P. ndërsa, komisioni i dale nga mbledhja, nuk shkoi për të konstatuar akuzat. Në këto gjendje, jo vitem wife, pot jam i informuar se shumë anetare të ish Kryesisë, Icri më 01.06. 1998 vërtet u ishin dërguar me shkrim mendimet. Në vend që komisioni të rnerre mendimet e anetareve të apostrofuara, apo (le kishin të dhëna, deri edhe të gjithë anetareve LPK-se që ishin njohes të gjendjes, ata i shkruan mendimet me shkrim dhe is dërguan komisionit. Kjo u bë për të ndihmuar atë. Por, edhe pse u bë kështu nga anëtarët e ish-Kryesisë, Bedri Islami perseri nuk e pa të arsyeshme të verponte shpejt, po la kohë dhe krijoi terren për anarshi të talle në LPK-ne.

Mos thirrja e saj krijoi mundësi për të intervenuar. Disa here e pata ftuar Sabri Kiqmarin, Bedri Islamin, (*edhe pse këtë fundit nuk e njihja sa duhet, veç me emër si gazetar e anëtar i LPK-së*) Rrahim Ramën, etj. Nga ata kërkova të thirrej urgjentisht mbledhja e KP të Degës, duke treguar edhe shkaqet të cilat i thash me sipër. vura në dukje se ishin duke

nënshkruar shkatërrimin e LPK-se si organizate, e njohur nga programi për të ndërtuar Frontin për Kosovës. Këta me premtuan se së shpejti do të thërrisnin mbledhjen e KP të Degës, Po ajo nuk u bë (shënimet). Prandaj, vendosa të shkruaj një letër për LPK-ne. Letra ime ishte mbi 20 faqe dhe shkurtimisht theksoja elementet e rrugës neper të çilen kishte kaluar LPK-ja dhe UCK-ja deri në MP të Gjashtë të LPK-se., Dega e j.v, përkatësisht, deri më 01.06.1998. Me atë letër kërkova mbajtjen urgjente të mbledhjes së KP të Degës, për të marrë masa statusore dhe për të ecur në rrugën e programit të politik (Letra e MK më 01.06.1998). Por, as kjo nuk ndikoi tek zotërinjtë e Kryesisë Teknike (Përhershme) të Degës.

Dhe, pasi mbledhja e LPK-se nuk u ftua, në muajin qershor isha me disa shokë në Kosovë. Që atje kalova në fillim të korrikut në botën jashtme. Edhe gjatë asaj kohe mbledhja nuk u bë, duke e lënë organizatën në pasivitet. Kjo i mundësoi grupit që, të ndërtohej tërësisht, si brenda organizatës, ashtu edhe në UÇK.

Disa dite para 11 korrikut erdhi një thirrje nga Kryesia Teknike (Përkohshme) ku thuhej se mbahet mbledhja e KP të Degës në Wdrzburg, më 11 dhe 12 korrik 1998 (Thirrja e KT të Degës). Fakti thirrjen e ishte lëshuar kur çështjet ishin vendosur. Aty ishte caktuar edhe rendi i punës, një rend që provonte praktik të organizatës, pa bërë fjalë për çështjet e sistemit dhe të

bashkimit në front. Tash, në realitet, LPK-ja nuk kishte mundësi për të ndërruar asgjë. Ajo e kishte shkatërruar edhe veten si organizatë çlirimtare dhe ishte shndërruar vetëm në servis financiar dhe për asgjë tjetër. Të gjitha strukturat e saj u stërkeqen dhe e humben lidhshmërinë me organet e larta dhe ana shjelltas. Shumë prej bazave e shpallen veten inekzistente. Prandaj, ishte e qartë se duheshin kërkuar masa ndëshkuese ndaj KT-se dhe grupit të organizuar në Degë e UCK, kuptohet sipas programit dhe statutit që i kishte ende formalisht organizata jone dhe që ende vlente.

Mbledhja e KP të Degës u ftua, sipas thirrjes, për të dëgjuar raportin e grupit të posaçëm të punës dhe atë të Kryesisë së "përkohshme" të Degës, për punën dy mujore. Kështu thuhej në thirrjen e lëshuar për mbledhjen e korrikut. Aty ishte përcaktuar pika për zgjedhjen e Kryesisë së KP dhe diskutimet mbi problemet e veçanta. Pra, që në thirrje tregohet se Kryesia Teknike kishte vendosur të likuidonte LPK-ne si organizatë, derisa dilte me thirrje si Kryesi e "Përhershme", pa e zgjedhur KP. Kjo në njërin anë, ndërsa, në anën tjetër, në vend që në thirrje të shtroheshin si tema çështja e shqyrtimit të gjendjes luftarake brenda vendit, pozita e LPK-se përballë kësaj dhe mos organizimi i FÇK, etj, thirrja lëshohej për ane formale dhe për të legalizuar "Kryesinë". Këto tema ishin larguar me motivacion se në ish Dege e LPK –së edhe pse organizatë nuk kishte brenda, për të mos u futur në çështjet themelore, duke treguar se gjoja nuk kemi kompetenca. Por, kjo tregonte se KT donte të likuidonte organizatën, ndërsa në vend kishte marrë fund ndërtimi politik i grupit të UÇK-se. Vete thirrja ishte kundër organizatës, kuptohet edhe kundër sistemit çlirimtar, duke dalë tek karakteri financiar.

Ndërsa, në mbledhje të KP të Degës, Kryesia Teknike nuk paraqiti as punën e ndërtimit të Frontit për Çlirimin e Kosovës, madje komisioni i dalë nga ish KP nuk u pranua, as vete sistemi çlirimtar, sikundër as marrja e masave ndaj ish-akuzuesve, atyre bene grusht politik. dhe e likuiduan praktikisht organizatën. Nuk raportohet as për mjete financiare dhe as për logjistike, sikundër as për situatën në UCK-e. Ata nuk dhanë as llogari të punës së vet si Kryesi Teknike, e cila ishte shndërruar në të "Përkohshme", jashtë vendimit të KP që e kishte "zgjedhur" si Teknike. Në mbledhje nuk u diskutua as koha prej me se tre muajve për mos mbajtje të mbledhjes së KP të Degës j.v. (shih: *punimeve mbledhjes*). Me një mbledhje e KP të Degës mbahej për të përligjur rrugën antilëvizje dhe në heshtje, pa marrë masa statusore të kalohej dhe miratohej udhëheqja.

Duke parë këto çështje paraqita që në fillim kërkesën e shkarkimit të Kryesisë Teknike, për shkak të fakteve që i theksova dhe, kërkova të zgjidhej Kryesia e Punës së mbledhjes së KP

deri sa të zgjidhet Kryesia. Por, kjo u refuzua me motivacion se nuk duhej të shkonim kënde, sepse një pune kane për të kryer, atë të udhëheqjes së mbledhjes, gjë që e bënte qesharake vetë "kërkesën" time. Unë kërkoja dorëheqje për çështje elementare dhe programore, të atyre statusore, e, jo për formë. (*Punimet e mbledhjes së KP, korrik 1998*). Nga kjo temë u kalua në raportim mbi çështje të akuzave të paraqitura nga grupi përballë ish-Kryesisë. Kryetari i komisionit deklaroi, në përmbajtje, faktin se nuk kishte asnjë të dhënë se ndokush nga ish-anëtarët e Kryesisë, të apostrofuara, ishin përzierë në çështje të akuzuara. Atë ishin thjesht inskenime dhe asgjë me shumë. Por, kryetari nuk shkoi me tutje, d.m.th. të paraqitjes së masave ndëshkuese ndaj tyre, kuptohet sipas dokumenteve të organizatës. Ai me këto ishte shndërruar në vegël të tyre, vegël që i kishte mundur po asaj klikë që akuzonte, ndërtimin dhe marrjen e udhëheqjes së UCK-së, si dhe shkatërrimin e LPK-së. Prandaj e la çështje në mes, pa kërkesa statusore e masa ligjore ndaj autorëve.

Ajo që duhet për të theksuar është edhe raportimi i Sejdi Geges mbi punën me akuzuesit. Ai, duke folur dhe raportuar qante dhe tregonte ofendimet që i kishin bërë atij anëtarët e grupit akuzues, duke u çuditur si këta njerëz, deri dhe shokë e anëtarë të LPK-së, sot të ofendonin, shpiknin e akuzonin me gënjeshtër kaq të ashpra, edhe pse nuk e kishin as edhe të një fakt. Ai propozoi masa statusore (*Raportimi në KP*). Lidhur me këto çështje diskutuan edhe shumë anëtarë të tjerë, kush e kush kundër, duke kërkuar që çështja të mbetej pa masa, sepse ajo paska qenë një keqkuptim. Predikues kësaj ish-udhëheqja Teknike, kryesisht Bedri Islami, Bardhyl Mahmuti, Mehmet Bislimi, Agush Buja, etj., madje ky edhe ofendoi duke sharë në nënë, ata që kërkonin masa. Në mbledhje nuk ishin: Azem Sylja e Xhavit Haliti, ndërsa, Hashim Thaçi e Kadri Veseli edhe pse nuk ishin anëtarë, ishin ftuar për të marrë pjesë, por ata nuk u paraqitën në mbledhje (*Mbledhja e KP të Degës j.v. korrik 1998*).

Mirepo, tashme e kishin ndërtuar klikën, prandaj edhe nuk erdhën në mbledhje. U interesonte vetëm beshtja financiare, prandaj as çështja nuk u paraqit në mbledhje re KP të Degës, në mënyrë që edhe me tutje të kalohej në të njëjtën formë të (decentralizuar, pa kontroll dhe neper duar të dy a tre-katër vetave, duke lënë mundësi të keqpërdorimit të gjere. Kjo temë, zaten, as nuk u fut në rend të punës për shqyrtim.

Edhe këtu kërkoja të ndërmerren masa konkrete. Ato duhej të ishin të dyanshme:

1. Kundër atyre që kishin ngritur akuza pa baza, si dhe kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Azem Sylës, Adem Grabovcit, Bilal Sherifit dhe Xhavit Halitit, që e përkraken akuzën, me të vetmin qëllim që të ngrinin ndjenjat e këqija tek anëtarët e KP për të bërë grusht politik ndaj Kryesisë, vetëm e vetëm që mos të lejonin ish-Kryesinë e Degës dhe Komisionin e zgjedhur nga ish-KP në punën e vet të madhe, në atë të ndërtimit të sistemit çlirimtar në Kosovë (*FCK*), duke u mbështetur në dokumentet e LPK-së.

2. Ndaj disa anëtarëve të KP dhe grupit të punës të çilet, si sot, edhe atëherë e kishin ditur se nuk ishin akuza reale dhe, megjithatë qëndruan pas tyre, me qëllim që të Benin karriere dhe të përfitonin në sferën financiare, logjistike, etj. Këtu e apostrofova Bedri Islamin, Bardhyl Mamutin, Jashar Salihun, Agush Bujen, Mehmet Bislimin, duke mos përjashtuar edhe grupin që merrej me financa në Zvicër dhe Gjermani etj, të cilët e kishin njohur punën e Kryesisë dhe e kishin ditur se akuzat ishin gënjeshtër dhe, megjithatë ishin për këto rrugë, vetëm e vetëm (le të realizohej kjo anarki (*propozimet e MK, shënime mbi mbledhjen e KP*)).

As kjo çështje nuk u pranua në KE

Në fakt, për mua ishte e qartë gjendja në këto organ. Shumë anëtarë të KP ishin njëherësh anëtarë të klaneve të formuara, prandaj edhe votuan kundër, ndonëse kishte të painformuar dhe kundër klikave në kuadër të organizatës. Por, ata ishin shumë pakë. Në fund kërkoja që mos të shkohej kah zgjedhja e Kryesisë të K.P të Degës së LPK-së, deri sa të merreshin masa ndaj anëtarëve Kryesisë së vjetër, apo ndaj atyre që kishin akuzuar atë, organ për "tradhti". Nuk mund të zgjidheshin anëtarët në këto organ, derisa ende nuk ishin liruar ish-

anëtarët e Kryesisë nga akuzat dhe ndaj akuzuesve nuk janë marre masa statusore, duke u mbështetur ne raportin e komisionit. Duhet të merreshin masa dhe të tjerët të liroheshin per të krijuar barazinë midis anëtareve të KP dhe pastaj të shkohej kah zgjedhja e këtij organi (Kryesisë. se KP) të rëndësishëm të Degës. Ndërsa, ne kandidim dhe ne vetë zgjedhjen e ketij organi kerkova që të merreshin per bazë dhe të respektoheshin dispozitat e organizatës, si territori, vendi dhe proporcionaliteti; koha e anëtarësimit të anëtarëve ne LPK-ne, sepse kishte të tillë si Bedri Islami që nuk e plotesonte kete kriter të anetaresise, ku kerkohej tri e me shume vjet (*Programi dhe statuti i LPK-se*).

Edhe ketë çështje statutore u refuzuan. Prandaj, ne këtë moment nuk mbeti tjetër vëm të jepja doreheqjen e parevokueshme nga çdo pozite ne organet udhëheqëse të Degës se LPK-së. Dorëheqjen e dhashë me shkrim dhe tregoja se kjo është e parevokueshme. Me të tregova se KP është kundër vijës politike të LKP-se, luftës dhe Frontit të Përbashkët për Çlirimin e Kosovës (*dorëheqja e MK nga KP*). Ndërsa, shkaqet pse keshtu u veprua në kuadër të KP të Degës janë shumta, por atë mund. të përmbliidhen ne disa, të cilat e kane një qëllim, atë të mos ndërtimit të sistemit çlirimtar (FCK). Kjo ishte fitorja a humbja e forcave politike të anëtarëve të ish-Kryesisë, ishte edhe fitorja dhe humbja. e vetë bashkimit të forcave ne kuadër të sistemit çlirimtar. Janë picerish anëtarët e KP të Degës ata që votuan kundër masave statusore ne llogari të elementeve me desktruktive ne organizate, qe e bene ndarjen edhe me të ashpër në kuadër të kombit, ne emër te luftës dhe kundër tyre. Me këtë vendim u mbyll .mundësia. e një lufte mbarëkombëtare çlirimtare në Kosove.

Në kuadër të kesaj numërojmë disa shkaqe:

1. Frika nga ndërtimi i sistemit çlirimtar duke bashkuar forcat shqiptare, Si fakt qe shume prej anëtarëve të grupit politik të i dertuar dhe të KP të Degës do di. nxirrte jashtë lojës politike, pozitës ne grupin e UCK-se dhe LPK-se, si dhe nga organet e Fondit, duke bore zëvendësimin e tyre ne sistemin çlirimtar të Kosovës, pas bashkimit me forcat tjera të subjekteve politike do të bashkoheshin në sistem.

2. Fërkimet e thella dhe urrejtja e ashpër ndaj subjekteve politike shqiptare, ne emër të mosbesimit dhe, të faktit se, kur arritëm ne kete faze, nuk duhej të lejonim qe atë të shfrytëzonin subjekte të tilla, as edhe atë shtetërore.

3. Interesat e mëdha financiare të cilat ne emër të veprimtarisë logjistikës, të financimit të radheve brenda vendit, si dhe të aktivitetit ne boten e jashtme, qofte të LPK-se, qofte të veprimeve tjera per UCK-ne, duhej re' ishin të kontrolluara. Shume vetë merreshin me të, sidomos ata të logjistikës, kishin mundësi pa kontroll te Benin shpenzime, ndërkohe qe ne krahasim me formën e vjetër, kur mjetet menaxhoheshin nga Kryesia me vendim, të cilën e anuluan me punë, cdo gje ishte e centralizuar dhe llogaria duhej të jepej nga te gjithë ata qe merreshin me mjetet financiare.

4. Lufta e ashpër per pozitat ne kuadër te LPK-se, e cila nga Kryesia Teknike dhe nëndegët e saja u be e ashpër, madje edhe me akuza kriminale, si forme e mënyrë shume jonjerëzore, gjithashtu edhe banditeske per t'i likuiduar shokët, ata të çilet e kishin organizuar luftën dhe qe ishin per bashkimi e përgjithshëm të kombit shqiptar. Kjo lufte u be nen drejtimin e Kryesisë Teknike, shume anëtarë te se çiles u zgjodhën edhe ne Kryesi te KP.

5. Interesi i ndryshëm, per te mos thëne armiqësor, si dhe lodhja me forca te huaja, me atë qe nuk e donin bashkimin e vendit tonë dhe një lufte te gjere çlirimtare.

6. Vullneti i grupit .te ndërtuar te UCK-se dhe te Kryesisë Teknike, per te zhdukur LPK-ne si organizate, ne mënyre qe grupi i ndërtuar ne kuadër te UÇK-se te bënte pa pengesa punën e vet, të vepronte me mjete dhe te kryente aktivitet, ndërsa nga jashtë të veprohej veten né drejtim te mbledhjes se mjeteve, duke shndërruar LPK-ne ne servis.

Nëpërmjet organeve udhëheqëse te LPK-.se, puna per ndërtimin e Frontit per çlirimin e Kosovës u përfundua pikërisht me anën e votës se anëtarëve te rinj te KP kundër ish-Kryesisë ne KP. Te mbështetur ne këta faktorë, shumica e anëtarëve dolën ne anën e grupit,

tani te ndërtuar ne kuadër të UCK-se. Mundet ndokush te kundërshtojë, sepse gjoja ndoshta nuk kishte menduar ashtu, por kjo nuk qëndron. Anëtarët e KP te Degës, sidomos Kryesia Teknike, tash Kryesia e KP, i kane pasur te gjitha çështje t e njohura, sepse ata u informuan mbi sistemin çlirimtar (Frontin), vet patën votuar ne mars te vitit 1998 ne KP per atë. Pas këtij votimi, si kundërshpërblim, filloi ndarja e detyrave ne kuadër te Degës dhe te UCK-se. Shume prej anëtarëve te KP u bene ministra, këshilltarë, oficerë e përfaqësues ne bote (Deklarata e *Qeverise se Përkohshme te Kosovës, prill 1999*). Kjo gjendje flet qarte për vetëdijen e tyre politike ne rrugën per shkatërrimin e punes per ndërtimin e FÇK.

Ndërsa ne kuadër te Degës, kuptohet se per punën e madhe në luftën kundër ish-Kryesisë, u "zgjodh" kryetari i Kryesisë klikë ne kryetar te Kryesisë se KP, ndërsa anëtarë u "zgjodhën" Bardhyl Mahmuti, Jashar Salihu e Agush Buja. Në organ (*Kryesi të KP*) arritën te futen si forca të kundërpeshës formale juridike. Ibrahim Kelmendi, Sejdi Gega dhe Ali Ahmeti, per te treguar se akuzat te pavërteta, u futen ne Kryesi (*shënimet nga te dhënat e dëshmitareve okulare ne mbledhjen e KP te Degës, korrik 1998*). Ky kompromis i tille negativ, në fakt, shkaktoi demin me të madh ndaj luftës, sepse me këta anëtarë u luftua ashpër çështja e bashkimit te gjitha forcave ne sistemin çlirimtar, pa bere fjale per ish-anëtarët e Kryesisë, disa prej te çileve u vlerësuan nga Bedri Islami në shkrimin e tij me pseudonim te Martin Shkrelit ne "tradhtarë", gomarë", "pseudopolitikanë", etj. si formë qe tregonte tradhtinë e larte përballë vijës politike te LPK-se dhe ndaj vete 9 shokëve ish-Kryesisë se KP te këtij pseudopatritëti te Shkodres, lajkatari dhe megalomani te pa kurriz. Ky "politikolog", thjesht mbi bazën e interesit financiar, shkeli mbi programin dhe Statutin LPK-se, e shkatërroi atë (*Zëri i Kosovës, shtator 1998*).

Per punën e madhe ne luftën kundër shokëve per ndërtimin e grupit, këta anëtarë u shpërblyen edhe ne kuadër te UCK-se, kush grupin politik, kush ne fonde, kush ne logjistike e ne çështjet tjera, deri edhe ne udhëtime jashtë kontinentit, nëpër përfaqësi. Me këta persona, te përkrahur nga LBD, me vonë ndërtuan edhe organet e tjera te shtetit. Duke u vene ne shërbim të UÇK-ës, ata ndihmuan ne ndërtimin e saj, edhe pse i dinin çështje t, çrregullimet e krijuara, decentralizimin e mjeteve, si dhe shkatërrimin e luftës popullore çlirimtare. Mirepo, përballë interesave te ngushta personale, atyre karrieriste e financiare, ata i shkelen vendimet LPK-se dhe nënshkruan dështimin. Ata i kane ditur te gjitha çështjet, sikundër edhe faktin. e dalies se grupit politik, te **klikës**: Xhavit-Azem-Hashim-Kadri ne ballë. Anëtarët e KP te Degës i kane ditur dhe përjetuar vete. Per te gjitha atë qe kishin votuar ne ish-Kryesi por i shkelen per interesa të ngushta karrieriste, financiare.

KP i Degës tash doli kundër vetvetes. Me vetëdije te plotë anëtarët e këtij organ u vunë ne shërbim të klikës. Është vete KP që e dertoi përtej mase luftën per çlirimin e vendit tone, duke përkrahur klikën e cila ishte kundër bashkimit të forcave, .mjeteve e energjive te kombit ne organizëm te përbashkët çlirimtar. Ketë veprimtari vazhdoi ky grup i ndërtuar, tani. brenda -UCK-se dhe jashtë vendit, ne kuadër te Degës se LPK-se, edhe pas kesaj periudhe.

Veprimtaria kryesore nuk ishte .vetëm e drejtuar kah zhdukja si organizate, por kah shndërrimi i saj ne një subjekt të varur politiko-juridik., krahas rrëmbimit te pozitave udhëheqëse në UÇK. Ne fakt, ketu ishte edhe qëllimi kryesor i klike, e cila e filloi luftën per likuidimin e shokëve dhe per rrëzimin e ish-Kryesisë se Degës ne format me kriminale. Pa kete veprimtari likuiduese, duke u mbështetur ne bazën politike që kishte ky organ, klika nuk fitonte.

Mirepo, që para MP të LPK-se patëm thënë se, në kadet te LPK-se që udhëhiqte "UCK-ne, ishin krijuar dy grupe, te cilat ishin ne fërkime e .kundërthënie mes tyre, pot që u bashkuan per te ndaluar kryesisht aktivitetin per bashkimin e te gjitha forcave te popullit tone ne Front. Kjo lufte i bashkoi ato dy grupe ne një klike unike dhe, natyrisht, se bashku bene kompromise te ndryshme te cilat u drejtuan kundër Organizatës dhe krahas kesaj, kooptuan

organe dhe vendosen ne të anëtarët e klikave, pa shikuar aftësitë e tyre profesionale per te drejtuar ne sferat e larta ne një situatë luftë.

Por deri ne krijimin e një klike kishim këto dy grupe:

1. Grupi i Xhavit Halitit,
2. Grupi i Azem Sylës.

Këto dy grupe benë vendosjen e anëtarëve të KP në punë ndryshme te UÇK-se e LPK-se, si shpërblim per mbrojtjen e dhënë ne aspektin politik.. Disa i vendosen ne Kryesi te Degës, per çka bëmë fjale me sipër, te tjerët ne sferat te veprimtarisë se tyre, si ne logjistike, përfaqësim politik, shtetëror, etj.

Mirepo, per te korrur sukses, ketë dy grupe bene edhe kompromis. Prandaj, ne marrëveshje midis këtyre dy personave, të çilet ishin udhëheqës kryesore të UCK-se, kuptohet pas grusht politik mbi Kryesine e Degës, mbeten këta dy vetë. Këta vazhduan punës me emërime. Pas majit-qershorit e priste emërimin e vete Bardhyl Mahmuti, Adem Grabovci, Agush Buja, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jashar Salihu, Bedri Islami, Mehmet Bislimi, etj. Këta, herë kalonin kah njeri e here kah grupi tjetër. Ne kete kohe vazhdoi kooptimi i anëtarëve per Shtabin Qendror,, me vone Shtab Përgjithshëm. Krahas "konsolidimit" te kesaj udhëheqjeje, po punohej per daljen me grupin e përfaqësuesve te drejtorive e te sektorëve te ndryshëm te UCK-se.

Ky "konsolidim" i grupeve te udhëhequra nga, këta dy anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, ish anëtarë të Kryesisë, tani luftëtarë për zhdukjen e LPK-se, çoi deri tek kompromisi midis tyre dhe emërimi i anëtarëve ne Shtab. Në kete kohe (qershor) 1998 del zëdhënësi Jakup Krasniqi, i cili ishte shok i Azem Sylës, dhe e kishte organizuar ne UCK-ë. Në periudhën qe po flasim me ndikimin e Hashim Thaçit, qe ishte here me njërin dhe here kalonte te grupi tjetër, kalon nga Prishtina ne Drenicë dhe behet anëtar i Shtabit te Përgjithshëm Ramë Buja. Përveç këtyre, thuhej se anëtarë ishin edhe Azem Sylë, Xhavit Haliti, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli. Të dhëna të tilla dolën në rrugët e Tiranës (*dëshmitë e dëshmitarëve korrik 1998*).

Kooptimi i anëtarëve sipas lidhjeve dhe sheshimeve ndaj grupeve ne udhëheqje të UCK-se, e dobësoi përtej mase luftën çlirimtare. Grupet, kuptohet duke bërë marrëveshje midis veti, arritën kompromise. Ajo solli edhe tek marrëveshjet e tjera. Këto dy grupime politike arritën formalisht te bashkoheshin ne një, duke bere kompromise edhe ne fusha te tjera të organeve udhëheqëse te UÇK-se, në mënyrë qe te zhduknin ish-udhëheqjen e LPK-se.

Është vete Xhavit Haliti ai qe e futi përfaqësues te përgjithshëm të UÇK-së Adem Demaçin. Zaten kjo kishte qene kërkesë e tij e kamotshme, por ne atë kohe, Kryesia kishte mendime e qëndrime tjera. Ndërsa, ne kohen që po flasim, pas majit 1998, u bashkua me idenë e tillë edhe Azem Sylë, një nder kundërshtarët kryesorë të Adem Demaçit. Por, tash kemi kompromise. Futet Ademi si përfaqësues politik i përgjithshëm, si kundërpeshë caktohet Jakup Krasniqi e Bardhyl Mahmuti, duke bere dhe Hashim Thaçi e Xhavit Haliti ne kete përfaqësi. Ndërsa, në aspektin e përfaqësisë territoriale e futën Faton Mehmetin. Midis tyre u ndanë edhe detyrat dhe u caktua hierarkia. Atë te përfaqësuesit gjeneral e mori .Adem Demaçi, me ndihmës Jakup Krasniqin, ndërsa përfaqësues ne boten e jashtme u caktua Bardhyl Mahmuti, te cilit me vone iu bashkëngjitën edhe anëtarët tjerë te Kryesisë dhe te KP te LPK-se, si Mehmet Bislimi, Ramadan Avdiu, Agush Buja, Sabri Kicmari etj. (*Vendimi i Shtabit Përgjithshëm te UCK-se*).

Me këto emërime ne fakt u be ndërtimi i tërësishëm i strukturës udhëheqëse të Shtabit te Përgjithshëm dhe bazës politike (**bërthamës se Hashimit, Xhavit, Azemit e Kadriut**), kesaj bërthame politike qe doli ne balle te UÇK-se. Mbi te do te ndërtohen edhe organet e tjera. Tani udhëheqës i kesaj bërthame u caktua nga Xhavit Haliti, Azem Sylë, etj. Hashim Thaçi, me qellim qe të largonin nga vetja veprimtarinë armiqësore, tejet te dëmshme per çlirimin e

vendit. Ata e kishin arritur qëllimin politik, zhdukjen e bazës për bashkimin e popullit në Front, prandaj tamam siç thotë populli: "ia lamë këmbët e arushës në dorë Hashim Thaçit". Por, sikurse në tërësi, edhe kjo ka arsye të vet, faktin se edhe në sferat tjera, i kishin arritur qëllimet e veta.

Pas ndërtimit të tillë politik, Jashar Salihu u caktua kryetari i Fondit në fondin "Vendlindja Thërret", duke nxjerrë të tjerë vartës lehtë nën fonde. Me vone e ndajnë Fondin nga LPK-ja dhe e futën tërësi nën kontrollin e drejtorisë Financiare të UÇK-se, përkatësisht të Jashar Salihut, duke bërë edhe zëvendësime adekuate. Ndërsa, me vone e vendosën në tërësi nën kontroll të grupit.

Klika që u ndërtua ishte kompetente edhe për forcat ushtarake. Kështu, këtij grupi iu bashkua në maj edhe grupi i ushtarakeve (oficerëve), diku shtate sa ishin, të udhëhequr nga Bislim Zyrapit. Megjithatë ky dhe oficeret e tij nuk ishin nën ndikimin e tyre, ata pranuan, sepse në frontin e luftës kishte jashtëzakonisht dobësi. Dhe, pavarësisht se si erdhi deri të kjo lidhshmëri, kam mendimin se hyrja e këtij grupi të oficerëve ishte jashtëzakonisht e qëlluar. UÇK-së i duheshin forcat ushtarake, njerëzit e kalibrit të Bislim Zyrapit, Naim Malokut, Fadil Demirit, etj. Por, ja, se shumë pak lejoheshin për t'u futur në radhët e UÇK-se, përveç atyre që e kishin vizën e tyre, të çilet me vone edhe u futën në Shtab Operativ, ca prej tyre edhe në SHQ. Edhe këta që u dërguan, nuk u vendosën në organe udhëheqëse, aty ku bëhej planifikimi i operacioneve, organizimi i radhëve, komandimi, etj, përveç në disa vende pa kompetenca, jo në radhët e UÇK-se.

Kështu, sipas logjikës së grupit, pati përfunduar ndërtimi politik-ushtarak dhe juridik i UÇK-se. Lypsej vetëm ndihma financiare, në mënyrë që të çliroheshim.

Pas ndërtimit të tillë Xhavit Haliti deklaroi në Tiranë:

"Azem Syla dhe unë jemi ata që vendosim në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm (...). Askush nuk mund të largohet, afrohet dhe behet anëtar pa mendimet e ne të dyve. Prandaj, Muhamet, shko me mirë tek Azem Syla se ai të respekton, por duhet që të nënshtrohesh në formë ndaj tij, edhe nëse nuk e do, sepse ti e njeh atë se çfarë dobësie ka, e di si punon. etj, në mënyrë që kur të propozojë, të futesh anëtar i Shtabit (...)" (*Deklarata e Xhavit Halitit, shtator 1998 në Tiranë*).

Kjo thënie, mua si ish udhëheqës i Kryesisë, më bëri të qartë se në çfarë pozite të mjere gjendej kjo udhëheqje e UÇK-se. Me vinte shumë keq për luftëtarët e UÇK-se, për luftëtarët në terren dhe për popullin tone të vuajtur, i cili pa llogaritur fare, u bashkua me luftën dhe dha jetën, shtëpinë e familjen, dha çdo gjë që kishte. E, këta, ishin ata që e kapën për fyti këtë luftë dhe po e pëlcisnin në interesat e ngushta karrieriste.

- Jo i thash - Xhavit. Nuk është fjala këtu për mua apo ndonjë ish shokun. tone të Kryesisë, me të cilët kemi punuar së bashku në organizimin dhe ndërtimin e kësaj ushtrie, por për luftëtar tone, për Kosovën dhe popullin shqiptar, të cilëve ju jeni duke ua krijuar fatkeqësinë. Ti e di, se kështu, sikundër po ecet, me ju në balle, nuk mend të bëjmë rezistencë dhe të fitojmë kundër armikut e çlirojmë Kosovën, sepse jemi të dobët dhe shumë forca, qofte politike, qofte organizative, qofte ushtarake, janë të ndara nga lufta. Kosovës dhe popullit tone i duhet bashkimi, prandaj duhet menjëherë të kalosh, nëse e do ti dhe Azem Syla çlirimin e vendit, në punë për bashkimin e të gjitha forcave tona në një subjekt unik, në mënyrë që të behet bashkimi politik e organizativ, ai ushtarak, sepse vetëm në këtë mënyrë e fusim tere popullin në lëvizje. Kështu lufta jone fiton peshë dhe merr karakter shtetëror (*Ditari i MK*),

Ky diskutim nuk ndikoi fare.

Pas dorëheqjes sime dhe fitores përfundimtare të grupit, u bë legalizim i organeve dhe personave udhëheqës të UÇK-se. Euforia e kishte kapluar tere këte organizëm.. Në fakt, ishin këta dy-tre superpolitikanë, që e kishin marrë fatin e Kosovës në dorë.

As gjate ofensivave te mëdha te okupatorit, ku tregohej domosdoshmëria e rindërtimit te organeve udhëheqëse te UCK-se, nuk u be. I takon këtyre te japin llogari.

c) Shkelja përfundimtare e luftës çlirimtare mbi bazat e sistemit çlirimtar (Frontit)

Forcat politike legale dhe qeveria u pa se ishin kundër sistemit. Kësaj, iu shtua edhe një force tjetër, doli edhe një grup politik i ri, deri atëherë i panjohur ne hapësirën politike shqiptare. Ky grup, i mbështetur ne idenë per te dalë ne ballë të kombit, duke i shfrytëzuar bufen e popullit tone e ndërtoi sistemin e vet jashtë çdo rregulli, prej nga e luftoi bashkimin e popullit ne sistem çlirimtar.

Mirepo, ne kushtet e gjendjes se krijuar dhe te intensifikimit veprimtarisë shkatërruese nga forcat ushtarake, paraushtarake serbe ishte e domosdoshme qe te arrihej bashkimi i forcave politike, i te gjitha subjekteve shqiptare. Duhej qe forcat politike legale, Qeveria e Bukoshit, Kuvendi, organizatat, duke përfshirë, edhe UCK-ne, te bënin gjithçka per te mos lejuar ndarjen e armës nga organizimi politik, përkatësisht e UCK-se nga subjektet tjera, cilat duhej te bashkoheshin ne sistem unik çlirimtar. Por, ne vend te kesaj pune te madhe, u be ndarja. Tani, përveç partive politike ekzistuese, u nda dhe u ndërtua një klike e re politike, aspak me progresive se ajo legale. Ajo qe po vepronte ne emër te UÇK-se ishte tamam si çdo subjekt tjetër, ne anën e mosndërtimit të Frontit tone çlirimtar, ne anën e ndarjes ne emër te bashkimit . Kjo politike u ndërtua juridikisht, duke mohuar çdo subjekt, politikan, deri edhe ish-udhëheqësit te LPK-se, përveç vartësve le tyre. Edhe vete puna per te dale ne skenën politike dhe per te krijuar ne opinion emër, karriere politike, si dhe per te arritur çoi deri tek zhdukja e idesë per Front.

Per këtë interesa te ngushta, ky grup hyri ne bashkëpunim dhe u lidh me subjekte antiçlirimtare. Ndërsa, per te arritur qëllimin, klika, se pari, veproi kundër ish-Kryesisë se KP te Degës e cila e mbështetur ne programin e vet dhe ne vendimet qe dolën nga mbledhjet e shumta te kësaj organizate, ishte duke punuar per bashkimin e forcave politike, juridike e ushtarake shqiptare, tërë popullit tone ne lufte, per te ndërtuar Frontin. Se dyti, ata vepruan kundër subjekteve te tjera politike shqiptare, jo aq per t'i dëmtuar atë, sepse me atë (Kupto LBD) veç bashkëpunonin dhe vepronin ne lidhje te ngushte politike e. individualiste, por per aq sa forcave politike te UCK-se iu nevojiti per te dale si subjekt i veçante politik ne kuadër te forcave tjera legale vendore ne Kosove, si grup politik i pavarur, jashtë çdo organizmi politik, ne mënyrë qe te bashkëpunonin me atë ne fund. Se treti, u veprua ne ndërtimin e sistemit financiar të pavarur, i cili ishte i domosdoshëm pas ndërtimit te sistemit te pavarur politik e ushtarak. Duke u përpjekur keshtu per dalluar si force supreme, dolën ne skenën politike me një mishmash kërkesash politike.

Dalja me subjekt politik e juridiko-ushtarak e likuidoi ne tërësi punën per krijimin e sistemit çlirimtar mbi bazat e shtetit duke ndërtuar Frontin per Çlirimin e Kosovës. Ky organizim i ri i këtij subjekti zgjati jetën politike te forcave legale ne Kosove, si te partive, ashtu edhe te Qeverise se Bukoshit, sepse ne vend te bashkimit, ndodhi edhe një ndarje e re, shume me e ashpër përballë forcave shqiptare. Kjo u mundësoi forcave legale ekzistencën politike, madje pa asnjë vështirësi. Është pikërisht kjo force qe u shfrytëzua nga legalitet per ekzistencën e vet, sepse ne të kundërtën, ata do te ishin te detyruar te bashkoheshin ne sistem çlirimtar (FCK) duke i vene ne shërbim te luftës te tera forcat e veta politike, materiale e njerëzore. Por, u veprua ndryshe, ne skenën politike doli një subjekt i ri, grupi i UCK-se si force tjetër politike, juridike e ushtarake. Ky grup u legalizua politikisht, duke vetëshpallur i pavarur dhe me përfaqësues te vete politike, diplomatike e shoqërore; jashtë interesit vital, te ndërtimit te sistemit unik çlirimtar, si forme moderne e luftes çlirimtare. Ai u fut ne luften me subjektet politike, duke dale jashte cdo rregulli te luftes.

Kjo eshte armiqesore! Pse?

Dihet se eshte pikerisht teoria dhe praktika e ltitferave ne bote e cila na meson se, duhet te ecim vetem me sistem ne luften clirimtare. Me këtë nuk dal kundër organizmave politike te UCK-se, sepse edhe organizimin politik ne ushtri e përkrahu, por vetëm nen organizimin shtetëror, pra, idetë politike qe dalin dhe ndërtohen mbi Kushtetutën e shtetit dhe ligjet tjera shtetërore, e jo jashtë sistemit çlirimtar ne Front. Çdo organizim tjetër, qofte partiak, qoftë organizativ, qofte ushtarak qe nuk e ka bazën politike shtetërore per organizmin luftarak, është i dëmshëm dhe shume miqësor. Ai vetëm Ben ndarjen e forcave çlirimtare, sepse pa organizmin e sistemit nuk ka mundësi të shihen dhe zgjerohen radhët e luftës tek çdo shtrese e popullit, ne qytet e fshat dhe te dalim si një trup para botes.

Pikërisht, kjo u luftua. Ne Kosove nuk u ndërtua sistemi politik e juridik shtetëror, duke bere bashkimin e çdo subjekti, si baze e bashkimit te tete kombit, por kemi veprimtari te një grupi i cili imponoi vullnetin e vet kesaj force madhore e ushtarake te kombit shqiptar. Ky organizim politik ne UCK, e dëmtoi frontin e luftës terren kundër armikut tone shekullor, sepse nuk u be as bashkimi i tete kombit, as i mjeteve dhe as i forcave tona njerëzore materiale te cilat ishin jashtëzakonisht te mëdha. Përkundrazi, me kete grup te ri politik, sikurse me partitë politike, mbeten jashtë UCK-se qytete, krahina e masa të gjera te popullit, pa u organizuar. Askush nuk ishte kunder organizimit politik plural neper parti ne kushtet normale, sepse vet sistemi plural i ndërtimit jetës se vendit e nënkupton kete loje politike. Por, ne kushtet e luftës se gjere popullore, si dhe kur dihet aftësia goditëse e armikut, ky mosbashkim ne sistem çlirimtar (UCK), është me tepër se armiqësor, sepse populli nuk organizohej i tëri. Pa kete organizim, ai nuk kishte mundësi te vepronte me sukses ushtarakisht, te armatosej dhe as qe kishte mundësi te mbrohej, pa bere fjalë per çlirimin e vendit. Dhe, duke mos vepruar mbi kete baze te sistemit çlirimtar, mbeten qytetet te tera shqiptare pa asnjë njësi çlirimtare, thjesht nen mëshirën e okupatorit, pa pasur forca të veta luftarake. Kjo u krijoi terren forcave serbe per dhune e masakra, dëbime e përdhunime të mëdha.

Kështu qëndron termet per kombin tone.

Forcat politike e ushtarake ne Kosove dolën kundër çdo rregulli te njohur per lufte apo ne gjendje lufte. Keshtu ndodhi pikërisht kur kërkohet mobilizimi dhe bashkimi i te gjitha forcave ne një sistem unik, vënia ne shërbim te saj e subjektit, pasurisë, deri edhe e jetës, sepse lufta kërkon bashkimin e tërësishëm ne një subjekt çlirimtar, e jo ndarjen. Mirëpo, duke mos e pasur kete organizim ne Frontin Çlirimtar te Kosovës, nuk u arrit të mbrohej një pjese e madhe e popullit, per të mos thënë mbi 60-70% e popullsisë shqiptare, ne kushtet e renda mbeti e paorganizuar dhe pa udhëheqjen e vet, politike, organizative, e ushtarake. Ajo u la nen mëshirën e fatit e të serbeve.

Ndërsa, duke ndërtuar një grup të tille, jashtë sistemit, veç subjekteve politike legale te qeverise, Kosovës iu krijua një gjendje tjetër e rende. Ajo karakterizohej:

1. Nga mosbashkimi i forcave shqiptare ne tërësi, pa dallim moshe, gjinie e lokaliteti, vendi dhe përkatësie politike, subjekti a shtrese shoqërore e sociale.

2. Nga ndarja organizative, e ku nuk u arrit as bashkimi i kërkesave politike e juridike, sikundër dhe atyre shoqërore përballë subjekteve vendore ne bote, sepse u ndanë dhe me tej sipas subjekteve, deri sa u nënshkrua Marrëveshja per autonominë substanciale ne Jugosllavi, mbi te cilën u arrit edhe vendosja e paqes ne Kosove.

3. Nga mosbashkimi i mjeteve materiale dhe atyre financiare kombit shqiptar, gjë qe e dobësoi furnizimin e forcave luftarake me arme te reja, me arme qe mund te realizonin rezistence kundër hordhive fashiste serbe.

4. Nga ndarja edhe me e thelle e kombit neper subjekte e organizma, deri sa u detyruan nen presion te bënin marrëveshje formale per pushtet, e jo per ndërtimin e sistemit çlirimtar, prej nga doli edhe një Qeveri tjetër e Kosovës, ajo e quajtur e përkohshme.

5. Me ndarjen politike e ushtarake iu krijuan kombit tone na te gjëma, sepse mbeti pa organizim unik ne sistemin çlirimtar dhe mbrojtje te përgjithshme, prej nga arritën hordhitë shoviniste e banditeske serbe te bënë shkaterrime ne mase, duke masakruar e përdhunuar e duke dëbuar mbi **(1) një milion** veta.

Këto fakte flasin se është papërgjegjësi totale politike, shoqërore e kombëtare, e te gjitha forcave politike per gjendjen krijua ne sferën organizative, politike e ushtarake ne Kosove. Jam krejtësisht i bindur se, forcat politike e ushtarake, shtetërore e organizativ atë forca qe e udhëhiqnin jetën politike dhe ushtarake në vend, i kane bërë një dem te madh kombit tone ne luftën çlirimtare. E tërë armiqësia është tek mosndertimi unik i luftës çlirimtare, një lufte ku populli do te ishte i organizuar politikisht ushtarakisht në sistem dhe ku, dëmet dhe pasojat ne njerëz do të ishin me te vogla, ndonëse ne lufte atë bënë te pakalueshme.

Tash me se miri u pa se parse nuk u ndërtua sistemi çlirimtar në Kosovë. Arsyeja qëndron thjesht tek karrizmi, interesat ndryshme pa i përjashtuar edhe atë financiare, te cilat ndikuan te mos kryhet bashkimi, por ndarja. Kjo d.m.th se ushtarake dhe atë shtetërore u pajtuan per pushtet, duke ndërtuar qeverinë e koalicionit te përkohshëm, pot nuk u pajtuan per sistem çlirimtar. Bashkimi ne sistem çlirimtar nuk u arrit nga etja per pushtet. Fete e dëshmon qarte bashkimi per pushtet midis subjekteve ne Paris, nga doli qeveria e re! Shtrohet pyetja: - a ka pasur mundësi qe forcat shqiptare të bashkoheshin dhe te realizonin bashkimin tone kombëtar ne sistem çlirimtar, forme kjo e vetme per te organizuar tere popullin ne lufte çlirimtare?! Veprimi i këtillë pa fije dyshimi do te ishte me i përshtatshëm dhe shume me i suksesshëm ne lufte, sepse populli do te ishte me i bashkuar dhe, rezistenca do të ishte shume me e larte. A ka fakte me te qarta se ketë? Unë kam mendim se jo.

REZYME

I shtjellova ketë çështje per te shqyrtuar dhe per te treguar pikërisht gjendjen aktuale te cilën po kalon populli shqiptar i Kosovës. Por, këtu është shqyrtuar çështja (lëvizja jone çlirimtare) deri ne maj-qershor 1998, sepse deri ne atë kohë isha ne udhëheqje.

Per kohen ne vijim si dhe, per te mos ardhur deri tek kjo gjendje kaq e rendë, (*ndonëse ne lufte edhe vrasje, sharrime e dëme te mëdha ka; dëbime e përdhunime masovike, djegie etj.*) ishte përpjekja e forcave tona përparimtare ne UÇK-e dhe LPK-e per te ndërtuar një sistem unik çlirimtar ne FÇK. Kjo per faktin se shume më me sukses do të mbrohej kombi ynë, territori dhe familja shqiptare. Natyrisht, me sistem do te realizoheshin aspiratat e popullit me mire, se sa kur ka ndarje, konflikte e fërkime te ashpra. Edhe ne bote do te kishim peshë më të madhe.

Dihet se dhuna e terrori., masakrimet e shkatërrimet e mëdha, deri edhe dëbimet nuk do te ndaleshin, sa kohe qe populli ynë do të luftonte, por me sistemin e ndërtuar politik e juridiko-ushtarak ato do te kishin një tjetër intensitet, shume me te vogël. Theksova se dhuna nuk do te ndalej, sepse armiku me tendenca per te zhdukur popullin tone me brutalitet fashistë-terroriste dhe me një gjenocid te papare kanibalist kundër popullit tone paqedashës, mirëpo ato masa shkatërruese do te ishin me te vogla dhe lufta jone çlirimtare do te ishte shume me efikase, me e gjere dhe me një pjesëmarrje masive, ne qytet e fshat, kudo ku jetonte kombi ynë, duke mbrojtur veten. Por, duke mos vepruar keshtu, populli ynë përjetoj një dhune e terror te papare ne historinë tone kombëtare. Populli ynë tregoi një heroizëm te larte dhe një sakrifice te pashoqe.

Çështja ketu është trajtuar ne anon programore e cila tregon elementet e një lufte unike te zhvilluar nëpërmjet sistemit unik qe duhej te ishte plotësuar, ne mënyrë qe beshtja jone ne front te ishte shume me e avancuar se sa populli ynë kaloi ne kohen deri ne qershor 1999. Kam mendimin, se edhe pasojat, si ne njerëz, ashtu edhe ne pasurinë e tundshme e te

patundshme, do te ishin me te vogla. Mund te kritikohen se kjo nuk qëndron. Mirëpo gjendja aktuale tregon pozitën që e kemi. Mbi 70-80% e popullit ishte e pa organizuar, sikundër ishte edhe pjesa me e madhe e territorit. Vete ky fakt shpie drejt dokumentimit të faktit të shkeljes së rregullave me elementare të luftës çlirimtar, sikundër është ndërtimi i Frontit unik Çlirimtar në Kosovë. Kjo bëri ndarjen e forcave dhe krijoi terren për spastrime masive të vendit, duke vrarë e masakruar me qindra e mijëra vete, fëmijë e gra, pleq e plaka, pjesa masive shqiptare që nuk ishte në gjendje për t'u mbrojtur nga hordhitë gjakatare serbe. Ky fakt, tani i vënë në pyetje tregon dobësitë e mëdha në organizimin politik, juridik, shtetëror e ushtarak në Kosovë.

Duke e refuzuar me forcë ndërtimin e Frontit për Çlirimin e Kosovës, bazën politike, atë të LPK-së, shokët e saj dhe bartësit e tërë aktivitetit çlirimtar, nuk u arrit në Kosovë të ndërtohej një luftë e përgjithshme popullore; çlirimtare mbi bazën e sistemit unikal shtetëror. Prej këtej, mund të konkludojmë:

1. Në aspektin politik nuk u arrit bashkimi i faktorit politik. Ai mbeti i ndarë në parti e organizata, pa u bashkuar në një sistem unik çlirimtar, sikundër është forma e Këshillit Kombëtar të Kosovës, si formë e tabanit për ndërtimin e Frontit, kur vendi gjendet në luftë.

2. Duke mos e ndërtuar një organ të tillë politik, u ndërtua edhe një qeveri, përveç asaj ekzistuese, duke u mbështetur në marrëveshjen midis subjekteve që morën pjesë në Rambuje, prej nga doli Qeveria e Përkohshme e luftës, formë kjo e njëjtte si me herët në sferën juridike, jashtë interesit të kombit për ndërtimin e sistemit unik çlirimtar, duke ndërtuar Këshillin Kombëtar të Kosovës si bërthamë kryesore e Frontit.

3. U bë ndarja dhe me e thellë e forcave politike e organizative shqiptare në organizma, duke dalë pro a kundër formës juridike të ndërtimit të shtetit, e cila krijoi ndarje edhe me të thella midis dy subjekteve të kombit tone.

4. Populli ynë nuk arriti të organizohej në njësitë e armatosura sepse nuk u bë bashkimi në sistem (Front), si baze e fortë ndërtimit të luftës çlirimtare kudo në vend. Duke mos vepruar u krijuan lehtësira të mëdha për forcat e armikut, që ato pa vështirësi bënin masakrime në masë, dëbime masive etj, pa qene në gjendje populli ynë të bënte rezistencën e duhur.

5. Duke mos e organizuar popullin tone paraprakisht në një Front Çlirimtar, nuk arritëm të ndërtojmë luftën çlirimtare, prej nga nuk arritëm jo vetëm të mbrojmë popullin, por as të çlirojmë territorin tone.

6. Nëpërmjet dobësive të tilla nuk ishim në shqiptaret ata që caktuam pozitën e Kosovës, por forcat e NATO-s dhe SHBA-ja, si dhe shtetet e tjera, të cilat u futën në luftë ajrore kundër shtetit fashist Serb. Me këtë edhe pozita jonë varet nga qëndrimet e tyre, nga lufta që po e zhvillonte aleanca kundër Beogradit.

7. Mbi këtë baze erdhi dhe u përcaktua edhe pozita politike e juridike-shoqërore e Kosovës në Jugosllavi. Ajo është mos ndryshimi i kufijve shtetërorë, por gjetja e një zgjidhjeje për Kosovën brenda atij territori, duke vendosur ndoshta protektoratin, nëse nga ai nuk do të vije ndarja, copëtimi i saj.

U mundova t'i qartësoj këtë çështje për të kuptuar një fakt, atë të mos ndërtimit të Frontit si baze e sistemit shtetëror unik, në mënyrë që në shqiptaret të ishim në pozite shumë me të favorizuar, duke shfrytëzuar aleancën e krijuar në bote kundër regjimit fashist të Beogradit. Kjo aleancë kishte mbetur në vend dhe shqiptaret shumë pak, për të mos thënë fare, nuk e kanë shfrytëzuar. E kjo vjen kryesisht nga mosuniteti politik, juridik, shtetëror dhe ushtarak i kombit. Shume me mirë dhe me siguri gjendja do të ishte me e fortë me sistem. Por, ja që interesat e ngushta, të natyrës së dobët dhe të politikaneve me virtyte të ulëta, e ndaluan punën e madhe, atë të ndërtimit të sistemit unik shtetëror. Në emër, gjoja të luftës,

gjakut e te çlirimit te vendit, u shkatërrua çdo iniciative per ndërtimin e një lufte te përgjithshme çlirimtare ne Kosove.

Edhe pas bombardimeve të ashpra 10 javore nga NATO te bazave ushtarake serbo-jugosllave, re komunikacionit e telekomunikacionit, te tere sistemit luftarak te Jugosllavisë se mbetur, nuk arritëm te futemi si komb dhe territor, subjekt politik e shtetëror me force dhe me peshe ne qendrat ndërkombëtare te vendosjes. Kosova doli dhe nga kjo marrëveshje e G-8, te NATO-s, tek UE, ne OKB-ne etj, përballë serbojugosllavisë me te drejta autonome, si pjese e Jugosllavisë. Dallimi i vetëm per Kosovën është: demilitarizimi i Kosovës nga forcat serbe, futja e forcave ushtarake të NATO-s, etj, si dhe te ruseve, nen flamurin e OKB-se ne Kosove. Ndoshta protektorati dhe vetadministrimi, sjell rrezik të ndarjes se vendit, pikërisht pse ruset po marrin pjese. Ndërsa, ne sferën politike e juridike u përcaktua autonomia substanciale nen Jugosllavi, me te drejtën per zgjedhje te lira e per vetadministrim lokal te saj.

Vete kjo gjendje e Kosovës përballë vetes dhe botës, kuptohet me sistem çlirimtar do te ishte tjetër, shume me pozitive. Ne një rën ane, me sistem unik ne Kosove do te kishin një tjetër gjendje politike e juridike, mundet edhe ushtarake, sepse ashtu do te kishim arritur çlirimin e shume viseve, ne mos me shume dhe gjysmën e territorit tone. Me unitetin tone ne Front, kombi ynë do të ishte me unik dhe shume me i. forte kundruall armiqve tanë ne vend. Ndërsa, ne anën tjetër, vet beshtja kombëtare do të kishte përfundim tjetër ne bote, përballë qendrave te vendosjes, sepse pesha jone do të ishte me e madhe, prej nga edhe per vendime do te konsultohet shteti i Kosovës. Prandaj kur merren dhe shqyrtohen këto së bashku del:

- Së pari, bashkimi i kombit tonë duhej të ishte unik dhe i përgjithshëm, me mekanizma të aftë ushtarakë dhe politik, pa dallim partie e organizate, vendi a ideje politike, po vetëm mbi bazën kombëtare ai do të unifikohet në institucione të luftës sonë të madhe.

- Së dyti, nëpërmjet bashkimit te tillë do te realizohet edhe uniteti politik ne kërkesa, si dhe ai juridik e organizativ i shtetit tonë të pushtuar, duke ndërtuar sistemin çlirimtar: Frontin çlirimtar të Kosovës, si baze e vetme e shtetit te Kosovës ne lufte.

Së treti, me këtë dy heshtje do te intensifikohet lufta çlirimtare dhe mbrojtja e popullit tone ne qytete e fshatra, kudo ne hapësire në kohë, do te ishte kombi shume me i organizuar dhe shume me i fortë, sikundër edhe dëbimi qe do ishte me i vogël, ashtu si dhe masat e dhunës, vrasjet e përdhunimet, masakrat, shkatërrimet, pa pretenduar se do te ndaleshin atë ne çfarëdo lloj organizimi te luftës. Por, me siguri, sistemi unik çlirimtar do te na ndihmonte te vendosnim nen kontroll vise te shumta të Kosovës.

- Se katërti, mbi kete lufte te kombit tone do te kishim peshë më të larte si komb ne vendimet politike te aleancës përballë çështjes sonë, jo vetëm duke e respektuar vullnetin e kombit ne bisedime me palën pushtuese, por edhe duke i bere shqiptaret të barabarte me organizmat vendore ne UE, ne NATO, ne OKB-ne, pranë shteteve, etj.

- Se pesti, kishte mundësi per t'u sanksionuar e drejta per vetëvendosje deri ne shkëputje te Kosovës me akt ndërkombëtar. Ky akt do te sanksionohet pas organizimit të vendit ne protektorat nëse nuk realizohet pavarësia e Kosovës ne politike, sferën juridike e territoriale, me akte ndërkombëtare do te sanksionohet referendumi.

Këto janë faktet qe bien si bumerang mbi forcat politike, organizative-luftarake e shtetërore të kombit. Nga kjo nuk përjashtohet askush. Me kete organizim politik e ushtarak nuk arritën ne Kosove. Por, përkundrazi, e luftuam, duke bërë ndarje midis politikës, armës, organizimit e popullit. Çdokush po vepron ne emër të kombit per llogari të vet. Kjo është e dëmshme, sepse populli i ynë e do lirinë e tij. Atë, ai e tregoi gjate dhjetëvjeçarit të fundit, sidomos ne muajt e pare të këtij viti. Populli ynë, pa pare vështirësitë u lidh i teri pas pavarësisë se vendit. Pikërisht ketu nuk pati force per ta tërhequr ne luftën e madhe. Ai mbeti nen breshrin e dhunës terroriste të çizmes çetnike serbe.

Kjo nuk i falet askujt.